

Gjuhë shqipe 9

Gjuhë shqipe 9



Gjuhë shqipe 9

Prof.dr. Mimoza Gjokutaj
Prof.as.dr. Flora Koleci

Prof.as.dr. Anila Mullahi
Tereza Babasuli

GJUHA SHQIPE 9

Për klasën e nëntë të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2022

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: Prof. Sejdi GASHI, Vesel ISLAMI,
Gyltene SELIMI
Redaktore: Aida BARO, Brunilda MENO
Korrektor: Arlon LIKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN:

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, qershor 2022
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Teksti *Gjuha shqipe 9* mbështetet në kërkesat dhe kriteret e caktuara nga programi i lëndës së Gjuhës shqipe, shpallur nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, dhe zberthen kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, të strukturuar sipas fushave të studimit.

Gjuha shqipe 9 synon t'i përfshijë nxënësit në veprimtari të gjera të të nxënit, përmes të cilave pritet të fitojnë aftësi, shprehi dhe vlera të gjithanshme.

Përmes këtij teksti, nxënësit do të aftësohen për ta përdorur gjuhën në situata të larmishme dhe do të fitojnë shprehi që lidhen me aftësitë e tyre për ta dëgjuar, folur, lexuar dhe shkruar atë në një nivel të përshtatshëm për moshën e tyre.

Kjo gjë do të arrihet përmes përfshirjes së tyre në veprimtari të gjera ndërvepruese dhe bashkëpunuese, në veprimtari krijuese dhe në projekte, duke i zhvilluar dhe rritur intelektualisht dhe gjuhësisht.

Përmes këtij libri, do të zhvillohen edhe shumë kompetenca kyçe, të tilla si: zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues, human, digjital, social etj., të cilat do t'u shërbejnë nxënësve për ta përdorur drejt gjuhën në situata konkrete komunikimi.

Për të përmbushur synimet e mësipërme, të shpalosura në program, struktura e këtij teksti i orienton nxënësit në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit në situata të ndryshme, zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe formimin kulturor, zhvillimin emocional, krijues dhe estetik përmes shkathtësive të komunikimit, zhvillimin e vetëbesimit dhe të të menduarit kritik e të pavarur, zhvillimin e përdorimit të gjuhës letrare, si dhe përgatitjen e nxënësit për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Teksti përbëhet nga dy pjesë.

Pjesa e parë përfshin fushat përmbajtësose të programit, që lidhen me: me zhvillimin e shkathtësive të komunikimit: **të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit** dhe **të folurit**, të cilat, të gërshetuara me njëra-tjetrën, krijojnë një ansambël njohurish dhe praktikash ndërvepruese në tërë rrjedhën e tekstit.

Pjesa e dytë e tekstit, e emërtuar "Njohuri për gjuhën", zberthen në mënyrë shkencore dhe didaktike tema dhe kompetenca, të cilat lidhen me leksikologjinë, gramatikën (fonetikën, morfologjinë dhe sintaksën e shqipes), në vazhdimësi të programit të klasës së tetë.

Kjo pjesë krijon mundësinë për ta njohur dhe përdorur drejt sistemin morfo-sintaksor dhe drejtshkrimor të shqipes.

Gërshetimi i pjesës së parë të lëndës me pjesën e dytë është një tipar tjetër i *Gjuhës shqipe 9*, i cili mundëson dhe lehtëson punën me llojet e teksteve dhe me njohuritë për gjuhën.

Ju urojmë rrugëtim të mbarë në eksplorimin e gjuhës sonë!

PËRMBAJTJE

TEKSTI LETRAR

Rrëfime popullore

Rrëfime nga e kaluara	8
Kutia e Pandorës	8
Peshkatari dhe e Bukura e Dheut	8
Legjenda e shpatës së Skënderbeut	10
Prit. Të ik unë, hyr ti	10
Rozafati	13
Fjalë e grosh	17
Epi i Gilgameshit	21
Fabula	25
Cjapi dhe dhelpira	25
E vërteta	25
Mençuria popullore	27
Unë kujtova se po thue: A e pe shqiponjën	27
Pse s'po m'vetni për rrafsh?	27
Nëse s'e kanë kimen të njëjtë, mos u frikoni	27
Nepërka dhe bretkosat	28

Tekste realiste

Lodra mbi akull	30
Fshati mbi shtatë kodrina	34
Djali me pizhame me vija	38
Të mjerët	42
Gjerdani	46
Krahaso romanin me tregimin	51
Në stuhi	53
Vdekja e nëpunësit	56
Krastakraus	60

Tekste fantastike

Tre vëllezërit dhe e Bukura e Dheut	64
Harri Poter mund trashëgimtarin e Gjarpërblertit	69
Krahasimi i heronjve të përrallës me heronjtë e filmave fantastikë	73
Udhëtim për në qendër të Tokës	76
Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit	80
Shndërrimi i doktor Xhekillit	84
Maska e Murtajës së Kuqe	88

Tekste poetike

Vargje kushtuar mallit	92
Malli për t'pambërrijtshmen	96
Ejani, o kujtime!	98
Lamtumirë!	100
Në rrugën <i>Gjenerali Vajs</i>	102
Martesa e Halilit	104
Gjuha shqipe	107
Këndo ose vdis pa klithmë	110
Sharlota	112

Tekste dramatike

Trashëgimia	116
Makbeth	121
Cili është ndryshimi midis tragjedisë dhe shfaqjes së saj në teatër?	126
Shekspiri në teatër dhe Shekspiri në film	130

TEKSTI JOLETRAR

Tekste rrëfyese

Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë	134
Udhëtimi në Paris	138
Homeri i Shqipërisë	142
Tung, babë!	144
Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar	146

Tekste informuese-paraqitëse

Bibliotekat më të bukura në botë	152
Veshjet popullore	158

Tekste udhëzuese

Këshilla për të shmangur shqetësimin e panevojshëm gjatë pasigurisë globale	161
Dieta e jetëgjatësisë	164

Tekste argumentuese

Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut	167
Zbulimi i Hektorit	169
Shkruajmë ese argumentuese	172

Tekste përshkruese

Parku i Gërmisë	174
Banesa tiranase	177
Shkruajmë ese përshkruese	179

Histori gjuhe

Historik i shkurtër i gjuhës shqipe të shkruar	182
Dokumentet e para të shkrimit shqip	184

Njohuri për gjuhën

Drejtshkrim

Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit	188
Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë	190
Përdorimi i drejtë i ligjëratës së zhdrejtë	192
Drejtshkrimi i fjalëve ku takohen dy zanore	194
Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupet ye, ua, ue	195
Drejtshkrimi i fjalëve të huazuara nga gjuhët e huaja	196
Drejtshkrimi i nyjës së përparme të emrave (i, e, të, së)	198

Drejtshkrimi i njës së përparme të mbiemrave dhe të përremrave pronorë	200
Drejtshkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura	202
Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras	204
Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes	207
Tingujt dhe ndryshimet fonetike të tingujve në shqip: shtesat e tingujve	210

Leksikologji

Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij	113
Dialektet e gjuhës shqipe	216
Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj	218
Huazimet. Shmangia e tyre	219
Regjistrat e gjuhës	222
Stilet e gjuhës	225
Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat dhe stilet e ndryshme në gjuhën shqipe	228

Morfologji

Klasat e fjalëve	233
Fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme	235
Lakimi i emrave	238
Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi	241
Lakimi i përremrave vetorë	242
Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përremrit vetor	244
Përdorimi i apostrofit para trajtave të shkurtra	246
Folja	247
Mënyrat dhe kohët e foljes	250
Forma veprorë dhe forma joveprorë e foljeve	253
Pjesorja dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes	254
Foljet gjysmëndihmëse	256

Sintaksë

Kallëzuesi	259
Llojet e kallëzuesit: foljor dhe emëror	262
Fjalitë e përbëra me bashkërenditje	264
Fjalitë e përbëra me nënrenditje	266
Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethimore	270
Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore	273
Referenca	276

Rrëfime nga e kaluara

Para leximit

Populli e ka endur fantazinë nëpër krijime artistike. Imagjinata e paskajë, por dhe mençuria e thellë e tij janë gërshetuar në mite, përralla, legjenda dhe fabula, duke i dhënë një kënaqësi të madhe, dikur, dëgjuesit e tani, lexuesit. Nëpërmjet krijimit të realiteteve imagjinare, ku përzihen realja dhe irrealja, ku ndodhin situata nga më të jashtëzakonshmet, ku takojmë personazhe nga më të çuditshmet, ku çdo gjë është e mundshme dhe e pranueshme, këto krijime na magjepsin, por edhe na bëjnë të mendojmë.



Kutia e Pandorës

Pasi Prometeu u dha njerëzve zjarrin dhe u mësoi zanate të ndryshme, njerëzit punuan dhe jeta e tyre u bë më e lumtur. Zeusit të madh nuk i pëlqeu kjo, ndaj vendosi t'u dërgonte njerëzve të keqen në tokë. Zeusi thirri djalin e tij, perëndinë **Hefest**, dhe e urdhëroi të përziente tokën me ujë dhe të bënte një vajzë me bukuri të jashtëzakonshme. Athina endi rrobat e saj të mrekullueshme me fije argjendi dhe i vuri një kurorë të artë në kokë. Afërdita i dha vajzës një bukuri të parëzistueshme dhe Hermes i dha një shpirt mashtrues dhe dinak.

Ata e quajtën vajzën Pandora, që do të thotë “me të gjitha dhuratat”. Dhe me të vërtetë ishte kështu, sepse ajo mori dhurata nga të gjitha perënditë.

Kur vajza ishte gati, Zeusi urdhëroi Hermesin ta çonte në shtëpinë e **Epimeteut**, vëllait të Prometeut. Prometeu e kishte paralajmëruar gjithmonë vëllain e tij që të mos pranonte asnjë dhuratë nga Zeusi dinak. Ai e dinte se këto dhurata mund t'u sillnin njerëzve vetëm fatkeqësi dhe vështirësi. Por Epimeteu nuk iu bind këshillës së mençur të vëllait të tij, dhe përveç të tjerave, vajza ishte aq e bukur sa që ai me kënaqësi e pranoi atë dhe mori Pandorën si grua.

Së bashku me Pandorën, në shtëpinë e Epimeteut ishte shfaqur një kuti. Ajo ishte një dhuratë martese e Zeusit për Pandorën, por që ajo nuk duhej ta hapte. Kutia qëndroi për një kohë të gjatë në një cep të errët dhe askush nuk e hapi. Por një ditë, Pandora kureshtare dhe dinake, e nxitur nga kureshtja, iu afrua ngadalë.

“Nuk do ta hap”, mendoi ajo, “do të hap vetëm pak kapakun sa të shikoj çfarë ka brenda saj.”

Dhe ajo hapi vetëm pak kapakun. Por kjo çarje ishte e mjaftueshme që e gjithë e keqja, të gjitha veset dhe fatkeqësitë njerëzore, sëmundjet që gjendeshin në kuti të dilnin jashtë. E frikësuar, Pandora mbylli kapakun, por ishte tepër vonë. Të gjitha veset, sëmundjet dhe fatkeqësitë njerëzore u shpërndanë në tokë dhe vetëm shpresa mbeti

Fjalor

Hefesti – bir i Zeusit dhe Herës, perëndia e zjarrit dhe farkëtari i armëve të perëndive.

Epimeteu – titan. Ai është vëllait i Prometeut iu dha detyra të popullonin tokën me kafshë dhe njerëz.

në fund të saj. Përsëri, e keqja u vendos në tokë, njerëzit vuajtën nga fatkeqësitë e ndryshme që ranë mbi ta njëra pas tjetrës.

Kështu, bota u bë një vend i pamëshirshëm, derisa Pandora hapi përsëri kutinë dhe në botë doli edhe shpresa.

Peshkatori dhe e Bukura e Dheut

Qe një peshkatar dhe kish edhe të shoqen. Një ditë, i thotë e shoqja: “Ore burrë, ti ngaherë shet peshk, nuk do të na sjellësh edhe neve ndonjëherë?” Edhe ay vate të nesërmen të gjuante për shtëpinë edhe, tek hodhi *mërezhën*, zuri një peshk të mirë. Po ay peshk i tha peshkatarit: “Mos më trazo mua, se s’jam fati yt, po lëshomë. Pa eja nesër të zësh një tjetër, që do të jetë për ty”. Edhe ay e lëshoi e vate zbrazët në shtëpi, ku e shoqja po priste peshk me tigan në zjarr.

E pyeti e shoqja: “Përse nuk solle peshk, o burrë?” Ay i tha se, kështu e kështu më ngjau, o grua.

Të nesërmen, vajti përsëri ay, edhe zu një peshk të math, i cili i tha: “Mirë më zure, po të më bësh tetë fela, dy nga ato t’i shtjesh në portën tënde, dy t’ia shtjesh pelës, dy bushtrës, edhe dy, t’ia japësh tjetër shoqe”. Edhe ay me të vajtur në shtëpi, e ndau atë me vërtet ashtu siç ish porositur prej tij. E pa ditur fare gjë ay, me natë, te porta mbinë dy selvi, pelëza polli dy hamshorë të mirë pa anë, bushtra polli dy luanë të çudiçim, edhe shoqja lindi dy djem trima, edhe të bukur shumë.

Në një fshat atje pranë këtyre, rrinte e bukur’e dheut. E djal’ i madh i peshkatarit posa e *nxu* atë, u shti kaqë pas asaj, sa vendosi të vejë e ta marrë për grua.

I jati i djalit edhe e ëma rrahën me gjithë udhët që ta prapsën atë, sa gjith’ i rrëfuyen edhe rrezikun e krej’ që do të hiqte më të vajtur atje, po ay, s’qe me mund të bindet. Më së fundi, u tha djali se në qoftë se selvija e tij do zërë të mfishket edhe të *mpshojë* tatëpjetë, ta dinë se atëherë është i humbur ay. Edhe u nis e shkoi.

Pasi u sos në fshat të së bukurës dheut, vete me gjithë luanë e tij drejt e në shtëpi të saj. Atje i doli përpara një shtrigë dhe e pyeti: “Ç’do?” e posa tha ky se, “do të bukurën e dheut”, me të parën, shtriga e bëri gur këtë, në çast dhe selvija e tij tek i ati u mfishk edhe mvari qafën e saj e prindrit e mjerë ia dhanë të qarët, pasi pikasën nga selvija që djali u ka humbur.

E kur pa këto djali i vogël, kërceu e thirri: “Do të vete unë, hem tim vëlla ta shpëtoj, hem të bukurën e dheut ta marr”. Po i ati dhe e ëma zunë të qarët, e i luten atij duke lebetitur, që të mos gënjehet të vejë, se do ta gjejë edhe atë, ajo që gjet të vëllanë.

Po me gjithë këtë gurgule, ay s’deshi të dëgjonte asnjë nga ato fjalë edhe u nis e shkoi bashkë me luanë e tij.

Fjalor

mërezhën – grep.

nxu – mësoi.

mpshojë – rrëzohet.



Luanë ama e porositi fort duke thënë që, posa të sosen te shpija e së bukurës së dheut, e posa të dalë shtriga (përse djali i kish nxënë të tëra ato që shtriga u punonte djemve) ta rrëmbenjë aqë fort sa, ja të ngjallnjë ajo të vëllanë, t'i japë të bukurën e dheut, ja të vritet.

Arrinë pra te port' e asaj e kur panë vëllanë me gjithë luanë të ngrirë e të bërë gur, lëshuan lotët si breshër nga sytë. E luani siç ishte porositur, e rrëmbeu sakaqë shtrigën edhe kaqë fort e shtrëngoi, sa gati u bë kruspull.

Ashtu ajo, pasi pa vetëhen e sajë më të keqe, i tha djalit të hap një dollap q'ish atje pranë, e të marrë që brenda dy qelqe, që kishin njëra ujë si të bardhë, e tjera ujë si të kuq, edhe u rrëfeu se, me ujin si të bardhë i ngrinte njerëzit, e me të kuqin, i ngjallte. Ay, pra, në çast shtiu ujë të kuq mbi vëllanë edhe luanin, edhe sakaq ata u ngjallën.

I vëllai, duke fshirë syt' e tij tha: "Oji! Sa shumë fjetur kam". "Nuk fjete, i tha ay, o vëlla po kështu kështu...". Në çast edhe selvija në shtëpi u ngrit e u krekua. Ia dhanë gazit edhe prindrit duke pikasur se u është ngjallur djali.

Legjenda e shpatës së Skënderbeut

Sulltan Mehmetit II i kishte mbetur merak shpata e Skënderbeut. Ai mendonte se ajo kishte diçka të veçantë. Kishte dëgjuar se duheshin tre burra që të ngrinin shpatën e tij dhe se ai mund të copëtonte shkëmbinj ose të shponte male me të.

Gjatë bisedimeve për paqe, Sulltani, i cili kishte dëgjuar kaq shumë bëma për shpatën e Skënderbeut, ia kërkoi atij si nder.

Gjergji e kuptoi dredhinë e tij. Nuk ishte aq e hollë sa të mos e kuptonte, por bëri sikur nuk e mori vesh. Skënderbeu pranoi dhe i dërgoi shpatën e tij si dhuratë për sulltanin.

Me të mësuar lajmin, njerëzit e Skënderbeut u shqetësuan shumë. Disa ia thanë hapur Gjergjit mospëlqimin e tyre; si mund ta dorëzonte kaq lehtë shpatën e tij legjendaren e duarte armikut?! Por Skënderbeu qeshi dhe u përgjigj: – Unë dorëzova shpatën, por jo krahun.

Prit. Të ik unë, hyr ti

Një gjarpri, teksa rrinte mirë e bukur në vrimën e vet, i vajti aty iriqi dhe iu lut, që ta linte të hynte edhe ai në vrimë, të flinin bashkë, mbasi atë natë ai kish mbetur pa strehë. Gjarpri pranoi, u mbloodh edhe më e i bëri vend edhe iriqit në vrimën e vet.

Ndërkaq, iriqi tashmë brenda vrimës, pak e nga pak, filloi të shtrihej e të zgjerohej, duke e shtyrë dhe shtyrë gjarprin, gjith' edhe më andej, derisa ky i fundit i tha:

– Prit. Të ik unë, hyr ti!



Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni mitin e mësipërm dhe përgjigjuni pyetjeve:
 - a) Në çfarë mënyrë u krijua Pandora? Kush ndihmoi në krijimin e saj?
 - b) Kë kërkonte të ndëshkonte Zeusi, kur urdhëroi krijimin e Pandorës?
 - c) Kujtoni cili është shkaku i grindjes mes Zeusit dhe Prometeut?
 - d) Cili është plani i Zeusit që synonte ta arrinte nëpërmjet Pandorës?
- 2 Në përrallën "Peshkatarin dhe e Bukura e Dheut", fjalët e peshkut që zuri peshkatarin "Mos më trazo mua, se s'jam fati yt" e shtyjnë atë ta lëshojë. Si iu shpërblye peshkatarit ky veprim?
- 3 Në njërin nga përrallat e mësipërme, personazheve u duhet të përballen me një shtrigë që mban peng të bukurën e dheut:
 - a) Çfarë i bëri shtriga vëllait të parë?
 - b) A arriti t'i bënte të njëjtën gjë vëllait të dytë?
 - c) Në çfarë mënyre mund të zhbëhej magjia e shtrigës?
- 4 Çfarë i kërkoi iriqi gjarprit? A ia plotësoi gjarpri kërkesën iriqit?
- 5 Në cilin prej këtyre teksteve flitet për një personazh real dhe një kohë reale? Shpjegoni si shkrihen elementet reale me ato fantastike në të njëjtin tekst.
- 6 Çfarë veprimesh të jashtëzakonshme thuhej se mund të kryente Skënderbeu me shpatën e tij? A ishte ajo një shpatë magjike?

Analizojmë tekstin

- 7 Analizoni këshillën që i ka dhënë Prometeu vëllait të tij, Epimeteut. Si rezultoi kjo këshillë?
- 8 Në përrallën e mësipërme, ndonëse përpjekjet e vëllait të parë për të marrë të Bukurën e Dheut rezultuan pa sukses, edhe vëllai i dytë vendosi të bënte orvatjen e tij. Cilat janë arsyet që e shtyjnë të ndërmarë një rrezik të tillë?
- 9 Në fund, nga kutia e Pandorës pas gjithë të këqijave doli shpresa. Çfarë roli luan ajo në jetën e njerëzve?
- 10 Çfarë elementesh magjike gjenden në përrallën "Peshkatarin dhe e Bukura e Dheut"?

Interpretojmë tekstin

- 11 Duke u nisur nga miti, shpjegojeni kutinë e Pandorës si metaforë të:
 - a) zbulimit të të fshehtave të tmerrshme që kanë qëndruar gjatë në errësirë e vjen momenti që shfaqen e nuk mund t'i fshehësh më;
 - b) e asaj që në dukje është e parëndësishme, pa ndonjë vlerë të dukshme, por që fsheh pasojat të pallogaritshme, të fshehta me pasojat të jashtëzakonshme.
- 12 Kujt ia dhuroi shpatën Skënderbeu? Çfarë kërkonte të shprehte me këtë veprim ai?
- 13 Në fillim të përrallës tregohet për peshkatarin: "Edhe ay e lëshoi e vate zbrazët në shtëpi, ku e shoqja po priste peshk me tigan në zjarr". Çfarë shprehjeje popullore na vjen ndër mend nga ky fragment për gruan e peshkatarit?

- 14 Çfarë “mirënjohjeje” pati gjarpri nga veprimi që kreu, duke pranuar iriqin në shtëpinë e tij?

Gjuha e tekstit

- 15 Në përrallë synohet të realizohen situata sa më të tensionuara, që e mbajnë vëmendjen e lexuesit pezull. Me cilat prej teknikave të mëposhtme arrin ky efekt në përrallën “Peshkatari dhe e Bukura e Dheut”? Vendosni shenjën \checkmark në alternativat e sakta.

- krijimi i situatave të papritura;
- fjali të shkurtra dhe të thjeshta;
- fjali të gjata që tregojnë me hollësi shumë gjëra njëkohësisht;
- gjuha shumë e figurshme;
- prania e pasthirmave të shumta e të frikshme.

- 16 Shpjegoni kuptimin e shprehjeve të figurshme në përrallën e mësipërme.

- Rrahën me gjithë udhët që ta prapsën atë: _____
- Selvija mvari qafën e saj: _____
- Pa marrë as dhe fromë: _____
- Lëshuan lotët si breshër: _____

- 17 Në fabulën e mësipërme thuhet: “*pak e nga pak, filloi të shtrihej e të zgjerohej duke e shtyrë dhe e shtyrë gjarprin, gjith’ edhe më andej*”. A mund ta zëvendësoni tërë këtë fjali me një fjalë të vetme? Cila mund të jetë ajo?
- _____

Reflektojmë rreth tekstit

- 18 Skënderbeu dhuroi shpatën e tij. Reflektoni rreth përgjigjes së Skënderbeut “ai i dorëzoi shpatën, por jo krahun e tij”. Ku qëndron forca e vërtetë e Skënderbeut?
- 19 Në të katërta krijimet ndodhin ose flitet për veprime të pazakonshme. Diskutoni rreth këtyre veprimeve, në secilin prej teksteve.
- 20 Në disa raste, mesazhi i fabulës është i shprehur në tekst. Në rastin e fabulës së mësipërme, jo. Gjeni mesazhin ose mesazhet që përcjell ajo.

Detyrë:

- Gjeni në internet forma të tjera të rrëfimit për kutinë e Pandorës.
 - Në një rrëfim është Prometeu ai që i ka futur të këqijat e botës në kuti.
 - Në një tjetër thuhet se kutia nuk erdhi bashkë me Pandorën, por u la nga lajmëtari i Zeusit në shtëpinë e saj për ta ruajtur gjersa ai ta merrte. Gjejini ato dhe diskutoni ndryshimet.
- Gjeni ndonjë përrallë tjetër, ku luftohet dhe rrezikohet për të Bukurën e Dheut. Gjeni si përshkruhet bukuria e saj.
- Gjeni ndonjë legjendë tjetër në të cilën rrëfëhet për Skënderbeun. Krahasojeni me legjendën e dhënë në libër.

Rozafati

Para leximit

Legjenda e Rozafatit është një legjendë e përcjellë ndër shqiptarë brez pas brezi. Siç bën dhe me shumë përralla, rrëfenja e tregime popullore, Kuteli na ritregon në një formë të re legjendën e Rozafatit. Kjo rrëfenjë është pjesë e përmbledhjes "Tregime të moçme shqiptare".

Krenare ngrihet mbi Bunën e gjerë e mbi qytetin e Shkodrës kështjella e lashtë e Rozafatit.

Kur është hedhur guri i parë në themelet e kësaj kështjelle? S'dihet. Historia e saj humbet në mjegullën e lashtësisë ilire, banorëve të moçëm të kësaj **mënge**. Një gjë dihet qartë: atë e kanë pasur dikur labeatët dhe pastaj ardianët, që ishin fise të forta ilire. Në atë kohë, tërë bregu i këtejshëm i Adriatikut, gjer në Tergestën e bujshme apo Trieshtën e ditëve tona, ish breg ilir. Më vonë, u derdhën këtej romakët, pastaj sllavët, normanët, venetikët, turqit e shumë popuj të tjerë të huaj. Gjatë shekujve, ata **krepat** e thatë nën muret e Rozafatit, si edhe vetë muret e kështjellës, janë lagur me përrenj gjaku të atyre që e kanë sulmuar dhe të atyre që e kanë mbrojtur. Të huajt erdhën e shkuan, kurse populli ynë mbeti ngulur në këtë tokë ilire. Ndërtimi i kështjellës së Rozafatit ka një gojëdhënë të bukur dhe të hidhur, që na ka ardhur nga lashtësia jonë.

Ja se ç'thotë kjo gojëdhënë...

I ra mjegulla Bunës dhe e mbuloi të tërën. Kjo mjegull mbeti aty tri ditë e tri net. Pas tri ditësh e tri netësh, fryu një erë e hollë dhe e largoi mjegullën. E lartoi dhe e shpuri gjer në kodrën e Valdanuzit. Aty majë kodrës, punonin tre vëllezër. Ndërtonin një kështjellë. Muri, që e bënë ditën, prishej natën dhe kështu nuk e lartnin dot.

Na shkon aty një plak i mirë.

– Puna mbarë, o tre vëllezër.

– Të mbarë paç, o plak i mirë.

– Po ku e sheh ti të mbarën tonë? Ditën punojmë, natën shembet. A di të na thuash ndonjë fjalë të mirë; ç'të bëjmë që të mbajmë muret më këmbë?

– Unë di, – u thotë plaku, – po e kam për mëkatë t'jua them.

– Atë mëkatë hidhe mbi kryet tonë, se ne duam që ta qëndrojmë më këmbë këtë kështjellë.

Plaku i mirë mendohet e pyet: – A jeni të martuar, o trima? A i keni ju të tria vashat tuaja?

– Të martuar jemi, – i thonë ata. – Edhe të tre i kemi vashat tona. Na thuaj pra, ç'të bëjmë që ta qëndrojmë këtë kështjellë.

Fjalor

mëngë – pjesë e ndarë nga një e tërë në formë mënge.

krep – shkrep mali.



Mitrush Kuteli

Mitrush Kuteli (1907-1967) është pseudonimi i Dhimitër Paskos. Ai ka qenë shkrimtar, përkthyes, kritik. Krijimtaria e tij letrare përfshin: "Tregime të moçme shqiptare", "Net shqiptare", "Shënime letrare", "Sulm e lotë", "Mall e brengë" etj. Në krijimet e tij gjejmë tema si: dashuria për atdheun, dashuria për njerëzit, identiteti dhe tradita.

– Në doni ta qëndroni, lidhuni me besa-besë; vashave mos u rrëfeni, në shtëpi mos kuvendoni për fjalët që do t’ju them unë. Atë nga të tria kunatat që do të vijë nesër t’ju sjellë bukën, ta merrni e ta muroni të gjallë në mur të kështjellës. Atëherë keni për të parë se muri do të zërë vend e do të qëndrojë, për jetë e mot. Tha kështu plaku e shkoi: tani u pa, pastaj s’u pa.

Vaj! Vëllai i madh e shkeli besën e fjalën. Kuvendoi në shtëpi, i tregoi vashës së vet kështu e kështu, i tha të mos vinte atje të nesërmen. Edhe i mesmi e shkeli besën e fjalën; ia tregoi të gjitha vashës së vet. Vetëm i vogli e mbajti besën e fjalën: nuk kuvendoi në shtëpi, nuk i tregoi vashës së vet. Në mëngjes, ata të tre ngrihen shpejt e shkojnë në punë. Çekanët godasin, gurët copëtohen, zemrat rrahin, muret lartohen...

Në shtëpi, nëna e djemve s’di gjë. I thotë së madhes: – Moj nuse e madhe, mjeshtrit duan bukë e ujë; duan **kungullin** me verë.

Nusja e madhe ia kthen: – Besa, nënë, sot s’mund të shkoj, se jam sëmurë.

Kthehet i thotë së mesmes: – Moj nuse e mesme, mjeshtrit duan bukë e ujë; duan kungullin me verë.

– Besa, nënë, sot s’vete dot, se do shkoj te fisi për të **bujtur**.


Fjalor

kungull – shishe ose enë me bark të gjerë.

brof – ngrihem menjëherë më këmbë, çohem me rrëmbim.

buj – kaloj natën ose rri për ca ditë diku si mysafir.

druhem – kam frikë nga dikush a nga diçka, i trembem dikujt a diçkaje.



Nëna e djemve i kthehet nuses së vogël: – Moj nuse e vogël...

Nusja e vogël **brof** në këmbë: – Urdhëro, zonja nënë!

– Mjeshtrit duan bukë e ujë; duan kungullin me verë.

– Besa, nënë, unë vete, po e kam djalin të vogël. **Druhem** se do gji të pijë e qan.

– Nisu, shko, se djalin ta shikojmë ne, s'ta lëmë të qajë, – po thonë kunatat.

Ngrihet e vogla, e mira, merr bukë e ujë, merr kungullin me verë, e puth djalin në të dyja faqet, niset e bie në Kazenë; që aty ngjit kodrën e Valdanuzit, i afrohet vendit tek punojnë të tre mjeshtrit; dy të kunetërit dhe i shoqi.

– Puna mbarë, o mjeshtër!

Po ç'është kështu? Çekanët ndalen e s'godasin, po zemrat rrahin fort e fort. Fytyrat zbehen. Kur e sheh i vogli të shoqen, hedh çekanin nga dora, mallkon gurin e murin.

E shoqja i thotë: – Ç'ke ti, o imzot? Pse mallkon gurin e murin?

Hidhet kunati i madh: – Ti paske lindur në ditë të zezë, moj kunata jonë. Ne e kemi bërë me fjalë të të murojmë të gjallë në mur të kështjellës.

– Shëndoshë ju, o tim kunetër. Po unë do t'ju lë një porosi: kur të më mureni në mur, synë e djathtë të ma lini jashtë, dorën e djathtë të ma lini jashtë, këmbën e djathtë të ma lini jashtë, gjinë e djathtë të ma lini jashtë. Se djalin e kam të vogël. Kur të nisë të qajë, me njërin sy do ta shikoj, me njërin dorë do ta ledhatoj, me njërin këmbë do t'i tund djepin e njërin gji do t'ia jap ta pijë. Gjiri im u nguroftë, kështjella qëndroftë, djali im trimëroftë, u bëftë mbret e mbretëroftë!

Ata e marrin nusen e vogël dhe e murojnë në themel të kështjellës. Dhe muret ngrihen, lartohen, nuk shemben më si më parë. Po rrëzë tyre, gurtë janë edhe sot të lagur e të myshkët, sepse vazhdojnë të pikojnë lotët e nënës për birin e saj... Dhe i biri u rrit, luftoi e trimëroi.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Kur është ndërtuar kështjella e Rozafatit?
 - b) Çfarë ka ndodhur gjatë shekujve në muret e kështjellës?
 - c) Sipas gojëdhënës, kush merrej me ndërtimin e kështjellës?
 - ç) Çfarë këshille u jep plaku i urtë tre vëllezërve, që muri të mos shembej?
 - d) Përse nuk e çojnë ushqimin dy nuset e mëdha?
 - dh) Çfarë porosie lë nusja e vogël para se ta murosin?
 - e) Ku janë në kështjellë gjurmët e murosjes?

Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni në tekst fjalitë që tregojnë se shqiptarët janë autoktonë.
- 3 Çfarë thuhet në tekst për fiset ilire?
- 4 Si del në dritë fakti që në ato anë ka pasur pushtime dhe luftëra të shumta?

Studim teksti

- 5 Çfarë efekti krijon fjalia "Çekanët godasin, gurët copëtohen, zemrat rrahin, muret lartohen..."? Si ndihen vëllezërit teksa presin nusen që do t'u sjellë ushqimin?

Interpretojmë tekstin

- 6 Çfarë ndjenje mbizotëron te nusja e tretë: dashuria për jetën e saj apo ndjenja e amësisë?
- 7 Në tekst thuhet "... gurtë janë edhe sot të lagur e të myshkët". Çfarë tregon kjo për dashurinë e nënës?
- 8 Plaku (i urtë) është një figurë që e gjejmë shpesh në përralla dhe legjenda. Ai simbolizon:
përvojën jetësore, _____, _____.

Gjuha e tekstit

- 9 Shkruani me fjalë të tjera kuptimet e fjalëve dhe të shprehjeve të mëposhtme:
tani u pa, pastaj s'u pa _____;
për jetë e mot _____;
gojëdhënë _____;
lartoj _____;
të myshkët _____;
kuvendoi _____.
- 10 Gjeni në tekst urimet që jep nusja e vogël, nënvizoni foljet në to dhe tregoni cilës mënyrë i përkasin.

Reflektojmë rreth tekstit

- 11 Qarkoni alternativën e saktë:
Murosja e nuses së tretë duhet parë si:
a. akt flijimi për të siguruar një kështjellë për djalin e vogël;
b. akt dhune ndaj grave;
c. metaforë që tregon se për vijimësinë e kulturës shqiptare në rrjedhën e kohës, janë kryer sakrificat të mëdha.
Legjenda e Rozafatit mund të konsiderohet edhe si:
a. legjenda e sakrificës dhe e fjalës së dhënë;
b. legjenda e tradhtisë vëllazërore;
c. legjenda e gruas heroike;
ç. legjenda e djalit jetim.
- 12 Si mendoni se e shkuan jetën dy vëllezërit e mëdhenj dhe gratë e tyre?

Detyrë

- ▣ Diskutoni me prindërit rreth traditës së murimit, kur ndërtohet një shtëpi e re.
- ▣ Çfarë vendoset në themele dhe përse? Shkruani një tekst të shkurtër rreth këtyre rritualeve.
- ▣ Gjeni legjenda ose gojëdhëna nga folklori, të cilat trajtojnë motivin e besës.

Fjalë e grosh

Para leximit

Cili është vendimi më i rëndësishëm që keni marrë deri tani? Si u siguroat që ishte i duhuri?
Pjesa e mëposhtme "Fjalë e grosh" është një përrallë popullore shqiptare. Ajo tregon se si në momente të caktuara mund të përballësh me situata, në të cilat duhet të marrësh vendime që përcaktojnë gjithë jetën tënde. Djaloshi të përrallës sonë nuk i mungon as guximi, as dëshira për punë, është edhe njeri i ndershëm, por ajo që e bën të lumtur në fund është mençuria në marrjen e vendimeve.

Njeni s'kishte te shpia veç një nanë e një grue. Tue qenë në nevojë të madhe, ndau mendjen me dalë e **me qarue** në botë.

Kërko, kërko e kërko, u vendos rrogëtar te një zotni. Mbas tri vjetësh lypi me u nda e priti me marrë **hakun**.

– A do, – po i thotë zotnia, – tre grosh të **hallallit**, a treqind grosh të **haramit**?

Mendoi një herë e tha:

– Joo, ma mirë po marr tre grosh të hallallit.

Merr ato pare e vehet për rrugë. E ze nata në një katund e hyn në një shtëpi për **me bujtë**. Aty kishte pasë qenë një plak njëqind vjeç, që rrinte buzë votrës me krye ulët pa baza.

– A flet ky plak? – pyeti djali.

– Në të rrallë, – i përgjegjin. – Ky flet fjalë e grosh.

– Qe një grosh! – ia pret djali, tu e lëshue groshin në votër, – por, plak, folma një fjalë!

Plaku çoi kryet e tha:

– **Robin** e Zotit kurrë mos e shaj!

I pëlqeu djalit ky këshill, nxuer groshin tjetër e ia vu para plakut e i tha:

– Merre edhe këtë grosh, por folma edhe një fjalë.

Plaku foli së dyti e tha: – Ujit turbull mos i bje!

“**Fikë se fikë**, – mendoi djali, – po ia jap edhe këtë groshin tjetër.”

Fjalor

grosh – emri i monedhës që përdorej dikur, që kishte një vlerë shumë të vogël; qindarkë.

me qarue – këtu: dal për të fituar.

hak – shpërblim a pagesë e merituar për punën e kryer.

hallall – diçka e merituar ose e drejtë.

haram – diçka e padrejtë, e pamërituar.

me bujtë – kaloj natën ose disa ditë diku.

robin – këtu: njeriun.

fikë se fikë – i marrë fund se i marrë fund.



– Folë, plak, – i tha, – edhe një fjalë. – Qe groshin, se po çohem.
– Idhnimin e mramjes, – tha plaku, – lenë për në mjes e idhnimin e mjesit lenë për në mramje.

Bujti atë natë te ai **konak** e të nesërmen **u fal me ata të shpisë** e me plakun e u vu për rrugë, tue i blue me mend fjalët e plakut. Në një **shej** vendit po del në një **log** plot zall. Në midis të atij logu ishte grumbullue popull i madh përreth një pusi. Avitet edhe ky e pyet se çka kishte ndodhë.

– Na **ka shterrë** uji, – ia pret njeni, – e s'dijmë çka na e ka marrë. Puna asht që, sa vetë shtijmë në këtë pus, të gjithë i nxjerrim **pa krena**.

– Hyj vetë, – u thotë djali.

– Po ti po merr në qafë veten, se vështirë se del shëndoshë.

– Ç'po keni ju?! – u thotë ai. – Gjaku ju qoftë falë.

S'e çuen ma gjatë, por e lidhën me litar e e ulën poshtë.

Aty gjetën ujë sa deti, që rridhte me furi, e ndër dy anët sheh dy sende të ndritshme si dy gra; njena krejt e bardhë e tjetra krejt e zezë.

– Cila asht ma e mirë? – e pyet e zeza.

Djalit i bje ndër mend fjala e plakut: “Robin e Zotit kurr mos e shaj!”, prandaj përgjigjet:

– Të dyja po më dukeni baraz të mira.

– Ti s'do me folë drejt, – po i thotë e zeza, – pse ty e di se e bardha të pëlqen ma tepër.

– Jo, – ia pret djali, – si të bardhën, si të zezën i ka falë Zoti. E prandaj të dyja i ka falë të mira.

Të gjithë ata që hyjshin në atë pus pyeteshin në këtë mënyrë e, prejse lëvdoshin ma fort të bardhën, e zeza **ua shkurtonte** kryet. Këso here, tue ndie e zeza gjyqin e paanshëm, thotë: – Të lëshohet uji!

Ban shej djali që ta ngrejnjë përpjetë e del shëndosh e mirë e me të ngjitet edhe **gurra**, e aq me shumicë del uji, sa merr fushën e i ngop të gjithë.

Gëzohen vendasit e atij katundi e i falin dy mushka me pare.

– Fjala e plakut, – tha djali, – më solli fat. Tash mundem me kthye te shpia, pse kam pare mjaft.

E u vu për rrugë me gjithë atë pasuni. Mbrin te një lumë. Një natë para kishte pasë ra shi i madh e kishin qenë çue projet e shenat e lumi ishte turbullue. I ra ndër mend fjala e plakut: “Ujit turbull mos i bje!”, e u ul në breg me pushue deri të **skjarohej**. Po vjen andej një pasanik i madh, që kishte me vete dy kuaj me pare.

– Pse s'po kalon? – i thotë djalit.

– Asht uji turbull, – i përgjigjet, – e s'mundem.

– Kot je tue u frigue, – ia pret pasaniku. – Unë e kam ba shpesh këtë rrugë; këtu s'ka asnji gju ujë.

E, me ato fjalë, **zbathet** e hyn në ujë: ai para e kuajt mbrapa... Kur qe, e merr rrjedha me vete, s'mundet me qëndrue e mbytet. Kuajt i mbesin djalit shtegtar. Si u skjarue uji, kalon me dy mushka e me kuaj si asht ma mirë e vehet me kërkue katundin e vet. Dikur mbërriti te shpia.

Fjalor

konak – dhoma ku qëndrojnë njerëzit, dhoma e zjarrit.

u fal me ata të shpisë – u përshëndet, u nda me ata të shtëpisë.

shej – shenjë.

log – shesh i vogël i pjerret, shesh luftime, dyluftimi.

shterr – këtu: është ndërprerë.

krena – këtu: kokat.

ua shkurtonte – këtu: ua priste.

gurra – burim uji.

skjarohej – kthjellohet, bëhet i kthjellët, i kulluar.

zbathet – zhvishet.

në të shtrueme – këtu: dyshek që njerëzit e vendosnin dikur poshtë në dyshe me për të fjetur.

Aty gjen plakën, nanën e vet, gruen e një djalë të rritshëm si nja 18 vjeç. Ata s'po e njoftin, as ky s'po e njëf djalin, pse, kur kishte pas dalë prej shpie, s'kishte pas lanë tjetërkënd veç t'amën e gruen. Prandaj nis e mendon zi e ma zi për atë djalë e bahet me luejtë mendsh.

Kur vjen koha me ra, qe se djali po shkon me fjetë me t'amën, domethanë me të shoqen e shtegtarit të panjoftun. I kërcen gjaku, ndan me e mbytë, e ishte he-he tuj lëshue në të, kur i vje ndër mend fjala e plakut: "Idhnimin e mramjes lene për në mjes", edhe thotë: "Të bahet çka të bahet, po pres deri nesër!"

Të nesërmen, grueja e tij kishte qenë çue herët e dalë në arë, ndërsa i biri ishte ende në të shtrueme. Qatje ma vonë po e thërret plaka e i thotë: – Çou, biro, e shko te nana jote e ndihmoji pak!

“Pale, – thotë me vete shtegtari, – po kjo çka do me thanë?”

I avitet plakës e nisë me e pyet:

– A ke njeri? – po e pyet. – Kush asht ai djalë?

– Kam pasë, – po i dëfton plaka, – një djalë. Mbasi e rehatova e gjithësesi, në vend që me më gëzue, më la mbas një muaji me nusen e u nis për kurbet. Vjetët e para na pat çue pare edhe mirë, por tash ka shumë vjet që s'dij gja për te a asht gjallë a vdekë. Nusen ma ka pasë lanë shtatzanë e i ka falë Zoti këtë djalë që tash asht rritë e burrnue e ende s'e ka pa babën e vet. Lene Zot se, kur e shoh, si me pa djalin tem. Ndërsa flitte plaka, këtij i shkonte e i vinte fytyra, s'mund të presi ma, por i bje ndër krahë e i thotë:

– Djali yt jam vetë. A s'po më njëf?

Plaka u ra syve si të ishte tue u çue prej gjumit, kaq e papritun i erdh ajo fjalë. Ia gjet një shej në qafë e, tue qa, e rroku me mall. Thirri mandej nusen e nipin e jetuan bashkarisht me një mijë të mira.

Përralla

Përralla është një krijim gojor që gërsheton motivet reale me ato fantastike. Kalimet nga realja në fantastiken, nga natyrorja në mbinatyroren, nga e pamundura në të mundur janë të natyrshme dhe nuk të befasojnë. E jashtëzakonshme është elementi kryesor artistik i përrallës. Zakonisht, personazhet nuk karakterizohen nga ana psikologjike, por jepen në një formë të caktuar dhe nuk shmangen prej saj. Çuditë që ndodhin në përralla, ndërtohen në mënyrë të tillë që askush të mos habitet dhe të frikësohet. Ato janë shumë të pëlqyera dhe argëtuese, por mbartin edhe vlera didaktike (edukative). Përrallat tregohen në prozë.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni përrallën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Cilët njerëz lë në shtëpi djali, kur vendos të largohet? Çfarë synon të arrijë me largimin e tij?
 - b) Sa vjet punoi djali te zotnia? Sa grosh është pagesa që mori për punën e bërë?
 - c) Djali i shpenzon këto monedha për këshillat e një plaku të urtë. Çfarë përfiton djali nga këshillat e plakut? Kë ndihmon tjetër nëpërmjet tyre?

Plotësoni tabelën.

Tri momentet kur djali vë në jetë tri këshillat:			
--	--	--	--

Analizojmë tekstin

- 2 Dalloni hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e përrallës. Vendosini çdo pjese nga një titull. Argumentoni përgjigjen.
- 3 Dalloni në fragmentin e fundit (djali mbërrin në shtëpi) pjesët rrëfyese, dialogueuse dhe ato medituese.

Studim teksti

- 4 Përmes shembujve nga teksti, shpjegoni disa karakteristika të përrallës.

	Përshkrimi i ngjarjes	Karakterizimi psikologjik i personazheve	Shkrirja e elementeve reale me ato fantastike	Mesazhi edukativ
Shembull nga përralla				
Shpjegimi				

Interpretojmë tekstin

- 5 Shpjegojini me fjalët tuaja tri këshillat e plakut:
- ▣ Robin e Zotit kurrë mos e shaj. _____
 - ▣ Ujit turbullt mos i bje! _____
 - ▣ Idhnimin e mramjes, lene për në mjes e idhnimin e mjesit lene për në mramje. _____
- 6 Përshkruani përjetimet e personazhit kur sheh djaloshin e panjohur 18-vjeçar që del nga shtëpia e tij.

Gjuha e tekstit

- 7 Shpjegoni kuptimin e shprehjeve të figurshme.
- ▣ *Ndau mendjen...* _____
 - ▣ *Me dalë e me qarue...* _____
 - ▣ *Tue i blue me mend...* _____
 - ▣ *Bahet me lujt menç...* _____
 - ▣ *I kërcet gjaku...* _____
 - ▣ *I shkonte dhe i vinte ftyra...* _____
- 8 Ktheni në gjuhën standarde këto fjalë dhe shprehje.

<i>nanë</i>	
<i>tue qenë</i>	
<i>vehet në rrugë</i>	
<i>katund</i>	
<i>votrës</i>	
<i>tue lëshue</i>	
<i>idhnim</i>	
<i>avitet</i>	
<i>njena</i>	
<i>kishte qenë çue</i>	

Reflektojmë rreth tekstit

- 9 Plaku është simbol i përvojës njerëzore. Pse është e rëndësishme të mësojmë nga më të moshuarit? Flisni në klasë për raste kur ju është dashur të dëgjoni këshillat e më të rriturve.
- 10 Mesazhi i tekstit mund të përmbliidhet përmes një fjale të urtë: *Më mirë të dish, sesa të kesh.* Tregoni raste nga jeta juaj kur keni dalë në këtë përfundim.

Detyrë

- ▣ Gjeni dhe sillni në klasë përralla të tjera, të cilat i vlerësoni për mesazhet e rëndësishme që përcjellin.

Epi i Gilgameshit

Para leximit

Epi i Gilgameshit mendohet se është eposi më i vjetër në gjithë letërsinë botërore, i zbuluar deri më sot. Kjo vepër i përket qytetërimit Mesopotam dhe traditës së shkrimit kuneiform. Ajo është gdhendur me kunja në 12 pllaka argjile. Ashtu si gjithë eposet e tjera, është një rrëfim për trimat. Ky është një epos kushtuar Gilgameshit, mbretit të Urukut, trimërisë dhe forcës së tij, por edhe mëdyshjeve dhe pikëpyetjeve për jetën dhe vdekjen. Gilgameshi, dy të tretat i ka perëndi dhe një të tretën, njeri. Ai bashkë me mikun e tij Enkidujin, i cili në fillim sillej si kafshë, por më pas u përshtat dhe jetoi me njerëzit, ndërmarrin veprime për të mposhtur armiqtë e njerëzve dhe të hyjnive. Në pjesën e mëposhtme tregohet se si Gilgameshi me mikun e tij Enkidujin vrasin Humbabën, rojë në malin hyjnor. Ata, si gjithë heronjtë epikë, duan të fitojnë lavdi nëpërmjet veprimeve të tyre.

Përkthyer nga Anton Berisha

Një dy, tri orë të dyfishta ecin.
E rëndë është rruga dhe e rrëpirë,
që shpie drejt në malin e hyjnive.
Humbabën nuk e shohin, s'e dëgjojnë.
Mbi mal lëshohet nata, yjet dalin.
Të dy u shtrinë e gjumë i rëndë i mori.
Herët n'mëngjes, Enkiduji e zgjon mikun:
"Një ëndërr e kam parë, miku im,
vërtet e frikshme ishte ajo ëndërr,
në majë të malit rrinim të dy bashkë,
dhe ja, një shkëmb që kishte mbetur pezull,
u rrokullis e thekshëm shungulloi.
Një njeri u copëtua, n'sa ne të dy
mënjatë fluturuam, sikur t'ishim
miza të vockla n'fushë kah fluturojnë.
Mandej t'filluam rrugën për n'Uruk".
Aherë mbreti mikut se ç'i tha:
"E mirë është ëndrra që ke parë,
kuptim të mirë ka ëndërrimi yt.
Atë që e pe duke u shembur maja,
përfundi që e dërrmoi njeriun e tretë,
këtë kuptim e ka përmbajtja e saj:
ne do ta zëmë Humbabën, do ta mbysim,
atij kufomën n'fushë do t'ia hedhim
dhe n'ag të parë kthehemi n'shtëpi".
Tridhjetë orë udhëtuan pa u ndalur,
tridhjetë orë ata i numëruan.
Një gropë e çelën para hyut të diellit
dhe ngritën duart, Shamashit t'i luten.
Mbi grumbull dheu, Gilgameshi hip



Fjalor

Uruk – qyteti ku sundon Gilgameshi.
Humbaba – roja e malit të Cedrit,
qenie me forcë të jashtëzakonshme,
kanoset dhe u bën të këqija njerëzve,
por ka fyer edhe hyjni.



Fjalor

resh – bie mbi tokë.

cedri – një lloj peme që bën pjesë në familjen e drurëve halorë.

tevona – më vonë.

Irni – hyjnesha e qytetit të Urukut, vajzë e hyjit të qiellit.

Shamashi – dielli, zot i diellit, ai është mbrojtës i Gilgameshit. Ai e nxit dhe e ndihmon në përleshjen me Humbabën që ta vrasë atë.



në gropë, ca kokrra i flak edhe flet:
 “O mal, na sill një ëndërr, o i larti Shamash, i sill një ëndërr Enkidujit!”
 Një erë e fortë drurët i përshkon, thëllim i tmerrshëm atëherë çohet. Gilgameshi e lejon mikun të shtrihet, mandej dhe vetë shtrihet afër tij. Përkulet prej stuhisë si drithi në erë dhe bie n’gjunjë, kryet e mikut t’vet e mban. S’vonon një gjumë i fortë e i rëndë, që i merr njerëzit, bie mbi Enkidujin. Në mes të natës na i doli gjumi, ngrihet dhe mikut t’vet kështu i flet:
 “Mos më thërrite mua, o Gilgamesh? Si vallë u zgjova? A thua ti më preke? Pse jam i frikësuar? A mos kaloi një hy këndeje? Pse gjithë trupin tim e kam t’këputur? Përsëri, o mik, një ëndërr t’frikshme unë e kam parë: gjëmonte qielli, toka e tërë trandej, të zezat re t’stuhisë afroheshin, shumë të errta mblidheshin në grumbuj; ndriçonte vetëtima, rrufeja shkrepse, përherë shkonin retë duke u zgjeruar, si t’ishte duke *reshur* binte vdekja. Shndrit dhe një herë flaka, pastaj shuhet. Rrufeja një njeri e bëri hi. Të shkojmë! Në kasollet, atje n’mal, në mes të *cedrave* të bëjmë këshillë”. Hap gojën Gilgameshi, i flet mikut:
 “Ëndërr të mirë Enkiduj ke parë, t’gëzueshëm shumë kuptimin ajo e ka. E ashpër lufta pa dyshim do t’jetë, por ne të dy Humbabën do ta mbysim”. Me mund u ngjitën në majë të malit, ku cedrat madhështorë e të harlisur e rrethojnë vendbanimin e hyjnive. Në bardhësinë që verbon, shkëlqen tempulli i shenjtë i hyjneshës *Irni*. *Tevona* ndihet një gulçim i frikshëm dhe drurët zënë thekshëm t’vërshtëllejnë. Shohin Humbabën vetëm duke ardhur, i ka të mprehta kthetrat si t’luanit;

me luspa t'hekurta trupin mbuluar
 thonjtë në këmbë sikur të skifterit;
 në kokë brirët si të demit t'egër, [...]
 “Çohu Enkiduj! Shamashi, zoti i diellit,
 neve tash jetën le të na e dhurojë!”
 Gjuajnë me shigjeta e me hobe,
 të gjitha këto përmbropa u kthehen,
 pa asnjë shenjë trupi i tij mbetet.
 Qëndron përpara tyre. Edhe e kap
 me kthetra t'mprehta e t'forta Enkidujin.
 Tevona mbreti shpatën vringëllon.
 Përtokë bie Humbaba i goditur
 dhe Gilgameshi kokën ia këput,
 me t'sheptë ia pret nga qafa luspa-luspa.
 Aherë e marrin trupin e fuqishëm
 duke e zvarritur e qesin në lëndinë –
 ta hanë zogjtë, për ushqim ua hedhin.
 Kokën me brirë n'shkop të gjatë ia vënë
 duke e bartur n'shenjë të fitores.
 Për n'mal t'hyjnive trimërisht vazhdojnë,
 n'për cedrat e harlisur, madhështorë,
 dhe n'fund arrijnë në majë të malit.
 Nga mali atëbotë një britmë ndihet,
 zëri i Irinës sa fort sokëllin:
 “Kthehuni prapa! Veprën tuaj e kryet,
 n'Uruk t'filloni, se ju pret qyteti!
 Në malin hyjnor, ku banojnë hyjnitë
 nuk ka arritur kurrë vdekatar.
 Kush i shikon n'fytirë perënditë
 atë përjetë vdekja do ta gjejë!”

Epi

Epi (epos) paraqet formën e gjatë të krijimit në vargje. Ai është një nga llojet më të vjetra të poezisë epike. Epi shquhet për rrëfimin madhështor mbi ngjarje jo të zakonshme dhe të rëndësishme që zhvillohen në një botë të çuditshme. Në të paraqitet heroizmi kolektiv dhe individual, por edhe vdekja heroike e heronjve. Epopeja thuhet ekskluzivisht është kënduar në vargje. Mentaliteti i njeriut të kohëve të hershme, tregon gjendjen që përjetonte njeriu përpara së panjohurës, e cila tek ai shkaktonte pasiguri dhe frikë në një anë dhe entuziazëm në luftën për mposhtjen e së panjohurës nga ana tjetër. Ai e ndiente veten të dobët para forcave objektive të natyrës, të cilave u jepte rol mbinatror. Këto forca, ai i mendonte në formën e hyjnive, të cilat përziheshin në fatet njerëzore. Si rrjedhojë e kësaj, bota epike e njeriut ishte botë e së çuditshmes dhe e fantastikes. Në pajtim me këtë, edhe personazhet e poezisë epike paraqiten në përmasa të mëdha, gjysmëperëndi – gjysmënjerez, kurse figura më e shpeshtë në përshkrimin e personazheve është hiperbola.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Për ku ishin nisur Gilgameshi dhe Enkiduji?
 - b) Kush i pa ëndrrat e çuditshme? Sa ëndrra panë dy trimat?
 - c) Kujt iu lut Gilgameshi në gjunjë dhe për çfarë ishte lutja?
 - ç) Për ku nisen, pasi vrasin Humbabën? A arrijnë dot atje? Kush i ndalon?

Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni në tekst vargjet ku tregohet miqësia dhe përkujdesja e madhe që ka Gilgameshi ndaj Enkidujit. Për çfarë ane të karakterit të tij flasin këto veprime?
- 3 Analizoni fjalët e hyjneshës Irninë. "Kthelhuni prapa! Veprën tuaj e kryet, n'Uruk t'filloni, se ju pret qyteti!" A mendoni se ajo ishte dakord me veprimin e Gilgameshit?
- 4 Në këtë epos shkrihen dhe bashkëjetojnë tri botë. Bashkoni me shigjetë cilës botë i përket secili prej personazheve (mund të ketë më shumë se një shigjetë ndërlidhëse).
 - ▣ Gilgameshi
 - ▣ Enkiduji njerëzit
 - ▣ Humbaba hyjnitë
 - ▣ Shamashi kafshët
 - ▣ Irnina
- 5 Analizoni mënyrën se si u drejtohen heronjtë tanë perëndive. Cilat janë arsyet që i shtyjnë heronjtë tanë të komunikojnë me hyjnitë?

Interpretoni tekstin

- 6 Në epose, ëndrrat janë një element i përdorur shpesh me funksion paralajmërues. Gjeni dy ëndrrat dhe analizojini ato duke shpjeguar dhe funksionin e tyre.
- 7 Irnina i ndalon Gilgameshin dhe Enkidujin të shkojnë në majë të malit. Cila është arsyeja?

Gjuha e tekstit

- 8 Cila është figura letrare në vargjet e mëposhtme?
*gjëmonte qielli, toka e tërë trandej,
të zezat re t'stuhisë po afroreshin*
- 9 Në analizën e Humbabës, cila është figura që është përdorur më shpesh?
*Shohin Humbabën vetëm duke ardhur
i ka të mprehta kthetrat si t'luanit;
me luspa t'hekurt trupin të mbluar
thonjtë në këmbë sikur të skifiterit;
në kokë brirët si të démit t'egër, ...*

Reflektojmë rreth tekstit

- 10 Cilës periudhë kohore mendoni se mund t'i përkasë "Epi i Gilgameshit"? Gjeni nga interneti informacione rreth hipotezave mbi kohën e krijimit të kësaj vepre.

Detyrë:

- ▣ Duke u nisur nga karakteristikat e Gilgameshit, trimëria dhe guximi, gjeni figura të tjera të ngjashme në eposet që njihni.

Fabula

Para leximit

Nëpërmjet një strukture të thjeshtë dhe me një gjatësi të shkurtër, fabulat, një lloj tregimi i shkurtër, kanë synuar të mësojnë një të vërtetë morale që fshihet në brendësi të tyre. Në pjesën më të madhe të rasteve, ato e rrëfejnë këtë moral nëpërmjet personazheve që janë kafshë si të "Cjapi dhe dhelpra", por kjo nuk është absolute, sepse ndodh që personazhet të jenë edhe njerëz si në rastin e fabulës së mëposhtme "E vërteta".

Cjapi dhe dhelpra

Një dhelpër ra njëherë në pus dhe u detyrua të presë, sepse nuk dinte si të dilte. Kur një cjac i shtyrë nga etja, erdhi në atë pus dhe e pa dhelpërën brenda, e pyeti se a ishte uji i mirë.

Dhelpra filloi ta lëvdonte e ta mburrte qartësinë dhe kthjelltësinë e ujit sa s'ka më.

Pastaj i tha: – Hajde më mirë këtu poshtë, se këtu e shijon më mirë.

Cjapi zbriti poshtë, pasi e kishte marrë etja, por pa se nuk dilte dot nga pusi.

– Si t'ia bëjmë tani? – tha cjac. – Si do të dalim prej pusit?

Dhelpra i tha:

– Mos u bëj merak. Kam menduar unë për të dy. Shiko si do të dalim... Vendosi këmbët e para në murin e pusit dhe afroji brirët. Kur të ngjitem unë lart mbi kurrizin tënd, do të të tërheq dhe do të të ndihmoj edhe ty.

Cjapi pranoi. Dhelpra kërcëu mbi shpatullat e tij, qëndroi në brirë, doli prej pusit dhe filloi të largohet.

Cjapi i thirri: – O dhelpër, po mua më harrove?

Cjapi e qortoi që nuk e mbajti fjalën e dhënë. Dhelpra u kthye e i tha:

– I dashur cjac, sikur të kishe aq mend sa ke qime në mjekër, ti as që do të zbritje në pus para se të mendoje se s'do kishe për të dalë.

Thonë se cjac, atje është akoma.

Morali: Njerëzit e mençur së pari duhet ta mendojnë mbarimin e punëve dhe pastaj të fillojnë të zbatojnë mendimet e veta.

E vërteta

Diku ishin mbledhur katër a pesë veta dhe bisedonin. Ndërhyn në bisedë një i pasur dhe thotë se miu i hëngri thikën e hekurt të plugut. Të gjithë e besuan këtë gjë si të vërtetë.

Ndërkaq, hidhet një i varfër dhe thotë se dhe atij miu i hëngri një çyrek bukë. Të gjithë e panë me dyshim, duke menduar se ai gënjente.



Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni fabulën “Cjapi dhe dhelpira” dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Çfarë e papriture i ndodhi dhelpres? A u përpoq ta zgjidhte me forcat e veta?
 - b) Në ç’mënyrë arriti të shpëtonte nga situata?
 - c) A e mbajti fjalën dhelpira?
- 2 Lexoni fabulën “E vërteta” dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Kush janë protagonistët e kësaj fabule?
 - b) Sa histori personale me minj u treguan në fabulë?
 - c) Cilën histori besuan njerëzit dhe cilën jo?

Analizojmë tekstin

- 3 Në sa pjesë mund ta ndani fabulën “E vërteta”? Çfarë i lidh të dyja pjesët në një fabulë të vetme?
- 4 Ndodh që dikush të shfrytëzojë të tjerët për të arritur qëllimet e tij. Në cilën prej fabulave ndodh kjo? A është gjë e mirë të përdorësh të tjerët? Si ndihesh, kur kupton se dikush po të shfrytëzon?

Interpretojmë tekstin

- 5 Në fund të fabulës “Cjapi dhe dhelpira” është shkruar një mesazh. A mund të nxirri ndonjë mesazh tjetër prej saj?
- 6 Zakonisht, nëpër fabula, personazhet janë kafshë siç ndodh në fabulën e parë. Ndërsa në fabulën “E vërteta”, personazhet janë njerëz. Cili është mesazhi i kësaj fabule? Diskutoni rreth tij.

Gjuha e tekstit

- 7 Në përgjithësi, rrëfimi i fabulave karakterizohet nga humori. Gjeni si ndërtohet humori në fabulën “Cjapi dhe dhelpira”.
- 8 Me cilën fjalë mund ta zëvendësoni këtë shprehje: *“sikur të kishe aq mend sa ke qime në mjekër”*?

Reflekojmë rreth tekstit

- 9 Cilat janë karakteristikat që e bëjnë një njeri të besueshëm për ju? Po për personazhet në fabulën “E vërteta”, çfarë vlerësohet për të krijuar besueshmëri?
- 10 Në fabulën “Cjapi dhe dhelpira”, një nga mesazhet që mund të nxirri, ka të bëjë me mirënjohjen. Diskutoni rreth vlerave të mëdha që ka mirënjohja.

Detyrë

- ▣ Gjeni edhe fabula të tjera, ku personazhet nuk janë kafshë dhe diskutoni për mesazhin e tyre.
- ▣ Tregoni dhe ju një rast, kur keni treguar diçka të vërtetë dhe nuk ju kanë besuar. Pse mendoni se nuk ju besuan?

Mençuria popullore

Para leximit

Një nga llojet më të njohura të krijimtarisë popullore janë anekdotat. Ato sintetizojnë shumë mençuri brenda tyre. Mençuria është ndërlidhje e disa funksioneve që krijon njeriun me mjedisin në të cilin jeton. Anekdotat janë tregime në të cilat mençuria dhe kënaqësia që merr nga leximi, janë të bashkuara në një. Ato, jo vetëm na bëjnë për të qeshur dhe na argëtojnë, por edhe na ndihmojnë që nëpërmjet tyre të gjejmë zgjidhje praktike. Nga ato mund të mësojnë fëmijët e të rinjtë, por janë këshilla për ata të rritur që nguten dhe marrin vendime të gabuara e të nxituara.

Unë kujtova se po thue: A e pe shqiponjën

Njëri e merr të birin dhe e çon në mal për jetojnë shtazët e egra. Këqyrin e këqyrin panë një shqiponjë që kish zënë një lepur dhe ishte duke e ngrënë. Pak më larg, panë edhe një dhelprë që ishte bërë pupërr dhe shikonte. Kur fluturoi shqiponja, dhelpra u afrua te mbeturina e lepurit dhe filloi t'i merrte erë e t'ia lëpinte gjakun... Kur i shikuan mirë, plaku e muarr të birin dhe u nis për në shtëpi. Duke ecur rrugës, priste çfarë po i thoshte i biri. Mas një copë rrugëtim, djali po i thotë:

– Babë, a e pa dhelprën si e l'pikë gjakun?
Babës nuk i erdhi hiç mirë dhe ia ktheu me hidhërim:

– Heu, bre bir, heu! Unë kujtova si po thue: “A e pe si e preu leprin” e jo “dhelprën si e l'pikë gjakun”.
qef t'bahesh si shqiponjë...

të parë se si
dhe dikur



shqiponjën
Se unë kam

Pse s'po m'vetni për rrafsh?

Një plak i urtë ishte pas nis për rrugë. Rrugës po takohet me disa udhëtarë të tjerë dhe gjatë bisedës këta po e pyesin:

– O mixhok, a kie ma qef me hecë përpjetëz a teposhtës?

Plaku po e çon kokën e po iu përgjigjet:

– Lanet i koftë njanës edhe qetrës! Po pse s'po m'vetni për rrafsh?

Nëse s'e kanë kimen të njëjtë, mos u frikoni

Ujqit dhe qentë kishin caktuar një ditë për të dalë në mejdan. Para se të fillonte mejdani, një ujk plak, i thotë një ujku të ri: – Dil e shih a kanë dalë shumë qen dhe a kanë të njëjtën kime.

Del ai ujku dhe, kur kthehet, i thotë ujkut plak se qentë ishin



kallaballëk i madh, por nuk ishin me të njëjtën kime.

– Sikur të kishin të njëjtën kime, kishte me qenë rrezik, por mbasi qenkan të llojlojtë, mos u frikoni hiç, se kemi me e fitu mejdanin, – u tha ujku plak.

Nepërka dhe bretkosat

Një nepërkë shkoi në një burim për të pirë ujë, por gjarpri i ujit e pengoi me zemërim, duke i thënë se asaj nuk i mjaftonte vendi që kishte, po vinte edhe në shtëpinë e tij.

E meqë grindja arriti kulmin, ranë në një mendje, që të ndesheshin midis tyre dhe fituesit t'i takonte edhe uji, edhe vendi.

Së fundi, caktuan kohën dhe vendin e dyluftimit.

Nga urrejtja që kishin për gjarprin e ujit, bretkosat shkuan te nepërka dhe i dhanë zemër, duke i premtuar se do të luftonin në krahë të saj. Filloi beteja e nepërka luftonte me gjarprin e ujit, ndërsa bretkosat, meqë nuk mund të bënin asgjë më shumë, ia dhanë një kuak-kuak me tërë fuqinë e tyre.

Kur fitoi, nepërka i qortoi se, me gjithë që i kishin premtuar të merrnin pjesë në beteje, jo vetëm që nuk e ndihmuan, po këndonin pa prerë së largu.

Atëherë ato i thanë: – Po duhet ta dish se bashkëpunimi ynë nuk u arrit me duar, por me zë.

Fabula tregon se aty ku duhen duar, ndihma me fjalë s'ka asnjë vlerë!

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni anekdotën “Unë kujtova se po thue: A e pe shqiponjën” dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Ku shkuan së bashku babai dhe i biri? Çfarë bënë atje?
 - b) Cilat kafshë dhe shpendë panë atje?
 - c) A bëri djali atë pyetje që priste babai i tij?
- 2 Cila ishte pyetja që i bënë Plakut udhëtarët në anekdotën “Pse s’po m’vetni për rrafsh?” dhe cila ishte përgjigjja e tij?
- 3 Lexoni anekdotën “Nëse s’e kanë kimen të njëjtë, mos u frikoni” dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Çfarë kanë vendosur të bëjnë ujkit dhe qentë së bashku?
 - b) Çfarë i kërkoi ujku plak dhe çfarë pyetjeje i bëri ai ujkut të ri?
 - c) A e qetësoi përgjigjja e ujkut plak tufën e ujqve?

Studim teksti

- 4 Lexoni anekdotën “Nepërka dhe bretkosa” dhe përgjigjuni pyetjeve.
- Pse u grindën gjarpri i ujit me nepërkën?
 - Si vendosën ta zgjidhnin këtë problem?
 - Cilat ishin ato që dolën vullnetare për të ndihmuar nepërkën?
 - Si u zgjidh konflikti mes nepërkës dhe gjarprit të ujit?
 - Po bretkosat çfarë roli patën në atë konflikt?

Analizojmë tekstin

- 5 Në fabulën “Nëse s’e kanë kimen të njëjtë, mos u frikoni”, ujku i ri pasi ka parë turmën e qenve që po priste në mejdan për t’u ndeshur thotë: “qentë ishin kallaballëk i madh, por nuk ishin me të njëjtën kime”.
- ▣ Cila është fjala që duhet të merrej seriozisht në këtë frazë?
 - ▣ Cila ishte arsyeja që ujku plak e përqendroi përgjigjen te lloji i qimeve?
 - ▣ A mendoni se ka ndonjë lidhje mes “kimeve” dhe trimërisë së qenve?

Interpretojmë tekstin

- 6 Interpretoni simbolet e lepurit, dhelprës dhe shqiponjës. Pse babai dëshiron që djali i tij të ishte shqiponjë?
- 7 Çfarë i bashkon nepërkën dhe bretkosat në anekdotën “Nepërka dhe bretkosat”?
- 8 Për cilën nga anekdotat e mësipërme mund të themi shprehjen e famshme “Rruga e mesme është rruga e artë”?

Gjuha e tekstit

- 9 Disa nga anekdotat kanë një gjuhë, e cila është larg gjuhës standarde. Çfarë tregon ky fakt:
- ▣ për kohën e krijimit;
 - ▣ për mënyrën sesi janë ruajtur ndër vite.

Reflektojmë rreth tekstit

- 10 Bretkosat i thanë nepërkës: “Po duhet ta dish se bashkëpunimi ynë nuk u arrit me duar, por me zë.”
- ▣ A mendoni se bretkosat bënë atë që mund të bënin?
 - ▣ A kishte ndonjë mënyrë tjetër që ato mund ta ndihmonin nepërkën?
 - ▣ A mendoni se ndonjëherë “tifoza” ka vlerën e vet në fitoren e një ndeshjeje?
- 11 A mendoni se kishte ndonjë rrugë tjetër për ta zgjidhur konfliktin mes nepërkës dhe gjarprit të ujit?

Detyrë

- ▣ Tregoni ndonjë rast nga jeta juaj kur dikush tjetër ju ka nxitur të bëheni pjesë e një grindjeje, por në fund nuk ju ka ndihmuar.
- ▣ Në dy prej anekdotave të mësipërme, mençuria e “pleqve” vlerësohet shumë. Çfarë i bën njerëzit e moshuar më të matur, më të mençur dhe më të ditur?

Lodra mbi akull

Para leximit

"Lodra mbi akull" është një nga tregimet e përmbledhjes "Të fala nga fshati", të shkrimtarit Sterjo Spasse. Libri është ndërtuar nga një sërë letrash. Secili prej tregimeve është një letër që Ylli ia dërgon Sokolit, shokut të tij bashkëmoshatar. Ylli jeton në fshat, ndërsa Sokoli në kryeqytet. Autori ka paraqitur në libër vetëm letrat e Yllit, por prej tyre nënkuptohet edhe çfarë ka shkruar Sokoli, sepse përmbajtja e tyre përmendet. "Lodra mbi akull" është një prej letrave të Yllit, në të cilën ai përshkruan ditët e mbushura me lojëra, madje ndonjëherë të rrezikshme, të fëmijëve në fshatin e tij të bukur buzë liqenit.

Fjalor

makar – të paktën, fundja, qoftë.
fellë – thellë.



Sterjo Spasse

Sterjo Spasse (1914–1989) është një shkrimtar shqiptar që filloi të shkruajë në vitet '30. Ndër shkrimet e botuara, përmendim: tregime, romane, por edhe studime pedagogjike e tekste shkollore. Spasse u dallua me krijimet e tij, sidomos në fushën e tregimit dhe në atë të romanit. Ai ka botuar katër përmbledhje me tregime: "Kuror rinie", "Në krahët e një femre", "Nusja pa duvak" dhe "Të fala nga fshati", si dhe dhjetë romane, ndër të cilat: "Pse?", "Afërdita", "Ata nuk ishin vetëm", "Afërdita përsëri në fshat", "Kryengritësit" etj.

Sokol,

Dimri vazhdon. Borë e të ftohtë kemi shumë. Sot në mëngjes u gdhi një ngricë e tillë që s'mbahet mënd. Ne mezi vajtëm në shkollë. Buza e liqenit kishte ngrirë disa metra thellësi. Lajmin e parë ma dha Vasoja që në mëngjes dhe pa prituri ta pyesnja më gjatë si shkoi. Unë nuk hëngra as mëngjesin dhe renda me të katra. Kur ç'të shihnja! Kish ngrirë i tërë liqeni! Gjë fort e rrallë ndër ne! Pleqtë s'e mbajnë mënd që të ketë ngrirë ndonjë dimër liqeni aqë shumë. Edhe babagyshit, ja i kujtohet, ja s'i kujtohet që të ketë ndodhur nj'a dy herë gjatë jetës së tij një gjë e tillë. Ishim grumbulluar tërë fëmijët e shumë prej tyre kishin guxim edhe rrëshqisnin mbi akullin e liqenit. Vasoja ishte i pari që hapi rrugën. Filloi bredhja me sa na hante vrapi përmes akullit. Kapeshin fëmijët katër e pesë dorë për dorë dhe fërrshsh... rrëshqisnin! Shumë nëna, që nga buza e liqenit, i qërtonin, u thërrisnin të largoheshin. Po kush i dëgjonte, se! Të them të drejtën, edhe mua më rrihte zemra: **makar** ta provonja njëherë. Kur do ti e më vjen Pirroja, më rrëmben me zor e më fut midis pesë-gjashtë shokësh të tjerë. Aqë desha dhe unë: fërrshsh... rrëshqitëm me këmbë gjer aty tutje gjatë bregut të liqenit, pa guxuar të shkonim më **fellë**. Kur po mateshim të bënim vrapimin e dytë nga prapa dëgjuam një "kërc" të rënduar, pastaj një "bëlduf" e po n'atë ças ulërima fëmijësh... Këthyem kryet, kur, ç'të shihnim: ishte çarë akulli në një vënd dhe njëra këmbë Vasos i qe futur brënda. Vasoja ishte shtrirë sa gjatë gjerë mbi akull dhe s'lëvizte fare! E ngritëm shpejt e shpejt. Disa fshatarë nga bregu na shanë rëndë e na trembën se po çahet akulli i tërë e se do të mbyteshim. Ne u zumë ngushtë. U larguam shpejt e shpejt me të rendur e me të rrëshqitur drejt bregut. Por në buzë të liqenit vazhduam të rrëshqisnim gjersa ra zilja e mësimit.

Të shihnje, Sokol, edhe një gjë tjetër: lopët, kuajt e kafshët e tjera shtëpijake këtij mëngjesi vërtiteshin buzë liqenit, se nuk kishin ku të pinin ujë. Shumë fshatarë çanë akullin me kazmë dhe çelnë gropa për të pirë ujë kafshët.

Orët e mësimit i kaluam me mëndje të ngritur. Padsdreke asnjë nxënës nuk mungoi buzë liqenit: disa kishin marrë me vete edhe nga një drasë. Drasën e lidhnin me litar; tre vetë rrinin mbi drasë, dy të tjerë tërhiqnin litarin dhe rrëshqisnin! Por më shumë rrëshqisnin grupe-grupe, të kapur përdore: rrëshqisnin drejt ose në formë rrethi si valle. Sa bukur që ishte! Herë rrëzohej njeri e mbahej pas shokëvet! Herë rrëzoheshin dy a tre me një herë – e atëherë i tërë grupi bëllduf mbi akull! Kush vritej në këmbë, kush në këllket, kush në dorë, por... lodra nuk u la gjersa u ngrys mirë!

Kështu e kaluam ditën e djeshme. Edhe sot lodra vazhdoi, por buzë liqenit, se djelli që pat rënë, si për çudi, e holloi akullin dhe ia patëm frikën, nuk guxonim të shkonim thellë. Dhe frikën më të madhe na e futi viçi i vogël i Gjergjit. Ai, me bishtin ngritur mbi kurriz, rendi buzë liqenit, pastaj i dha një vrap në thellësi, kur “kërc-trak” u ça akulli e viçi ra brenda n’ujë! Asnjëri nuk guxonte që t’i afrohej! Vetëm i ati i Gjergjit u përpoq sa ai e di: e lidhën këtej nga buza me litar; ai shkoi sa shkoi, por dëgjonte se nënë këmbët e tij kërciste akulli e nuk guxoi t’i afrohej viçit, që pat ngelur brenda në gropët t’akullit mbuluar me ujë. E pamë që u përpoq shumë viçi i shkretë për të shpëtuar, e pamë të përplitet si i zënë në çarkth; pamë edhe dëshpërimin e madh të babajt të Gjergjit e përpjekjet e shumë fshatarëvet, por mundi shkoi kot: kur vajtën fshatarët me lundër pas vijës që hapnë, e gjetën viçin të ngrirë në akull.

Fjalor

çarkth – çark: mjet për të kapur kafshët, shpendët.



Kjo ishte ngjarja më e madhe e ditës së djeshme e të soçme. Vetëm tani e kuptojmë se ç'marrëzi kemi bërë duke rrëshqitur aqë fellë dje e pardje. Paskemi shpëtuar si për çudi! Ne na erdhi shumë keq për Gjergjin që humbi viçin, të vetmin viç që kishin!

Fjalor

snegare – lloj shpendi.

Sot pasdreke ishte një diell i bukur! Ne fëmijët e kaluam pasdreken buzë liqenit: ndriçonte si çelik i tërë ai akull, vënde-vënde i çarë, vënde-vënde pllakë e tërë! Por duket që ka marrë të tatëpjetën: pamë edhe copa akulli të mëdha duke notuar në thellësi të liqenit! Herë-herë mbi 'to ven'e qëndrojnë **snegaret** e bardha ose rosat e zeza. Ne i kemi zili këta zogj, se na duket sikur vozitin si lundra akulli mbi liqen! Dhe sa e bukur që është një vozitje e tillë!

Të përshëndes, Sokol, me gëzimin e këtyre ditëve të fundit!
Ylli

Proza epistolare

Në disa raste, shkrimtarët përdorin në tekstet e tyre, letra, shënime ditarësh ose artikuj gazetash, madje edhe postë elektronike. Kjo lloj proze quhet epistolare. Përfaqësuesi më i njohur i saj është romani epistolar. Ai mund të jetë i ndërtuar në bazë të letrave që dërgon vetëm një person, në bazë të letrave që shkëmbejnë me njëri-tjetrin dy persona ose në bazë të shkëmbimit të letrave mes më shumë se dy personave.

I famshëm është romani "Drakula" i Meri Shellit. Roman epistolar është edhe romani "Ditari i Ana Frankut", i cili është bazuar në shënimet e një ditari. Rrallë ndodh që letrat ose ditarët e përdorur të jenë të vërtetë, por të shkruarit në formën e letrës ose ditarit e bën veprën të duket më realiste dhe më e besueshme. Proza në formë letrë paraqet mendime dhe ndjenja të brendshme të personazhit, pa ndërhyrje nga autori.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Atë ditë të ftohtë dimri, liqeni kishte ngrirë. A ndodhte shpesh ngrirja e liqenit në dimër?
 - b) Çfarë bënë fëmijët në liqenin e ngrirë? A ishte argëtuese një gjë e tillë?
 - c) Cila ishte ngjarja që i tronditi fëmijët? Çfarë shkaktoi ajo?
 - ç) Çfarë kuptojmë nga kjo pjesë? Cili është mesazhi i saj?

Analizojmë tekstin

- 2 Teksti është ndërtuar në formën e letrës. Çfarë i shton rrëfimit të ngjarjes përdorimi i kësaj forme?
- 3 Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet për të cilat rrëfëhet në këtë tekst?
- 4 Ngrirja e liqenit përjetohet me entuziazëm dhe frikë nga fëmijët. Gjeni në tekst ndodhitë që shkaktojnë ankth te personazhi.
- 5 Gjeni në tekst përshkrimet e ndjesive të fëmijëve ditën e parë dhe ditën e dytë.
 - ▣ Dita e parë: _____
 - ▣ Dita e dytë: _____

Studim teksti



- 6 Çfarë shtohet më shumë në ditën e dytë, kënaqësia apo ankthi? Pse?

Interpretojmë tekstin

- 7 Pse autori ka zgjedhur të rrëfejë një ngjarje të tillë?

- 8  Si i kuptoni fjalët e Yllit:

Vetëm tani e kuptojmë se ç'marrëzi kemi bërë duke rrëshqitur aq fellë dje e pardje. Paskemi shpëtuar si për çudi.

-  A përbëjnë ato mesazhin e pjesës?
 Po ju, a tregoheni gjithmonë të kujdesshëm kur luani? Pse?

- 9 Si e interpretoni shprehjen e mëposhtme.

Ne i kemi zili këta zogj, se na duket sikur vozitin si lundra akulli mbi liqen!






Gjuha e tekstit

- 10 Nënvizoni në tekst fjalët e shkruara në dialekt. Shkruajini ato në gjuhën standarde, sipas shembullit të dhënë.

Fjalët në dialekt	Fjalët në gjuhën standarde
pyesnja	pyesja
_____	_____
_____	_____
_____	_____

- 11 Çfarë tregon përdorimi i fjalëve dialektore në tekst?

- 12 Gjeni në tekst onomatopetë dhe shkruajini ato më poshtë.

-  _____
 _____
 _____
 _____
 _____

Onomatopeja është ajo figurë letrare që realizon imitimin nëpërmjet tingujve të zhurmave të qenieve të gjalla ose të zhurmave të dukurive natyrore: *kënga e zogjve (ciu-ciu), trokëllima e kuajve (trak-trak), lehja e qenit (ham-ham), zhurma e pyllit (fësh-fësh) etj.*

Sipas tingujve të imitimit të këtyre zhurmave, krijohen fjalët onomatopeike: *kukuvajkë, shushurimë, ulërimë etj.* Në letërsi, kjo figurë krijon atmosferë dhe emocion.

Reflektojmë rreth tekstit

- 13 Nisur nga fjalia: *Ne na erdhi shumë keq për Gjergjin që humbi viçin, të vetmin viç që kishin!* diskutoni për kujdesin që tregojmë ndaj gjërave, rëndësia e të cilave është jetësore dhe e pazëvendësueshme për ne.
- 14 Fëmijët dhe nënat e tyre kanë qëndrime të ndryshme ndaj lojës në akullin e liqenit. Po ju, a keni ndonjë qëndrim të ndryshëm nga ai i prindërve tuaj? Për çfarë?

Detyrë

-  Shkruani një tekst të shkurtër përshkrues në të cilin të përdorni sa më shumë onomatope.

Fshati mbi shtatë kodrina

Para leximit

Kjo pjesë letrare është shkëputur nga novela "Fshati mbi shtatë kodrina" e shkrimtarit Kasëm Trebeshina. Në pamje të parë, novela është shkruar në një stil që ka shumë tipare të letërsisë së traditës, të rrëfimit popullor. Proza duket sikur do të na fusë në një botë fantazie të mbushur me magji e mister si në përralla, por më pas e tëra jepet me një tis dyshimi për atë që ishte dhe për atë që është. Legjenda, përralla dhe historia bashkohen së bashku. Nëpërmjet kujtimeve të ngjarjeve të ndodhura në një fshat të vogël rrëfëhet për historinë shpirtërore të kombit. Përmes fatit individual, rrëfëhet fati i përgjithshëm i shqiptarëve dhe i Shqipërisë. Kjo vepër rrëfen për Shqipërinë, jetën dhe njerëzit e saj, duke u vështruar atyre shpirtin, mendësinë, traditën e zakonet.



Kasëm Trebeshina

Kasëm Trebeshina (8 gusht 1926 – 6 nëntor 2017) është një shkrimtar shqiptar, që filloi t'i botojë krijimet e tij në fillim të viteve '50. Pas njëfarë periudhe, atij iu ndalua e drejta e botimit, sepse kërkonte të shkruante një letërsi të lirë, larg ndikimeve politike. Pavarësisht ndalimit, ai vazhdoi të shkruante. Dorëshkrimet e tij u botuan vetëm pas viteve '90. Trebeshina është autor i shumë vëllimeve me poezi, tregimeve, novelave, si dhe i një numri të madh romanesh dhe dramash. Ai ka shkruar romanet: "Kënga shqiptare", "Odin Mondvalsen", "Rruga e Golgotës"; novelat: "Stina e stinëve", "Fshati mbi shtatë kodrina"; dramat: "Tiranozauri", "Ëndrra dhe hije" etj.

E pra, na ish njëherë një fshat që quhej... Nuk më kujtohet emri i tij!... Quhej... Ç'rëndësi ka të vrasim mendjen për të kujtuar atë që kemi harruar, kur edhe pa atë mund të bëhet puna si jo më mirë? Më vonë, ka shumë të ngjarë ta kujtosh atë gjë pa e çarë kokën për të. Kështu ndodh, ndaj edhe unë nuk po mundohem ta kujtoj emrin e atij fshati se mund të bëjmë shumë mirë edhe pa atë emër.

Fshati është fshat dhe qëndron atje tek qëndron dhe nuk e tund as... Le të themi topi i gorricës... Po... po. Ai qëndron atje, është atje tek është dhe quhet ashtu si quhet. Pavarësisht se ia dimë ne emrin ose jo, pavarësisht në mendojmë ne për të ose jo. Që t'i biem shkurt (se gjatë nuk i biem dot, jo se nuk kemi nge, po ngaqë nuk ia kemi fuqinë), fshati për të cilin shkruam më sipër dhe po vazhdojmë të shkruajmë ishte dhe, megjithëse nuk më kujtohet emri i tij, ngrihej mbi shtatë kodrina në formë elipsi dhe në mes kishte një qendër më të ulët.

Të shtatë kodrinat përbënin të shtatë **mëhallët** dhe qendra kishte vetëm një kullë të rrëzuar dhe një **mekam** të shenjtë. Kjo qendër dukej e çuditshme dhe sikur nuk ishte qendër. Mëhallët sikur mbaheshin dora-dore me njëra-tjetrën dhe quheshin... Dreq e gjysmë!... Si mund të kujtoj emrat e mëhallëve kur nuk më kujtohet as emri i fshatit? Njeriu kur harrokërka, i harrokërka të gjitha! Të gjitha!... I harrokërka të mirat dhe të ligat, të rëndësishmet dhe të parëndësishmet!

Po fshati ishte dhe qëndronte i ndërtuar mbi të shtatë kodrat... Të paktën, kështu ishte që nga kohët e vjetra që nuk i mbante mend njeri. Kështu ishte edhe në kohët e vjetra që nuk i mban mend njeri. Kështu ishte edhe në vitin... Nuk më kujtohet viti!.. Po këtë edhe mund ta gjejmë: atë vit ishte luftë. Kjo është e sigurt: ishte luftë, se ishte luftë dhe kur ishte luftë, luftohej se ishte luftë. Me sa mbaj mend unë... Sa i nxituar që jam!... Ishte luftë!... Më parë se të ishte luftë, nuk ishte luftë. Ishte një gjë... Si të thuash. Një gjë si e papërcaktuar, në mes të luftës dhe paqes. As luftë dhe as paqe. As paqe dhe as luftë. Dhe ishte verë. Po, po! Me sa mbaj mend, ishte verë. Jo se nuk kishte dimër në atë vend, por atë vit ishte verë, se më pas erdhi vjeshta dhe

pas saj erdhi dimri... Se, kur i thonë fjalës, stinët **këmbehen** radhazi dhe nuk e ngatërrojnë kurrë radhën: sa ikën dimri, vjen pranvera... Pastaj vera, vjeshta dhe, si ikën kjo e fundit, pasi mbledh vreshtat dhe gjithë të tjerat si ia do zanati, nderi dhe muhabeti, ia lë vendin dimrit përsëri. Kështu ka qenë që nga kohët e vjetra që nuk mbahen mend dhe kështu do të jetë gjer **në jetë të jetëve**.

Kështu ishin punët dhe punët vinin e shkonin së bashku me stinët. Punët vinin dhe shkonin dhe ai fshat qëndronte mbi shtatë kodrina, në mes të maleve që largoheshin ose afroheshin sipas kohës që bënte. Mund që ndonjërit t'i duket e çuditshme, veç edhe pse është e çuditshme me të vërtetë, mbetet gjithnjë ashtu e vërtetë, më e vërtetë se e vërteta vetë. E tillë është Shqipëria. Mund të ketë edhe vende të tjera që ngjajnë me vendin tonë, por ne këtë njohim dhe për këtë shkruajmë, të tjerët le të shkruajnë për vendin e tyre. Shqipëria e tillë është, kush nuk e beson le ta provojë, pastaj le të na e thotë mendimin e vet. Shqipëria, miq dhe dashamirë, ose më mirë le të themi malet e Shqipërisë, malet që t'i sheh syri kudo që të jesh, janë të çuditshme.

Sikur i ka magjepsur një fuqi e mrekullueshme; ti i shikon në një ditë të pastër, kur dielli shkëlqen madhërisht në kupën e qiellit dhe ato të duken të kaltëruara, të mjegulluara, të menduara, të bukura sa më s'thuhet... Po të largëta dhe që s'arrihen dot!... I sheh dhe nuk i sheh.

Fjalor

mëhallë – lagje.

mekam – varri i një të vdekuri të shquar për virtyte fetare e njerëzore, varri i një shenjtori.

këmbehen – shkëmbehen me njëra-tjetrën.

në jetë të jetëve – gjithmonë.

Eseja

Eseja është një lloj shkrimi që paraqet, përshkruan a mbron një ide ose pikëpamje. Kryesisht esetë janë dy llojesh: letrare dhe joletrare.

Eseja letrare është një lloj shkrimi që synon të interpretojë një temë të dhënë, duke arsyetuar logjikisht, përmes një stili personal në mënyrën e përdorimit të gjuhës. Pra, ky lloj shkrimi është një bashkim mes analizës logjike dhe krijimit artistik. Përgjithësisht, nëpërmjet këtij lloj shkrimi analizohen vepra letrare, si: poezi, shfaqje teatrore, muzikore etj.



Fjalor

mavi – blu e mbyllur.

Janë aty para syve të tu dhe ti nuk i sheh duke i parë, nuk i arrin dot. E kupton që nuk mund të arrish atje kurrë... Vetëm dëgjon disa këngë... E kush i këndon ato këngë?... Ku këndohet?!... Ajo nuk dihet!... Po këngët këndohen dhe malet janë diku aty, të paarrtshme. Zoti im! Ku e kanë gjetur këtë bukuri këto male? Po kur moti është i vrenjtur?... Po kur moti është i vrenjtur?... Hej, si duken atëherë! Marrin një pamje të zemëruar, një ngjyrë të thellë mavi dhe ngrihen të egra pikërisht përpara vështrimit tënd. Ngrihen të egra, të heshtura, të pakalueshme!... Ngrihen të gjalla, sikur të kishin një shpirt njerëzor që ka kaluar provat e gjata dhe të rënda të jetës... Të tilla janë malet e Shqipërisë!

Më duket se dikush po qesh me këtë vend, këto dy pëllëmbë vend që kemi ne. E dimë që ka vende më të bukura më të mëdha në botë, po e dimë se ka diej edhe më të mëdhenj se dielli ynë në hapësirat e pakufishme të gjithësisë. Ka... Dhe ç'nuk ka?!... Të gjitha janë dhe të gjithë ne i dimë... Se ky është shekulli XX, shekulli kur çdo njeri mund të hedhë një satelit në orbitën e Rignonit, Plepit... qoftë dhe në atë të Diellit...

Novela

Novela është lloj i prozës më i shkurtër se romani, por më i gjatë se tregimi. Novela rrjedh si emërtim nga fjala latine *novellus*, që do të thotë "i ri" dhe me këtë nënkuptohet që në qendër të saj duhet të jetë një ngjarje e re, shpesh nënkupton të treguarit e ngjarjeve të çuditshme.

Ajo trajton një motiv të vetëm, rrotull të cilit zhvillohen ngjarjet dhe arrin në një përfundim të befasishtëm. Motiv i zgjidhet të jetë tërheqës dhe që sjell të papritura.

Novela ka një numër të kufizuar personazhesh, aq sa ka raste ku vetëm protagonist i jepet i ravijëzuar qartë, ndërsa personazhet e tjera jepen pak.

Novela ka ngjashmëri me përrallën, veçanërisht kur tek ajo gërshetohen elementet realiste dhe fantastike.

Në novelë, pjesa më e madhe e tekstit përbëhet nga rrëfimi, i cili mbizotëron në raport me dialogun.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Në çfarë relievi është ndërtuar fshati për të cilin flet proza?
 - b) Në cilën stinë të vitit zhvillohen ngjarjet që do të rrëfohen?
 - c) Çfarë përfshin brenda vetes fshati?

Analizojmë tekstin

- 2 Në çfarë vete rrëfëhet në këtë prozë? Pse mendoni se natyrës së kësaj proze i përshtatet rrëfimi në këtë vetë?
- 3 Rrëfimi herë duket si fantazi, herë duket se është rrëfim i ngjarjeve të ndodhura vërtet. Cilat janë arsyet që e shtyjnë rrëfimtarin ta nisë sikur do të rrëfejë një përrallë e më pas një prozë realiste?

Studim teksti

- 4 Përshkrimi i fshatit bëhet nëpërmjet kujtimeve të autorit. Siç është normale, njeriu nuk mund t'i mbajë mend të gjitha, pasi jo gjithçka lë mbresë në nënvetëdijen e tij. Nisur nga fakti që rrëfimtari vazhdimisht thotë se ka harruar, flisni për ndryshimin mes kohës së rrëfimit dhe kohës kur mendohet se kanë ndodhur ngjarjet e rrëfyera.

Interpretojmë tekstin

- 5 Pse rrëfimtari u drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë lexuesve, duke i quajtur ata *miq dhe dashamirës*?
- 6 Në novelën për fshatin që ngrihet mbi shtatë kodrina, rrëfimtari ndalon gjatë në përshkrimin e maleve. Pse e bën një gjë të tillë? Çfarë simbolizojnë ato për të? Po këngët?
- 7 Duke pasur parasysh shprehjen "stinët e jetës", interpretoni frazën e shkëputur nga teksti i mësipërm:
Jo se nuk kishte dimër në atë vend, por atë vit ishte verë, se më pas erdhi vjeshta dhe pas saj erdhi dimri...

Gjuha e tekstit

- 8 Nënvizoni në tekst pjesët kur rrëfimit i vishen nota humori dhe diskutoni në klasë për këtë karakteristikë të stilit të shkrimtarit.
- 9 Dalloni në tekst pjesët në të cilat rrëfimtari bën monolog. Çfarë tregon përdorimi i këtyre monologëve në këtë pjesë?
- 10 Përcaktoni figurat letrare:
- dielli shkëlqen madhërisht në kupën e qiellit _____
 - pa e çarë kokën për të _____
 - mëhallët sikur mbaheshin dora-dore me njëra-tjetrën _____
 - dy pëllëmbë vend _____
 - malet marrin një pamje të zemëruar, një ngjyrë të thellë mavi _____
 - sikur të kishin një shpirt njerëzor që ka kaluar provat e gjata dhe të rënda të jetës _____
- 11 Në këtë tekst, vendin më të madh e zë:
- përshkrimi;
 - rrëfimi;
 - dialogu;
 - arsyetimi.

Reflekojmë rreth tekstit

- 12 Komentoni frazën: *E dimë që ka vende më të bukura më të mëdha në botë, po e dimë se ka diej edhe më të mëdhenj se dielli ynë në hapësirat e pakufishme të gjithësisë...*

Detyrë

- Shkruani një ese përshkuese për vendlindjen tuaj.

Djali me pizhame me vija

Para leximit

“Djali me pizhame me vija” është një roman që përshkruan atë që ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore në kampet e përqendrimit të nazistëve. Bruno, djali i vogël i një ushtaraku të lartë nazist, i cili kishte marrë detyrën e re të drejtonte kampin e përqendrimit, njihet me një djalë, i cili qëndronte brenda gardhit me tela. Ai e kishte emrin Shmuel dhe shpejt bëhet shoku i tij i vetëm. Ata janë moshatarë dhe asnjëri nuk është i kënaqur që gjendet në atë vend, të detyruar të jetojnë aq larg shtëpisë dhe shokëve të tyre.

Përkthyer nga Elda Beta

* * *

Fjalor

i sertë – i egër.

ngriheshin pincë në këmbë – qëndronin drejt.

nuancë – ngjyrim.

vërdallisem – sillem rreth e rrotull, sa andej-këtej.

hop – çast.

duzinë – këtu: me shumicë.

Dukej sikur ata që jetonin dhe punonin së bashku në krah të shtëpisë ku ai jetonte, ishin një qytet më vete. Vërtet ishin kaq të ndryshëm? Në kamp të gjithë visheshin njësoj, me të njëjtat pizhame e kapele me vija; kurse gjithë ata që endeshin nëpër shtëpi (përveç mamit, Gretelit dhe atij vetë) vishnin uniforma me cilësi të ndryshme dhe dekorata, kapela ose helmata, mbanin shirita kuqezi të ndritshëm, kishin armë dhe dukeshin gjithmonë shumë të sertë, sikur ajo që po bënë të ishte shumë e rëndësishme dhe asnjë nuk duhet të mendonte për tjetër gjë. “Ku qëndronte ndryshimi? – pyeste veten. – Dhe, kush e vendosi se kush duhet të vishte pizhame me vija dhe kush duhet të vishte uniformë?” Sigurisht që të dyja grupet përziheshin. Shpeshherë i kishte parë njerëzit të jetonin në anën e tij, të kalonin në anën tjetër të gardhit dhe, çdo herë, dukej qartë që ata ishin të ngarkuar me ndonjë detyrë. Njerëzit me pizhame ngriheshin pincë në këmbë sa herë që u afroreshin ushtarët, ndonjëherë shtriheshin në tokë, por ndonjëherë ndodhte që ata nuk ngriheshin fare, por zhdukeshin.

“E çuditshme që s’e kam vrarë asnjëherë mendjen për këta njerëz”, – mendoi Brunoja. Ishte e çuditshme edhe kur kujtoi sa shumë herë shkonin ushtarët tek ata – madje, edhe babi ca herë – por asnjëherë ata nuk ia kishin kthyer vizitën dhe as i kishte ftuar njeri të vinin në shtëpi.

* * *

Djali ishte më i vogël se Brunoja, ishte ulur në tokë dhe kishte një pamje të mjerë. Kishte mbathur pizhamet me vija si gjithë të tjerët nga ana tjetër e gardhit dhe në kokë mbante të njëjtën kapelë si ata. Nuk kishte veshur këpucë apo çorape dhe këmbët i kishte tërë zhul. Në krahë kishte një shirit me një yll.

Kur Brunoja iu afrua, ai ishte ulur këmbëkryq në tokë dhe vështronte pluhurin poshtë vetes. Megjithatë, pas një çasti, ai ngriti sytë dhe Brunoja arriti t’i shihte fytyrën. Ishte një fytyrë vërtet e çuditshme. Lëkura ishte pothuajse ngjyrë gri, por në një nuancë grije të paparë deri atëherë. Sytë ngjyrë karamелеje, me të bardhat më tepër se të bardha, i kishte vërtet të mëdhenj dhe ajo që arriti të shihte Brunoja aty, ishin vetëm një palë sy të pikëlluar.



John Boyne

John Boyne (1971, Dublin) është shkrimtar irlandez bashkëkohor. Ai është autor i një sërë romanesh për të rritur, por ka shkruar edhe romane për fëmijë dhe të rinj, si dhe përmbledhje me tregime. Libri “Djali me pizhame me vija” është vepra e tij më e njohur, e cila është përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe është ekranizuar.

Brunoja mund të bënte be që s'i kishin zënë sytë kurrë më parë ndonjë djalë më të dobët dhe më të pikëlluar se ai, prandaj mendoi se do të ishte më mirë t'i fliste.

– Isha duke eksploruar, – i tha.

– Vërtet? – pyeti djali i vogël.

– Po. Zëre se po bëhen dy orë që kur kam nisur.

Ai, në fakt, s'po i tregonte të vërtetën, sepse kishte veç një orë që vërdallisej për eksplorimin e tij, por mendoi se s'kishte ndonjë gjë të keqe po ta zmadhonte edhe ca. Në fund të fundit, nuk ishte e njëjta gjë si të gënjeje, ama e bënte atë të dukej edhe më aventurier seç ishte.

– Ke gjetur ndonjë gjë? – e pyeti djali.

– Eh!

– Fare-fare?

– E po, ja, të gjeta ty, – tha Brunoja pas një **hopi**.

Ia nguli sytë djalit gjithë kërshtëri dhe pyeti veten nëse duhet t'i kërkonte pse dukej kaq i trishtuar, por ngurroi kur i shkoi në mendje se kjo mund të tingëllonte si diçka e pasjellshme. Ai e dinte se ndonjëherë, kur njerëzit ishin të mërzitur, nuk kishin dëshirë që t'i pyeste njeri; ndonjëherë ata flasin vetë dhe ndonjëherë nuk ndalojnë së foluri për muaj me radhë, por, në këtë rast, Brunoja mendoi se duhet të priste para se të nxirrte ndonjë fjalë. Gjatë eksplorimit, arriti të zbulonte diçka dhe tani që më në fund po fliste me një nga njerëzit e anës tjetër të gardhit, nuk donte t'i ikte nga duart kjo mundësi.

U ul në tokë nga ana e tij e gardhit, i kryqëzoi këmbët si djali i vogël dhe i erdhi keq që s'kishte me vete ndonjë copë çokollate apo ëmbëlsire që ta ndante bashkë me të.

– Unë jetoj te shtëpia këtej nga ana tjetër, – i rrëfeu Brunoja.

– Vërtet? E pashë një herë shtëpinë nga larg, por jo ty.

– E kam dhomën në kat të parë dhe që aty mund të shoh përtej gardhit. Dhe, meqë ra fjala, unë quhem Bruno.

– Kurse unë Shmuel, – tha djali i vogël.

Brunoja shtrembëroi fytyrën, pa qenë i bindur nëse e kishte dëgjuar mirë atë që tha djali.

– Si e kishe emrin? – e pyeti.

– Shmuel, – ia ktheu djali, sikur të ishte gjëja më normale në botë. – Po ti, si the që e kishe?

– Bruno.

– S'ma ka zënë veshi ndonjëherë këtë emër, – tha Shmueli.

– As mua tëndin, – tha Brunoja, – Shmuel, – po e bluante në mendje. – Shmuel, – përsëriti me vete. – Më pëlqen se si tingëllon kur e shqiptoj. Shmuel. Duket si tingulli i erës kur fryn.



– Bruno, – tha Shmueli, duke e ulur kokën i lumtur. – Po, mendoj se edhe mua më pëlqen emri yt. Duket si emri i dikujt që të fërkon krahët për të të mbajtur ngrohtë.
 – Asnjëherë më parë nuk kam takuar ndonjë me emrin Shmuël, – tha Brunoja.
 – Nga kjo anë e gardhit, ka një **duzinë** me Shmuëlë, – tha djali i vogël. – Ndoshta qindra. Do të doja të kisha një emër të veçantë.
 – Unë s’kam takuar ndonjë me emrin tim, – tha Brunoja. – Përveç meje, sigurisht. Mendoj se unë duhet të jem i vetmi.
 – Atëherë qenke me fat.

[...]

– Nga vjen ti? – e pyeti Shmueli, duke picërruar sytë dhe duke e parë Brunon me kureshtje.
 – Nga Berlini.
 – Ku ndodhet ky?

Brunoja hapi gojën për t’u përgjigjur, por kuptoi që s’e dinte dhe aq me siguri.

– *Është në Gjermani, sigurisht. Ti nuk je nga Gjermania?*

– Jo, unë jam nga Polonia, – tha Shmueli.

Brunoja rrudhi vetullat.

– Po atëherë, çne që flet gjermanisht? – e pyeti. – Sepse ti më përshëndete në gjermanisht, prandaj.

– Po ti, mund të flasësh polonisht?

– Jo, – tha Brunoja, – unë nuk njoh ndonjë fëmijë tjetër të moshës sime që mund të flasë dy gjuhë. Mami im ishte mësuese në shkollë dhe ajo më mësoi gjermanisht. Para se të vinim këtu, jetoja me mamin, babin dhe me vëllanë e vogël, Jozefin, në një apartament të vogël mbi dyqanin ku babi ndreqte orët... Pastaj gjërat ndryshuan përsëri. Një ditë, kur erdha në shtëpi, mami më tha që nuk mund të jetonim aty.

– Kështu ndodhi edhe me mua! – thërriti Brunoja i kënaqur që nuk kishte qenë i vetmi që ishte detyruar të largohej nga shtëpia.

Fabula shënon vetëm vargun e ngjarjeve kryesore, por jo gjithçka që përmban vepra. Një vepër letrare përfshin brenda saj ngjarje, përshkrime, një shumësi ndjenjash, mendimesh, qëndrimesh etj. Të gjitha këto përbëjnë përmbajtjen e veprës. Përmbajtja përfshin gjithë lëndën e veprës, madje edhe titullin, ndërsa fabula shënon vetëm rrjedhën e ngjarjeve kryesore.

Subjekti i një vepre letrare tregon rendin që ndjek një vepër dhe mënyrën e lidhjes së ngjarjeve, e cila nuk mund të priset, sepse ndryshe humbet kuptimi i veprës. Shpesh gabohet kur barazohet subjekti me fabulën. Në të vërtetë, fabula përbëhet nga ngjarjet kryesore, ndërsa subjekti nga rendi i ngjarjeve dhe nga mënyra sesi rrjedhin ato në veprën letrare.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Duke u nisur nga informacionet që marrim në tekst, për çfarë lloj kampi mendoni se flitet?
 - b) Si visheshin njerëzit brenda gardhit të kampit? Po në shtëpinë e Brunos?
 - c) Kush ishte pjesëtari i vetëm i familjes që e kalonte gardhin me tela? Kush tjetër, nga ata që njihite Brunoja, kishte të drejtë të kalonte në të dyja anët e gardhit?
 - ç) Ç’po bënte Brunoja, kur dalloi djaloshin e vogël brenda gardhit? A kishte ndonjë shenjë dalluese në rrobat e djalit?
 - d) Çfarë i bëri përshtypje Brunos te Shmueli? Pse autori e përshkruan me detaje të hollësishme fytyrën e djalit? Çfarë kërkon të vërë në dukje?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

- 2 Në tekst vihet në dukje se emri Shmuel është emër shumë i përhapur, *një duzinë*, ndërsa ai i Brunos i përveçëm, *i vetmi*. Në kuptim të figurshëm, ç'kërkon të na tregojë rrëfimtari me këtë?
- 3 Mes dy djemve të së njëjtës moshë që jetojnë kaq pranë njëri-tjetrit, qëndron një gardh. Gjeni në tekst sa herë përmendet fjala "gardh" dhe shpjegoni çfarë simbolizon ai, duke iu përgjigjur pyetjeve:
 - ▣ Përse nevojitej gardhi me gjemba?
 - ▣ Si e përjetojnë Brunoja dhe Shmueli telin që i ndan? A janë ata plotësisht të ndërgjegjshëm për të?
- 4 Duke u nisur nga informacionet e marra nga teksti dhe nga fotografitë që e shoqërojnë atë, bëni krahasimin mes Brunos e Shmuelit.
 - ▣ *Krahasojmë portretet fizike.*
Shmueli e ka lëkurën e fytyrës pothuajse ngjyrë gri...
Brunoja...
 - ▣ *Krahasojmë familjet, edukimin.*
Prindërit e Brunos janë gjermanë dhe babai i tij është ushtarak me uniformë...
Prindërit e Shmuelit janë...
 - ▣ *Krahasojmë rrethanat në të cilat kanë lindur dhe jetojnë.*
Brunoja jetonte në Berlin. U largua prej andej kur babai i tij u bë komandant i kampit...
Shmueli jetonte në Poloni, por...
 - ▣ *Krahasojmë gjendjet e tyre shpirtërore.*
Brunoja ishte i pakënaqur që ishte detyruar të largohej, i vetmuar...
Shmueli...

Interpretojmë tekstin

- 5 Si i kuptoni fjalitë: "*Ku qëndronte ndryshimi? – pyeste veten. – Dhe, kush e vendosi se kush duhet të vishte pizhame me vija dhe kush duhet të vishte uniformë?*" Ku qëndron dilema e djalit?
- 6 Përshkruani përjetimin emocional të Brunos gjatë takimit me Shmuelin.

Gjuha tekstit

- 7 Në paragrafin e parë përdoren fjalët antonime të *ndryshëm/njësoj*. Shpjegoni përdorimin e tyre për njerëzit në të dyja anët e gardhit.
- 8 Gjeni në tekst epitetet me të cilat përshkruhet gjendja e Shmuelit, në çastin kur takohet me Brunon.

Reflektojmë rreth tekstit

- 9 Si mendoni, çfarë ndjenjash shkakton mungesa e lirisë tek individit? Flisni rreth kësaj çështjeje duke u mbështetur në tekstin e mësipërm.
- 10 Reflektoni rreth shprehjes: *Të ndryshëm, por të ngjashëm*.

Detyrë


- ▣ Shikoni filmin "Djali me pizhame me vija" dhe shkruani një ese rreth tij.

Të mjerët

Para leximit

"Të mjerët" është romani më i famshëm i Viktor Hygoit. Në qendër të romanit është Zhan Valzhani një ish-i burgosur, sepse kishte vjedhur dy bukë për të ushqyer fëmijët e motrës. Pas burgut, jeta e tij do të jetë do të jetë një rrugëtim i vështirë. Ai do të njohë Fantinën, një grua e braktisur, që bën gjithçka për t'i dhënë një jetë më të mirë së bijës, Kozetës. Në momentet e fundit të jetës së saj, Zhan Valzhani i premtonte Fantinës se do të kujdeset për vajzën e saj. Zhan Valzhani ua mori Tenardjeve Kozetën që e përdornin si shërbëtoreshë dhe u përkujdes për të si për vajzën e tij. Ata jetojnë një periudhë kohe në një kuvend murgeshash, ku Kozeta merr mësimet e para, ndërsa Zhan Valzhani punon si rojtar. Një ditë, ata largohen që atje.

Përkthyer nga Misto Treska



Viktor Hygoi

Viktor Hygoi (Victor Hugo 1802-1885) ishte poet, dramaturg, shkrimtar, eseist, aktivist i zellshëm i të drejtave dhe lirive të njeriut. Ai shkroi pothuajse në të gjitha gjinitë letrare, nga lirika, te tragjedia, te zakonet, te satira politike, te romani historik e social, duke nxitur një adhurim të jashtëzakonshëm dhe të pranuar nga të gjithë. Në krijimtarinë e tij poetike, në përmbledhjet "Ode", "Mendimet", "Legjenda e shekujve" ka treguar se është një poet lirik i spikatur. Ai është bërë i pavdekshëm me romanet e tij "Njeriu që qesh", "Katedralja e Parisit", "Të mjerët", "Punëtorët e detit". Hygo është konsideruar edhe si babai i drejtimit letrar të romantizmit.

Kur doli Kozeta nga kuvendi, ishte akoma pothuajse fëmijë; ajo ishte pak më shumë se katërbëdhjetë vjeçe dhe ishte në moshën e pubertetit...

Ajo nuk dinte asgjë nga bota, gjë e hijshme, por edhe e rrezikshme. Shpirti i një vajze të re nuk duhet të lihet në errësirë, më vonë në atë shpirt bëhen vegime tepër të befasishme dhe tepër të gjalla, si në ndonjë dhomë të errët. Ai shpirt duhet ndriçuar me ngadalë dhe me kujdes, më mirë me anën e refleksit të realiteteve, sesa me anën e dritës së tyre të drejtpërdrejtë dhe të ashpër. Gjysmëdritë e dobishme dhe hijerëndë me lezet, që largon dhe zhduk frikën miturake dhe ndalon gremisjet. Asgjë tjetër përveç instinktit të nënës, intuitë e admirueshme, ku hyjnë dhe përvoja e gruas, nuk mund të dijë më mirë se si dhe me se duhet të bëhet kjo gjysmëdritë. S'ka gjë që mund të zëvendësojë këtë instinkt për të brumosur shpirtin e një vajze të re, edhe sikur të gjitha murgeshat e botës të mblidhen, nuk vlejné sa një nënë e vetme.

Kozeta nuk kishte pasur nënë. Për sa i përket Zhan Valzhanit, ai i kishte në vetvete të gjitha dhembshuritë njëherësh dhe të gjithë përkujdesjet; por ai ishte vetëm një burrë plak. Që nuk dinte gjë prej gjëje, por sa shumë shkencë u dashka në këtë vepër të edukimit, në këtë detyrë të rëndë të përgatitjes së një gruaje për jetën, për të luftuar kundër asaj padijes së madhe që quhet pamëkatësi!

Duke u larguar nga kuvendi, Kozeta s'kishte ku të gjente gjë më të ëmbël dhe më të rrezikshme se shtëpinë e rrugës "Plume". Aty ishte vazhdimi i vetmisë dhe fillimi i lirisë; një kopsht i mbyllur, por një natyrë e gjallë, e pasur, e harlisur dhe tërë kundërmime.

Por, po e përsëritim, kur ajo arriti aty, ishte akoma vetëm një fëmijë. Zhan Valzhani i dorëzoi këtë kopsht të papunuar. "Këtu bëj ç'të duash", i thoshte ai Kozetës. Kjo punë e argëtonte Kozetën: ajo trazonte të gjitha kaçubat dhe s'linte gur pa lëvizur për të kërkuar "shtazë"; ajo luante atje, duke pritur kohën që të ëndërronte: ajo e donte këtë kopsht për insektet që gjente nën këmbët e saj përmes

barërave, duke pritur kohën që këtë kopsht ta donte për yjet, që do të shikonte përmes degëve sipër kokës së saj.

Pastaj ajo e donte babanë e vet, domethënë Zhan Valzhanin, me gjithë shpirt, me një pasion të dëlirë bijor, që e bënte atë babëlok babaxhan një shok të dëshiruar dhe shumë të këndshëm... Në bisedimet e tyre kokë më kokë, ai bënte shpjegime të gjata për gjithçka, duke gërmuar nëpër ato që kishte lexuar, duke gërmuar edhe në ato që kishte hequr e vuajtur. Kozeta e adhuronte këtë babaçko. Ajo i qëndronte gjithnjë pranë e s'i ndahej. Atje ku ishte Zhan Valzhani, ishte mirëqenia. Duke qenë se Zhan Valzhani nuk banonte as në shtëpi, as në kopsht, asaj i pëlqente më shumë oborri i përparmë, i shtruar me plloça, sesa avllia plot me lule, dhe më shumë kthina e vogël e mobiluar me karrige me kashtë, sesa salloni i veshur me tapiceri, ku qëndronin radhë-radhë kolltukët e bukur dhe të mbushur. Zhan Valzhani i thoshte ngandonjëherë duke buzëqeshur nga lumturia që ndiente që po e trazonin: “Po ik tani në shtëpinë tënde! Lërmë pak të qetë edhe mua!”

Ajo i bënte ca nga ato gërnja të këndshme e të ëmbla, që janë aq të hijshme kur dalin nga vajza dhe i drejtohen babait.

– Baba, këtu në shtëpinë tuaj kam shumë ftohtë; përse nuk shtroni këtu një qilim a nuk vini një sobë?

– Bijë e dashur, ka kaq e kaq njerëz që vlejnë më shumë se unë dhe s'kanë as çati ku të futin kokën.



Romani

Romani është lloji i gjatë i prozës artistike, brenda të cilit gjenden disa linja të zhvillimit të ngjarjeve që thuren me njëra-tjetrën. Në roman nuk paraqitet një ngjarje ose jeta e një personazhi, por përfshihen shumësi ngjarjesh që janë të lidhura ndërmjet tyre, shkaktojnë njëra-tjetrën ose rrjedhin nga njëra-tjetra. Po kështu dhe personazhet janë në kontakt të pandërprerë dhe në bashkëveprim. Veprimi i përfshirë në roman ndikon si një tërësi organike.

Karakteristikat e romanit nuk mund të përkufizohen në mënyrë të prerë e të qartë. Në përgjithësi, romani është një rrëfim i gjatë, i shkruar në prozë (në disa raste edhe në vargje). Romani dallohet nga tregimi dhe novela nga gjatësia më e madhe e tekstit, gjë që lejon zhvillimin më të plotë dhe më të hollësishëm të karaktereve dhe subjektit. Gjatësia e tekstit të romanit duhet të jetë e mjaftueshme për të justifikuar publikimin e tij në një libër më vete, ndryshe nga llojet e tjera të prozës. Në varësi të karakteristikave të veçanta janë krijuar një mori nënlojesh të romanit, si: romani historik, romani detektiv, romani epistolar, romani realist etj.

- Atëherë pse në dhomën time ka zjarr dhe gjithë të mirat?
- Sepse ti je një grua dhe një fëmijë.
- Bah! Po pse, burrat u dashkan që të kenë ftohtë dhe të jetojnë keq?!
- Disa burra.
- Mirë, atëherë unë do të vij aq shpesh këtu, sa të detyroheni të ndizni zjarr.

Ajo i thoshte edhe kështu:

- Baba, pse hani këtë bukë të keqe?
- Se ashtu, bija ime.
- Mirë pra, po ta hani ju, do të ha edhe unë.

Atëherë, që të mos hante edhe Kozeta bukë të zezë, Zhan Valzhani hante bukë të bardhë. Kozetës i kujtohej si nëpër tym fëmijëria. Ajo falej në mëngjes e mbrëmje për t'ëmën, që s'e kishte njohur kurrë. Tenardietë kishin mbetur si dy figura të neveritshme në kujtesën e saj dhe i dukeshin si ëndërr. Asaj i kujtohej se si kishte qenë “një ditë, natën” për ujë në një pyll. Ajo mendonte se ishte shumë larg nga Parisi. I dukej sikur e kishte filluar jetën në një humnerë dhe Zhan Valzhani e kishte hequr së andejmi. Fëmijëria e saj i dukej si një kohë ku rreth saj kishte vetëm dyzetkëmbështa, merimanga dhe gjarpërinj. Kur mendonte mbrëmjeve përpara se të përgjumej, meqenëse nuk e kishte shumë të qartë nëse ishte e bija e Zhan Valzhanit dhe nëse ai ishte babai i saj, ajo thoshte me vete se shpirti i s'ëmës kishte kaluar te ky babaxhan dhe kishte ardhur të qëndronte pranë saj.

Kur ai qëndronte ulur në karrige, ajo mbështeste faqen mbi flokët e tij të bardhë dhe linte të pikonte në heshtje një lot, duke thënë me vete: “Ndoshta ky njeri është nëna ime!”

Kozeta, megjithëse kjo mund të dukej e çuditshme, në padijeninë se saj të thellë prej vajze të rritur në kuvend, meqenëse amësia është kryekëput e pakuptueshme për të, kishte arritur të besonte se kishte pasur kaq pak nënë, sa s'kishte ku të vinte më. Ajo nuk ia dinte as emrin kësaj nëne.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Ku kishte jetuar Kozeta më përpara?
 - b) Në cilën rrugë shtrihej shtëpia ku jetonte Kozeta dhe Zhan Valzhani?
 - c) Si e kalonte kohën Kozeta gjatë ditës?
 - ç) Kozeta dhe Zhan Valzhani jetonin në dy shtëpi të ndryshme, por me një oborr të përbashkët. Në çfarë kushtesh jetonte Kozeta dhe në çfarë kushtesh jetonte Zhan Valzhani?
 - d) A e mbante mend Kozeta nënën e saj?
 - dh) Si i kujton Kozeta Tenardjetë?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

- 2 Si e shpjegoni shprehjen *“Vazhdimi i vetmisë dhe fillimi i lirisë”* për jetën e Kozetës në shtëpinë e re larg manastirit?
- 3 Analizoni frazën *“Duke pritur kohën që ajo të ëndërronte”*. Çfarë tregon kjo për moshën e Kozetës?
- 4 Kozetës i kujtohej se e kishte takuar Zhan Valzhanin në *“një ditë, natë”* kur ajo po shkonte të mbushte ujë në pyll. Bashkimi i fjalëve ditë dhe natë në një fjalë, si mund të interpretohet?
- 5 Kozeta po rritej dhe Zhan Valzhani përpiquej t’i plotësonte çdo nevojë, por ai e ndiente se përkujdesjet e tij nuk ishin kurrë të mjaftueshme. Çfarë nuk arrinte t’i jepte Zhan Valzhani Kozetës?

Gjuha e tekstit

- 6 Gjeni në tekst dhe shkruani në fletore fjalët që përdor Kozeta për të përshkruar Zhan Valzhanin. Çfarë ndjesie ju japin ato karakterizime?
- 7 Me çfarë i ngjante Kozetës fëmijëria e saj, para se të takonte Zhan Valzhanin? Gjeni në tekst si paraqitet ajo kohë nëpërmjet një krahasimi të zgjeruar.
- 8 Shkrimtarët romantikë përshkruajnë natyrën me hollësi. Gjeni në tekst të gjitha epitetet për kopshtin e shtëpisë së Kozetës.

Interpretojmë tekstin

- 9 Përshkruani përjetimet e Kozetës në lidhje me nënën që thajse nuk e kishte njohur fare.
- 10 Kozeta thoshte për Zhan Valzhanin *“Ndoshta ky njeri është nëna ime”*! Pse mendon Kozeta se shpirti i nënës së saj kishte kaluar te Zhan Valzhani?
- 11 Kozeta asnjëherë nuk shprehet se ishte e bindur nëse Zhan Valzhani ishte apo jo babai i saj. Ndërkohë që e thotë se për herë të parë e pa në *“një ditë natë”* kur kishte shkuar për ujë. Pse ndodh ky dyzim? Si e shpjegoni këtë?

Reflektojmë rreth tekstit

- 12 Gjeni në tekst pjesën ku rrëfimtari flet për çështje të edukimit. Si duhet të edukohet, sipas fjalëve të tij, një vajzë që është në fazën e kalimit nga fëmijë në një vajzë të rritur?
- 13 Kozeta ishte në moshën e pubertetit dhe Zhan Valzhani ndihej në vështirësi për edukimin e saj. Gjejini në tekst këtë çast dhe analizoni mënyrën sesi e përjetonte ai këtë pjesë. Cili është roli i nënës në edukimin e fëmijëve, veçanërisht të vajzave në moshën e pubertetit?

Detyrë:

- ▣ Diskutoni në klasë për rolin e prindërimit. A mund të jetë prind shumë i mirë, edhe dikush që nuk ka lidhje biologjike me fëmijët?
- ▣ Nga mëson më shumë njeriu: nga modeli i prindërve, nga shkolla, nga përjetimi i vështirësive në jetë? Diskutoni në klasë.

Gjerdani

Para leximit

Matilda, një grua e bukur dhe e këndshme, kishte ëndërruar gjithmonë për një jetë luksoze. Ajo vjen nga një familje e thjeshtë, ndaj martohet me një nëpunës të thjeshtë. Bashkëshortin e saj e ftojnë për të marrë pjesë në një festë të rëndësishme, por Matilda, ndryshe nga ç'priste i shoqi, nuk e priti me shumë kënaqësi, sepse ajo nuk kishte veshjen e duhur. Me kursimet e tij, ajo blen një fustan të bukur dhe i merr hua shoqes së saj të pasur një gjerdan me diamante. Në ballo, ajo ndihet gruaja më e bukur dhe kënaqet shumë, por me t'u kthyer në shtëpi, kupton se kishte humbur gjerdanin. Mopasani është një shkrimtar realist dhe shfaq aftësi të jashtëzakonshme në përshkrimin e ngjarjeve, të cilat na bëjnë të humbasim kufijtë mes imagjinatës dhe jetës reale.

Përkthyer nga Neka Turkeshi



Gi de Mopasan

Gi de Mopasan (Henri-René-Albert-Guy de Maupassant, 1850–1893) është një nga shkrimtarët më të njohur francezë të shekullit XIX. Ai ka shkruar tregime, novela dhe romane, por është vlerësuar në mënyrë të veçantë si mjeshtër i tregimit. Janë shumë të njohura tregimet e tij; "Topi prej dhjami", "Shtëpia Telie", "Zonjusha Fifi" etj. Historitë e Mopasani karakterizohen nga një stil lakonik, i prerë dhe shprehës. Mopasani shmangte përsëritjen e fjalëve dhe shqetësohej për ekonominë e mjeteve shprehëse. Krijimtaria e Mopasani shfaq tipare të dukshme të realizmit, si dhe ndonjë ndikim nga natyralizmi.

Ishte një nga ato vashat e bukura e të këndshme, të lindura, si të thuash, prej një gabimi të fatit, në një familje punëtore. Ajo nuk kishte pajë, nuk rronte me ndonjë shpresë dhe as që kishte mundësi të njihej me ndonjë burrë të shquar a të pasur, të kuptohej me të, të dashurohej e të martohej. Kur e martuan me një nëpunës të vogël në Ministrinë e Arsimit, ajo nuk kundërshtoi. Ishte e thjeshtë, pasi nuk kishte mundësi të stolisej, por vuante dhe ishte fatkeqe si ndonjë e rënë nga vakti.

Nuk kishte petka të bukura, nuk kishte stoli, nuk kishte asgjë. Dhe pikërisht këto që i mungonin, i dëshironte më fort se çdo gjë në botë! Ajo e ndiente se vetëm për këto gjëra kishte lindur. Digjej nga dëshira që ta pëlqenin të tjerët, ta lakmonin, t'i shkonin pas e ta çmonin.

Ajo kishte një shoqe të pasur, kishte qenë në një kuvend me të, por tani nuk donte t'i shkonte në shtëpi e ta takonte, se vuante shumë kur e shihte. Dhe shkrehej në vaj e qante ditë të tëra nga brenga që e mundonte, nga dëshpërimi, vuajtja e pikëllimi...

Një natë, i shoqi u kthye në shtëpi i gëzuar; në dorë kishte një zarf të madh. – Merre! – i tha. – Është për ty.

Ajo e grisi zarfin shpejt e shpejt dhe gjeti një letër ku shkruhej: "Ministri i Arsimit dhe zonja Zhorzh Rampono, lusin zotin dhe zonjën Luazel të kenë nderin të urdhërojnë për ta kaluar mbrëmjen në pallatin e ministrit, të hënën më 18 janar."

Po ajo në vend që të gëzohej ashtu siç e priste i shoqi, e hodhi ftesën me përbuzje përmbi tryezë duke mërmëritur: – E ç'të bëj unë atje?!

– Por... unë kujtova se do të gëzoheshe, e dashur. Ti nuk del kurrë nga shtëpia dhe ky është një rast shumë i mirë! Sa u mundova për ta shtënë në dorë këtë ftesë! ...

Ajo e vështronte me sy të egërsuar. Iu përgjigj: – Pa mendo pak, çfarë do të vesh unë për atje?

– A s'më thua, sa mund të kushtojë një veshje e përshtatshme për ty, që të shërbejë dhe për raste të tjera?

– Nuk jam e sigurt, por besoj se me nja katërqind franga mund t'i mbërrijmë qëllimit.

Ai u zbeh pakëz, se pikërisht atë shumë e kish vënë veçmas për të blerë një çifte. Po prapëseprapë foli e tha: – Bukuri! Katërqind frangat t'i jap unë. Vetëm shih të zgjedhësh diçka të mirë e të bukur.

Dita e festës po afrohej dhe zonja Luazel dukej e trishtuar, e shqetësuar, e brengosur, e gjithë ankth anipse veshjen e dëshiruar e kishte gati.

Një mbrëmje, i shoqi i tha:

– Ç'ke kështu që rri e brengosur? Këto tri ditë më dukesh si tjetër njeri. Fol, ç'ke?

E ajo u përgjigj: – Jam e mërziur se nuk kam ndonjë stoli, ndonjë gur të çmuar, s'kam asgjë.

– Sa e marrë bëhesh! Çohu e shko te mikja jote, zonja Forestje, dhe thuaji të të huazojë ndonjë stoli.

Ti ke aq miqësi me të sa t'i kërkosha kaq gjë.

Asaj i shpëtoi një thirrme gëzimi.

Të nesërmen, shkoi te shoqja dhe i qau hallin. Zonja Forestje shkoi te rafti me pasqyrë, mori një kuti të madhe, e solli aty, e hapi dhe i tha zonjës Luazel: – Zgjidh e merr ç'të duash, e dashur!

I provonte stolitë përpara pasqyrës, e pavendosur, pa ditur ç'të merrte e ç'të linte. Befas, në një kuti të mbështjellë me saten të zi, i zunë sytë një gjerdan të mrekullueshëm me një gur diamanti. Sakaq zemra filloi t'i rrihte me vrull. Ah, sikur t'ia jepte këtë gjerdan zonja Forestje! E mori me duart që i dridheshin, e vari në gushë mbi fustanin me jakë të lartë dhe shtangu duke vështruar veten në pasqyrë. Pastaj pyeti me ngurrim e gjithë ankth: – A mund të ma huash këtë? Vetëm këtë e asgjë tjetër.

– Posi jo! Merre me gjithë qejf!

Ajo iu hodh në qafë shoqes, e përqafoi me gëzim të madh dhe iku me vrap me thesarin në duar.

Erdhi dita e festës. Zonjës Luazel i shkuan punët mbarë. Ajo ishte më e bukura nga të gjitha gratë, elegante, e këndshme, buzagaze dhe si e marrosur prej gëzimit. Të gjithë burrat e vështronin, pyesnin si e kish emrin, donin ta njihnin. Të gjithë nëpunësit e ministrisë donin të vallëzonin me të. Edhe ministrit i ra në sy. U larguan nga ora katër e mëngjesit. Karrocë nuk gjetën. Më në fund, gjetën një pajton nga ata që njeriu sheh rrugëve të Parisit vetëm natën vonë, pasi erret, sepse me atë paraqitjen e tyre të mjeruar, sikur kanë turp të dalin në dritë. Pajtoni i shpuri gjer në shtëpi në Rrugën e Martirëve dhe ata hynë brenda të trishtuar.

Ajo qëndroi përpara pasqyrës dhe e hoqi mantelin që kishte hedhur krahëve, me qëllim që të shihte dhe njëherë veten, ashtu, madhështore. Por befas lëshoi një klithmë. Gjerdanin nuk e kishte në gushë! I shoqi, që ishte zhveshur pjesërisht, e pyeti: – Ç'pate?



Tregimi

Tregimi është lloj i shkurtër i prozës që, për nga madhësia, vjen pas novelës. Në tregim, ngjarja zhvillohet brenda një kohe të shkurtër ose jepet çasti kulmor i saj. Ka një personazh kryesor, kurse të tjerët jepen në funksion të tij. Nuk përshkruhet procesi i zhvillimit të karaktereve, as jepen hollësi, por dalin anët më të rëndësishme të tyre. Subjekti është i thjeshtë, por me konflikt të ngjeshur. Në tregim pasqyrohen anët të rëndësishme të realitetit. Teksti i shkurtër dhe gjuha tregimtare kanë bërë që të ndiqet dinamika e jetës: aktualiteti dhe tema e ditës.

– S’e... nuk... s’e kam gjerdanin e zonjës Forestje...

– A je e sigurt se e kishe kur dole nga balloja?

– Po. Mbjaj mend që e preka me dorë në hyrjen e ministrisë.

Ata vështronin njëri-tjetrin të dërrmuar e të pikëlluar. Ajo u shemb në karrige dhe mbeti aty.

– Duhet t’i vëmë gishtin kokës e ta vëmë në vend këtë gjerdan, – tha ai.

Të nesërmen, morën kutinë e gjerdanit dhe shkuan tek argjendari, emri i të cilit ishte shkruar në kuti.

– Jo zonjë, – tha ai, – unë kam shitur vetëm kutinë, gjerdani s’është blerë këtu.

Atëherë, shkuan argjendar më argjendar, të pikëlluar e gjithë ankth për të gjetur një gjerdan që t’i ngjasonte gjerdanit të humbur, duke u përpjekur, me mundimin e një njeriu të dërrmuar shpirtërisht, të sillnin në kujtesë stolinë e zonjës Forestje. Në dyqanin e Pale-Ruajalit gjetën një gjerdan me gurë diamanti që iu duk identik si gjerdani që kërkonin. Kushtonte dyzet mijë franga, por argjendari do t’ua linte për tridhjetegjashtë mijë.

Luazeli kishte katërmëdhjetë mijë franga, trashëguar nga i ati. Të tjerat do t’i merrte hua. Dhe mori hua. I kërkoi një mijë franga njërit, pesëqind tjetrit, pak këtu e pak atje. Lëshoi dëftesa, mori zotime që kish rrezik ta rrënonin, u ngatërrua me fajdexhinj e llojlloj huadhënësish, vuri në rrezik të ardhmen e tij, nënshkroi kambiale, pa qenë i sigurt në do të mund të dilte faqebardhë e të ruante emrin dhe nderin e tij.

Kur zonja Luazel ia ktheu gjerdanin, zonja Forestje i tha qejfprishur: – Duhej të ma kishe sjellë më shpejt. Po sikur të më qe dashur për vete?

Ajo nuk e hapi kutinë. Sa frikë pati zonja Luazel se mos e hapte faqe saj! Po sikur ta kuptonte ajo se gjerdani s’qe i pari? Çfarë do të mendonte, vallë? Çfarë do t’i thoshte? A nuk do ta quante kusare?

Zonja Luazel u krodh në jetën e tmerrshme të njerëzve nevojtarë. Dhe iu përvesh kësaj jete menjëherë me heroizëm. Duhej paguar borxhi që i kallte frikën kur e kujtonte. Dhe ajo do ta paguante. I dhanë duart shërbëtores, ndërruan shtëpi, shkuan dhe u vendosën në një banesë nën çati. E çfarë punësh nuk bëri ajo!

Pasditeve, i shoqi punonte te një tregtar, të cilit i hidhte në të pastër llogaritë, ndërsa natën, shpeshherë, daktilografonte dorëshkrime për të fituar sadopak para.

Dhe kështu kaluan kaq vjet. Në krye të dhjetë vjetëve, ata i kishin larë të gjitha borxhet, bashkë me kamatat e fajdes dhe interesin, që i qenë shtuar shumë sëmarrë hua. Zonja Luazel dukej tani si ndonjë plakë. Ajo ishte shndërruar në një grua të fortë, të ashpër e të regjur nga punët e rënda të shtëpisë, ishte bërë si gratë e varfra e të mjera. Tani krihej si t’i vinte, vishej me fustane që i vareshin kindat, duart i qenë skuqur e fryrë, fliste me zë të lartë.

Dhe ja, një të diel, kur ajo kishte dalë e po shëtiste në Shanz Elize, që të çlodhej pas punëve të rënda të javës, befas pa një grua që kishte dalë të shëtiste foshnjën e saj. Ishte zonja Forestje, gjithnjë e re, e bukur, tërheqëse si më parë.

Zonja Luazel u mallëngjye. Si të bënte? T’i fliste? Po, sigurisht do t’i fliste. Dhe tani, që e kish shlyer borxhin, do t’ia tregonte të gjitha fill e për pe. Pse të mos ia rrëfente?

Iu afrua. – Mirdita, Zhanë!

Tjetra nuk po e njihte dhe u habit me këtë grua të panjohur që e thërriste kështu në emër. Ajo mërmëriti: – Po... unë, moj zonjë... më duket se gaboheni... Unë nuk...

– Jo, nuk gabohem. Unë jam Matildë Luazel.

Shoqes së saj i shpëtoi një klithmë: – Oh! Matildë e dashur, sa shumë paske ndryshuar!

- Po, vërtet. Kam kaluar ditë shumë të vështira që nga koha që s'jemi parë. Kam vuajtur shumë. Dhe të gjitha këto për shkakun tënd!...
- Për shkakun tim? Si kështu?
- A e mban mend atë gjerdanin që ma dhe atë mbrëmje që do të shkoja në ballo në ministri?
- Po. E pastaj?
- Ja pra. Atë gjerdan unë e humba.
- Si është e mundur ta kesh humbur gjerdanin, kur ti ma ktheve përsëri?
- Unë të ktheva një të ngjashëm me atë, po jo tëndin. Dhe ja, kemi dhjetë vjet që punojmë për të paguar gjerdanin që blemë. Ti e kupton sa e vështirë ka qenë kjo për ne që s'kishim asgjë. Po më në fund, borxhin e lamë dhe tani jam e gëzuar sa s'rrëfëhet dot me fjalë. Zonja Forestje kishte shtangur në vend.
- Ç'thuhet kështu, e dashur? Paske blerë një gjerdan diamanti për të paguar gjerdanin tim? Dhe ajo po buzëqeshte me një gaz krenar e pa të keq.
- Oh, Matildë e dashur! Po gjerdani im ishte i rremë. Ai nuk vlente më shumë se pesëqind franga!

Lidhja subjekt – intrigë – hero

Subjekti ka të bëjë me rendin që ndjek një vepër dhe me mënyrën se si zhvillohen dhe lidhen ngjarjet me njëra-tjetrën. Nëse prishet ky rend, atëherë humbet kuptimi i veprës. Subjekti i një vepre letrare zhvillohet përmes *konfliktit të personazheve* që, në letërsi, merr emrin **intrigë**.

Intriga është një varg veprimesh të ndërlikuara e ngjarjesh të ngatërruara, me kthesa të papritura, që zbulojnë interesat e qëllimet e kundërta të personazheve të një vepre letrare dhe që ndikojnë në rrjedhën e zhvillimit të subjektit të saj.

Në tregim, intriga është e thjeshtë edhe ngaqë subjekti është i thjeshtë dhe konflikti mes personazheve është i thjeshtë.

Në tregimin "Gjerdani", Matilda është një grua me shumë ëndrra, e cila dëshiron të bëjë një jetë mondane. "Digjej nga dëshira që ta pëlqenin të tjerët, ta lakmonin, t'i shkonin pas e ta çmonin". Asaj nuk i pëlqen jeta që bën, madje i vjen turp dhe ka zili jetën e zonjës Forestje, shoqes së saj.

Cila është intriga e këtij tregimi? Intriga në një vepër letrare krijohet nga interesat dhe qëllimet e kundërta të personazheve. Zonja Forestje nuk i tregon se gjerdani është i rremë. Ajo e ka futur atë në një kuti të një argjendarie të shtrenjtë, por ajo ka blerë atje vetëm kutinë dhe jo gjerdanin. Pse e ka bërë një gjë të tillë? Pse nuk i tregon shoqes së saj se gjerdani nuk është i shtrenjtë? Sepse ajo do të duket se bën një jetë tepër të shtrenjtë para të gjithëve, edhe para shoqes së saj të ngushtë, si dhe do të tregojë se është bujare, ia huazon pa mëdyshje.

Nga ana tjetër, Matilda, që fati e ka destinuar të bëjë një jetë modeste, do të duket se është një grua që bën një jetë luksoze para të ftuarve në ballo. Ajo kërkon të duket ndryshe nga ç'është në të vërtetë. Në tregim kemi një pikë kthese të fortë që e përmbyset gjithë çfarë është rrëfyer në të më përpara. Kthesa e fortë e bën edhe intrigën e tregimit interesante dhe shkakton pezmatim e habi.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Cila ishte origjina e familjes së Matildës? Po bashkëshorti, çfarë rangu shoqëror kishte?
 - b) Si e priti Matilda ftesën që kishte marrë i shoqi për të shkuar në një festë të rëndësishme?
 - c) Sa franga i duheshin Matildës që të kishte një veshje të përshtatshme për ballo?
 - ç) I shoqi i Matildës kishte kursyer pak para, të cilat ia dha së shoqes për të blerë veshjen e duhur. Për çfarë i kishte kursyer ai ato franga?
 - d) A ishte pamja e Matildës në nivelin e duhur në ballo? A u kënaq Matilda?
 - dh) Çfarë e papriture ndodhi, kur u kthyen në shtëpi?

Studim teksti

- e) Sa kushtonte gjerdani që u detyruan të blejnë Matilda dhe i shoqi? Ku i morën gjithë këto franga?
- ë) Sa vjet iu deshën dy bashkëshortëve për të paguar borxhet?
- f) Si ishte reagimi i Zonja Forestje, kur Matilda i tregoi të vërtetën pas shumë vitesh?

Analizojmë tekstin

- 2 Gjendja shpirtërore e Matildës ndryshon shumë herë gjatë tregimit. Si është gjendja e saj shpirtërore në fillim dhe si është më pas? Gjeni arsyet e këtyre ndryshimeve.
- 3 Pse mendoni se Zonja Forestje nuk i tregoi Matildës se gjerdani që ajo po merrte borxh ishte i rremë?
- 4 Pse Matilda nuk i tregoi të vërtetën shoqes së saj që në fillim? Çfarë e pengoi?
- 5 Përshkruani si e imagjinoni Matildën përpara ballos dhe Matildën në fund të tregimit, ndërsa i tregon shoqes së saj për atë që ka kaluar në vitet e fundit.

Interpretojmë tekstin

- 6 Analizoni këto fjalë të tekstit: *Digjej nga dëshira që ta pëlqenin të tjerët, ta lakmonin, t'i shkonin pas e ta çmonin*. Çfarë tregojnë ato për karakterin e Matildës?
- 7 Duke u nisur nga tregimi, interpretoni simbolikën e gjerdanit.


Gjuha e tekstit

- 8 Cila figurë letrare është përdorur në këtë pjesë fjalie, të shkëputur nga teksti: *“vuante dhe ishte fatkeqe si ndonjë e rënë nga vakti”*. Shpjegoni mënyrën e ndërtimit të saj si nga ana formale, edhe kuptimore.
- 9 Cili është pika e kthesës në tregimin e Mopasanit?
- 10 Kur Zonja Forestje mori vesh të vërtetën, thuhet se ajo *“po buzëqeshte me një gaz krenar e pa të keq”*. Çfarë nënkupton atributi “krenar” që shoqëron fjalën gaz në një moment që vetëm për të qeshur nuk ishte?
- 11 Te shkrimtarët realistë është karakteristikë përshkrimi me objektivitet i ngjarjeve. Cilat janë elementet që përshkruan Mopasani për të treguar si e ka “robëruar borxhi çiftin”?

Reflektojmë rreth tekstit

- 12 Shpesh thuhet se nuk duhet të kesh pretendime përtej mundësive të tua. Të tjerë thonë se në jetë duhet të kërkosh më të mirën për veten. Duke u nisur edhe nga tregimi, si mendoni, cili prej qëndrimeve të mësipërme është i saktë?
- 13 Pas martesës, Matildës nuk i pëlqente më të shkonte ta takonte zonjën Forestje, shoqen e saj të pasur. Po ashtu, ajo e kritikon Matildën për vonesën e kthimit të gjerdanit, sikur të mos kishte asnjë stoli tjetër. Si ju duket marrëdhënia mes tyre?

Detyrë:

-  Duke u nisur nga ajo që ka dhënë shkrimtari, si mendoni se do të shkojë fati i Matildës dhe bashkëshortit të saj?

Krahaso romanin me tregimin

Karakteristikat e poetikës së tregimit dhe romanit

Tregimi është lloj i shkurtër i prozës që, për nga madhësia, vjen para novelës. Në tregim, ngjarja zhvillohet brenda një kohe të shkurtër ose jepet çasti kulmor i saj. Ka një personazh kryesor, kurse të tjerët jepen në funksion të tij. Nuk përshkruhet procesi i zhvillimit të karaktereve, as jepen hollësi, por dalin anët më të rëndësishme të tyre. Subjekti është i thjeshtë, por me konflikt të ngjeshur. Në tregim pasqyrohen anë të rëndësishme të realitetit. Teksti i shkurtër dhe gjuha tregimtare kanë bërë që të ndiqet dinamika e jetës: aktualiteti dhe tema e ditës.

Romani është lloj i gjatë i prozës artistike, brenda të cilit gjenden disa linja të zhvillimit të ngjarjeve, që ndërthuren me njëra-tjetrën. Në roman nuk paraqitet një ngjarje ose jeta e një personazhi, por përfshihen shumësi ngjarjesh të lidhura ndërmjet tyre, që shkaktojnë njëra-tjetrën ose rrjedhin nga njëra-tjetra. Po kështu, edhe personazhet janë në lidhje të pandërprerë dhe në bashkëveprim. Veprimi i përfshirë në roman, ndikon si një tërësi organike.

Karakteristikat e romanit nuk mund të përkufizohen në mënyrë të prerë e të qartë. Në përgjithësi, romani është një rrëfim i gjatë, i shkruar në prozë (në disa raste edhe në vargje). Romani dallohet nga tregimi dhe novela për nga gjatësia më e madhe e tekstit, gjë që lejon zhvillimin më të plotë dhe më të hollësishëm të karaktereve dhe subjektit. Gjatësia e tekstit të romanit duhet të jetë e mjaftueshme për të justifikuar botimin e tij në një libër më vete, ndryshe nga llojet e tjera të prozës.

Në varësi të karakteristikave të veçanta të romanit, janë krijuar një mori nënlojesh të tij, si: romani historik, romani detektiv, romani epistolar, romani realist etj.

Karakteristikat e përgjithshme	
Tregimi	Romani
1. Tekst i shkurtër, më i shkurtër se novela dhe romani.	Tekst i gjatë, më i gjatë se tregimi dhe novela.
2. Ngjarjet zhvillohen brenda një periudhe të shkurtër.	Zakonisht, ngjarjet zhvillohen në periudha të gjata, por edhe nëse koha nuk është shumë e gjatë, ka dendësi rrëfimi.
3. Jepet vetëm çasti kulmor.	Brenda tij, gjenden disa linja të zhvillimit të ngjarjeve, që ndërthuren njëra me tjetrën.
4. Ka një personazh kryesor, të tjerët i shërbejnë atij.	Ka shumë personazhe, të cilat jepen në kontakt të shpeshtë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin.
5. Nuk përshkruhen personazhet në të gjitha anët e karakterit, por vetëm në anët më kryesore.	Zhvillim i plotë e i hollësishëm i karaktereve, si nga ana psikologjike, ashtu edhe emocionale.
6. Nuk jepen hollësi.	Jepen hollësi, detaje.

7. Subjekt i thjeshtë.	Subjekt i ndërlikuar.
8. Konflikti i ngjeshur, por i thjeshtë.	Konflikti shtjellohet gjerë e gjatë.
9. Intriga e thjeshtë.	Intriga është e ndërlikuar, sepse edhe qëllimet dhe kundërshtitë mes personazheve janë më të forta.
10. Në prozë.	Në prozë (ndonjëherë në vargje).

Tiparet e romanit, duke u bazuar konkretisht te romani “Të mjerët”

Romani “Të mjerët”
1. Tekst shumë i gjatë. Romani “Të mjerët” është shumë voluminoz.
2. Ngjarjet në roman shtrihen në periudha të gjata kohore, në shumë vite. Zhan Valzhani qëndroi 19 vjet në burg, pas 6 vjetësh u bë pronar i një fabrike. Qëndroi me Kozetën 10 vjet në manastir.
3. Ka shumë personazhe të rëndësishme. Ndonëse Zhan Valzhani është personazhi kryesor i romanit, ka kapituj të tërë që kanë personazh kryesor Fantinën, Kozetën, Mariusin, Tenardjetë etj.
4. Personazhet në roman jepen në një zhvillim të gjatë; nga koha kur Zhan Valzhani ishte i ri, gjersa ai u plak dhe vdiq; Kozeta nga një fëmijë i vogël, gjersa u bë grua dhe u martua etj.
5. Personazhet paraqiten nga të gjitha anët, pamja fizike, karakteri, bota shpirtërore. Shpesh, flitet për të shkuarën dhe të tashmen.
6. Romani është lloji letrar që ka brenda tij përshkrime të detajuara, elemente teknike etj.
7. Subjekti është i ndërlikuar, konflikti shtjellohet në disa linja që zhvillohen paralelisht.
8. Romani i shkruar në prozë.
9. Intrigë e ndërlikuar. Një numër i madh ngjarjesh të ndërlikuara e situatash të ngatërruara, me shumë kthesa të papritura, që zbulojnë interesat e qëllimet e kundërta të personazheve.

Radhitni tiparet e tregimit, duke u mbështetur te tregimi “Gjerdani”, i Mopasanit.

Karakteristikat e “Gjerdanit”
1. Tekst i shkurtër.

Në stuhi

Para leximit

Anton Pashku ende nuk i kishte mbushur të njëzetat kur shkroi tregimin “Në stuhi”, të botuar në vitin 1957. Që në fillimet e tij, Pashku sjell një frymë krejtësisht moderne në prozën shqiptare. Në këtë prozë poetike, personazhi që identifikohet me rrëfimtarin është i zhytur në një trishtim të skajshëm. Në vetmi dhe trishtim, ai ka zgjedhur rrugën të struket në vetvete. Stuhia e brendshme e bën atë të vuajë në vetmi. Ai është i mbërthyer nga ndjenja e frikës, nuk arrin të bëjë asgjë, nuk arrin të shkojë asgjëkund. Ai qëndron pezull mes hiçit-të të mos bërit asgjë dhe botës që lëviz. Nuk mundet më të veprojë, as të ikë, as të mendojë dhe gjatë vetmisë së tij shoqërohet vetëm nga rrëkëllimi i një trau dhe rrapëllima e një dere.

N’cast ndjeu një plogshti të madhe që ia përshkoi tan trupin. Çdo gja i dukej e çuditshme, madje edhe vetvehtja. Kurr nuk e kishte tradhtue fuqija si kësaj radhe. Nji lodhje e madhe e kaploi, tue fillue prej qepallave të syve e deri te gishtat e dorës, që i dridheshin bashkë me gotën. Ndjeu nevojën me u çue dhe me ikë prej atij vendi, por mendimi se kur t’eci do të duket qesharak, e pengoi, krenarija e tij nuk e la. Ajo e bani me u ulë edhe një herë në karrike. Ndezi një cigare dhe filloi me shikue i lodhun fjollat e tymit.

“Ha, ha, ha... – përçau heshtjen një e qeshun së brendshmi, – shihe një herë ti... he, he, he... shihe, shihe një herë...”

Veshët i fishklojnë, dora me cigare lëshohet me pritesë mbi tavolinë. “Tingër...”

E theu një gotë. Copat e qelqit u derdhën gjithkrah. Ky filloi me i mbledhë si yjtë nëpër qiell. “Ooo!” briti në heshtje. “Qe ku jam. Më jep një akullore... të ftoftë, si bora në mal. Ej!”

Muer gotën tjetër dhe e piu deri në fund. Mandej paloi kryet mes duerve.

“Kërrr...” iu duk se rrëkëlloi trau mbi derë. I frigsuem, u struk në lëkurën e vet.

“Brum... bram..!” rraplloi dera me të madhe.

“Zhzhbërsht, zhbërsht...” i rrëshqitën kambët nëpër baltë.



Anton Pashku

Anton Pashku (1937–1995), i lindur në Grazhdanik të Prizrenit, punoi si gazetar kulture dhe redaktor në gazetën “Rilindja”. Shkroi prozë dhe drama. Tregimet e para i botoi në vitin 1957. Ai është autor i disa vëllimeve me tregime: “Një pjesë e lindjes”, “Kulla”, “Kjasina”, “Lutjet e mbrëmjes” etj. Ai ka shkruar dy drama: “Sinkopa” dhe “GoF”, si dhe romanin “Oh”. Pashku është shkrimtari, vepra e të cilit shfaq tipare të dukshme dhe të qarta të modernizmit. Proza e tij tregon mjeshtëri letrare në ndërtimin e tekstit, vlera estetike të dallueshme, i veçantë për nga fryma letrare e përgjithshme e kohës së tij. Në planin stilistik, shfaqet si një mjeshtër i madh i gjuhës, që di të luajë, të eksperimentojë në mënyrë specifike me të, duke krijuar vlera të mëdha artistike. Konsiderohet edhe si nismëtar i prozës meditative. Anton Pashku është një ndër shkrimtarët më të veçantë të letërsisë shqipe.

“Fiuuuu...” fukati era e tërbueme.

Ulet në prehën të mendimeve, i përqaftuem prej krahëve të kangës së magjupëve:

“Kush ka për t’ja la fëmijt?”

“Shiu ka për t’ia la!”

“Kush ka me i luhatë për Shën Gjergj fëmijt e tu?”

“Era ka me i luhatë”.

“Po djalit tand kush ka i dhanë gji?”

“Dhija e egër ku kalon atypari.”

Bulza djersësh rrëshqasin nëpër ballin e tij. Çliron kravatën, çon gotën në buzë e pin deri në fund dhe shikon në fundin e saj.

“SOS... SOS... Anija “Titanik” në rrezik... SOS...”

Klithi me dëshprim. Përreth tij shpërthen gazi. Njerëzit qeshin me të.

“Ku me dijtë se çfarë mbretnije lumnish ka andrrue!” – i tha njëni shokut afër tavolinës së tij.

Ky nuk u vuni vesh talljeve, as që i ndiente. Ishte thellue n’Unin e tij të turbullt. Plotsisht. Ndiente vetëm vërshtëllimën e stuhisë së marrë. Ajo në mbrendsin e tij, shkante tue çue valë të mëdha, stërkalat e të cilave e shpijshin si thumba. E ndiente dhimbjen e tyne t’madhe, të stërmadhe; por fija e arsyes së tij ishte e ngjyeme në langun e bardhë; ishte e dehun, e përputhun me rrafshin rrethak të gotës së zbrazun...



Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Cili ishte mendimi i parë që i erdhi në mendje personazhit? A e realizoi atë? Pse nuk e realizoi atë që mendoi?
- 2 Në këtë tregim, nuk tregohet as koha dhe as vendi ku ndodhin ngjarjet. Kjo gjë e nxit dhe e motivon pareshtur lexuesin që ta kërkojë atë që nuk thuhet, atë që, duke heshtur, e sugjeron. Duke u nisur nga detajet e tekstit, përcaktoni kohën dhe vendin ku mund të jetë zhvilluar ky episod.
- 3 Personazhi i tregimit ka një mpirje të plotë të arsyes. Cilat janë motivet që e kanë shkaktuar këtë gjë?

Analizojmë tekstin

- 4 Njerëzit qeshin me fjalët e klithjen e tij. Dikush thotë: *"Ku me dijtë se çfarë mbretnije lumnish ka andrrue!"* Analizoni këto fjalë dhe ajo që nënkuptohet prej tyre.
- 5 Gjeni në tekst fjalët që përshkruajnë vetminë e tij.
- 6 Gjeni në tekst fjalët që përshkruajnë trishtimin e tij.
- 7 A komunikon me ndokënd personazhi në këtë tregim? Me kë?

Gjuha e tekstit

- 8 Ai është shumë i vëmendshëm ndaj tingujve që dëgjon rreth e qark. Çfarë tregon kjo?
- 9 Në tregim ka shumë onomatope. Gjejini në tekst dhe shpjegoni praninë e tyre në këtë prozë.

Interpretojmë tekstin

- 10 Çfarë e bën personazhin me u *"struk në lëkurën e vet"*? A ka dikë që e frikëson?
- 11 Në tekst, rrëfimtari thotë se: *"Ndiente vetëm vërshtëllimën e stuhisë së marrë"*. Shpjegoni simbolikën e stuhisë, të cilën e ndiente kaq fort. Gjeni figurën letrare te togfjalëshi i nënvizuar.
- 12 Gjeni në tekst fjalët që tregojnë sesi personazhi i tregimit, ëndërron për lumturi të pamundura. Analizoni fjalët që ju çojnë te bota e ëndrrave të tij.

Reflektojmë mbi tekstin

- 13 Nisur nga mënyra sesi përshkruhet vetmia e personazhit të këtij tregimi, si mendoni, ai e ka zgjedhur vetë vetminë apo ajo është mundësia e vetme që ka?
- 14 Reflektoni mbi gjendjen e vetmisë, që përjetojnë njerëzit. Cilat janë arsyet që i shtyjnë njerëzit që të zhyten në vetmi? Diskutoni në klasë.

Detyrë:

-  Gjeni dhe diskutoni në klasë për ndonjë tregim tjetër të Pashkut, që ka motive popullore.

Vdekja e nëpunësit

Para leximit

Në qendër të këtij tregimi është drama e një nëpunësi, i cili është shumë i shqetësuar pasi mendon se ka ofenduar një funksionar të lartë me një teshtimë. Ai bën çmos që të marrë falje për teshtimën e pakontrolluar, por ndeshet me indiferencën e funksionarit të lartë. Nënvlërësimi i vetes dhe ankthi e bëjnë të vuajë shumë.

Në këtë pjesë letrare, komikja dhe tragjikja ndërrojnë lehtësisht vendet me njëra-tjetrën, duke na paraqitur fatin e njeriut të dobët, i cili vetërrënohet nga pasiguria e tij.

Përkthyer nga Jorgji Doksani

Fjalor

portier – ai që rri si rojë te porta e një institucioni.

Shkëlqesi – këtu: titull nderimi për t’iu drejtuar një zyrtari të lartë.

funksionar – nëpunës me funksion të lartë.

virtësi – të varesh nga dikush tjetër me detyrë më të lartë a me përgjegjësi më të madhe.

superior – përgjegjës që drejton një zyrë, një sektor, një organizëm pune.

arrogant – që është i vrazhdë, fytes përbuzës.



Anton Çehov

Anton Çehov

(1860–1904) është një nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë ruse. Çehovi ka shkruar një numër të madh tregimesh dhe novelash. Janë shumë të njohura përmbledhjet “Tregime të larme”, “Muzgu” etj. Ai është bërë shumë i njohur edhe në fushën e dramaturgjisë me veprat: “Kopshti i qershive”, “Pulëbardha”, “Xha Vanja”, “Tri motrat” etj. Veprat e tij janë përgjithësisht rrëfime realiste.

Një mbrëmje të mrekullueshme, një portier jo më pak i mrekullueshëm, Ivan Dimitriç Çervjakov, i ulur rehat në një poltronë të radhës së dytë në Teatrin e Operas po ndiqte shfaqjen “Kambanat e Kornevilit”. Dëgjonte muzikën, shikonte balerinat dhe ndihej i lumtur.

Por, papritur fytyra e Çervjakovit u bë e vogël, flegrat e hundës iu drodhën, frymëmarrja i ndaloi, dylbitë iu ulën dhe... apshi hi hi!!!... Çervjakovi teshtiu. Nuk është e ndaluar për askënd që të teshtijë. Teshtijnë fshatarët, agjentët e policisë, madje edhe gjeneralët ndonjëherë. Të gjithë teshtijnë. Çervjakovi nuk u hutua, por fshiu gojën dhe hundën me shami dhe si i edukuar që qe, hodhi një sy përçark për t’u siguruar që nuk kish shqetësuar njeri. Por, atëherë u turbullua më shumë, kur vuri re se një rresht përpara tij, në radhën e parë të sediljeve një burrë i vjetër po fshinte ngadalë me dorashkë kokën tullace dhe qafën, duke murmuritur fjalë të pakuptueshme. Çervjakovi e njohu: ishte Shkëlqesia e Tij Brizalov, një nga funksionarët e hekurudhave. “Kam spërkatur kokën e tij, – mendoi Çervjakovi. – Në të vërtetë, nuk jam nën virtësinë e tij mentalisht, por kjo nuk do të thotë që mos t’i kërkoj të falur.” Çervjakovi u kollit lehtë, përkuli trupin përpara dhe i pëshpëriti në vesh Shkëlqesisë së Tij:

– Shkëlqesi, më falni se ju bëra pis pa dashur... kam...

– Asgjë, asgjë...

– Për hir të Zotit, ju lutem të më falni! Ju siguroj se nuk e bëra me qëllim...

– Po lëre tani, se e mora vesh. Më lër të dëgjoj!

I turbulluar, Çervjakovi buzëqeshi si budalla dhe hodhi vështrimin nga skena. Dëgjonte muzikë, shikonte balerinat, por nuk ndihej më i lumtur. Ankthi po e torturonte. Në pushimin e afërt, iu afrua Brizalovit, e ndoqi për njëfarë kohe dhe, më në fund, duke mundur turpin që e kish kapluar të tërin i murmuriti: – Shkëlqesi... nëse kam spërkatur kokën tuaj, ka qenë në mënyrë të pavullnetshme... ju lutem të më falni... unë nuk desha...

– Po lëre tani! Nuk po e mendoj më! Dhe ju gjithmonë një muhabet, – iu përgjigj Shkëlqesia e Tij me një ngërdheshje padurimi. “Nuk po e mendon më, thotë, dhe syri i tij është plot ligësi”, – mendoi Çervjakovi duke parë në mënyrë të dyshimtë nga Shkëlqesia e Tij.

“Nuk do as të flasë. Është e nevojshme të shpjegohem që nuk e bëra qëllimisht... që të teshtiturit është ligj i natyrës; përndryshe do të mendojë se desha ta pështyj në zverk. Dhe, në qoftë se nuk do ta mendojë tani, do ta mendojë më vonë!...”

Kur u kthye në shtëpi, Çervjakovi i foli gruas për gjithë çfarë i kishte ndodhur. E pa që gruaja nuk i dha ndonjë rëndësi të madhe: sigurisht që u frikësua pak, por u qetësua menjëherë, kur mori vesh që Brizalovi nuk ishte **superiori** aktual i burrit të saj.

– Megjithatë, ti shko dhe kërkoji të falur, – e këshilloi ajo, – përndryshe Brizalovi do të mendojë se nuk je i denjë për të qëndruar në një shoqëri me të.

– Po tamam, kështu bëra! I kërkoja të falur, por ai se si qe, si i çuditshëm... nuk di si të them. Nuk më tha asgjë të qartë e pozitive. Në të vërtetë, nuk kishte dhe kohë për të folur. Ditën tjetër, Çervjakovi u vesh mirë, shkoi te berberi dhe, pasi u siguria se figura e tij ishte në rregull, u nis te Brizalovi për t’u shpjeguar. Salla e pritjes së Shkëlqesisë së Tij ishte e mbushur plot me persona që kërkonin favore dhe mbrojtje. Shkëlqesia e Tij e kishte filluar pritjen.

Pasi dëgjoji disa nga të pranishmit, Shkëlqesia e Tij u kujtua për Çervjakovin dhe vështroi në mënyrë pyetëse.

– Dje në opera... Shkëlqesia Juaj ndoshta do t’ju kujtohet... – filloi Çervjakovi, – unë teshtita dhe... pa dashur ju spërkata kokën, Shkëlqesia Juaj... Do të më falni... Nuk qe për...

– Po ç’thua, ç’thua! Budallallëqe! Çfarë dëshironi? – vazhdoi Shkëlqesia e Tij, duke iu drejtuar një tjetri që qëndronte i ulur pranë Çervjakovit.

“Jo, gjë që s’bëhet. Nuk mund ta lë kështu, duhet patjetër të shpjegohem mirë...”

Çervjakovi priti. Kur Shkëlqesia e Tij përfundoi pritjen e fundit, u drejtua drejt apartamentit të tij privat. Çervjakovi e ndoqi duke i pëshpëritur:

– Shkëlqesi! Në qoftë se më lejoni t’ju shqetësoj, për të shprehur ndjenjat e mia, desha t’ju vë në dijeni se më vret ndërgegjja, si të them, jam i penduar. Nuk e bëra me qëllim, duhet të më kuptoni!... – Fytyra e Brizalovit mori një pamje të indinjuar.

– Bëni shaka apo si? – pyeti dhe u zhduk pas daljes.

“Po çfarë shakaje, nuk ka vend për shaka”, – mendoi Çervjakovi duke iu afruar drejt shtëpisë. “Ky njeri ka arritur të marrë titullin Shkëlqesi dhe nuk arrin të më kuptojë. Kur është kështu, nuk dua më që t’i kërkoj të falur një **arroganti** të tillë. Kush djallin e duron mburrjen e tij? Do t’i shkruaj një letër dhe nuk do të kthehem më këtu!”

Por letrën nuk e dërgoi kurrë, pasi nuk arriti ta formulonte. Mendoi e mendoi dhe nuk i erdhi në mendje asgjë. Ditën tjetër u kthye përsëri te Shkëlqesia e Tij, për t’u shpjeguar vetë...

– Qeshë dje këtu, Shkëlqesi,
– belbëzoi Çervjakovi,
kur Brizalovi nguli në të vështrimin pyetës, – jo për të qeshur, siç thatë ju, jo, por për t’u shfajësuar, sepse duke



Shënim

Autori, për të dhënë karakterin e dobët të protagonistit të tij, ka zgjedhur që mbiemri i protagonistit të jetë Çervjakov, që vjen nga fjala ruse "çervjak", që do të thotë krimb i vockël.

teshtirë ju spërkata... nuk e çoj në mend që të bëj shaka me ju, nuk do të guxoja kurrë. Në qoftë se i lejohej dikujt për të bërë shaka, duhet të gëzojë respektin e duhur te personi i...

– Jashtë që kënde! – ulëriti Shkëlqesia e Tij me zë të lartë, duke u bërë mavi në fytyrë.

– Si thatë? – pyeti Çervjakovi me zërin që i dridhej nga tmerri.

– Jashtë që këtu! – ulëriti Shkëlqesia e Tij edhe më fort, sikur ta kishin shkelur në kallo.

Çervjakovi u lëkund: ndjeu t'i shkëputej diçka nga brenda. Nuk pa më asgjë, nuk dëgjoji asgjë, duke ecur mbrapsht deri te porta. U gjend në rrugë. Mekanikisht, mori rrugën drejt shtëpisë. Dhe këtu, pa u çliruar nga ankthi që e kish zënë, u shtri mbi minder... dhe vdiq.

Satira

Satira është një krijim që e gjejmë në letërsi, në arte të tjera, si dhe në forma të ndryshme komunikimi. Ajo karakterizohet nga një vështrim kritik, i shprehur me anë të humorit thumbues, ironisë dhe sarkazmës, ndaj të metave, veseve dhe anëve të tjera të dobëta të njerëzve e të shoqërisë.

Që në Greqinë e Lashtë, satira ka pasqyruar ngjarjet politike dhe shoqërore me rëndësi të madhe për qytetin (polis), duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në opinionin publik, pikërisht në prag të zgjedhjeve. Për këtë arsye, krijuesit e saj janë sulmuar shpesh nga pushtetarët e kohës.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Çfarë bëri Çervjakovi në Teatrin e Operës?
- 2 Në këtë tregim vendosen pranë dy personazhe. A ka ndonjë raport miqësor apo pune mes tyre? Ç'përfaqëson secili prej tyre?
- 3 Ngjarjen që ndodhi në Teatrin e Operës, Çervjakovi:
 - e harroi sapo u largua prej andej;
 - u përpoq ta fshihte, të bënte sikur nuk kishte ndodhur kurrë;
 - e mohoi që të mos e fajësonin si të pasjellshëm;
 - e mori me zell të tepruar për t'u shfajësuar.

Analizojmë tekstin

- 4 Gjeni në tekst fjalët, të cilat e shfajësojnë plotësisht Çervjakovin nga ajo që ndodhi. Çfarë tregojnë ato?
- 5 Gjeni në tekst fjalët që tregojnë:


a) mirësjelljen e Çervjakovit;	b) përlësinë e Çervjakovit;
c) indiferencën e Brizalovit;	ç) pompozitetin e Brizalovit.
- 6 Shpesh rrëfimtari e quan Brizalovin vetëm *Shkëlqesia e Tij*, pa nevojën e emrit. Pse?

Interpretojmë tekstin

- 7 Në ç'vetë kryhet rrëfimi në këtë tregim? Ç'raport mban rrëfimtari me ngjarjet që rrëfen?
- 8 Çfarë ndjenjash përjeton Çervjakovi kur sheh se kë ka spërkatur me teshtimën e tij. Ç'gjë e shkakton shqetësimin e tij?

Studim teksti

- 9 Vdekja e Çervjakovit është:
- një përfundim i kuptueshëm për rrethanat;
 - një fund i hiperbolizuar i njeriut të dobët;
 - një përfundim i pashpjegueshëm.
- 10 Gjeni në këtë tekst elementet që janë karakteristike për tregimin si lloj letrar.



Gjuha e tekstit

- 11 Analizoni gjuhën e Çervjakovit kur i drejtohet Brizalovit.
- Si janë të ndërtuara fjalitë me të cilat i kërkon vazhdimisht falje?
 - Për çfarë arsyeje përdoren vazhdimisht reticencat ndërmjet fjalëve të tij?
- 12 Dalloni në tekst monologët nga dialogët.
- 13 Çehovi njihet si një autor që e përdor shpesh komizmin për të kritikuar qëndrime apo dukuri të ndryshme. A ju bën të qeshni ky lloj komizmi?
- 14 Gjeni fjalët onomatopeike në tekst.

Reflektojmë rreth tekstit

- 15 Heroi i tregimit është mishërim i njeriut që është gati t'i nënshtrohet gjithkujt që gëzon një pozitë shoqërore më të lartë. Njëpër një shfaqet drama e njeriut të pasigurt në vetvete. Diskutoni rreth saj.
- 16 Çfarë ndjenjash përjetoni ndaj Çervjakovit? Jepni shpjegimin për zgjedhjen ose jo të secilës alternativë.

	Po/Jo	Shpjegimi
Keqardhje		
Vlerësim		
Mosrespekt		
Mëshirë		
Admirim		
Përrulje		

Detyrë

- Luajeni në role këtë pjesë, duke u përpjekur të transmetoni botën e brendshme të personazheve të saj.

Krastakraus

Para leximit

Bilal Xhaferri e shkroi shpejt e me ngut romanin, për konkursin e vitit jubilar të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Pjesa e parë e romanit përfundoi në muajt e parë të vitit 1968. Romani u miratua për botim, por më pas u ndalua. Për të nisi persekutimi. Që t'i shpëtonte burgut, në shtator të vitit 1969, u arratis. Libri i ruajtur si dorëshkrim u botua vetëm në vitin 1993.

Fjalor

arenë – sheshi ku zhvillohet ndeshja, beteja.

juga – erë e ngrathtë, që fryn nga jugu dhe sjell shi.

mëdyshje – kur je në mes të dy mendimeve.

ngurrim – nuk je i sigurt dhe mendohesh.

plogështi – ngadalë, pa energji.

llohë – borë e përzier me shi, e lagësht.

triumf – fitore.

ogur – shenjë që paralajmëron diçka të mirë a të keqe.



Bilal Xhaferri

Bilal Xhaferri (1935-1986) ka botuar vëllimin me tregime "Njerëz të rinj, tokë e lashtë", vëllimin me poezi "Lirishta e kuqe", romanin "Krastakraus". Pasi internimit, ai u arratis nga Shqipëria dhe shkoi në SHBA, në Boston, ku punoi në gazetën "Dielli". Atje themeloi revistën "Krahu i shqiponjës", ku botoi shumë artikuj publicistikë, poezi, tregime, pjesë romanesh, skeçe, vizatime, karikatura, foto artistike etj.

Oraniku tani ishte pragu i atdheut. Këtë gjë e dinin mirë të gjithë ata që kishin ardhur të luftonin në fushën e Oranikut.

Bëheshin njëmbëdhjetë mijë ushtarë, të ngulur në kampin e fushës. Mbi tre mijë të tjerë qenë shpërndarë në pritat malore, gjatë rrugëve nëpër të cilat vinte armiku.

Nuk besohej se mund të mblidhej gjatë atij dimri të tmerrshëm një ushtri kaq e madhe. Po ajo u mblodh. U mblodh, siç mblidhen pikat në rrëke, siç mblidhen rrëketë në përrenj e përrenjtë në lumenj.

Të pasnesërmen arritën edhe turqit. Ata e ngritën kampin e tyre në mbrëmje, në anën tjetër të fushës.

Atje, në fund të maleve, fusha e Oranikut ngjante me arenën e ndonjë Koloseu ku ndesheshin gladiatorët në lashtësi. Në maja zbardhte bora, kurse përposh, në lugina, përmes egërsisë së dimrit, sapo kish shpërthyer një gjelbërim i vonë prilli, gjelbërim jугe, i butë, i njomë. Të nesërmen, të dy ushtritë u gjendën ballë për ballë, të gatshme për t'u ndeshur.

Era e rrëmbyer përplaste në ajër palët e flamujve, përziente hingëllimat e kuajve dhe të thirrurat e komandantëve që radhitnin trupat. Ajo shtynte në Veri turma resh të rënda.

Juga mblidhte turma resh të tjera që vazhdonin të dyndeshin gjithnjë në Veri. Nga thellësitë e Maqedonisë vinte një shtrëngatë.

Ishte e bezdisshme të luftohej në shi dhe ushtritë nuk vendosnin të hidheshin në ndeshje. Po ndërsa zgjatej ajo mëdyshje e ngurrimit dhe e plogështisë së përgjithshme, të dy palët i afroheshin vetveti gjithnjë e më shumë njëra-tjetrës dhe grupe të veçuara kalorësish harkëtarë shkëputeshin dhe sulleshin gjer te vija e armikut.

Strezit iu kujtua se edhe në betejën e Torviollit kështu ishin sulur harkëtarët për të dhënë shenjën e fillimit të luftës. Atëherë ishte qershor. Nëpër një llohëz shiu që zuri papritur, mbi majat e shigjetave që u ngritën në hapësirën e fushës, dielli ndezi një ylber si hark triumfi. Ylberi u shua menjëherë, po shkëlqimi i tij verbonjës i mbeti përgjithmonë në mendje Strezit. I dukej si një shenjë oguri dhe sikur gjatë këtyre dymbëdhjetë vjetëve luftërash të pandërprera, atdheu kalonte gjithnjë nën një ylber shigjetash, nën atë hark lavdie.

Ky kujtim i largët, i mbuluar nga tymi dhe pluhuri i Beratit, tani këtu në fushën e Oranikut atij iu duk përsëri si një shenjë oguri.

Strezi e kishte të ngulur në vetëdije, se duhej ta fitonin patjetër betejën e Oranikut. Këtë e kishte të ngulur në **vetëdije** çdo ushtar shqiptar. Në qoftë se do të mundeshin turqit, pas tyre do vinin turq të tjerë dhe do kërkonin një betejë tjetër. Edhe po të mundeshin përsëri, ata do vinin përsëri, dhe përsëri, po të mundeshin, do vinin dhe do kërkonin beteja të tjera. Ishin një popull i madh dhe kishin një ushtri të madhe, që s'**shteronte**. Kurse shqiptarët ishin një popull shumë i vogël dhe po të mundej ushtria e tyre këtu në Oranik, tani pas betejës së Beratit, kjo do të qe një mundje përgjithmonë.

Së bashku me shigjetat, kalorësit harkëtarë lëshonin mbi njëri-tjetrin edhe një breshëri të sharash e kërcënimesh.

– O Moisi Golemi! – dëgjoheshin zëra të egërsuar, përmes rrapëllimës së erës dhe përmes britmave të tjera. – O **Judë** i pabesë! Dil në shesh të burrave, po je burrë, o tradhtar i tradhtarëve. Nxirre kokën nga **samari**, oj, breshkë zvarranike!

“Tradhtar! O gjarpër!” përsëritej kjo britmë nga goja në gojë.

“Tradhtia, – mendonte Strezi. – Kështu i ka ndodhur gjithnjë popullit tonë, që nga kohët më të largëta deri sot. Sa herë gjoksi i tij mbushet me shtrëngatën e lirisë, pas shpine përdridhet gjarpri i **reumatizmës** së tradhtisë, që i paralizon shtyllën e kurrizit. Tradhtia! Ah, sikur të mund ta shtypja me dhëmbët e mi kokën e këtij gjarpri!”.

Fjalor

vetëdije – ndërgjegje, aftësi për të njohur veten.

shterim – (këtu) humbas përfundimisht.

judë – këtu tradhtar, spiun i poshtër.

samari – (këtu) guaska e breshkës.

reumatizëm – një lloj sëmundje që krijon dhimbje, therje në gjymtyrë e muskuj.

doriun e kuq – kalë i kuqërremtë.



Krahasimi

Krahasimi është ajo figurë, e cila krijohet nga vënia ballë për ballë e dy sendeve, dy frymorëve ose dy dukurive për të ndriçuar më mirë njërin prej tyre, si dhe për ta bërë më të gjallë e më të pasur mendimin. Në krahasim, vihen përballë fjalët që shënojnë dukuri, sende a frymorë që kanë ngjashmëri dhe lidhen me lidhëzat si, ashtu si, pors, sikurse. p.sh., buzët si burbuqe, sytë si gështenjë, vrapoi pors shigjeta, ballët si diell, faqet si mollë, vetulla pors hana etj.

* Krahasimi përdoret shumë në letërsi, por edhe në ligjërimin bisedor.

... Strezi kish urdhër t'i mbante të tijtë jashtë përleshjes. Kolona rezervë që komandonte, i numëronte një mijë kalorës të zgjedhur, të ndarë në pesë shtiza, me nga dyqind shpata secila. Sa herë që kthente kokën pas, shikonte Lekë Balshën mbi **doriun** e kuq, me pelerinën e kuqe, me përkrenaren me skifter, shikonte Zugon e vrerët që shtrëngonte vetullat nën strehën e helmetës, Martin Ubinin mbi pullaliun e madh, si të gdhendur në një trupore mermeri, axhë Vrananë me sy të butë, të mençur, me flokët e bardha, që ia merrte era anëve të helmetës, me fytyrën e plakur që shprehte urtësi dhe qëndresë.

Pastaj Strezi e kthente përsëri kokën përpara dhe, duke shikuar armikun aq pranë, nuk e mbante dot veten.

Ah! Sikur të kishte fuqi ta hidhte gjysmën e fushës së Oranikut mbi gjysmën tjetër dhe ta fundoste aq thellë, sa të dilte ujë i zi nga pafundësitë e dheut!

Romani historik

Në romanin historik, ngjarjet historike gërshetohen me trillimin. Autori përdor elemente reale (ngjarje e personazhe historike, vende reale, luftëra, beteja të ndryshme të fituara apo të humbura), të cilave u qëndron besnik dhe elemente joreale (besëtytnitë, gojëdhënat, personazhe të jashtëzakonshme, personazhet mitike etj.).

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit.
 - a) Ku zhvillohet beteja e përshkruar në tekst?
 - b) Në tekst përmendet edhe një betejë tjetër. Cila është ajo?
 - c) Në cilën periudhë historike ndodh ngjarja?
 - ç) Kush e kishte tradhtuar kombin?
 - d) Sa ishte numri i ushtarëve shqiptarë që prisnin në fushën e betejës? Po në pritaf malore?
 - dh) Sa ishte numri i ushtarëve të kolonës rezervë që drejtonte Strezi?
 - e) Përshkruani gjendjen fizike dhe emocionale të ushtarëve dhe të komandantëve të ushtrisë shqiptare.

Analizojmë tekstin

- 2 E gjithë ngjarja është ndërtuar duke vendosur përballë njëra-tjetrës ushtritë kundërshtarë. Shënoni në tabelën karakteristikat e tyre.

Shqiptarët	Turqit

Studim teksti

- 3 Gjeni në tekst elementet reale të romanit historik. Shënojeni ato në tabelë.

Vende reale	Personazhe historike	Ngjarje historike

- 4 Në fragment ka shumë përshkrime të natyrës dhe të dukurive natyrore, të cilat plotësojnë imazhin e fushëbetejës dhe që bashkëshoqërojnë gjendjen e trazuar shpirtërore të luftëtarëve. Gjeni fragmentet dhe detajet me të cilat përshkruhen këto.
- 5 Në tekst ka disa shenja paralajmëruese, të cilat kanë një domethënie të veçantë për fundin e betejës. Nënvizojini ato.

Interpretojmë tekstin

- 6 Pse tregimtari shprehet në fjalinë e parë të tekstit: *"Oraniku tani ishte pragu i atdheut"*?
- 7 Pse fusha e Oranikut ngjante me arenën e një Koloseu?
- 8 Analizoni fragmentin: *"Ishin një popull i madh dhe kishin një ushtri të madhe, që s'shteronte. Kurse shqiptarët ishin një popull shumë i vogël dhe po të mundej ushtria e tyre këtu në Oranik, tani pas betejës së Beratit, kjo do të qe një mundje përgjithmonë."*
- ▣ Pse ky moment është vendimtar për shqiptarët?
- 9 Interpretoni fjalët e Strezit: *"Tradhtia! Ah, sikur të mund ta shtypja me dhëmbët e mi kokën e këtij gjarpri!"*

Gjuha e tekstit

- 10 Si cilësohet Moisi Golemi? Ç'pjesë e ligjëratës janë fjalët që përshkruajnë figurën e tij? Çfarë funksioni stilistik kanë ato?
- _____
- _____
- _____
- 11 Duke u mbështetur në kuptimin e parë të foljes *shteroj*, zbërtheni kuptimin e figurshëm në shprehjen *"... kishin një ushtri të madhe, që s'shteronte kurrë"*.
- 12 Gjeni dhe shkruani në fletore 5 krahasime dhe 5 epitete. Analizoni mënyrën sesi janë ndërtuar.

Reflektojmë rreth tekstit

- 13 Tradhtia është një akt, i cili mund të sjellë përfitime vetjake, por dëmton interesat e shoqërisë a të kombit. Diskutoni rreth kësaj çështjeje.

Detyrë

- ▣ Përshkruani me disa fjali një personazh historik.
- ▣ Gjeni dy romane të tjera, që përshkruajnë ngjarje të periudhës së Skënderbeut.

Tre vëllezërit dhe e Bukura e Dheut

Para leximit

Në qendër të përrallës janë marrëdhëniet e veçanta që krijojnë tre djem, që, ndonëse nuk janë të një gjaku, bëhen si vëllezër me njëri-tjetrin, për shkak të vështirësive që hasin gjatë rrugëtimit të tyre. Në përrallë rrëfohen peripecitë dhe pengesat që kalojnë, të cilat, herë e venë në provë lidhjen e tyre, herë e bëjnë edhe më të fortë. Situatat e jashtëzakonshme, forcat e mbinatyrshe me të cilat ndërveprojnë këto personazhe, i japin përrallës ngjyrat e një bote të magjishme.

Fjalor

hatullë – hapësira ndërmjet tavanit e çatisë; pullaz.

jesën – do të kalojnë jetën.

Një grua, gjashtë muaj pas vdekjes së të shoqit lindi një djalë, edhe me gjithë varfërinë e saj, e rriti djalin gjersa u bë pesëmbëdhjet' vjeç. Dhe pasi erdhi në mënt, djali pyeti t'ëmën se mos kish ndonjë send prej t'et, me qenë i kish thënë ajo, se ay kish baba. E ëma iu përgjegj se i ati kish lënë shumë plaçka, por ajo i shiti, që e rriti atë gjer m'atë moshë. “Më bëhet sikur është një kordhë në hatullë të shtëpisë akse-ku”. E djali i tha: “Ngremë më krahë që t'a arrinj, e ta marr”. Pasi mori këtë kordhë djali, të palarë që motit, e të ndryshkur, e lau dhe e shkëlqeu, edhe e mvari më qafë; pa i tha s'ëmës: “Unë, o nënë, do vete në dhe të huaj”. Pas këtyre fjalësh e ndërroi dhe emrin e tij, e vuri “Kordhë”, edhe mori e shkruajti emrin e tij përsipër. Në fund, i hodhi duart e tija më qafë s'ëmës për të puthur njëri-tjetrin, se do të ndaheshin, e nuk po ndaheshin dot një copë herë të madhe nga të qarët. E pasi iu largua fshatit pesë a gjashtë orë, djali arriu në një mal, i vetmi filli, edhe ndenji më një shesh, nxori kordhën, e puthi dhe e lëshoi në prehërt. Nuk shkoi gjysm' ore, edhe i erdh' një djalë në moshë të tij, e i tha: “Mirë dita, o mik”. Edhe ky ju përgjegj: “Mirë erdhe, o vëlla”. E pyet ay këtë: “Ngaha vjen e ku vete”? Ky i tha: “Kam dalë për kësmet”. “Edhe unë kështu, – i thot ay, – edhe në do, haj të bëhemi vëllezër e të vemi për kësmet”. Ky i shtiu duart më qafë e puthi, e pyeti dhe për emrin, ç'e quanin. Ay i tha se quhet “Yll”, i rrëfeu edhe ky të tijën: “Kordhë”.

U nisën pra këta të dy, e muarrën udhën drejt gjersa i zuri nata. Ndejtën atje më një vend, e pasi folën pak, ranë të flenë pa ngrën' e pa pirë. Të nesërmen muarrën përsëri udhën drejt, e pas ndo gjysm' ore u poqën me një djalë mbë moshë të tyre e i thon' atij: “Udhë e mbar' o fshatar!” Edh' ay u përgjigj: “Mbarë paçi o vëllezërit e mij!” E këta i thonë: “E nga na ke ti vëllezër neve?” E ay u përgjegj: “Nuk ju kishnja, por tani ju kam”. I thonë këta: “Të kemi edhe ne ty për vëlla”. E pysën edhe për emrin e tij, e u tha se e quanin “Det”. I rrëfyen edhe këta të tyrët, e u pushtuan të tre, e u puthën si tre vëllezër të vërtetë,

edhe lidhën besë që si do t'u ngjajë puna, të vdesin bashkë.

Kështu pra, muarrën udhën të tre e duke ecur, vajtën pranë një qyteti ku kishte edhe mbret, i cili ato ditë kishte çarë një hendek të gjerë, edhe kish lëçitur e përhapur fjalë që, ay që të kapërcejë këtë hendek, do të marrë çupën e mbretit për grua, e atij që të mos e kapërcenjë dot, do t'i pritët krynjët. Shumë veta kërcyen atje me shpresën që do ta kapërcenin, e ranë brenda, edhe me të parët e dërguan te therësi, i cili u preu krerët të gjithvet.

Pasi u afruan atje, edhe ndëgjuan se ishte pun' e hendekut për të kapërcyer, u mentuan këta të tre së bashku, e thanë: “A bëjmë zemër t'i hidhemi këtij hendeku, e mbase e kapërcejmë? E në mos e kapërcefshim, le të vdesim edhe ne”. Kordha pa pritur më u shti ay në mes të të dyvet të Yllit dhe të Detit, e i pushtoi mirë të dy, me të dy krahët, edh' u hoth me gjith' ata mbatanë pa ndonjë rëndësi, aqë sa, kur panë gjithë atë popull që ish atje, u

manitën. Edhe mbreti urdhëroi në çast e i muarrën me karrocë ata, i shpunë në pallat, e i qitën përpara tij, edh' ay i pyeti: “Cili nga ju do të marrë çupën time për grua?” I tha Kordha se do t'a marrë Ylli. E ca dit pas dasmës, Kordha lypi ndjesë prej Yllit, e prej Detit, që të nisët për të shkuar. Po ata me pikëllim të math i thanë: “Kaqë e pakë qënka vllazërija jonë? Sa ta jep zemra t'ikësh e të na lesh neve?” E Kordha u tha se “vëllazërija jonë është e pasosur, edhe unë ja ku po ju lë një pendë më derë tuaj, që, po të shikohet se kjo zu të pikonjë gjak, të delni sakaq e të më kërkoni, gjersa të më gjeni, se do të ndodhem më ditë të keqe”. E u puth pra me ata, edhe u nis e shkoi. Duke ecur ky tani tri, katër dit' udhë i vetmë, arriu në një vend ku ndaheshin shtatë udhë. Atje ishte një kullë, tek rrinte një plakë. Kësaj plake iu lut Kordha që t'i dëfjejë se ku venë ato udhë, e pasi mori vesh për udhën e të Bukurës së Dheut, u nis të shkojë. Atëherë plaka i tha këtij: “Mos, o bir, hump kryet tat' e djalërinë tënde më kot, se m'atë udhë kanë shkuar mbretër me ushtri të fortë, edhe s'kanë vajtur dot atje tek kërkon të vesh ti një fill i vetëm”.

Vajti pak më tej, e gjeti kuçedrën me gjashtë këlyshë mb'udhë, e cila iu derth ta hajë, po ay xhveshi kordhën edhe e preu me gjithë



këlyshë. Duke pritur më tej, iu duk atij pallati i së Bukurës së Dheut e tek ecte udhën për në pallat, gjeti një krua mb' udhë edhe qëndroi pakëz tek kroji. E pa e Bukura e Bheut atë, edhe i tha kuçedrës: “Po vjen një trim i mveshur në rroba të bardha”. E ajo iu përgjegj: “Pa vështro që nga dritoret, vallë qysh do të pijë ujë. Me dor' apo mbë gjunjazi?” Djali ra mbë gjunjë, kalli kryet në luk të kroit, edhe piu ujë. Atëherë i tha kuçedra asaj: “Nga ky njeri mua m'u trëmb syri”. Atje jashtë pallatit ishte një dru molle që kish edhe pemë, e kur djali u afrua pranë, ajo po e vështronte, a do të kërcente ay të mirrte atë mollën më të madhe. E djali kërceu edhe e zuri mollën me dhëmbë, jo me dorë. Posa pa kështu kuçedra, “Po, po, – tha, – nga ky njeri s'kam shpëtim unë”.

Arriu aty në derë të pallatit, edhe hyri drejt' e brënda. Arriu e xhveshi kordhën në çast, edhe ja hoqi asaj, e bëri dy gjysma. E kështu zaptoi të Bukurën e Dheut. Pasi shkoi ndonjë javë, e u vate në vesh mbretërve se një trim vrau kuçedrën, edhe mori të Bukurën e Dheut për grua, u ngrenjtën ata me të shpejtë e më të çuditur e vajtën në të shtatë udhët, edhe po pyesën plakën: “Ç'njeri shkoi këtu për te e bukur' e dheut? Edh' ajo u thosh: “Një djalosh nja gjashtëmbëdhjet' vjeç”. Ata pra e kuvenduan t'i venë përsipër atij. Dhe u nisën, e ja mbajtën penë drejt e përmbi atë, e luftuan njëzet e katër dit, e me gjith'atë, s'panë se ç'ti bëjnë. Po u këthyen prapë më kot. Ata mbretër, pasi nuk mundën ta mposhtin Kordhën, duke ikur prapë, ardhën tek plaka, e porositën atë të vejë tek' e Bukur' e Dheut', e t'e pyesë atë se, me çfarë trimërije e fuqie e zaptoi atë ay djalë. Pastaj plaka i tha asaj, që ta pyesë djalën ajo vetë se ku e ka ay gjithë trimërinë. Edhe ajo pas disa dit'sh e pyeti Kordhën: “Ku e ke tërë këtë trimëri?” E ay i gjori, nga dashurinja që kish për të, i rrëfeu duke thënë se gjithë trimërija e tij ishte kordha e tij, e se po t'i merrte kush kordhën, ishte fare i bjerrë dhe i humbur. E ashtu, plaka në krye të pak dit'sh ia gjeti volinë djalit, ia vodhi kordhën, dhe ja hodhi në det. Posa ja hodhën kordhën në det, Kordhës, që m'atë çast ay ra në lëngim e u bë për vdekje. Plaka u kthye në kullë të saj e gëzuar, edh' u dha zë mbretërve se: kush të dojë të marrë të Bukurën e Dheut prapë pa ushtri, pa luftë, le të vejë, se i arth dita. Edhe mbretërit porsa e ndëgjuan, u nisën të venë përmbi Kordhën. Po, sa pa vajtur këta, të vëllezërit e Kordhës kishin parë pendën e tij, që po pikonte gjak edhe kishin dalë me të shpejt për të gjetur vëllan' e tyre. Ylli mori Detin më krahë edhe sakaqëherë ia arritën Kordhës shumë më parë se mbretërit, e me të vajtur e pyetën të Bukurën e Dheut: “Ku e ka kordhën vëllaj i ynë?” Ajo u tha se ia muarrën, edhe ia flakën në det. Prandaj u ngrit Deti në çast, hyri në det, edhe e gjeti kordhën, e ja suall të vëllajt, i cili posa i erth' kordha, sa të fshish synë, u squa, edhe u ngrit sikur ish i shëndoshë. E duke fshirë sytë, u tha atyre: “Oji! Ç'paskam fjetur shumë!”. Por kur pa të vëllezërit pranë, pikasi që e kish gjetur e keqja. Arritën edhe mbretërit për të luftuar, edhe i ranë burrërisht, po pasi ishte prap' i shëndoshë Kordha, edhe këtë herë u mposhtën ata. Duke hequr, erdhën te mbreti, vjehrr' i Yllit, të cilit i kish marrë të bijën, e i lypën ndjesë për të vajtur në dhe' të tyre, me gjithë të bijën e tij, po mbreti u përgjegj

atyreve: “Ju ecni kudo që të doni, po im dhëndër edhe ime bijë do të **jesën** këtu”. I thotë Kordha mbretit: “Po të jenë të dy palët më një mendje, le të jesën këtu, po ne do të shkojmë”. E Ylli u tha në syt’ e mbretit: “Unë për gjë, edhe për vajzën e mbretit nuk ndahem prej jush, o vëllezër”. Hidhet mbreti dhe i thotë: “Do, s’do, do të ndahesh”. Hidhet Kordha dhe i thotë mbretit: “Kjo do, s’do, ç’do me thënë? Yllin, vëllanë tonë do të mbash ti këtu me pahir? Ay njeri që do të dojë të mbajë një nga ne të tre me pahir, s’është lindur”.

Të pastajmen u vete përsipër ushtria këtyreve, e ata po rrinë të patrembur. Atëherë Kordha pa ç’pa, u tha vëllezërvet: “Merrni gratë ju, edhe shkoni përpara”. E ay, i vetëm, xhveshi pallën e tij, e u derdh mbi ata e preu shtatë qind veta prej syresh, edhe të parin e tyre bashkë. Ushtri e ngratë, thyer e prishur në ditë të keqe, duke parë që u vra dhe i par’ i tyre, pa parë më i pari të dytin, ikën prapë me lemeri të madhe. Ashtu pra u nis edhe Kordha e mori udhën e tij dhe ja arriu të vëllezërve atje tek po e prisnin atë.

Të gjithë bashkë muarrën udhën e tyre, edhe pas tri dit’sh arrinë në shtëpinë e Kordhës. Duke përshëndosur t’ëmën e atij, kjo u tha: “Cilët jeni ju që më thoni mua mëmë”? Ata i thanë se “ashtu na ka porositur yt bir. Ajo zu të verë re mirë, e pasi e mblodhi veten e saj, shëmbëllen të birë, edhe e njohu. Ju hoth djalit e puthi me mall të math. Ani puthi edhe të tjerët, edhe të dy gratë e atyre.

Si u vendosën këta atje, pas ca moti thanë ndër njëri-tjetrit: “A tre vëllezër jemi ne, apo dy?” Ylli u përgjegj: “Jemi tre”. “E po kur ne jemi tre, përse kemi vetëm dy gra? U hoth Deti, e u tha atyre: “Pahiçë s’prish punë”. Atëherë tha Kordha: “Yllë, do të të bëjmë mbret mbi të gjithë vendin tënd”. Edhe e bënë mbret, e mbretëroi gjithë jetën e tij. Edhe sa rojtën ata që të tre, ishin tërë jetën vëllezër të dashur.

Heroi i përrallave

Në qendër të përrallave ka gjithmonë një hero, por kjo nuk do të thotë se nuk mund të jenë më shumë. Heroi i përrallave përballat me probleme të cilat duhet t’i zgjidhë vetë (për shembull, i duhet të luftojë kundër të keqit, përbindëshit, që të mbijetojë). Ai mund të ndërmarrë një udhëtim, të kapërcejë vështirësi, të ndeshet me të papritura apo rrethana të jashtëzakonshme dhe në fund gjithmonë do të triumfojë. Tiparet e heroit të përrallave janë: i mirë, trim, i zgjuar, i guximshëm, i shkathët. Në disa raste, heroit nuk ka fuqi magjike, por ka ndonjë objekt ose ndonjë ndihmës që ka aftësi magjike që e ndihmon.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni përrallën dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Çfarë i kërkoi djali nënës së tij?
 - b) Kë takoi djali gjatë rrugëtimit të tij? Çfarë i premtuan njëri-tjetrit djemtë?
 - c) Në ç’mënyrë arritën ta kapërcenin sfidën e mbretit?
 - ç) Kush e mori për grua të bijën e mbretit?
 - d) Si do ta kuptonin dy vëllezërit, kur Kordha do të kishte nevojë për ta?
 - dh) Kordha u gjend në mes të shtatë udhëve. Cilën udhë zgjodhi ai?
 - e) Me kë ndeshet Kordha dhe në ç’mënyrë arrin të fitojë?
 - ë) Ç’vendim morën vëllezërit pasi mundën ushtrinë e mbretit? Kush i kundërshtoi ata?

Analizojmë tekstin


- 2 Cilat janë dy veprimet e Kordhës që e frikësuan Kuçedrën?

- 3 Analizoni përrallën dhe dalloni tri elemente të veçanta, të jashtëzakonshme, që i bëjnë të tre vëllezërit të pamposhtur.
- 4 Përshkruani pengesat që kaloi Kordha gjatë rrugëtimit të tij.

Interpretojmë tekstin

- 5 Si e interpretoni vendimin e Kordhës për t'ia dhënë Yllit vajzën e mbretit, ndërsa vetë të mos marrë asgjë e të niset përsëri për udhë?
- 6 Si ju duket vendimi i vëllezërve për të jetuar së bashku? Pse?
- 7 Mbreti kërkon që Ylli me vajzën e tij të mos largohen. Fjalët: "Do, s'do, do të ndahesh", çfarë tregojnë për karakterin e mbretit?
- 8 Cilin nga të tre vendosën të bënin mbret vëllezërit? Interpretoni zgjedhjen e tyre. Çfarë tregon kjo për marrëdhënien mes vëllezërve?

Gjuha e tekstit

- 9 Gjeni këto shprehje në tekst dhe shpjegoni kuptimin e secilës prej tyre.
- pasi erdhi në mënt _____
- muarrën udhën _____
- a bëjmë zemër _____
- mos hump kryet tat' _____
- u ndez nga zemërimi _____
- u derdh mbi ata e preu shtatë qind veta _____
- 10 Shënoni me  veçoritë që karakterizojnë gjuhën dhe strukturën e përrallave.
- | | |
|---|--|
| <input type="checkbox"/> gjuhë e thjeshtë | <input type="checkbox"/> formula tipike hyrëse |
| <input type="checkbox"/> gjuhë e ndërlikuar | <input type="checkbox"/> situata fantastike |
| <input type="checkbox"/> përsëritja e fjalëve | <input type="checkbox"/> fjali të gjata |
| <input type="checkbox"/> fjali të shkurtra | <input type="checkbox"/> situata që synojnë një moral të caktuar |

Reflektojmë rreth tekstit

- 11 Pasi keni lexuar më vëmendje përrallën, diskutoni me njëri-tjetrin se ku qëndron forca e tre djemve.

Detyrë

- Në përrallë përmenden disa numra që janë tipikë për krijimet popullore, veçanërisht numri tre. A dini përralla të tjera, në të cilat ky numër ndeshet më shpesh?
- Cili është mesazhi më i rëndësishëm që përcjell kjo përrallë?

Harri Potter mund trashëgimtarin e Gjarpërblertit

Para leximit

Harri arrin të futet në Dhomën e të Fshehtave, që nuk ishte hapur prej shumë kohësh, ndonëse për të flitej shpesh mes nxënësve të shkollës së magjistarëve "Hogwarts". Aty, ai do të përballlet me Ridllin, një ish-nxënës i kësaj shkolle. Ridlli i thotë Harrit se ai është pasardhës i Salazar Gjarpërblertit dhe ndryshe njihet si Lordi Fluronvdekja. Ridlli ka nën urdhrat e tij një Bazilisk, një gjarpër gjigand që del nga shtatorja e Gjarpërblertit. Në dyluftimin me Baziliskun e ndihmon Foksi, Feniksi i Urtimorit dhe Kapela që Flet. Pas përlëshjeve të përgjakshme, Harri vret Baziliskun dhe triumfon mbi Ridllin, duke shpëtuar miqtë e tij dhe gjithë shkollën.

Përkthyer nga Amik Kasoruko

– Dy herë... në të kaluarën tënde, në të ardhmen time... jemi takuar. Dhe dy herë s'ia kam dalë të të vras. Si dreqin më ke shpëtuar? M'i trego të gjitha. Sa më gjatë të flasësh, – shtoi me zë të ulët, – aq më vonë do të vdesësh.

Harri po shtrydhte trutë si nëpër ethe sesi të shpëtonte. Ridlli kishte shkopin magjik. Ai, Harri, kishte Foksin dhe Kapelën që Flet, por asnjëri syresh nuk do ta ndihmonte kushedi sa në atë dyluftim...

– E di pse s'ia dole të më vrisje? Sepse ime më dha jetën e vet për të më shpëtuar. Mëma ime, që pat rrjedhur nga një fis i rëndomtë babanacësh, – shtoi duke u dridhur nga mëria e ndrydhur.

Fytyra e Ridllit u ngërdhesh. Pastaj djali u detyrua të vinte buzët në gaz: një buzëqeshje e tmerrshme.

– Domethënë, mëma jote paska vdekur për të të shpëtuar? Po, duhet ta pranoj se është fjala për një kundërshti të fuqishme. Tani e kuptoj ... në fund të fundit, ti nuk ke asgjë të veçantë. Doja ta dija a e kupton? Sepse midis nesh, Harri Potter, ka disa ngjashmëri të çuditshme. Edhe ti duhet t'i kesh vënë re. Që të dy jemi gjakpërzier, jetimë, dhe na kanë rritur babanacët. Me gjasë, jemi edhe të vetmit që flasim gjuhën e gjarpërinjve dhe që jemi shkolluar në "Hogwarts" që nga koha e Gjarpërblertit të madh. Edhe fizikisht sikur ngjasojmë... por prej meje shpëtove vetëm rastësisht, një rastësi fatlume. Tani, Harri, dua të të jap një mësim të vockël. Le të matim fuqitë e Lordit Fluronvdekja, trashëgimtar i Salazar Gjarpërblertit, dhe ato të të famshmit Harri Potter, i cili zotëron armët më të mira që është në gjendje t'i japë Urtimori.

Harri u kthye të shikonte shtatoren. Foksi luhatej mbi supin e tij.

Fytyra e stërmadhe prej guri e Gjarpërblertit lëvizti. I tmerruar, Harri pa që goja e tij po hapej gjithnjë e më shumë, derisa erdhi dhe u bë një alamet grope e zezë. Dhe brenda gojës diçka lëvizti.

Mbi dyshtemenë prej guri ra me një zhurmë të mbytur diçka e rëndë; Harri ndjeu që u drodh te këmbët e tij. E dinte ç'po ndodhte, e merrte



J. K. Rowling

Shkrimtarja Xhoan K. Rouling (Joanne K. Rowling, 1965) u bë e njohur pas botimit të librit të saj "Harri Poteri dhe Guri Filozofal". Suksesi i këtij libri dhe i të dytit, "Harri Poteri dhe Dhoma e të Fshehtave", e nxiti autoren të shkruajë edhe libra të tjerë për aventurat e Harri Poterit. Seria e këtyre librave është përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe mbi subjektet e tyre janë realizuar shumë prodhime kinematografike. Po kështu, shkrimtarja Rouling ka bashkëpunuar me skenaristë dhe regjisorë për vënien në skenë të dramës "Harri Potter dhe fëmija i mallkuar". "Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden" është skenari i saj i parë për film.



me mend, gati-gati i dukej se e shihte gjarprin e stërmadh duke u zhdredhur nga goja e Gjarpërblertit. Pastaj dëgjoji piskamën e Ridllit: “Vrite!”

Harri u pengua. Ra sa gjerë e gjatë mbi gurë dhe goja iu mbush me gjak. Gjarpri ishte disa metra larg tij, e ndjente që po i afrohej. Sipër tij u ndie një fishkëllimë çjerrëse, pastaj Harrin e goditi diçka shumë e rëndë, që e ngjeshi mbas faqes së murit.

Gjarpri gjigand, me trupin e shkëlqyer ngjyrë të blertë vreri, i trashë sa trungu i një lisi, kishte drejtuar trupin dhe koka e tij e madhe po lëkundej midis

shtyllave, sikur të ishte i dehur. Harri po dridhej: me t’u kthyer përbindëshi, ai u bë gati t’i mbyllte sytë, por pikërisht atëherë pa ç’e kishte hutuar.

Foksi po i rrotullohej fluturim sipër kokës së **Baziliskut**, i tërbuar, përpiqej t’i ngulte dhëmbët e gjatë dhe të mprehtë shpatë. Feniksi iu sul kryengulthi. Sqepi i tij i gjatë e i artë u zhduk dhe, pak çaste më vonë, një përrua gjaku i zi stërpiku dyshemenë. Harri e vështroi dhe pa që feniksi ia kishte shpuar sytë e verdhë dhe të dalë, gjaku rridhte çurg në dysheme dhe përbindëshi pështynte duke dhënë shpirt.

– Jo! – U dëgjua zëri i Ridllit tek bërtiste. – Lëre shpendin! Lëre shpendin! Djali është mbas teje! Mund ta nuhasësh! Vrite!

Përsëri bishtit i gjarprit fshikulloi dyshemenë. Harri iu shmang. Pastaj e goditi në fytyrë diçka e butë. Bazilisku i kishte gjuajtur me Kapelën që Flet. Harri e rroku. Ajo ishte tërë ç’i mbetej, mundësia e tij e vetme dhe e fundit. E vuri në kokë dhe pastaj u hodh përdhe, ku mbeti i shtrirë, ndërsa bishti i Baziliskut vijonte ta godiste.

Ndihmomë... ndihmomë... – mendonte Harri duke i mbajtur sytë mbyllur nën kapelë. – Të lutem, ndihmomë...

Kapela nuk u përgjigj, por u drodh, sikur ta kishte shtrydhur një dorë e padukshme.

Mbi kokën e Harrit ra një send i ngurtë e i rëndë dhe atij gati sa s’i ra të fikët. I trullasur, e kapi Kapelën nga maja për ta hequr nga koka, por aty për aty, ndjeu me dorë diçka të gjatë dhe të fortë.

Brenda Kapelës ishte shfaqur një shpatë e ndritshme prej argjendi, me dorezë të stolisur me rubinë të kuq, të mëdhenj sa një kokërr ve.

– Vrite djalin! Lëre shpendin! Djali është mbrapa teje! Nuhate... merri erë!

Gjarpri kërceu përsëri dhe gjuha **e bigëzuar** fshiku ijët e djalit. Harri ngriti shpatën me të dyja duart. Bazilisku u vërvit përsëri drejt tij. Harri mori vrull dhe ia nguli shpatën në qiellzë deri te doreza.

Një dhëmb i helmuar po i ngulej gjithmonë e më thellë në krah dhe iu këput brenda, kur Bazilisku u kthye anash dhe ra përsëri përdhe duke u përpëlitur. Harri u platit pas murit dhe ra. E mbërtheu dhëmbin që

Fjalor

Bazilisk – gjarpër me përmasa gjigande dhe jetëgjatësi të madhe.

Sipas legjendave dhe asaj që thuhet në roman, ai kishte fuqinë të vriste jo vetëm nëpërmjet dhëmbëve që përmbajnë një helm të fuqishëm, por edhe përmes vështrimit të tij, duke shkaktuar vdekje të përnjëhershme.

e bigëzuar – diçka që përfundon me një ndarje më dysh; gjuha e gjarprit në fund është e ndarë më dysh.

po i përhapte helmin nëpër trup dhe e shkuli nga krahu. Por ishte vonë, e dinte.
 – Foksi, ti je? – Gjuha i qe trashur. – U tregove shumë i zoti, Foksi... – Ndjeu që shpendi mbështeti kokën e tij të hirtë në vendin ku e kishte plagosur dhëmbi i gjarprit.
 – More fund, Harri Poter, – tha nga lart zëri i Ridllit, – more fund! Këtë e di edhe Feniksi i Urtimorit. E sheh ç'po bën, Poter? Po qan.

Harri përplasi qepallat. Koka e Foksit herë i turbullohej e herë i qartësohej përpara syve. Mbi pendën e ndritshme të shpendit rridhnin kokrra të madha loti si perla.

Tashti po ulem këtu të të shohë tek po vdes, Harri Poter. Merre me nge. Unë nuk kam ngut.

– Ky është fundi i të famshmit Harri Poter, – tha zëri i largët i Ridllit. – I vetëm në Dhomën e të Fshehtave, i braktisur nga shokët, i mposhtur më në fund nga Zotëria i errët, të cilit ai iu kundërvu pa mend në kokë. Shpejt ke për ta takuar mëmën tënde gjakpërzier, Harri. Të ka dhuruar dymbëdhjetë vjet jetë... por Lord Fluronvdekja më në fund të mbërtheu, siç e dije mirë që kishte për të ndodhur.

“Nëse vdekja është kështu, nuk qenka dhe aq keq”, – mendoi Harri. Edhe dhimbja po i shuhej... Një njollë në ngjyrë të perlave, formuar nga lotët e shpendit, shndriste rreth plagës... vetëm se plaga ishte zhdukur.

– Zhduku andej, zog i lig! – u dëgjua përnjëherësh zëri i Ridllit.

– Lotët e feniksit, – tha Ridlli ngadalë, duke ia ngulur vështrimin krahut të Harrit. – Posi... fuqi shëruese mrekullibërëse... e kisha harruar...

– Po s'prish punë. Madje kështu më duket më mirë. Vetëm ti dhe unë, Harri Poter... ti dhe unë.

Ngriti shkopin. Atëherë, mes një vorbulle flatrash, Foksi filloi përsëri të vinte rreth kokave të tyre dhe Harri ndjeu që i ra diçka në prehër... ditari.

Për një çast të vetëm, Harri dhe Ridlli që kishte ende të ngritur në gjysmë lartësie shkopin magjik, u panë sy ndër sy. Pastaj vetvetiu, pa u menduar, sikur të mos kishte pasur kurrë tjetër gjë në mendje, Harri ngriti përnjëherësh dhëmbin e Baziliskut dhe ia nguli librit mes për mes.

U dëgjua një ulërimë e gjatë, e llahtarshme, që të shponte tejmbanë. Boja nisi të rridhte me shkulma nga ditari mbi duart e Harrit, duke përmytur dyshe-menë. Ridlli po spërdridhej e përpëlitej, duke ulërirë dhe duke u përpushur, pastaj...

U zhduk. Helmi i Baziliskut, duke i kaluar përmes, e kishte djegur dhe i kishte bërë një vrimë që vazhdonte të kërciste si drutë. Harri u ngrit duke u dridhur. Ngriti ngadalë nga toka shkopin magjik dhe Kapelën që Flet. Pastaj, duke e tërhequr me forcë, e shkuli shpatën nga qiellza e Baziliskut.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) A janë takuar edhe herë të tjera Ridlli e Harri? Sa vjet kanë kaluar nga takimi i parë?
 - b) Si njihet ndryshe Ridlli nga fëmijët dhe mësuesit e Hoguorts-it?
 - c) Çfarë e sulmoi Baziliskun në sy?
 - ç) A arriti gjarpri gjigand ta helmonte Harri Poterin me helmin e tij?
 - d) Në ç'mënyrë e mundi Harri Poteri kundërshtarin e tij? Ku qëndronte fuqia e Ridllit?

Analizojmë tekstin

- 2 Nëpërmjet diagramit të Venit, përcaktoni çfarë kanë të përbashkët dhe çfarë e dallon Harri Poterin nga Ridlli.



- 3 Gjeni në tekst momentet kur Foksi e ndihmon Harrin dhe shpjegoni në ç'mënyrë.
- 4 Analizoni tekstin dhe përmendni objektet magjike që përdoren gjatë përlëshjes.
- 5 Gjeni në tekst shprehjet që përshkruajnë figurën e gjarprit me hollësi dhe shpjegoni çfarë synohet me këtë.
- 6 Në tabelën e dhënë, identifikoni elementet që i japin romanit karakter fantastik. Shënoni Po ose Jo.

Udhëtime të rrezikshme	
U duhet të kapërcejnë pengesa të shumta, të jashtëzakonshme.	
Përballen me rreziqe të mëdha për jetën.	
Luftojnë me forca të panjohura, përtej përmasave e moshës së tyre.	
Konflikti merr përmasat e një përballjeje mes së mirës dhe së keqes.	

Interpretojmë tekstin

- 7 Teksa sheh Harrin të plagosur rëndë, Ridlli i thotë: "Tani po ulem këtu të të shohë tek po vdes, Harri Poter. Merre me nge. Unë nuk kam ngut". Çfarë tregojnë këto fjalë për karakterin e Ridllit?

Gjuha e tekstit

- 8 Autorja synon të krijojë një situatë sa më të tensionuar. Me cilat prej teknikave të mëposhtme e arrin këtë efekt? Shënoni me ✓.
- Me fjali të shkurtra dhe të thjeshta.
 - Me fjali të gjata, që tregojnë me hollësi shumë gjëra njëkohësisht.
 - Me shprehje të figurshme.
 - Me pasthirrma të shumta e të frikshme.
 - Me praninë e shpeshtë të gjendjes pezull (suspansës) për të krijuar pasiguri.
- 9 Në një situatë të caktuar, Ridlli i drejtohet me ironi Harrit. Gjejini këtë moment në tekst dhe shpjegoni përse e bën ai këtë gjë.

Reflektojmë rreth tekstit

- 10 Kanë kaluar shumë vite dhe Ridlli vazhdon ta urrejë Harri Poterin. Si mendoni, me kalimin e viteve, zbehen apo forcohen ndjenjat?
- 11 Ridlli merr vesh se shumë vite më parë, Harrin e shpëtoi prej tij e ëma, e cila u vetësakrifikua. Çfarë e shtyn një nënë të japë jetën për fëmijën e saj? Reflektoni për marrëdhënien që keni me nënën tuaj.

Detyrë:

- 📄 Feniksi është një figurë shumë e njohur mitologjike. Hulumtoni në internet rreth tij dhe përshkruani aftësitë e veçanta që ka.

Krahasimi i heronjve të përrallës me heronjtë e filmave fantastikë

Nëse do të krahasojmë heronjtë e përrallave me ata të filmave fantastikë, duke synuar të gjejmë ndryshimet e prekshme ose karakteristikat dalluese të tyre, do të zbulojmë se nuk është një punë edhe aq e thjeshtë. Kjo për vetë faktin se ekzistojnë disa veçori të përgjithshme, të cilat mund t'i kenë si heronjtë e përrallave, ashtu edhe ata të filmave fantastikë. Shumë prej këtyre veçorive, edhe pse të dobishme, mbivendosen te personazhet, çka e bën diferencimin më të paqartë.

Ndarja në dy grupe e këtyre personazheve është e vështirë, sepse shumë prej tyre mund t'i gjejmë edhe te përrallat, edhe te filmat fantastikë. Për shembull, dragonjtë, njëbrirëshit, magjistarët, zanat, princeshat dhe kalorësit me forca të jashtëzakonshme shfaqen si në filmat fantastikë, ashtu edhe në përralla.

- Te përrallat, heronjtë janë përgjithësisht figura që lëvizin në një hapësirë lokale të kufizuar dhe konflikti është gjithashtu i kufizuar. Heronjtë e përrallave luftojnë për dashurinë ose për të fituar lirinë, duke u përpjekur të shpëtojnë nga kthetrat e një shtrige, djalli, kuçedre, mbreti të keq etj. Subjekti i një përralle përqendrohet më shumë në karakterin e heroit sesa në atë që ndodh përreth tij. Mjafton një magji dhe ngjarjet marrin një drejtim tjetër. Në përralla nuk ka nevojë për shumë shpjegime. Ato kanë gjithmonë fund të lumtur dhe gjithçka përfundon si jo më mirë.

Kordha, heroi i përrallës “Tre vëllezërit dhe e Bukura e Dheut”, është një djalë i varfër, që ka trashëguar nga i ati një kordhë, e cila ka fuqi magjike. Djaloshi nuk lufton për të shpëtuar popullin, as botën, por për të marrë të bukurën e dheut dhe të bëjë pasuri që të jetojë i lumtur. Në këto





përpyekje, ai u bashkohet dy shokëve, të cilët ashtu si ai, kanë dalë për kësmet.

- Filmat fantastikë zakonisht janë saga, udhëtime epike, drama dhe veprime që kanë në thelb ndryshimin; që paraqesin shkatërrimin ose shpëtimin e mundshëm të një populli, vendi apo edhe të një bote të panjohur.

Harri Poterit i duhet të luftojë me forcat e errëta që vijnë nga Dhoma e të Fshehtave, për të shpëtuar jetën e vet dhe qëndrimin në Huguarts, vendin ku ai ndihet mirë. Megjithatë, më shumë se veten, ai dëshiron të shpëtojë jetën e shokëve të vet, Hermionës, Ronit, Xhenit dhe të gjithë atyre që mësojnë në shkollën e tij. Dhe jo vetëm kaq. Hapja e Dhomës së të Fshehtave është një e keqe e krijuar për të shkatërruar botën dhe për të sunduar atë që mbetet prej saj. Pikërisht kundër kësaj të keqeje lufton Harri Poteri.

- Ndonëse të gjithë e dimë se përrallat ndodhin “shumë larg” dhe “shumë kohë më parë”, shpesh na duket se ndodhin brenda botës ku jetojmë. Për nga struktura, ato nuk kërkojnë ndonjë diapazon aq të gjerë, mbushur me elemente specifike, si ato që përdorin autorët e fantazisë për të krijuar historitë e tyre.

Kordha, Ylli dhe Deti lëvizin në botën e njerëzve, ata rrezikojnë jetën e tyre, por jo të tjerëve. Botës nuk i kanoset ndonjë rrezik, nëse ata humbasin.

- Në filmat fantastikë, heronjtë veprojnë më së shumti në një botë të krijuar posaçërisht për ta, pra janë të ndarë nga bota “reale”. *Oz*, *Narnia*, *Wonderland*, *Warth-Sea*, *Westeros*, *Never-Never Land*, secila prej këtyre botëve ka një ndërtim, imazh fizik, rregulla dhe norma specifike, krejtësisht të ndryshme nga ato të botës ku jetojmë. Heronjtë e tyre mund të vijnë në botën tonë (në Tokë), por sapo shkëputen prej saj, bëhen krejtësisht të huaj.

Harri Poteri ka jetuar në Tokë, por tashmë i përket botës së magjistarëve. Gjithçka që ai bën, qeniet me të cilat ai miqësohet ose u kundërvihet, janë pjesë e një bote tjetër. Harri duhet të zbulojë dhe të mundë atë që ka hapur Dhomën e të Fshehtave. Dhe këtë e bën jo vetëm për të shpëtuar veten, shkollën e tij të dashur, por më shumë, për të shpëtuar jetën e çdo personi dhe krijese që jeton në botën, së cilës tashmë i përket. Pra, heroi lufton ndaj së keqe që rrezikon shkatërrimin, kaosin, ndaj dhe qëllimi i tij merr karakter universal.

- Në përrallë ndodhin ngjarje, veprime magjike, por rrallëherë lind nevoja për t'i shpjeguar ato. Kjo për shkak se përralla ndërtohet në mënyrë të tillë, që të japë efekt të drejtpërdrejtë të dëgjuesi apo lexuesi. Kështu, ai nuk ka nevojë të ndalet e të qartësohet për atë që ndodh.

Harri Poteri është një personazh që zë fill në botën reale, duke përfshirë brenda saj magji dhe elemente të mbinatyrshme. Ndryshe nga personazhet e përrallave, ai nuk bën gjithmonë gjënë e duhur. Thyen rregullat, bën gabime, ngatërrohet në situata që edhe mund t'i shmangë. Ndodh që shumë nga këto, ai i koklavit vetë. Aq sa, shpeshherë, na vjen t'i tërheqim vëmendjen apo t'i thërrasim: “Kujdes, Harri! Mos e bëj këtë gjë! Mos shko atje! Hermiona të ka njoftuar!”. Harri nuk është i pagabueshëm, megjithatë është shumë i ndjeshëm ndaj padrejtësive.

Përgjithësisht, heronjtë e filmave fantastikë janë të guximshëm, besnikë dhe të dhembshur. Harri është i gatshëm të bëjë gjithçka për miqtë e tij, madje edhe të rrezikojë jetën. Ai është përherë në krah të atyre që kanë nevojë.

Periudha e krijimit

Fillimisht, përrallat kanë qenë krijime gojore, të rrëfyera për shekuj me radhë e të përcjella nëpër breza. Krahas funksionit argëtues që kanë, ato synojnë të japin një mesazh për mbrojtjen apo ruajtjen e vlerave. Nisur nga zanafilla tejet e hershme e tyre, përrallat mund të konsiderohen me plot gojë *krijime origjinale* dhe pikërisht këtu qëndron veçantia e tyre, ndryshe nga çdo imitim apo ritregim që mund t'u bëhet në ditët e sotme.

Filmat fantastikë janë, natyrisht, krijime më të reja. Nuk mund të përcaktohet saktësisht një datë apo zanafilla e tyre, por duket se jo më shumë se një shekull më parë. Ngjarjet e filmave fantastikë mund të vendosen në mjediset e një kohe të shkuar (siç janë p.sh., fantazitë historike) ose në sfondin e nën-zhanreve të romanit fantastik të kohëve moderne. Këtij sfondi i përket edhe historia e Harri Poterit.

Përgjigjuni këtyre pyetjeve

- 1 Cilat janë elementet e jashtëzakonshme në përrallën “Tre vëllezërit dhe e Bukura e Dheut”? Po në filmin “Harri Poteri dhe Dhoma e të Fshehtave”?
- 2 Kush nga heronjtë e ka fatin të paracaktuar dhe është i destinuar nga forca të mbinatyrshme për të bërë gjëra të mëdha: Harri Poteri apo Kordha?
- 3 Në përrallën “Tre vëllezërit dhe e Bukura e Dheut”, kë shpëtoi Kordha dhe çfarë arriti me trimërinë e tij? Po në filmin “Harri Poteri dhe Dhoma e të Fshehtave”, kë shpëtoi Harri?
- 4 Krahasoni efektin e veprimeve të Kordhës mbi botën, me efektin e veprimeve të Harri Poterit mbi botën e njerëzve dhe të magjistarëve.

Udhëtim për në qendër të Tokës

Para leximit

"Udhëtim për në qendër të Tokës" është një roman fantastiko-shkencor, që rrëfen për udhëtimin e profesorit Lidenbrok, i cili së bashku me nipin e tij, Aksel, dhe shoqëruesin Hans, ndërmarrin një ekspeditë, duke udhëtuar përmes grykës së një vullkani ishullor në drejtim të qendrës së Tokës. Në këtë udhëtim të çuditshëm, mbushur plot me aventura, ata zbulojnë në nëntokë kafshë të egra, bimësi të periudhës prehistorike, si dhe shumë dukuri natyrore të çuditshme, krejtësisht të pashpjegueshme. Duke zbritur me kilometra të tërë poshtë, ata arrijnë në një shpellë jashtëzakonisht të madhe. Atje gjenden përballë një oqeani shumë të thellë nëntokësor, të rrethuar nga një bregdet shkëmbor. Sipërfaqja e ujit është kaq e madhe, sa nuk arrijnë të shohin çfarë ka përtej, por kur ulen në breg dhe soditin valët që përplasen me njëra-tjetrën, magjepsen krejt.

Përkthyer nga Roland Kajca



Zhyl Verni

Zhyl Verni (Jules Verne, 1828 - 1905) poet, dramaturg dhe romancier, është konsideruar "babai" i fantashkencës. Shpikjet e përshkruara në shumë nga librat e tij, tashmë janë bërë realitet dhe veprat e tij kanë frymëzuar breza të terë krijuesish e shpikësish. Zhyl Verni ka shkruar 58 romane, por më të njohurat mes tyre janë: "Pesë javë në balonë", "Ishulli misterioz", "Rreth botës për 80 ditë", "20 mijë lega nën det", "Nga Toka në Hënë", "Udhëtim për në qendër të Tokës", "Aventurat e kapitenit Hateras", "Bijët e kapitenit Grant", "Kapiteni pesëmbëdhjetëvjeçar", "Dy vjet pushime", "Një qytet lundrues", "Vullkani i artë" etj.

Ne ishim me të vërtetë të burgosur në një *gërmimë* të pamasë. Gjerësinë e tij nuk mund ta vlerësonin, meqë bregu shkonte duke u zgjeruar sa të hante syri, dhe as gjerësinë, sepse vështrimi ndalej shpejt nga një vijë e horizontit disi e papërcaktuar. Sa për lartësinë, ajo duhej t'i kalonte disa lega.

Fjala "shpellë" nuk i përgjigjet sigurisht mendimit tim për të pikturuar këtë ambient të pamasë. Po fjalët e gjuhës njerëzore nuk mund t'i mjaftojnë atij që *kuturis* të futet në humnerat e rruzullit.

Nga ana tjetër, nuk dija as si ta shpjegoja ekzistencën e një gërmime të tillë. A thua të ishte shkaktuar nga ftohja e rruzullit? Nga tregimet e udhëtarëve, i dija mirë disa shpella të famshme, po asnjë prej tyre nuk kishte përmasa të tilla.

Në qoftë se shpella e Guaçarës, në Kolumbi, e vizituar nga Humboldti, nuk ia kishte zbuluar të fshehtë të thellësisë së vet dijetarit që e njohu gjer në një hapësirë prej dy mijë e pesëqind këmbësh ajo, me ç'kish të ngjarë, nuk shtrihej shumë përtej kufiri. Shpella e pamasë e Mamuthit, në Kentaki, paraqiste vërtet përpjesëtime vigane, meqë kubeja e saj ngrihej gjer në pesëqind këmbë lartësi përmbi një liqen shumë të thellë, e meqë mjaft udhëtarë e përshkruan për më se dhjetë lega pa ia gjetur fundin. Po ç'ishin këto zgavra në krahasim me atë që po admiroja unë atëherë, me qiellin e saj me avuj, me rrezatimet elektrike dhe me një det shumë të gjerë e të mbyllur në barkun e saj? Të gjitha këto mrekulli po i soditja në heshtje. Fjalët më mungonin për të shprehur ndijimet e mia. Më dukej sikur isha në ndonjë planet të largët, në Uran ose në Neptun dhe shihja fenomene, të cilat natyra ime "tokësore" nuk i kuptonte dot. Për ndijimet e reja duheshin fjalët të reja, dhe imagjinata ime nuk i gjente dot. Vëreja, mendoja, sodisja me një mahnitje të përzier me njëfarë tmerrri.

Kjo pamje e paparë kurrë, më kishte kthyer menjëherë në fytyrë ngjyrën e shëndetit; isha duke u kuruar përmes habitës dhe po shërohesha nëpërmjet kësaj metode të re terapeutike; nga ana tjetër, ajri i freskët e shumë i dendur po më gjallëronte, duke u dhënë më shumë oksigjen mushkërive të mia.

Prandaj, nuk u pendova aspak që dola nga shpella ime e errët. Im ungj, që ishte mësuar tani me këto mrekulli, nuk mahnitej më.

– A e ndien veten në gjendje që të shëtitesh pak? – më pyeti.

– Si jo, – iu përgjigja, – madje, ka për të më kënaqur shumë.

– Atëherë, mbahu pas krahut tim, Aksel, dhe eja të ndjekim dredhat e bregut.

Pranova menjëherë dhe filluam t'i vinim rrotull këtij oqeani të panjohur. Nga e majta, shkëmbinj të thepisur, njëri mbi tjetrin, sajonin një grumbullim titanik me një efekt të mrekullueshëm. Faqeve të tyre lëshoheshin ujëvara të panumërta që derdheshin në shtresa të kulluara dhe **shungulluese**.

Në atë çast, vëmendja ime u tërhoq nga një pamje e papritur. Nja pesëqind hapa më tutje, në kthesën e një kepi të lartë, na doli përpara syve një pyll i dendur. Kishte drurë me një madhësi mesatare, të prerë në formën e ombrellave të rregullta, me konture që s'ndikonin fare mbi gjethet e tyre dhe, në mes të valëve të erës, ata qëndronin të palëvizur, si një tufë kodrash të ngurosur.

Shpejtova hapin. S'dija si t'i quaja këta drurë të çuditshëm. Mos bënin pjesë, vallë, në ato dyqind mijë lloje bimore të njohura gjer atëherë? Mos u duhej dhënë një vend i posaçëm në florën e bimësisë liqenore? Jo. Kur arritëm nën hijen e tyre, habia ime u shndërrua në admirim. Dhe vërtet, ndodhesha përpara produktesh të tokës, po të prera në përmasa vigane. Im ungj ua vuri menjëherë emrin.

– Nuk qenka veçse një pyll kërpudhash, – tha.

Dhe nuk gabohej. Merreni me mend se çfarë zhvillimi kishin marrë ato bimë, që u pëlqejnë vendet e ngrohta e me lagështi. Unë e dija që “likoperdon xhiganteum-i” arrin, sipas Buliardit, në tetë gjer në nëntë këmbë perimetër, po këtu ishte fjala për kërpudha të bardha, tridhjetë gjer dyzet këmbë të larta, me një skufë, diametri i së cilës arrinte po kaq.

Më larg ngriheshin tufa-tufa një numër i madh drurësh të tjerë

Fjalor

gërmimë – këtu, vend i gërmuar.

kuturis – vendos të bëj diçka, pa qenë shumë i sigurt nëse do ta çoj deri në fund.

shungulluese – që gjëmon, që oshtin thellë, që bën të dridhen a të tunden sendet përreth.

ranishtë – brez a rrip toke anës detit, liqenit ose lumit, i mbuluar me rërë.



me gjethe të zbërdhulura. Mund t'i njihje lehtësisht; ishin kaçubate e vogla të tokës, me përmasa fenomenale, likopode të larta, njëqind këmbë, sigjilare vigane, fiere si pemë, të mëdha sa predhat e vendeve të larta, lepidodendronë me kërcej cilindrikë të bigëzuar, që kishin në majë fletë të gjata cilindrike të bigëzuara, të cilat kishin në majë fletë të gjata e të kreshpëruara me qime të ashpra mu si bimë mishtake të përbindshme.

– E habitshme, madhështore, e shkëlqyer! – thirri im ungj. – Ja, këto bimë të përvuajtura të kopshteve tona, që bëheshin drurë në shekujt e parë të rruzullit! Shiko, Aksel, sodit! Asnjë botanist s'është gjendur kurrë në një festë të tillë.

– Keni të drejtë, im ungj. Në këtë serrë të pamasë janë ruajtur, ashtu siç kanë qenë, këto bimë të kohës më të vjetër, që mendjehollësia e dijetarëve i ka rindërtuar me aq sukses.

– Mirë thua, djali im, kjo është një serrë, po do të thoshe edhe më mirë sikur të shtojë se është, ndoshta, një kopsht zoologjik.

– Një kopsht zoologjik!?

– Po, pa dyshim. Shih këtë pluhur që po shkelim me këmbë, këto kocka të përhapura mbi këtë truall.

– Kocka! – thirra. – Po, kocka kafshësh të epokës parahistorike!

Isha sulur mbi këto mbeturina shekullore të bëra prej një substance minerale të pashkatërrueshme. U vija pa ngurruar nga një emër këtyre kockave vigane, që shëmbëllenin me trungje drurësh të tharë.

– Ja nofulla e poshtme e mastodontit, – thashë. – Ja dhëmballët e dinoteriumit; ja femuri, që nuk mund t'i ketë përkitur veçse më të madhit të atyre kafshëve, megateriumit. Po, është vërtet një kopsht zoologjik, sepse sigurisht, këto kocka nuk janë transportuar gjer këtu nga një kataklizëm.

– ... Por, në qoftë se kafshë të epokës parahistorike kanë jetuar në këto treva të nëndheshme, kush mund të thotë se ndonjë nga këta përbindësia nuk endet edhe sot në mes të këtyre pyjeve të errëta ose prapa këtyre shkëmbinjve të thepisur?

Me të më shkrepur në kokë ky mendim, zura të vëzhgoja, jo pa frikë, pikat e ndryshme të horizontit: po asnjë qenie e gjallë nuk dukej në këto brigje të shkreta.

Isha pakëz i lodhur. Shkova e u ula në skajin e një kepi, në këmbët e të cilit vinin e thyheshin dallgët me gjëmim. Që atje, vështrimi im përfshinte tërë atë gji të sajuar nga forma gjysmërreth e bregut. Atje në fund ishte një liman i vogël, i rregulluar midis shkëmbinjve piramidalë. Ujërat e tij të qeta flinin të mbrojtura nga era. Më bëhej sikur do të shihja ndonjë anije duke dalë me pëlhura të hapura, për të nisur lundrimin nën erën e jugës.

Po ky vegim u zhduk me të shpejtë. Ne ishim të vetmet krijesa të gjalla të kësaj bote të nëndheshme.

Si kaluam një orë me soditjen e kësaj pamjeje të mrekullueshme, morëm udhën e [ranishtës](#) për t'u kthyer në shpellë dhe, i pushtuar nga mendimet më të çuditshme, rashë në një gjumë të thellë.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve.
 - a) A mund ta përcaktoni formën e "gërmimës së pamasë"? Po gjatësinë, gjerësinë dhe lartësinë e saj?
 - b) Cili ishte shpjegimi më i mundshëm për krijimin e kësaj *gërmime* në nëntokë?
 - c) Cilat janë shpellat e njohura që përmenden në këtë tekst?
 - ç) Si ndikoi mjedisi ku u gjend Akseli në përmirësimin ose përkeqësimin e shëndetit të tij?
 - d) Ç'vegim iu shfaq Akselit, teksa qëndronte ulur në breg dhe sodiste limanin që kishin krijuar valët?
 - dh) Çfarë pyetjesh i lindën Akselit, ndërsa gjendej në këtë hapësirë gjigande nën tokë?

Analizojmë tekstin

- 2 Përshkruani si e përjeton Akseli atë që sheh, habinë, mahnitjen e tij.
- 3 Përshkruani pyllin e çuditshëm që u doli para syve Akselit dhe ungjit të tij. Nga se përbëhej ky pyll?
- 4 Ungji i thotë Akselit: "Asnjë botanist s'është gjendur kurrë në një festë të tillë". Shpjegoni përse prania e tyre në atë vend konsiderohet si një festë për botanistin.
- 5 Çfarë e shtyn Akselin ta quajë "serrë" vendin ku ndodhet?

Gjuha e tekstit

- 6 Dy shpellat me përmasa tejet të mëdha, Akseli i emërton me fjalën "zgavra". Në këtë rast, ai përdor një metaforë. Çfarë synon të shprehë përmes kësaj figure letrare?
- 7 Gjeneri në tekst emra kafshësh, për të cilat e dini që kanë jetuar shumë shekuj më parë dhe sot nuk jetojmë më.
- 8 Gjeneri në tekst emra bimësh që nuk i keni dëgjuar më parë.

Interpretojmë tekstin

- 9 Interpretoni fjalinë: "*Për ndijimet e reja duheshin fjalë të reja, dhe imagjinata imenuk i gjente dot.*"
- 10 Gjeneri në tekst elemente fantastike, vende reale dhe misterioze, ngjarje reale ose të fantazuara, personazhe reale ose të fantazuara dhe renditini ato në fletore.

Reflektojmë rreth tekstit

- 11 A ju ngjall interes fragmenti i mësipërm, për të mësuar më tepër për pjesën e nëndheshme të tokës? A do të donit të ishit edhe ju pjesë e ndonjë udhëtimi drejt saj?
- 12 A mendoni se bota nëntokësore është zbuluar plotësisht, apo nën sipërfaqen e Tokës, thellë në qendër të saj, mund të ketë befasi për njerëzimin?

Detyrë:

- ▣ Përshkruani një udhëtim drejt vendit ku ëndërroni të shkoni, si dhe personat me të cilët do të donit ta ndërmerrenit këtë udhëtim.

Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit

Para leximit

Fiderbët dhe Verrotët janë në luftë me njëri-tjetrin. Geri Hopi është verrot, nga qyteti i Besias. Ai ka humbur të atin në luftë dhe jeton me të ëmën dhe motrën. Nëna e tij ka qenë shëronjësja e këtij qyteti, por tani ajo rrezikon të vdesë për shkak të mungesës së barnave mjekësore. Ajo ka qenë nxënëse e shamanit plak, Bando Gropius, që jeton në ishullin e magjepsur të Hunias, i cili është molla e sherrit mes dy popujve. Geri ndërmerr i vetëm një udhëtim të gjatë e të rrezikshëm drejt këtij ishulli, me librin dhe pasqyrën që janë çelësi për të zbërthyer kodet e bimëve magjike në ishull, të cilat ia ka dhënë e ëma. Gjatë këtij udhëtimi, ai do të takojë Alinën, një vajzë nga fisi i Fiderbëve, e cila ka humbur prindërit në luftë. Dy fëmijët, të destinuar për t'u njohur për shkak të urrejtjes, shpejt do të gjenden si shokë udhëtimi dhe, në fund, do të bëhen miq për kokë.

Përkthyer nga Agim Dokani

Fjalor

Hunia – ishulli ku rriteshin bimë, nga të cilat krijoheshin barna shëronjësje dhe barishte alkimike për verrotët dhe fiderbët gjatë kohës që mbizotëronte paqja mes tyre.

Gremçet – shqiponjat gjigande të Hunias me pendë të praruar.

Duarmëdhenjtë – gorilla me sy të praruar, që ndihmonin Bando Gropiun të ngarkonte barishtet shëronjësje në anije.

Njerëzit shqyen sytë dhe ulëritën nga frika e hareja bashkë. Kur kthetrat e një mijë shqiponjave u mbështetën në truall, habia e qytetarëve u bë edhe më e madhe.

Kurrë ndonjëherë s'kishte ndodhur diçka e tillë. Askush deri atëherë s'i kishte parë ata zogj aq gjigantë, që mblodhën flatrat. Në atë pikë, para vështrimeve të shastisura u shfaqën dy gorillat me Bando Gropiun në krye, që ecte i ndihmuar nga bastuni i tij.

Luftëtarët çanë mes turmës, të gatshëm me heshta dhe armë për të sfiduar mysafirët e paftuar, të zbritur nga qielli por, me të parë plakun e urtë Bando Gropiun, hoqën përkrenaret në shenjë respekti. Pas tyre u shfaqën fëmijët dhe habia më e madhe ishte se po ecnin dorë për dorë.

– Ai është Geri Hopi! Djali që ia mbathi nga shtëpia! – bërtiti një grua duke e treguar me gisht.

– Po, është djali i Shëronjësës, – shtoi një fëmijë tjetër duke u shtrënguar në pelerinën vrima-vrима.

Nja dy luftëtarë vunë re se vajza përbri tij kishte në krah tatuazhin e armiqve: – Ajo është një fiderbe! Si ka fytyrë e vjen këtu?

Bandoja ngriti shkopin në shenjë qortimi: – Heshtni! Nuk jemi këtu për t'ju sfiduar. Kemi sjellë barna shëruese dhe barishte alkimike. Alina meriton të nderohet dhe jo të sulmohet. I ungji, me aq sa dimë, është i burgosur, i paditur për tradhti të lartë, por ajo është bartëse e paqes.

Luftëtarët pohan se Korneliusi ishte i arrestuar në fushimin e Urës Akor dhe shumë shpejt do të dërgohej në burgun e Besias. Alina mori frymë e lehtësuar: burgu ishte vendi i duhur ku të ngryste ditët.

Të gjithë u sulën sakaq mbi arkat dhe shportat. Të gjithë kishin nevojë për bimët magjike të Hunias që të mjekonin bijtë, nënat dhe pleqtë.

Geri përfitoi nga kaosi për të rendur në shtëpi, i ndjekur nga Alina, që dridhej prej të ftohtit. Megjithatë, zemra e vajzës gufonte nga lumturia për atë fund të suksesshëm të atij udhëtimi aq të rrezikshëm.



Roberta Rizzo

Në vitin 2002, gazetaria e kronikës së zezë, Roberta Rizzo, me pseudonimin Moony Witcher, botoi aventurën e parë të Ninës, "Vogëlushja e Hënës së Gjashtë", një vogëlushe që falë aftësive të saj alkimike, lufton kundër së keqes. Libri korri një sukses të bujshëm, ndaj u pasua edhe me gjashtë aventura të tjera, të cilat u përpunë nga fëmijët e gjithë botës. Më pas, Moony Witcher shkroi dhe serinë e Geno-s e tashmë rikthehet mes lexuesve me një histori njëherazi fantastike dhe tejet aktuale.

Kur djali hapi derën, gjeti motrën të ulur në kuzhinë bashkë me Rozaletin.

Geri u gjend përballë tyre, gjithçka iu duk ndryshe: tani ëndrra për të gjetur sërish prehjen e shëndetin mund të bëhej realitet.

– Geri! – thirri vogëlushja, duke rendur drejt tij e duke iu hedhur në krahë.

– Mami, mami... Geri u kthye! U kthye! – thirri me të madhe Eli duke rendur në dhomën e gjumit.

Odelia u shkund nga topitja, por kokën s'e ngrinte dot nga dobësia. Geri Hopi e puthi në ballë, i ledhatoi flokët e gjatë dhe e shtrëngoi me tërë dashurinë që ndiente.

– Ia dola, mama. U binde tani? Të solla barnat. Tani mund të shërohesh, – tha mes ngashërimit që ia ngecte fjalët në grykë.

Odelia fshiu lotët dhe zemra i rrahu aq fort, sa arriti të shqiptonte vetëm pak fjalë: – Të dua shumë. Je heroi im. Je si yt atë.

Një trokitje në dysheme e ndërpreu atë përqaftim. Në prag të derës u shfaq shamani, me shkopin e tij legjendar në dorë. Odelia u drodh e tëra dhe gazi që e përfshiu, ishte më i fortë se ethet që e dërrmonin:

– Bando! Bando Gropiùs!

– Odelia e adhuroar, yt bir bëri një magji të vërtetë. Një magji që kurrë s'do të mund ta bëja fillikat. Një mijë **Grremçe** sollën ngarkesa barërash dhe lulesh alkimike. Ka kaluar shumë kohë dhe lufta ka shkatërruar shpirtra e shpresa, por tani gjithçka do të ndryshojë. Sëmundjet do të mposhten falë kurajës së Gerit dhe Alinës.

Gruaja e re pa të vinte drejt saj një vajzë e mardhur, flokëshprishur dhe e ndrojtur në vështrim, gjë e pazakontë për të. Geri e mori për dorë dhe e çoi te koka e shtratit:

– Të njoh me Alina Obradetin, që ka forcën e një **Duarmadhi**. Është fiderbe dhe jam krenar që e kam në krahun tim.

Odelia çoi dorën te goja, për të ndaluar atë që do të thoshte. Frika që kishte një armike në shtëpi e drithëroi më fort se sëmundja.

Gropiùsi e vuri re dhe, me një dashuri të pafund, e qetësoi menjëherë:

– Ngrihu, do të të ndihmoj të ecësh. Duhet të vish me ne.

Geri dhe Alina me vështirësi e tërhoqën deri te dera. Aty e priste një Duarmadh që, me ta njohur, e mori në krahë butësisht, si të ishte një thesar i vyer.



Rrugët gëlonin nga njerëzit që vraponin me enë qelqi e voza, lule dhe vandakë bari nëpër duar. Sytë e atyre që, më në fund, mund të shpëtonin jetët e të dashurve të zemrës, shndritnin nga lumturia.

Kur gorilla iu afrua një mijë Grremçeve, befas pllakosi heshtja. Qytetarët e Karanit dhe luftëtarët ndenjën e vështruan, pa pipëtirë. Odelia përshëndeti dhe fill më pas Bandoja bëri përpara bashkë me Gerin dhe Alinën.

Për një çast, zhurma e marshimit të një grupi luftëtarësh fiderbë, i ndjekur nga një mori qytetarësh të Besias, ushtoi si një ogur i mbrapshtë. Po mbërrinin me hap të shpejtë dhe verrotët ishin të gatshëm të reagonin, në rast të një sulmi të beftë.

Por as përleshje, as dhunë nuk pati. Fiderbët kishin nxituar të merrnin barnat e sjella nga Hunia. S'kishin asnjë qëllim kanosës, por dëshirë për të mjekuar e shëruar të dashurit e tyre, dëshirë që tashmë i përbashkonte armiqtë me banorët e Karanit.

Vetëm atëherë, Bando Gropiùsi vendosi t'i drejtohej turmës:

– Dëgjoni! Kërkoj një minutë vëmendje nga ju. Po u drejtohem verrotëve dhe fiderbëve. Një tokë. Një tokë të vetme keni! Një vend të përbashkuar dhe jo të ndarë nga Ura Akor. Ishulli i Hunias është një thesar i lindur mbi det dhe u përket të gjithëve. Natyra nuk bën dallime mes popujsh. Ajo dhuron fryte dhe lule, bimë dhe gjethe, kafshë magjike dhe krijesa të ndjeshme që e duan jetën.

Verrotë dhe fiderbë, mbani tatuazhe të ndryshme në krahët tuaj, por keni nevoja të njëjta. Ju, popuj të çartur, keni të njëjtin fat, sepse vetëm urtësia dhe bujaria mund ta garantojnë paqen. Betohuni këtu, përpara meje, që do t'i shkatërroni armët. Që topat nuk do të vjellin më zjarr, se nuk do të vërvitni më shigjeta dhe asnjë shpatë s'do të përlyhet me gjak të pafajshëm. Betohuni këtu, para këtyre dy fëmijëve, se bota ku jetojmë do të qeveriset vetëm nga drejtësia e mirë. Betohuni këtu, para Geri Hopit, që ka treguar shumë më mençuri se të gjithë ju luftëtarët. Bashkë me Alina Obradetin, ai e mposhti frikën, duke u përballuar me vështirësi e rreziqe vdekjeprurëse.

Këta dy fëmijë sfiduan terrorin që ju të rriturit e mbollët me një luftë të pakuptimtë. Përruluni para tyre! Bëjeni në emër të jetës, që është e shenjtë për tërë popujt!

Një e nga një, tërë ajo turmë e derdhur në atë vend ra në gjunjë. Gra, luftëtarë, fëmijë, të moshuar, verrotë dhe fiderbë, u bashkuan në një hapësirë të vetme shprese dhe heshtjeje, derisa në qiell u ngritën brohoritjet dhe asnjë top nuk shtiu më rruzuj të përflakur. Tani të dy popujt ishin sërish të lirë të jetonin në paqe, pa ankthe e makthe.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Kë takoi Geri kur shkoi në shtëpinë e tij? Si ishte gjendja shëndetësore e së ëmës?
 - c) Kush u shfaq papritmas, pas Gerit, në derën e shtëpisë?
 - ç) Si e prezantoi ai Alinën para së ëmës? A i tregoi që ajo ishte fiderbe?
 - d) Përse ndaloi hareja e turmës? Cilët u shfaqën aty papritur?
 - dh) Kush ishte ungji i Alinës? Çfarë fati kishte pasur ai?
 - e) A pati ndonjë përplasje mes fiderbëve dhe verrotëve në këtë pjesë?
 - ë) Kush i mori barnat shëruese që sollën Geri, Alina dhe Bando Gropiùsi?
 - f) Kujt iu drejtua Bando Gropiùsi me fjalimin e tij? Çfarë u kërkoi ai atyre?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

- 2 Kur nëna e Gerit kupton çfarë ka bërë i biri, ajo i thotë: *"Je heroi im. Je si yt atë"*. Analizoni çfarë do të thotë ajo me këto fjalë.
- 3 Përshkruani çfarë ndodhi me turmën kur mbërritën një mijë shqiponjat dhe morën vesh se ato kishin sjellë bimë shëruese.
- 4 Fiderbët dhe verrotët ngjajnë në shumë aspekte. Përmendni disa prej tyre.
- 5 Çfarë i dallon fiderbët nga verrotët?

Gjuha e tekstit

- 7 Shpjegoni kuptimin e këtyre shprehjeve të figurshme:
 - topat nuk do të vjellin më zjarr
 - i mbeti fryma pezull
 - ushtoi si një ogur i mbrapshtë
 - asnjë top nuk shtiu më rruzuj të përflakur
 - sfiduan terrorin që ju të rriturit e mbollët
 - tërë ajo turmë e derdhur në atë vend
 - vendi i duhur ku të ngryste ditët
- 8 Pjesë e mësipërme është shkëputur nga një roman me aventura, ku dallohen qartë elementet fantastike. Gjeni në tekst disa prej këtyre elementeve.

Interpretojmë tekstin

- 9 Duke u nisur nga fjalët e Bando Gropiùsit: *"Lufta ka shkatërruar shpirtra e shpresa..."*, përshkruani të këqijat që kishte sjellë lufta për dy fëmijët në veçanti dhe për dy popujt në përgjithësi.
- 10 Miqësia e Gerit nga pala e verrotëve me Alinën nga fiderbët, i ndihmon njerëzit të ndryshojnë këndvështrimin e tyre për atë çka po ndodh. Në ç'mënyrë realizohet ky ndryshim?
- 11 Me fjalët e mëposhtme, marrë nga teksti, krijoni fjali që shprehin mesazhe kuptimplote.
 - Urrejtje _____
 - Të përbashkuar _____
 - Paqe _____
 - Ishull _____
 - Barna shëruese _____

Reflektojmë rreth tekstit

- 12 Geri dhe Alina janë fëmijë të dy popujve armiq. Nevoja për t'i mbijetuar udhëtimit të tmerrshëm i bëri bashkë për t'ia dalë me sukses. Diskutoni çfarë i dhanë ata njëri-tjetrit.
- 13 Si mendoni, cilat janë shkaqet që nisin luftërat? A fiton njerëzimi prej tyre?

Detyrë:

- Shkruani një ese me temë: *"Natyra ka mrekulli, burime dhe energji për të gjithë, mjafton ta respektojmë atë"*.

Shndërrimi i doktor Xhekillit

Para leximit

Njeriu është një qenie shumë kureshtarë. Ai kërkon të njohë botën që e rrethon, por në radhë të parë dëshiron të njohë vetveten. Në këtë pjesë që është shkëputur nga romani "Çështja e çuditshme e dr. Xhekillit dhe e z. Haid", rrëfhet për një eksperiment që dr. Xhekilli realizon në trupin e tij. Ai merr një substancë, të cilën e kishte krijuar vetë. Kur e pi, ai pëson një shndërrim të çuditshëm, kthehet në një njeri krejt të ndryshëm, në z. Haid.

Përkthyer nga Dashnor Kokonozi



Robert Luis Stivenzon

Robert Louis Stevenson (1850-1894) ka qenë poet, prozator dhe dramaturg skocez. Fama e tij lidhet me një sërë romanesh shumë të suksesshme, si: "Ishulli i thesarit" që u botua në vitin 1883, "Djaloshi i grabitur" (1886) dhe "Çështja e çuditshme e dr. Xhekillit dhe e z. Haid" (1896). Stevensoni ka aftësinë ta udhëheqë lexuesin drejt një jete të mbushur me aventura të pazakonta. Rrëfimi është i sinqertë dhe krijon befasi, shoqëruar me një humor të lehtë si tek "Ishulli i thesarit", ose mister, frikë e ankth si te "Çështja e çuditshme e dr. Xhekillit dhe e z. Haid".

Isha në këtë pikë të reflektimeve të mia, kur, siç ju thashë, një dritë e re nisi të shndrinte mbi subjektin në tryezën e laboratorit. Nisa të perceptoja më thellë nga sa ishte thënë ndonjëherë, jo ekzistencën që dridhej, përkohshmërinë si mjegull, të këtij trupi në dukje **solid**, me veshjen e të cilit ne lëviznim. Zbulova se disa agjentë e kishin fuqinë ta shkundnin dhe ta zhvishnin atë veshje ceremoniale të mishit, ashtu si një shkulum ere mund të tundë perdet e një salloni. Për dy arsye të forta nuk do të hyj në këtë aspekt shkencor të rrëfimit tim. Mbi të gjitha, sepse më është dashur të mësoj që fati dhe përgjegjësia e jetës sonë janë të vendosura përgjithmonë mbi shpatullat e njeriut dhe, kur bëhet përpjekje për ta hedhur poshtë, ai fat na kthehet me më shumë trysni të pazakontë e të tmerrshme. Së dyti, sepse, ashtu, siç do ta tregojë – mjerisht – shumë qartë rrëfimi im, zbulimet e mia ishin jo të plota. Mjafton vetëm të them se unë jo vetëm që njoha trupin tim natyror si një **aureolë** e thjeshtë e rrezatim i disa prej fuqive që përbënin shpirtin tim, por arrita të prodhoja një **bar**, efekti i të cilit ishte që këto fuqi të shfronësoheshin nga epërsia e tyre dhe të zëvendësoheshin nga një formë dhe përmbajtje e dytë, jo më pak të natyrshme për mua, sepse ishin shprehja që mbanin vulën e elementeve më të ulëta në shpirtin tim.

Ngurrova shumë, para se ta testoja në praktikë këtë teori. E dija shumë mirë që rrezikoja vdekjen, sepse çdo drogë që mund të kontrollonte aq fuqishëm dhe të shkundte vetë fortesën e njëjtësisë, me kalimin më të vogël të dozës ose me më të paktën papërshtatshmëri në çastin kur e kisha marrë, mund të fshinte nga faqja e dheut trupin jolëndor që kisha ndër mend të ndryshoja. Por tundimi për një zbulim aq të veçantë e të thellë më në fund i mposhti këshillat e maturisë. Lëngu ishte gati që prej kohësh, bleva shpejt nga një firmë farmaceutike me shumicë, një sasi të madhe të një kripe speciale që, në bazë të eksperimenteve të mia, e dija që ishte përbërësi i fundit që kërkohej dhe, në një natë të mallkuar, unë i përziejva elementet, i pashë teksa zienin së bashku e nxirrnin avuj në gotë dhe, kur vlimi ishte shuar, me një kurajë të fortë, e piva përzierjen.

Pasuan dhembje nga më torturueset: një kërcitje e kockave, një përzierje vdekjeprurëse dhe një tmerr i shpirtit që nuk mund të tejkalohet as në orën e lindjes dhe as në të vdekjes. Më pas, këto agoni nisën me shpejtësi të largoheshin dhe unë erdha në vete si të kisha dalë nga një sëmundje e rëndë. Kishte diçka të çuditshme në ndjenjat e mia, diçka papërshkrueshmërisht të re dhe, pikërisht për këtë risi të saj, pabesueshmërisht të ëmbël. Ndihesha më i ri, më i lehtë në trup, më i lumtur, së brendshmi isha i ndërgjegjshëm për një pakujdesi marramendëse, një fluks imazhesh të ngatërruara sensuale rridhnin si vija e ujit e një mulliri në imagjinatën time. Ndërsa binin vargonjtë e detyrimeve, përjetoja një liri të panjohur, por jo të pafajshme të shpirtit. E vlerësova veten, me frymëmarrjen e parë të kësaj jete të re, se isha më i keq, dhjetë herë më i keq, i shitur si skllav në të keqen time fillestare, dhe një mendim i tillë, në atë çast, më gjallëroi dhe më kënaqi si vera. Shtriva krahët i ngazëllyer nga freskia e këtyre ndjenjave dhe, kur vura re, papritur trupi im ishte zvogëluar.

Në atë kohë, në studion time nuk kishte pasqyrë. Ajo që është pranë meje tani që po shkruaj, u soll më vonë, pikërisht për shkak të këtyre shndërrimeve. Nata, gjithsesi ishte shtyrë përpara drejt mëngjesit; mëngjesi edhe pse i errët, ishte gati i përgatitur plotësisht për pranimin e ditës. Banorët e shtëpisë ishin zhytur në orët e gjumit më të rëndë dhe unë, nga **ekzaltimi** i shpresës dhe i triumfit, vendosa të shkoja me formën time të re deri në dhomën time të gjumit. Kalova oborrin nën kundrimin – siç mendova – e habitur të yjeve, si krijesa e parë e atij lloji që vigjilenca e tyre e pagjumë kishte zbuluar ndonjëherë; u përvodha përmes korridoreve të shtëpisë sime si një i huaj dhe, kur hyra në dhomën time, pashë për herë të parë pamjen e Eduard Haidit.

Fjalor

solid – i qëndrueshëm.

aureolë – shkëlqimi i madhështisë, i lavdisë ose i nderimit që rrethon dikë a diçka.

bar – lëndë e përgatitur për parandalimin ose për mjekimin e sëmundjeve a të plagëve, ilaç. Këtu: substancë e shpikur.

ekzaltim – lartësim, madhëstim.



Në këtë pikë më duhet të flas vetëm nga ana teorike, duke thënë jo vetëm atë që di, por edhe atë që mendoj se është më e mundshme. Ana e keqe e natyrës sime, mbi të cilën tani kisha mbartur fuqinë formuese, ishte më pak e fuqishme dhe më pak e zhvilluar se e mira që sapo e kisha shfronësuar. Në të vërtetë, gjatë rrjedhës sime të jetës, që për nëntë të dhjetat e saj ishte një jetë gjithë mobilizim, virtyte dhe disiplinë, të ushtruarit e pjesës së keqe ishte shfrytëzuar shumë pak. Dhe nga kjo, siç mendova, ndodhi që edhe Eduard Haidi ishte shumë më i vogël, më i dobët dhe më i ri se Henri Xhekilli. Siç shkëlqente e mira mbi fizionominë e njerit, ashtu dhe e keqja ishte shkruar gjerësisht dhe qartë në fytyrën e tjetrit. Përveç kësaj, e keqja (për të cilën ende duhet të besoj se është ana vdekjeprurëse e njeriut) kishte lënë mbi atë trup një gjurmë shformimi dhe kalbësire. Megjithatë, kur pashë atë idhull të shëmtuar në pasqyrë, nuk ndjeva fare neveri, përkundrazi lëshova një thirrme mirëseardhjeje. Edhe ai, gjithashtu isha po unë. Dukej i natyrshëm dhe njerëzor. I vështruar mirë, një imazh më i gjallë i shpirtit, më shprehës dhe më i veçantë, sesa pamja e papërsosur dhe pa lidhje që deri më tani isha mësuar ta quaja veten time. Dhe deri këtu kisha pa dyshim të drejtë. Kam vërejtur se, kur kisha pamjen e Eduard Haidit, askush nuk mund të më afrohej si fillim, pa një parandjenjë të dukshme të keqe. Kjo ndodhte, sipas meje, sepse të gjitha qeniet njerëzore që ndeshim ne, janë një përzierje e së mirës me të keqen. Eduard Haidi, i vetmi në të gjithë njerëzimin, ishte e keqja e pastër.

Ndenja vetëm një çast para pasqyrës; eksperimenti i dytë dhe përfundimtar ishte ende për t'u bërë. Mbetej ende për t'u parë nëse e kisha humbur pa kthim njëjtësinë time dhe nëse duhej t'ia mbathja përpara se të bëhej ditë nga një shtëpi që nuk ishte më e imja. Kështu, nxitova drejt kabinetit, përgatita sërish përzierjen dhe e piva, vuajta sërish ngërçet e shpërbërjes dhe u ktheva përsëri në veten time, me karakterin, trupin dhe fytyrën e Henri Xhekillit.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Cili është vendi ku zhvillohen ngjarjet dhe pse është zgjedhur pikërisht ky vend?
 - b) A ishte e rrezikshme ajo që bëri dr. Xhekilli?
 - c) Cilat janë personazhet e kësaj pjese? Kush është Eduard Haidi? Ç'lidhje ka z. Haid me dr. Xhekillin?
 - ç) Pse i duhet dr. Xhekillit pasqyra në laborator?
 - d) Si ka qenë jeta e dr. Xhekillit gjer në momentin e eksperimentit?
 - e virtytshme;
 - e mbushur me vese.
 - d) Çfarë synonte eksperimenti i dytë i bërë nga dr. Xhekilli?

Analizojmë tekstin

- 2 Në eksperimentin që përshkruhet ndodh një shndërrim që çon:
 - në ndryshime të pamjes së jashtme;
 - në ndryshime të karakterit;
 - në ndryshime të pamjes së jashtme dhe të botës së brendshme.

Studim teksti

- 3 Shndërrimi që ndodh është rruga drejt:
- së mirës; së keqes.
- ▣ A ka kthim pas shndërrimit, në drejtim të anasjellë?
- 4 Në këtë pjesë, rrëfimtari:
- është vetë pjesëmarrës në ngjarje;
- rrëfen për një ngjarje që ia ka rrëfyer dikush tjetër;
- e vëzhgon nga larg ngjarjen.
- ▣ Çfarë vlere i shton tekstit kjo mënyrë të rrëfyeri?
- 5 Gjeni ndryshimet mes doktor Xhekillit dhe zotit Haid.

Interpretojmë tekstin

- 6 Plotësoni karakteristikat e mëposhtme të teksteve me mister me shembuj nga fragmenti i mësipërm.
- a. Ngjarje të veçanta, situata mbytëse dhe të frikshme: _____
- _____
- b. Vende të frikshme, të mbyllura, të izoluara: _____
- _____
- c. Personazhe që në pamje të parë duken normale, por: _____
- _____
- 7 Interpreti frazën: *Ndërsa binin vargonjtë e detyrimeve, përjetoja një liri të panjohur, por jo të pafajshme të shpirtit.* Për çfarë lloj vargonjsh flitet në këtë frazë?

Gjuha e tekstit

- 8 Në paragrafin e parë, fjalitë fillojnë me folje. Çfarë efekti krijon ky përdorim në rrëfim?
- 9 Gjuha e përdorur në këtë paragraf karakterizohet nga shpeshtia:
- e termave që i përkasin shkencës;
- e ironisë;
- e figuracionit letrar.
- ▣ Si e shpjgoni këtë shpeshti?
- 10 Në këtë fragment, vendin më të madh e zë:
- rrëfimi; përshkrimi; dialogu.

Reflektojmë rreth tekstit

- 11 Reflektoni rreth frazës: *"Kjo ndodhte, sipas meje, sepse të gjitha qeniet njerëzore që ndeshim ne, janë një përzierje e së mirës dhe së keqes."*

Detyrë

- ▣ Përshkruani një situatë imagjinare, në të cilën ju mund të silleni dhe veproni sikur të mos kishit asnjë kufizim apo detyrim.

Maska e Murtajës së Kuqe

Para leximit

"Maska e Murtajës së Kuqe" rrëfen për një princ, që është shumë i pasur dhe jeton mes gjithë të mirave në pallatin e tij, i rrethuar nga oborrtarët që bëjnë gjithçka për ta lumturuar. Në vendin e tij, plas Murtaja e Kuqe, një sëmundje që shkakton vdekjen e gjysmës së popullsisë. Princi, bashkë me oborrtarët dhe miqtë e tij, mbyllet në një manastir të izoluar. Aty organizoheshin festa pa fund. Gëzimi ndalonte vetëm kur binte ora e vendosur në mur. Një natë, kur po zhvillohej një festë me maska, në mes të pjesëmarrësve shfaqet, në formën e një krijese të mistershme, një qenie e paftuar dhe e frikshme.

Përkthyer nga Lluka Qafoku

Fjalor

shkretton – sjell rrënim të plotë, shkatërron.

epidemi – sëmundje ngjitëse që përhapet shpejt te shumë njerëz.

fatale – që shkakton shumë dëm, vuajtje dhe vdekje.

damkë – shenjë, vullë.

të fortifikuara – me mure mbrojtëse, të forta.

shije ekscentrike – shije e veçantë, e dallueshme nga shija e të tjerëve.

kudhër – trung çeliku ku rihet hekuri i skuqur.

palaço – njeri që bën për të qeshur.

pehlivan – njeri që bën akrobacia.

halucinacion – gjendje në të cilën njeriu shikon gjëra, objekte që nuk janë reale.

delirant – që flet përçart, në gjendje entuziazmi të tepruar.

i ebantë – prej ebaniti (lëndë e fortë e krijuar nga bashkimi i gomës së vullkanizuar me squfur).

Murtaja e Kuqe kishte kohë që **shkretonte** vendin. Asnjëherë s'kishte rënë **epidemi** më **fatale**, më e neveritshme. Rruga e mundimeve dhe **damka** e saj ishte gjaku – kuqëlimi dhe llahtaria e gjakut. Të zinin dhembje therëse, marramendje të befta e më pas, shpërthim gjaku nga pore, me shpërbërje të trupit. Njollat e përskuqura mbi trup, e në veçanti në fytyrën e viktimës, ishin shenja e sëmundjes që ua zinte rrugën ndihmës dhe simpatisë së njerëzisë. Dhe nga shenja e parë, te përparimi dhe përfundimi i sëmundjes, s'kalonte më shumë se gjysmë ore.

Ama princ Prosperoja mbetet i lumtur, sfidues dhe i mençur. Kur zotërimeve të tij iu përgjysmua popullsia, ai thirri në pallat një mijë shokë të gjallë e gazmorë, ndër fisnikë e dama të oborrit, e me këta u mbyll, në vetmi të plotë, në një nga manastiret e tij **të fortifikuara**. Ky ish një ndërtime gjigant dhe madhështor, vepër e vetë **shijes ekscentrike**, por prapë lartësisht aristokratike, e princit.

Një mur i fortë e i lartë e qarkonte. E ky mur dyert i kishte të hekurta. Oborrtarët, sapo hynë, sollën **kudhra**, furra e çekanë dhe salduan drynat. Ata vendosën të bllokoniin hyrjen, madje edhe daljen...

Bota jashtë le të bënte ç'të donte. Ndërkohë, ishte budallallëk të dëshpëroheshe, ishte budallallëk të mendoje. Princi kishte menduar për çdo lloj qejfi. Kishte **palaço**, kishte **pehlivanë**, kishte balerina, kishte muzikantë, ishte Bukuria, ishte dhe alkooli. Të gjitha, bashkë me sigurinë, ishin brenda. Jashtë ishte Murtaja e Kuqe.

Andej nga fundi i muajit të pestë a të gjashtë që kur hynë, e në çastin kur epidemia jashtë bënte kërdrinë, princ Prosperoja na i dëfreu të një mijë miqtë e tij në një ballo me maska të një madhështie të paarritshme.

Në festë kishte **halucinacione delirante**, si ato të të çmendurve. Kishte shumë nga e bukura, nga e pangopura, nga e pazakonta, diçka nga e tmerrshmja dhe jo pak nga ajo që mund të shkaktojë neveri. Andej-këtej, nëpër shtatë dhomat parakalonte realisht një turmë ëndrrash. Dhe këto ëndrra gjarpëronin brenda dhe përreth, duke u nuancuar nga dhomat dhe duke bërë që muzika e çmendur e orkestrës të dëgjohej si jehonë e hapave të tyre. Dhe ja, tani sahati **i ebantë** bie, ai ndodhet në hollin e kadifenjtë. Dhe atëherë, për një çast, gjithçka hesht, gjithçka rresht, veç zërit të sahatit. Ëndrrat ngrijnë aty ku i zuri.

Dhe prandaj ndoshta ndodhi që, para se jehonat e fundit të kumbimit të fundit të mbyteshin në heshtje, shumë individë në turmë patën kohë të diktonin praninë e një figure të maskuar që s'kishte tërhequr vëmendjen e askujt më parë.

Figura që e gjatë dhe e hollë, e përçuar nga koka te këmbët me **qefin** e të vdekurit. Maska që fshihte fytyrën, ishte aq e ngjashme me një fytyrë kufome, sa që edhe vëzhgimi më i hollësishëm do ta kishte pasur të vështirë të zbulonte mashtrimin. E megjithatë, kjo mund të durohej, në mos edhe të miratohej... Por mumia kishte pamjen e të vdekurit nga Murtaja e Kuqe. Veshja e saj që e njollosur me gjak dhe balli i saj i gjerë, si dhe të gjitha tiparet e fytyrës, ishin pikëluar me tmerrin e përgjakur. Kur princ Prosperos i zunë sytë këtë pamje spektrale (e cila, me një lëvizje rëndë-rëndë e solemne, si të deshte ta luante më mirë rolin, andej mes vallëzuesve), ai kaloi në **konvulsion**, në një dridhje të përgjithshme tmerri a neverie; por prapë, një çast më vonë, fytyra iu skuq nga tërbimi. – Kush guxon, – pyeti ai i ngjirur, oborrtarët që i rrinin pranë, – kush guxon të na fyejë me këtë përqeshje **blasfeme**? Kapeni, demaskojeni, që ta dimë kë do të varim me lindjen e diellit, andej nga fortifikimet. Princ Prosperoja këto fjalë i tha në dhomën lindore, ose blu, ku edhe po rrinte ndërkohë. Ato kumbuan në të gjitha dhomat me zë të lartë e të qartë, ngaqë princi ishte burrë guximtar e i fortë fizikisht dhe ngaqë muzika kishte heshtur me shenjën e tij.

Në dhomën blu rrinte princi, me një grup oborrtarësh të zbehur pranë tij. Në fillim, ndërsa ai fliste, ndodhi një lëvizje e lehtë e këtij grupi në drejtim të ndërhyrësit, i cili gjithashtu ishte pranë, por që tani, me një hap të vendosur dhe **solemn** iu afrua folësit. Për shkak të njëfarë nderimi të paemër, që mjeshtëria e mumies kishte frymëzuar në të gjithë të ftuarit, askush nuk guxoi të ngrejë dorë dhe ta kapë; dhe kështu, e papenguar nga askush, mumia kaloi vetëm një metër pranë figurës së princit, ndërsa turma e madhe e njerëzve, me një **impuls** të vetëm, u tkurr nga qendra e dhomës anash mureve. Ajo hapi rrugën pandalshëm dhe, me të njëjtin hap solemn e të matur që e kishte dalluar që në fillim, kaloi mes dhomës blu për tek e purpurta – nga e purpurta te jeshilja – nga jeshilja te portokallia – nga kjo tek e bardha dhe madje

Fjalor

qefin – mbulesë e bardhë me të cilën mbështillen të vdekurit para se të varrosen.

konvulsion – gjendje krize me të dridhura, shkundje nga gojë.

blasfeme – që shan Zotin.

solemn – madhështor, i lartë.



Edgar Allan Poe

Edgar Allan Poe është shkrimtar amerikan, i njohur kryesisht për poemat (në vendin tonë, është shumë e njohur poema "Korbi", e shqipëruar nga Fan Noli) dhe tregimet që i përkasin prozës së misterit. Këto të fundit karakterizohen nga situata të frikshme e të rrezikshme dhe pëlqehen, ndër të tjera, për emocionet e forta që shkaktojnë. Poja konsiderohet si shkrimtari që krijoi prozën policore.



Fjalor

impuls – shtysë, hov, vrull.

burracakëri – të qenit burracak, njeri që s'ka guxim, që ka shumë frikë e së fsheh dot këtë.

te vjollca, para se të bëhej një lëvizje e vendosur për ta arrestuar. Atëherë ama, princ Prosperoja, duke u çmendur nga tërbimi dhe nga turpi për burracakërinë e tij kalimtare, u sul me ngut përmes shtatë dhomave, pavarësisht se askush nuk e ndoqi nga pas, për shkak të një frike vdekjeje që i kishte mbërthyer të gjithë. Princi kishte zhveshur e mbante lart një kamë dhe iu afrua me vrull një metër a një metër e gjysmë figurës që po tërhiqej, ndërsa kjo e fundit, pasi arriti fundin e apartamentit të kadifenjtë, u kthye befas dhe përballoi ndjekësin. U dëgjua një britmë e mprehtë dhe kama ra duke shkëlqyer mbi qilimin e zi, mbi të cilin një çast më vonë ra i vdekur princ Prosperoja. Atëherë, me guximin e të dëshpëruarit, një grumbull pjesëmarrësish u sul në apartamentin e zi dhe, pasi e mbërthyen mumien, figura e gjatë e së cilës qëndronte drejt e në këmbë, pa lëvizur përbrenda hijes së sahatit të ebantë, ranë në grahmat e një tmerri të patreguar, kur panë se qefini dhe maska e kufomës nuk përmbanin asgjë brenda. Tani e vunë re praninë e Murtajës së Kuqe. Ajo kishte hyrë si hajduti natën.

Tekstet e misterit

Këto tekste kanë disa karakteristika:

- ▣ Ngjarje të veçanta, si: shfaqje fantazmash, magji, vdekje të papritura, ndodhi të pashpjegueshme.
- ▣ Situata mbytëse dhe të frikshme: të krijuara nga nata, errësira, retë, zhurmat dhe tingujt e mistershëm.
- ▣ Vende të frikshme, të mbyllura, të izoluara, të pakalueshme, si: kështjella dhe manastire të izoluara, shtëpi të braktisura, varreza etj.
- ▣ Personazhe që në pamje të parë duken normale, por me kalimin e kohës nxjerrin diçka misterioze, fytyrën e tyre të vërtetë. Të tilla mund të jenë fantazmat, shtrigat, zombit, vampirët, demonët, shpirtrat djallëzorë etj.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Çfarë e bën princin Prospero dhe pasuesit e tij të futen në një manastir?
 - b) Cilat ishin simptomat e shfaqjes së Murtajës së Kuqe?
 - c) Sa miq mori princi në manastir? Si e kalonin kohën princi Prospero dhe oborrtarët e tjerë? Pse princi mendon se aty është i sigurt?
 - ç) Kur e organizoi princ Prosperoja ballon me maska që përshkruhet në tekst? Ç'pamje kishte figura e maskuar që u shfaq papritmas në mes të ballos me maska?
 - d) Çfarë efekti shkaktonte sahati i ebantë te mysafirët e princit?
 - dh) Në çfarë pjese të manastirit përballët princi me figurën e tmerrshme që ishte shfaqur në festë?

Analizojmë tekstin

- 2 Në fillimin e kësaj proze hasim disa elemente, të cilat janë karakteristike për llojin letrar të përrallës.
 - ▣ Gjejini në tekst këto elemente.
 - ▣ Cila është pritshmëria e lexuesit për pjesën tjetër të tekstit?
 - ▣ A përputhet ajo që nxit pjesa e parë e tekstit me atë që ofron teksti më tej?
- 3 Renditni ngjyrat e dhomave sipas radhës. Gjeni sa ngjyra janë gjithsej.

Studim teksti

Interpretojmë tekstin

- 4 Si i kuptoni fjalitë e mëposhtme?
Me këto masa, oborrtarët mendonin të sfidonin epideminë. Bota jashtë le të bënte ç'të donte. Ndërkohë ishte budallallëk të dëshpëroheshe, ishte budallallëk të mendoje. Princi kishte menduar për çdo lloj qejfi.
- 5 Princi Prospero vdes në fund si shumë të tjerë që ishin jashtë manastirit. Mesazhi që përcjell rrëfimtari me vdekjen e këtij njeriu të pasur dhe të fuqishëm është:
- Murtaja është një sëmundje shumë e rrezikshme dhe shpërndahet lehtë.
 - Me para, nuk mund të blesh gjithçka.
 - Muret e trasha të manastirit të ndajnë nga bota dhe të shkaktojnë vdekjen nga vetmia.
- 6 Si ishte gjendja emocionale e princit Prospero para se të futej në manastir dhe gjatë pesë a gjashtë muajve brenda tij? Përshkruani ndryshimin emocional, kur në festë shfaqet prania e qenies së maskuar.
- 7 Tregimet e Posë karakterizohen nga përshkrime të frikshme dhe të misterhme. Gjeni në tekst elementet që e bëjnë këtë prozë të klasifikohet si tregim misteri.



Gjuha e tekstit

- 8 Lidhni me shigjetë simbolin me shpjegimin e tij.
- | | |
|---|-------------------|
| <input type="checkbox"/> Ora | ngjyrat e ylberit |
| <input type="checkbox"/> Numri shtatë | vdekja |
| <input type="checkbox"/> Murtaja e Kuqe | koha që ikën |
| <input type="checkbox"/> Manastiri | mburoja |
| <input type="checkbox"/> Oborrtarët | servilizëm |
- 9 Gjeni në tekst shprehjen që tregon arrogancën e princit Prospero ndaj pjesës tjetër të popullsisë.

Reflektojmë rreth tekstit

- 10 Diskutoni rreth mesazhit të tekstit.
- 11 A ju pëlqejnë librat me mister? Çfarë efekti shkaktojnë ata te ju?

Detyrë

- Përshkruani krijesën e paftuar në manastir, duke ruajtur misterin me të cilin paraqitet në tekst.
- Shkruani një ese me temë: "Jeta vlen më shumë se gjithçka".

Vargje kushtuar mallit

Para leximit


Në letërsinë shqipe ka shumë vjersha, poezi, proza poetike, të cilat i janë kushtuar mallit si një dhimbje e thellë shpirtërore, në të gjitha format e shfaqjes së tij: malli për njerëzit e dashur, për vendlindjen, malli për atdheun. Në letërsinë shqipe, malli trajtohet më shumë si temë universale (malli për jetën, dashurinë, rininë) dhe po aq si ndjesi personale për dikë që është larg fëmijës, bashkëshortit/es, apo edhe për dikë që nuk jeton më.

I dashur atdhe

Me vite jam larguar,
i dashur atdhe,
por nuk të kam harruar,
se shumë i ëmbël je.

Kjo zemra më këndon
për ty, o Shqipëri,
por prapë më lëngon,
se je në varfëri.

Asdreni



Malli i atdheut

S'di ç'të mungon, s'di se ç'të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fytyrën; e, pikë së pari herë-herë, mbastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqve e shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm, ku qajtëm foshnja e ku lozëm djelm, kujtimi i atyre maleve larg të cilëve nuk rron dot mirë një shqiptar, kujtimi i kombit, që, me gjithë ca të liga që ka, është kombi ynë, e më tepër kujtimi e dëshira dhe etja e gjuhës sonë ta shtrëngojnë e ta dërrmojnë me të vërtetë zemrën.

Ah, malli i Shqipërisë, malli i atdheut të dashur, i shenjtë mall e dashuri e shenjtë, kush është ai shqiptar që s'e ka pasur në dhe të huaj! Duhet të jesh jashtë Shqipërisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç'forcë e ç'bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri! Ajo më e zbrazura letër, ajo fjala më e vogël, na sjell, kur vjen nga Shqipëria, një gaz të parrëfyeshëm, se na sjell si një copë të atdheut...

Faik Konica

Kënga e mallit të parë

Dëgjo, vash', këngën e par'
që ta thot' një djal' bujar,

...

Pra si nj'ëndërr vete e shkon,
po në zemër më qëndron.

Kushedi a më dëgjove,
mallin tim, a e kuptove?

Kushedi tek ti a foli
malli e zemrën a ta ndolli?

Serembe

Mall

Ca pika shiu ranë mbi qelq,
Për ty unë befaz ndjeva mall.

Jetojmë të dy në një qytet,
Dhe rrallë shihemi, sa rrallë...

Ismail Kadare

Kur të jesh mërziur shumë

Po kur të jesh mërziur shumë,
Në raft të librave kërkomë,
Atje i fshehur do të jem unë
Në ndonjë varg a ndonjë shkronjë.

Mjafton që librin pak ta heqësh
Dhe unë do zbres, do vij pas teje,
Ti si dikur me mall do qeshësh
Si një blerim pas një rrëkeje.

Dritëro Agolli

Qiell i djalërisë

Qiell i djalërisë në sqep të një zogu
U zhduk pas portës së ylbereve.

Zhduket pas portës së ylbereve djalëria
Dhe mua trishtimi më mbulon
Nën një hënë që nuk di të buzëqeshë,
Në një botë që nuk më kupton.

Frederik Rreshpja



Malli im

Erë e malit fryn ngadalë
Përmbi fushë plot me bar,
Mue malli porsi valë
Ma mbush zemrën plot me zjarm.

Erë e malit fryn e qetë
Si në lindje e perëndim;
Breg, lëndinë shohin jetë,
Zogjtë çmallen me këndim.

Më ha malli për natyrë,
Lisa, plepa në largim,
Malli i nanës si pasqyrë,
Ma zgjat jetën, m'ep gjallnim.

Hil Mosi

Malli

Mua mendja s'm'a kupton,
Mua syri s'ma vështron,
Po fillon edhe vajton,
E kullon, kullon, kullon:

Mall! O mall, që vjen e shkon!

Vjen e shkon e prapë vjen,
Mall që len nga perëndon:
Len e vjen e zjen e bren:
Malli mallin më s'e gjen...

Lasgush Poradeci

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Malli është një nga emocionet më të fuqishme të njeriut. Me çfarë ndjesish shoqërohet ai?
- 2 Pse i lëngon zemra Asdrenit kur kujton atdheun e tij?
- 3 Çfarë e bën të lumtur Konicën?
- 4 Në poezinë "Qielli i djalërisë", ndihen qartë notat e trishtimit. Çfarë e trishton më shumë poetin?

Studim teksti

Analizojmë poezinë

- 5 Dhimbje e thellë që ndiejmë për dikë a për diçka që ndodhet larg nesh; dëshirë e fortë për t'u kthyer sërish diku: për të takuar një njeri të dashur që është larg; për të përjetuar edhe një herë si dikur ose për t'u marrë përsëri me diçka që na ka pëlqyer shumë. Të gjitha këto ndjesi janë burimi i krijimeve të mësipërme. Përshkruani shkurtimisht në tabelë se kujt i referohet malli në çdo rast.

<i>I dashur atdhe</i>	
<i>Malli i atdheut</i>	
<i>Kënga e mallit të parë</i>	
<i>Mall</i>	
<i>Kur të jesh mërzitur shumë</i>	
<i>Qiell i djalërisë</i>	
<i>Malli im</i>	
<i>Malli</i>	

- 6 Zakonisht na merr malli për dikë që ndodhet larg, por ndonjëherë, mund të ndiejmë mungesën e dikujt që e kemi fare pranë. Cili nga fragmentet e mësipërme tregon se pavarësisht distancës gjeografike, malli nuk zbehet asnjëherë?

Interpretojmë tekstin

- 7 Konica shkruan: *"Duhet të jesh jashtë Shqipërisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç'forcë e ç'bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri!"*. Çfarë mesazhi kërkon të përcjellë ai me këto fjalë?

Gjuha e teksteve

- 8 Konica, që njihet për stilin e jashtëzakonshëm, përdor të njëjtin epitet, si për mallin, ashtu edhe për dashurinë: *"Malli i atdheut të dashur, i shenjtë mall e dashuri e shenjtë"*. Si mendoni, përse e bën ai një zgjedhje të tillë?
- 9 Gjeni figurën e anaforës në një prej fragmenteve të mësipërme.
- 10 Poezia e Poradecit karakterizohet nga prania e shpeshtë e figurave tingullore. Gjeni figurën e aliteracionit të vargjet e mësipërme.

Reflektojmë rreth tekstit

- 11 Në fragmentet e mësipërme, malli trajtohet herë në planin universal, herë në atë personal. Tregoni në cilin prej tyre, kjo ndjesi i shkakton njeriut dhimbje ose brengë.
- 12 Agolli në poezinë e tij shkruan: *"Po kur të jesh mërzitur shumë/Në raft të librave kërkomë..."*. Çfarë roli luajnë librat në emocionet dhe ndjesitë tona? Përse shpeshherë identifikohemi me personazhet e tyre?

Detyrë

- ▣ Krijoni një ese me temë "Malli për vendlindjen", duke përshkruar ndjesitë që keni përjetuar kur keni qenë larg saj.

Malli për t'pambërrijtshmen

Para leximit

Ajo që i karakterizon në mënyrën më të veçantë njerëzit, është aftësia e tyre për të ëndërruar. Kur janë fëmijë, ëndrrat janë shumë të bukura dhe me shumë ngjyra; në rini, janë më të vullshme dhe më të guximshme; në moshën e pjekurisë, njeriu vazhdon të ëndërrtojë, por më pak. Në këtë moshë, njeriu sjell ndër mend dhe analizon ëndrrat më të bukura të jetës. Ai ndien mall për fëmijërinë, rininë dhe veçanërisht për ëndrrat që kishte dikur, por që sot i duken të pamundura për t'u realizuar.



Esad Mekuli

Esad Mekuli (1916-1993) lindi në Plavë, ku kreu dhe shkollën fillore. Të mesmen e përfundoi në Pejë dhe më pas studioi në Beograd, Zagreb e Itali për veterinari. Në vitet e Luftës II Botërore, merr pjesë aktivisht në lëvizjen antifashiste, kohë gjatë së cilës u burgos disa herë. Për vite me radhë ka qenë kryeredaktor i revistës "Jeta e re". Esad Mekuli ka qenë kryetari i parë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Me krijimtari poetike filloi të merrej qysh në shkollën e mesme. U shqua si poet në vitet '30. Ka botuar përmbledhjet me poezi: "Për ty", "Dita e re", "Avsha ada" etj. Ka përkthyer në shqip rreth 18 vepra të gjinive të ndryshme letrare. Poezitë e Esad Mekulit janë përkthyer në gjuhën serbe, maqedonase, hungareze, kroate, italiane e të tjera. Krijimet e tij janë prezantuar në të gjitha antologjitë e poezisë shqipe, por edhe në shumë antologji botërore.

Retë luejnë n'altësin', si qingjat n'kodrina,
Ndërsa malli për t'pambërrijtshmen ndryhet n'mue:
Dëshirojsha mu kapë n'vallen e reve kuqle
E me fluturue në t'shkëqyeshmet naltësina
Me gëzimin e këngës baritore...
E kur hana e luginave ia beh n'shpejti
Dhe toka natën n'dishrim thërret,
Si rrezet e argjendta mbi kalli-
Të shkoj
E t'vizitoj
Skajet e dhimbjes e vendet ku pashë ankthet.

Vaj! Me u kapë n'vallen e reve n'kuqlime
Zemra me t'dhanun do t'më dëshironte
Që rinija t'gërthet i herë mâ me gëzime
Dhe mall i zemrës s'vuajtun t'gufonte.
- Por, pse zemra tingëllon përmallshëm
si za drithërim'
dhe droja kaplon thellë zemrën e shpirtin tim?!
Kur dëshiroj aq rëtë mbi qytet me i soditë,
Derisa malli për t'pambërrijtshmen m'kap, m'shafit.



Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Ju merr malli për të shkuarën? A i kujtoni ëndrrat që keni pasur dikur në fëmijëri? A ju duken të pamundura për t'u realizuar këto ëndrra?
- 2 Në çfarë moshe mendoni se është poeti, teksa shkruan këto vargje malli?

Analizojmë poezinë

- 3 Peizazhi i vendlindjes duket se e ndjek poetin. Ëndrrat e tij, ai i lidh gjithmonë me këtë peizazh. Ç'lloj tabloje ravijëzon Mekuli në këtë poezi dhe cilat elemente të saj veçon ai?
- 4 Poeti zgjedh të përshkruajë një simbiozë të çuditshme mes natyrës dhe ndjesive të tij. Dikur ëndërronte të kapte retë. Po tani, cila është dëshira e tij?

Interpretojmë poezinë

- 5 Vizioni i natyrës te Mekuli shfaqet i madhërishëm, fantastik, dhe është i tillë sepse përthyeret në sytë e poetit.
 - ▣ Analizoni mënyrën si e përshkruan natyrën poeti.
 - ▣ Përshkruani gjendjen shpirtërore të tij, kur sjell ndër mend gjithë këtë peizazh.
- 6 Poeti përmend vazhdimisht retë. Shpjegoni kuptimin e tyre simbolik.

Gjuha e poezisë

- 7 Duke u nisur nga gjuha që përdor poeti, përcaktoni llojin e poezisë: lirike apo epike. Argumentoni përgjigjen.
- 8 Që në vargun e parë të kësaj poezie spikat një figurë e njohur letrare. Si quhet ajo? Shpjegoni ndërtimin strukturor të saj.
- 9 Poezia është e ndarë në dy pjesë, që duket sikur shënojnë edhe dy kohë:
 - ▣ në pjesën e parë përdoret folja "dëshirojsha *mu kapë n'vallen e reve*";
 - ▣ në të dytën "*dëshiroj aq retë mbi qytet me i soditë*".
 Duke u nisur nga ndryshimi i kohës së foljes, shpjegoni çfarë ka ndryshuar lidhur me dëshirën e poetit.

Reflektojmë rreth poezisë

- 10 Në këtë poezi, nuk është natyra në qendër të saj, por uni poetik që shpërfaqet plotësisht. Përshkruani gjendjen shpirtërore të poetit.

Detyrë

- ▣ Përshkruani peizazhin që ju vjen në mendje më shpesh. Përse ky peizazh është kaq i veçantë për ju?

Ejani, o kujtime!

Para leximit

Pjesa "Ejani, o kujtime!" është një nga 15 prozat poetike të përfshira në ciklin "Hi dhe shpuzë" të Mid'hat Frashërit. Rrëfimtari kthen kokën pas dhe kërkon të sjellë ndër mend kujtimet e tij. Ai shpreson se kujtimet do t'i japin mundësi për të përjetuar atë që ka shkuar, pasi i konsideron si miq të mirë. Forma e prozës poetike i krijon mundësinë rrëfimtari lirik të paraqesë ndjesitë personale dhe brengat njerëzore nga këndvështrimi subjektiv.



Mid'hat Frashëri

Mid'hat Frashëri (1880–1949), ndryshe i njohur si Lumo Skëndo, cilësohet si një nga intelektualët më të shquar të kohës së tij, që dha kontribut në shumë fusha të jetës letrare e të historisë shqiptare. Kontributi i tij kulturor e gjuhësor faktohet edhe me përgatitjen e Kongresit të Manastirit (1908), në të cilin u zgjodh edhe kryetar.

Ka shkruar e botuar në shqip e frëngjisht vepra letrare, eseistike e kritike. Veprat në shqip të Mid'hat Frashërit janë: "Naim Be Frashëri", "Hi dhe shpuzë" (prozë poetike, novela, kujtime), "Pritimi i Shqipërisë" (studim mbi shqiptarët dhe të ardhmen e tyre), "Plagët tona" ese socio-politike e etnike. Ai botoi edhe një sërë veprash në frëngjisht. Ka përkthyer në shqip veprat "Robinson Kruzo" të Daniel Defosë, "Gyjom Tellit" të Lamartinit dhe përmbledhjen me përralla "Bëje të mirën pa hidhe në det" të Franc Hofmanit. Ai kishte krijuar një bibliotekë personale, e cila kishte mijëra vëllime, që sot ruhen dhe janë pjesë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Ejani, ejani, o kujtime, se kam nevojë për ju. Zemra sot më ka pikëllim. Ejani se u dua!

T'ëmbël a të hidhur, gjithnjë u kam dashur, o miqt' e mij. Të ngroht' a të ftohtë, si do që kini qenë, zëmra u ka pritur me dashuri!

Ini miq të vjetër: m'arrin të mbyll sytë që t'u shoh këtu pranë meje. Ejani, pra, o kujtime.

Kur shpirti më ndjen të ftohtë, kur zëmra ndjen veten e saj jetime, u dua, o kujtime, si i varfëri që trazon hin' e vatrës për të gjetur pakë shpuzë. Sa t'ëmbëla i duken ato shkëndijat e vogla!

Po edhe në kohë të gazit dhe të shpresës, ahëre kur një e sotm' e qeshur më bën të dua gjithë kohën e shkuarë dhe të shoh t'ëmbël dhe të bukur udhën që kam përpara, edhe ahëre, o miqt' e mij, dua të trazoj këtë hi të jetës që të shoh shpuzën, ta shoh e të gëzohem, e të qesh duk'e flakurë n'erë!

Fjalor

shpuzë – prush i imët në hi të nxehtë, që mbetet kur janë djegur drutë.

m'arrin – këtu: më mjafton.

Proza poetike

Proza poetike konsiderohet si formë e ndërmjetme, kalimtare, mes poezisë dhe prozës, e cila ruan karakteristikat e të dyja llojeve. Në pamje të parë, duket se i ngjan prozës. Fjalitë janë të shtrira deri në fund të rreshtit dhe rresht pas rreshti, ndërsa gjuha është shumë e figurshme, njësoj si në poezi.

Në prozën poetike zënë vend ritmi në fjali dhe rima e brendshme, që i japin muzikalitet të veçantë dhe unik, duke e afruar me poezinë; po ashtu, emocioni i theksuar shpreh përjetime personale dhe mendim të ngjeshur. Në këtë lloj letrar më shumë flitet për gjendjen shpirtërore sesa për atë që ka ndodhur ose që po ndodh.

Në prozën poetike, zakonisht rrëfëhet në vetën e parë njëjës (unë), nga ku nis e përfundon identifikimi i autorit me narratorin nëpërmjet një rrëfimi tejet personal. Në përgjithësi, proza poetike është e ndërtuar mbi figurën e metaforës dhe të simbolit dhe shtrihet nga disa rreshta deri në 3-4 faqe.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
- a) Çfarë synon nëpërmjet këtij teksti rrëfimtari?
- b) Çfarë risjellin kujtimet në jetën e autorit? Ato e bëjnë:
- të gjejë energji dhe forcë; melankolik e të trishtuar;
- të mërzhitet për kohën që ka shkuar.

Analizojmë tekstin

- 2 Kujt i drejtohet rrëfimtari me "o miqt' e mij", në fillim të tekstit dhe në fund të tij?
- 3 Në çfarë vete rrëfëhet në tekst? Cila është forma e rrëfimit: monologu apo dialogu?
- 4 Kur poeti flet për kujtimet, ai u referohet ngjarjeve specifike apo përjetimeve të tij?

Interpretojmë tekstin

- 5 Interpretoni frazën: "...dua të trazoj këtë hi të jetës që të shoh shpuzën, ta shoh e të gëzohem, e të qesh duk'e flakurë n'ërë!"
- 6 Për të përshkruar kujtimet, rrëfimtari ka përdorur epitete me kuptim të kundërt. Gjejini në tekst dhe shpjegoni çfarë efekti krijon një gjë e tillë.

Gjuha e tekstit

- 7 Gjeni çfarë figurash letrare janë fjalët me ngjyrë blu.
- Po edhe në kohë të gazit dhe të shpresës, ahëre kur një e sotm' e qeshurë më bën të dua gjithë kohën e shkuarë dhe të shoh t'ëmbël dhe të bukurë udhën që kam përpara, edhe ahëre, o miqt' e mij, dua të trazoj këtë hi të jetës që të shoh shpuzën, ta shoh e të gëzohem, e të qesh duk'e flakurë n'ërë.*
- 8 Cila është figura bazë mbi të cilën është ndërtuar kjo prozë poetike? Analizoni rastet e shfaqjes së saj në tekst.
- 9 Lexoni me kujdes rreshtat e mëposhtëm. Çfarë ju bën përshtypje në këtë pjesë?
- T'ëmbël a të hidhur, gjithnjë u kam dashur, o miqt' e mij. Të ngrohtë a të ftohtë, si do që kini qenë, zëmra u ka priturë me dashuri!*
- 10 Në këtë prozë poetike hasim përdorimin e kohëve të ndryshme të rrëfimit:
- Ejani, ejani, o kujtime...*
...gjithnjë u kam dashur...
...dua të trazoj...
- Si ndryshon koha e përdorur? Shpjegoni këtë lloj ndryshimi.

Reflektojmë rreth tekstit

- 11 Në pjesën e fundit të prozës poetike, poeti shkruan: *Po edhe në kohë të gazit dhe të shpresës, ahëre kur një e sotm' e qeshur më bën të dua gjithë kohën e shkuarë dhe të shoh t'ëmbël dhe të bukur udhën që kam përpara...*
- ▣ Pse poeti u kërkon kujtimeve që t'i vijnë jo vetëm kur ndihet i vetmuar, por edhe në kohë gëzimi e hareje?

Detyrë

- ▣ Gjeni shkrimtarë të tjerë shqiptarë dhe të huaj që kanë shkruar proza poetike.

Lamtumirë!

Para leximit

Titulli i poezisë sugjeron një ndarje. Në tekstin poetik të mëposhtëm, ndodh “ndarja” e poetit me vendlindjen e tij. Ai do të largohet prej saj për të shkuar në një vend tjetër. Kjo poezi është edhe fjala e tij e lamtumirës. Ajo është e mbushur me imazhe, silueta, ndjesi dhe kujtime nga vendi i tij.

Lamtumirë.

Marr me vete

*djegje perëndimesh nëpër muzgje të qeta,
silueta qiparisash nëpër sfonde të murrme
ullinjsh.*

Dhe blloqet e hijeve të Çikës,

që përkunden netve

mbi kostelacione yjesh Jonit përposh.

Lamtumirë.

Kudo që shkoj

jam një copëz peizazhi nga vendi im.



Fatos Arapi

Fatos Arapi (1930–2018) është një nga poetët më të spikatur të letërsisë shqipe bashkëkohore. Ai ka lindur në qytetin e Vlorës, ku mori mësimet e para dhe kreu shkollën e mesme. U diplomua për matematikë dhe ekonomi në Universitetin e Sofjes, në Bullgari. Megjithatë, për shumë vjet ka punuar si gazetar dhe pedagog në Fakultetin e Histori-Filologjisë së Tiranës. Fatos Arapi është fitues i disa çmimeve kombëtare e ndërkombëtare për poezi. Disa nga vëllimet e tij me poezi janë: “Shtigje poetike” (1962), “Poema dhe vjersha” (1966), “Poezi të zgjedhura” (1974), “Më vjen keq për Jagon” (1994), “Kujtohem që jam” (1997), “Antologji personale” (2001) etj.

Përveç veprave poetike, Fatos Arapi ka shkruar edhe në prozë: tregime, novela, romane dhe drama.

Vargu i lirë

Në një pjesë të madhe të poezisë, veçanërisht në atë të shkruar në bashkëkohësi, vargjet radhiten me gjatësi të ndryshme, nuk kanë ritëm ose rimë të rregullt ose, kur kanë, ajo nuk është sistematike. **Vargu i lirë** shkruhet pa zbatuar rregullat e njohura për ndërtimin e strofave dhe të vargjeve.

Ai mendohet se lindi në pjesën e dytë të shekullit XIX, si një mënyrë për të ndryshuar vargëzimin tradicional, veçanërisht për t’iu kundërvënë rregullave në lidhje me rimën, numrin e njëjtë të rrokjeve në varg etj.

Vargjet e lira karakterizohen nga muzikaliteti i krijuar nga aliteracioni dhe asonanca. Në to gjejmë përdorimin e shpeshtë të enumeracionit, përsëritjet, si dhe paralelizmat. Shkrimtari që e përdori me sukses këtë varg në letërsinë shqipe, është Migjeni. P.sh., poezia e tij “Vuejtja”:

Ka do ditë

që po shoh fare mirë

se si nga vuejtja sytë po më madhohen.

Nëpër ballë dhe fytyrë rrudhat po më shtohen

e si buzëqeshja më asht e hidhur...

...dhe po ndiej

se si mëngjezet e mia

nuk janë më mëngjezet e një pune të hovshme.

Shënim

Mali i Çikës bën pjesë në Vargun Bregdetar Jonik. Ky varg ka dy degëzime, atë perëndimor dhe atë lindor, të cilat ndahen midis tyre nga Gjiri i Vlorës dhe Fusha e Dukatit. Përgjatë këtij vargu, nga Uji i Ftohtë në Vlorë e deri në Butrint, shtrihet Riviera Shqiptare, në të cilën gjendet edhe Parku Kombëtar i Llogarasë.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

- 1 Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Cili është lajtmotivi i kësaj poezie?
 - b) Shkruani tri ide kyçe që shfaqen në këtë poezi.
 - c) Renditni detajet përshkruese të kësaj poezie.

Analizojmë poezinë

- 2 Shpjegoni kuptimin dhe ngarkesën emocionale që përcjell përsëritja e vargut: *Lamtumirë*.
- 3 Gjeni figurat letrare në vargjet me shkronja të pjerrëta dhe shpjegoni funksionin e tyre.
- 4 Kjo poezi është shkruar me varg të lirë. Ilustroni me shembuj karakteristikat e këtij vargëzimi.

Interpretojmë poezinë

- 5 Përshkruani gjendjen emocionale të poetit, duke plotësuar tabelën e mëposhtme.

Si ndihet poeti?	I çlirët.	I tensionuar.	Indiferent.
Pse mendoni në këtë mënyrë?			

- 6 Interpretoni vargun: *jam një copëz peizazhi nga vendi im*.

Gjuha e poezisë

- 7 Vlerësoni dhe komentoni zgjedhjet stilistike të poetit.

Zgjedhjet stilistike të poetit	Komenti	Vlerësimi im

Reflektojmë rreth poezisë

- 8 Shumë poetë të tjerë kanë shkruar poezi kushtuar vendlindjes, nga perspektiva e njeriut të larguar prej saj. Gjeni disa prej tyre dhe reflektoni rreth ndjesive të shprehura në secilën prej tyre.
- 9 Në rast se do të ishit në vend të poetit që po largohet nga vendi i tij, për çfarë do t'ju mernte më shumë malli?

Detyrë

- 📄 Gjeni shkrimtarë të tjerë të letërsisë shqipe që i kanë shkruar poezitë e tyre në varg të lirë. Lexoni në klasë pjesë nga poezitë e tyre.
- 📄 Ktheni poezinë në prozë.

Në rrugën Gjenerali Vajs

Para leximit

Poezia "Në rrugën Gjenerali Vajs" u botua për herë të parë në vitin 1979. Një poezi në dukje e thjeshtë, por që bart mendime të thella dhe universale. Me një shprehje e lirshmëri të natyrshme, poeti shfaq ndjenja dhe shqetësime më se njerëzore. Në qendër të saj është një lustraxhi, përfaqësues i njerëzve të thjeshtë, i atyre që nuk shfaqin ambicie a qëllime të mëdha në jetën e tyre. Ai qëndron i ulur në një qoshe të rrugës dhe lustron këpucët me shpresën që të sigurojë jetesën. Ndërsa punon, nis e mendon për jetën, për vlerat e saj. I zhytur në këtë botë mendimesh të bukura, gjithçka i duket e thjeshtë, e lehtë.



Rrahman Dedaj

Rrahman Dedaj (1939-2005) lindi në fshatin Penduhe, afër Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Podujevë, të mesmen në Prishtinë, ku ndoqi edhe studimet e larta në Fakultetin Filozofik. Pasioni i tij për letërsinë zë fill qysh në bankat e shkollës. Veprat e tij më të njohura janë: "Zogu dhe Kulla", "Me sy kange", "Simfonia e fjalës", "Balada e fshehur", "Etje", "Fatkeqësia e urtisë", "Kryqëzim hijesh", "Fshehtësia", "Medaljoni".

Në rrugën Gjenerali Vajs
Lustraxhiu shikon këmbët e njerëzve
Dhe sipas këpucëve
Klasifikon zemrat.

Lustron këmbët e majta,
Këmbët e djathta,
Në rrugën Gjenerali Vajs
Lustraxhiu – dhe qesh ëmbël,
I thotë vetes
Se lumturia është nga gjërat e thjeshta, si jeta.

Vë ngjyrë të kuqe
Vë ngjyrë të zezë,
Ngjyrë kafeje vë
Në rrugën Gjenerali Vajs.

Njeriu ia vë këmbën në arkë,
Fut duart në xhepa
Dhe dëgjohet xingërrimë
Monedhash të imta,
Një alegro, një muzikë xhepush
Në rrugën Gjenerali Vajs.

I buzëqesh vetes si fëmija
Dhe tund kokën nga mendimi
Si mund të pastrohen zemrat
E të përlyhen këpucët
Në rrugën Gjenerali Vajs.

As shi nuk bie,
As pluhuri s'lekundet
E njerëzit thithin ajrin e vaktë



Lustraxhiu pastron.
 Këmbët e majta, këmbët e djathta
 Dhe mendon urti të re për njerëzit
 Duke i thënë vetes se lumturia
 Është nga gjërat e thjeshta, si jeta.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë

- 1 Ç'mund të thoni për mesazhin që përcjell kjo poezi, nisur edhe nga vëzhgimi i gjatë që u bën lustraxhiu njerëzve përreth tij?

Analizojmë poezinë

- 2 Lustraxhiu shtron një pyetje, e cila tregon thellësi mendimi dhe interes të madh për botën përreth. Cila është kjo pyetje? Çfarë ju bën përshtypje në formulimin e saj?
- 3 Përshkruani ambientin e punës së lustraxhiut. A ndihet aty dashuria e tij për punën dhe për jetën e thjeshtë që bën?
- 4 Njerëzit i klasifikojnë të panjohurit duke u nisur nga veshja, pamja apo mënyra se si ecin. Po lustraxhiu, si i kategorizon ata që kalojnë në rrugë?

Interpretojmë poezinë

- 5 Në poezi përsëritet dy herë vargu: *Se lumturia është nga gjërat e thjeshta, si jeta.* Analizoni këtë fjali dhe gjeni domethënien e saj.
- 6 Rruga ka emrin e një gjenerali. Si mendoni, çfarë duhet të ketë bërë ky gjeneral që ka merituar këtë nderim?
- 7 Si mendoni, përse poeti e përmend kaq shpesh emrin e rrugës, kur mund të kishte folur thjesht për një rrugë çfarëdo?

Gjuha e poezisë

- 8 Në këtë poezi, rrëfimi kryhet kryesisht në kohën e tashme. Çfarë efekti synon poeti me një zgjedhje të tillë?
- 9 Lustraxhiu është vetëm, ndonëse pranë tij kalojnë shumë njerëz:
 - ▣ Ai bën një monolog të brendshëm. Çfarë i thotë vetes?
 - ▣ *I buzëqesh vetes. – Pse?*

Reflektojmë rreth tekstit

- 10 Nëse do të krahasonit figurën e gjeneralit me atë të lustraxhiut, në çfarë përfundimi do të arrinit?
- 11 Si mendoni, cilat kanë më shumë rëndësi në jetë, bëmat, fitoret apo vlerat?

Detyrë

- ▣ Shkruani një ese për gjërat që konsideroni më të rëndësishme në jetë dhe që ju bëjnë të lumtur.

Martesa e Halilit

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga kënga "Martesa e Halilit", marrë nga "Eposi i Kreshnikëve".

Një ditë, Muji bashkë me kreshnikët e tjerë doli në mal për gjueti. I ftohti shumë i madh e shtyu Mujin t'i ftonte të gjithë në shtëpinë e tij. Aty burrat e pyetën Mujin pse nuk po e martonte Halilin, vëllain e vogël. Në vend të Mujit, e merr fjalën vetë Halili, i cili u tregon kreshnikëve se tërë vajzat e krahinës i duken si motra dhe se është i dashuruar me Tanushën, vajzën e Krajlit.

Fjalor

plajm – borë e imët e thatë, që ngrihet lart prej erës.

shoshojnë – shoqi-shoqin,

njëri-tjetrin.

sharroj – këtu: mbaroj.

moca – mosha.

n'Kotorre t'reja – qytet në Dalmaci.

korit – turpëroj.

fligshiti – fëlliqësi, poshtërsi.

daji – trim.

Krajli – kështu quhej mbreti

në vendet sllave.

Jutbina – vendi ku jetojnë Muji dhe

Halili.

fiskajë – filiz, fidan, thupër e hollë.

Tusha – argjendar i famshëm

që stoliste armët.

Eposi i Kreshnikëve është pjesë e krijimtarisë popullore. Ai përbëhet nga një cikël këngësh me frymë heroike dhe legjendare. Ndryshe ai njihet edhe si Cikli i Këngëve të Mujit e të Halilit, duke u nisur nga emrat e dy personazheve kryesore. Secila prej këngëve trajton një ngjarje, një episod jete, po aq të rëndësishëm, madhështor e me të njëjtat personazhe: heronjtë e Jutbinës. Në të shkrihen elementet mitike, përrallore dhe fantastike. Eposi është një ndër monumentet më të rëndësishme artistike të trashëgimisë shpirtërore të shqiptarëve.

Ka dalë Muji me kreshnikë,
A thue ndeshet m'ndoi gja malit!
T'kjoshim falë, o i madhi Zot,
Sa shpejt diellin ma xu reja!
Shpejt ma endi i pëlhurë t'gjanë e t'gjatë!
E i ka veshun majet rreth e rrokull,
Qi, kur janë kapë trimat te lumi,
Kaq përzi i ka frima **plajm** e re,
Askurnja **shoshojnë** trimat s'p'e njofin.
In ngri trimat **me sharrue**,
Por n'breg t'lumit - kulla e Mujit,
T'tanë për darkë Muji i ka ndalë.
Kqyr shka bani Gjeto Basho Muji!
E ka vu një barrë dru t'vogël n'zjarm,
Treqind vetë priherë m'u xe, [...]
Sa shpejt frima burrave u ka ardhë!
Sa shpejt gjaku trimave po u xehet!
Kanë marrë llafin e po llafiten,
Kanë marrë gazin e po gazmojnë,
Kanë nisë trimat Mujin p'e pëvetin:
- N'votër tande kem' qillue,
Mos na ki randë për një fjalë!
Pash një zot, Mujë, qi t'ka dhanë,
Qysh Halilin s'e martove?
Janë martue krejt **moca** e tij,
Djelm e çika Zotynë u ka falë,
Djelt e tyne n'lojë t'tanë janë dalë.
A t'u dhimtën paret për me i dhanë?
A t'u dhimten darsmat për me i ba?
Tutna djalin dikush po na rre.
Shpesh e shpesh po bje' **n'Kotorre t'reja**,
Rob të gjallë djalin p'e xanë.
Le' konakun, Mujë, qi s'po ta fikin,
Ma zi fisin, Mujë, po na **koritin**. [...]
- Faqebardhë, more shokë, ju kjoshi,
Se mirë hallin po ma diki, burra!...

Krahasimi

Krahasimi është ajo figurë letrare, e cila krijohet nga vënia ballë për ballë e dy sendeve, dy frymorëve ose dy dukurive, për të ndriçuar më mirë njërin prej tyre, si dhe për ta bërë më të gjallë e më të pasur mendimin. Në krahasim vihen përballë fjalët që shënojnë dukuri, sende a frymorë që kanë ngjashmëri. Nga ndërtimi sintaksor, krahasimi ka dy pjesë: të krahasuarit dhe krahasuesin, që lidhen ndërmjet tyre me lidhëzat: si, ashtu si, porsì, sikurse.

Krahasimi është i thjeshtë kur përbëhet vetëm nga një fjalë dhe i zgjatur kur përbëhet nga shumë fjalë. Krahasimi i zgjatur quhet edhe similitudë.

Ju t'pavllazën, shokë, s'kini qillue,
 Kuj po i dhimen darsmat për vlla t'vet?
 Ky edhe s'asht, or burra, cub **fligshtish**,
 Mirë e njihni, se a daji trimnish [...]
 At be m'Zotin djali por ka ba:
 - Kah kam vlla e kah kam motër,
 Deksha para, n'u martosha!
 Se gjithë grat e Krahinës, ku janë,
 Se gjithë vashat e **Jutbinës**, ku janë,
 Bash si motra qi po m'duken.
 Dheu m'ka mlue e fat s'i qita vedit,
 Po s'e mora Tanushën e krajlit.
 E un Tanushën vetë e ko' pa,
 Kur kem' pasë besë me **Krajli**.
 Gja ma t'mirë s'shef njeri nën ket diell!
 Vetulla e saj ndrejt si fiskaja,
 Shteku i ballit si shteku i malit,
 Kur merr hana me pranue,
 Syni i saj si kokrra e qershisë,
 E ka qerpikun si krahi dallndyshës,
 Ftyra e saj si kuqet molla n'degë,
 Hunda ndrejt si kalemi i Tushës,
 Goja e vogël si lula qi shpërthen,
 Dhamët e bardhë si gurzit e lumit,
 Fill mbas shiut kur po i shndritë dielli,
 Qafa e saj si qafa e pllumbit...

Poezia epike

Poezia epike është një lloj letrar i gjatë, i shkruar në vargje, që trajton tema me rëndësi të madhe në jetën e një populli, siç janë tema e luftës, udhëtimet dhe zbulimet e mëdha, marrëdhëniet e njerëzve me perënditë, fati i njerëzve shumë të rëndësishëm, pra i atyre që i prijnë popullit. Ngjarjet janë të rëndësishme, të njohura dhe i përkasin së shkuarës historike dhe mitologjike të popujve. Personazhet janë të shumta dhe janë trima ose heronj. Rrëfimtari qëndron në distancë me atë që rrëfen dhe me lexuesin, si një dëshmitar i largët dhe i paanshëm. Ai është ndërmjetësues mes asaj që rrëfëhet dhe lexuesit.

Poezia epike ndahet në poezi epike gojore dhe në poezi epike të shkruar. Krijimtaria gojore është mbajtur mend përmendësh, ndërsa ajo e shkruar është autoriale. Një nga llojet më të njohura të poezisë epike është eposi. Janë të njohura vepra të tilla, si: "Iliada", "Odiseja", "Eneida" etj. "Lahuta e Malcis" është një vepër epike e shkruar nga Gjergj Fishta.



Kuptojmë poezinë

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Në cilën stinë kanë dalë kreshnikët për gjueti?
 - b) Çfarë i bën ata të heqin dorë nga gjuetia?
 - c) Cila është pyetja që i bëjnë kreshnikët Mujit në kullën e tij?
 - ç) Çfarë i thonë kreshnikët Mujit për kalimet e kufirit që bën Halili?
 - d) Kush është vajza që i ka marrë zemrën dhe mendjen Halilit?
- 2 Shënoni me ✓. Halili nuk martohet me vajzat e krahinës sepse:

<input type="checkbox"/> nuk ka ndonjë vajzë të përshtatshme;	<input type="checkbox"/> nuk i duket asnjëra e bukur;
<input type="checkbox"/> i duken të gjitha si motrat e tij;	<input type="checkbox"/> asnjëra nuk e ka pranuar propozimin e tij.

Analizojmë poezinë

- 3 Cili prej zakoneve të shqiptarit përshkruhet në pjesën e parë të tekstit?
- 4 Gjeni në tekst betimin e fortë që shqipton Halili, i cili mund të shndërrohet në mallkim nëse nuk kryhet. Për cilën anë të karakterit të tij bëhet fjalë?
- 5 Përshkrimi i pamjes fizike të Tanushës bëhet gradualisht. Përcaktoni në çfarë drejtimi bëhet përshkrimi.
- 6 Kjo këngë kreshnikësh, e ndërtuar në vargje, rrëfen një ngjarje. Cila është ngjarja që rrëfëhet?
- 7 Gjeni përsëritjet në fillim të vargjeve. Cili është roli i përdorimit të tyre?

Interpretojmë poezinë

- 8 Interpretoni arsyen pse janë kaq të frikësuar kreshnikët nga ikja e Halilit *n'Kotorre t'Reja*.
- 9 Interpretoni vargjet:
Rob të gjallë djalit po e zanë/ Le konakun, Mujë, po ta fikin/ Ma zi fisin, Mujë, po na koritin...
Çfarë mund të ketë më të keqe se vdekja?

Gjuha e poezisë

- 10 Gjeni figurën e hiperbolës dhe shpjegoni efektin emocional nëpërmjet shembullit të gjetur.
- 11 Gjeni në tekst: epitete, krahasime, inversione (anasjella), përshkallëzime.
- 12 Poezia epike nuk është e ndarë në strofa. Ajo është e ndërtuar në monokolonë. Gjeni dhe sillni në klasë poezi të tjera epike.
- 13 Përshkrimi i pamjes fizike të Tanushës mbështetet në elemente të natyrës. Gjejini në tekst këto elemente.

Reflektojmë rreth poezisë

- 14 "*Eposi i Kreshnikëve*" është ruajtur gojë më gojë, ndër shekuj. Diskutoni në klasë se si mund të ketë ndodhur kjo.

Detyrë

-  Mësoni përmendsh pjesën e përshkrimit të Tanushës.

Gjuha shqipe

Para leximit

Në letërsinë shqipe kanë zënë vend shumë poezi kushtuar gjuhës, si një prej elementeve më të rëndësishme të identitetit kombëtar. Në poezinë e mëposhtme, Ismail Kadare vlerëson forcën shprehëse të saj, si mjet që nxit një krijimtari letrare të pasur. Gjuha është frymë dhe ndërgjegje kombëtare, është informacioni më i rëndësishëm shpirtëror i mbërritur prej të parëve, është shenja e parë e identitetit shqiptar. Kjo poezi e Kadaresë shquhet për idetë e thella dhe për figuracionin e pasur e origjinal, me të cilët ka pasuruar poezinë shqipe.

Kur në sulm hodhën turqit
Hordhitë e pambaruara,
Kështjellat e sintaksës
S'i muar, që s'i muar.

Në bedena poemash
Popullore mbetën
Kufoma divanesh e
Kufoma bejtësh.

Kur panë se gjuhës
S'i hodhën dot prangat,
Lëshuan drejt saj
Gjithfarë merimangash.

Parashtesa dhe pjesëza
E lidhëza së prapthi
Të bukurën gjuhë
Ta bënë in lesh arapi.



Fjalor

hordhi – bandë e egër gjakatare.

beden – pjesë muri e ngritur si dhëmb në murin mbrojtës të kështjellës, prapa së cilës mbroheshin luftëtarët.

divan – (këtu) lloj poezie e njohur në letërsinë orientale.

bejte – lloj poezie e njohur në letërsinë orientale.



Ismail Kadare

Ismail Kadare (1936) është një nga shkrimtarët më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqipe. Rugën e krijimtarisë letrare e nisi si poet dhe u bë i njohur me vëllimin "Shekulli im" (1961), që u pasua nga vëllimet e tjera poetike: "Përse mendohen këto male" (1964), "Motive me diell" (1968) dhe "Koha" (1976). Në fushën e prozës, janë shumë të njohura romanet: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1963), "Kështjella" (1970), "Kronikë në gur" (1971), "Pallati i ëndrrave" (1981), si dhe përmbledhjet me tregime dhe novela: "Emblema e dikurshme" (1977) dhe "Ura me tri harqe" (1978). Veprat e Ismail Kadaresë janë përkthyer e botuar në më shumë se 45 gjuhë dhe janë vlerësuar nga kritikët dhe lexuesit anëmbanë botës. Vepra e tij ka karakter universal, por rrënjët i ka të ngulura thellë në tokën shqiptare. Në vitin 1996, Kadare u bë anëtar për jetë i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës. Në vitin 2005, fitoi *Man Booker International Prize*, në vitin 2009 çmimin Princi Asturias për Artet, në vitin 2015 Çmimin Jerusalem, kurse në vitin 2016 mori titullin "Komandant i Legjionit të Nderit" në Francë. Emri i tij përmendet shpesh nga shtypi dhe kritika ndërkombëtare si një nga shkrimtarët kandidatë për Çmimin Nobel në letërsi.

Në përçartje ta kthenin
Në **delir** në **jerm**,
Ishin vite të rënda,
Ishin shekuj plot helm.

Të të bënin ty, donin,
Shqipëri memece,
Po ja, erdhi Naimi,
Si yll mbi ty ecte.

Dorën e zbehtë
Mbi ballë të vuri,
Të të hiqte zjarrllëkun
Prej të sëmuri.

Dhe vdisnin pjesëzat,
Thaheshin merimangat,
Ndriste si perlat
Poezia e madhe.

Kjo gjuhë, që provoi
Akrepat e shkretëtirës,
Ç'do të thotë **përçartje**
E di, oh, e di mirë.

Kjo gjuhë **martire**,
Lehonë e përjetshme
Që lindi mes dhimbjesh
Art të pavdekshëm.

Fjalor

delir – dalldi, shastisje, kllapi.

jerm – kllapi, përçartje.

përçartje – të flasësh pa kuptim, pa vetëdije.

martir – ai që vuan shumë e jep edhe jetën për një çështje të lartë e të shenjtë.

lehonë – një grua që sapo ka lindur fëmijë.

Metafora

Metafora është ajo fjalë a shprehje që emërton një send a një dukuri me emrin e një sendi a dukurie tjetër, që i ngjan. Shpesh, metafora shpjegohet edhe si krahasim i shkurtuar, si krahasim pa lidhëzën krahasuese. Në metaforë mbartet kuptimi nga njëra fushë e jetës në një fushë tjetër, zëvendësohet kuptimi i një fjale me kuptimin e një fjale tjetër.

Një lloj metafore që përdoret shpesh është kur shpirtëzohen sendet a dukuritë, d.m.th., kur tiparet e karakteristikat e një frymori kalohen te një jofrymor. Psh.: pylli i shqetësuar, fusha frymon etj.

Studim teksti

Kuptojmë poezinë


- 1 Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Cili është motivi kryesor i poezisë?
 - b) Cilën kohë të historisë ka veçuar poeti si më shumë të rrezikshme për zhdukjen e gjuhës shqipe?
 - c) Si ka arritur të mbijetojë gjuha shqipe ndër shekuj?
 - ç) Çfarë ka vënë poeti përballë poemave popullore në luftë për të ruajtur gjuhën?
 - d) Çfarë ka prodhuar gjuha shqipe, sipas poetit?

Studim teksti



Analizojmë poezinë

- 2 Për ç'lloj *zjarllëku* bëhet fjalë në tekst? Nga cilat sëmundje mund të vuajë gjuha e një vendi?
- 3 Cilët janë *akrepat* që duan ta helmojnë gjuhën shqipe? Si mund ta arrijnë këtë gjë?
- 4 Shkrimtari ka përdorur në poezinë e tij një shumësi figurash letrare, si: krahasime, epitete, metafora etj. Cila është figura letrare e përdorur më shpesh? Gjeni pesë raste të përdorimit të kësaj figure.


Interpretojmë poezinë

- 5 Shënoni me . Qëllimi i kësaj poezie është:
 - t'i thurë himn gjuhës shqipe;
 - të tregojë dashurinë e madhe që ka poeti për gjuhën;
 - të paraqesë vështirësitë me të cilat është përballur gjuha për të mbijetuar;
 - të tregojë sa shumë ka ndryshuar gjuha ndër shekuj.
- 6 Cili është poeti që përmendet në strofën e pestë? Çfarë simbolizon figura e tij?
- 7 Çfarë "bedenash" mund të krijonin këngët popullore shqiptare?

Gjuha e tekstit

- 8 Zbërtheni kuptimin e figurshëm në togfjalëshat e mëposhtëm.
 -  Gjuhë martire _____
 -  Lehonë e përjetshme _____
- 9 Vargjet e poezisë krijojnë imazhin e një lufte të vazhdueshme të gjuhës për të mos u asimiluar. Gjeni në tekst dhe shënoni më poshtë fjalët tipike në përshkrimin e një lufte të mirëfilltë.


Sulm _____

 -  Pse mendoni se poeti zgjedh të bëjë një paralelizëm të tillë mes luftës që bën gjuha dhe asaj që bëhet në fushëbetejë?
- 10 Cili është lloji i strofës dhe i vargut të përdorur në poezi? Po lloji i rimës? Si ndërtohet ajo?

Reflektojmë rreth poezisë

- 11 Gjuha është pjesë e identitetit të njeriut. Si e ruan ajo lidhjen me të kaluarën dhe si e krijon lidhjen me të ardhmen?

Detyrë

-  Të gjitha gjuhët pasurohen me fjalë të reja që zakonisht krijohen nga fjalë ekzistuese. Megjithatë, ndodh edhe që pavarësisht se gjuha i ka fjalët e saj, në të ndërfuten edhe fjalë të huaja, të panevojshme. Përmendni disa prej tyre. Diskutoni në klasë rreth kësaj dukurie.

Këndo ose vdis pa klithmë

Para leximit

"Këndo ose vdis pa klithmë" është një krijim poetik, ku subjekti poetik që identifikohet me poetin është përpara zgjedhjes të ndryshme. Të shkruajë poezi dhe të lërë shpirtin e tij të lirë apo të heshtë e të vdesë në heshtje, pa klithmë. Poeti është i shkrië në natyrë, mëson prej saj. Lidhja është kaq e madhe sa e gjen veten pjesë të saj, barit, yjeve, zjarrit, bregut, zogut. Poeti identifikohet dhe shkëmben me natyrën, një simbiozë e përyetshme dhe e pandërprerë. Ai merr prej saj ngrohtësinë e zjarrit, gjelbërimin e barit, lartësinë e yjeve, paanshmërinë e qiellit, lirinë e zogut.



Din Mehmeti

Din Mehmeti (1932–2010) lindi në Gjocaj, një fshat afër Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në Junik, ndërsa Shkollën Normale në Gjakovë. Ka studiuar Gjuhë dhe letërsi shqipe. Ai njihet më së shumti për poezitë e tij, të cilat janë botuar që nga viti 1961 në shumë vëllime. Ndër to përmendim vëllimet: "Në krahët e shkrepare", "Rini diellore", "Dridhjet e dritës", "Heshtja e kallur", "Ora", "Ikje nga vdekja", "Kosovë, zog i diellit", "Mos vdis kur vdiset" etj. Përveç poezive ka botuar edhe disa proza, kritika letrare dhe një dramë. Din Mehmeti është ndër përfaqësuesit klasikë më të mirënjohur të poezisë së sotme në Kosovë.

Bëhu i blertë si unë,
më tha bari një natë
këndo derisa të vallëzojnë yjet
rreth diellit

si fëmijët rreth zjarrit në tokë
e pastaj dëgjo oshtimën
pa fjalë nër botë

lart do të mbesin kodrat duarthatë
e gurë breg rrugëve në mendime çarë

Këndo derisa të pëlçasësh
si kripa në flakë,
vajto po të duash

kosave të egra s'do të mundesh t'u ikësh kurrë
kur çmenden kohërat në furtun'...

Bari ma tregoi ëndrrën e vet:
- majet më të larta e hëngrën qiellin
e zjarrtë

e shteku i rrezeve kërkon veten në breg...
e bregu bregun pas bregut në breg...

I bukur është vetëm zogu në fluturim
që me puhinë e krahëve të rreshk,
këndo ose vdis pa klithmë...



Studim teksti

Analizojmë poezinë

- 1 Heroi lirik është në një dilemë të vështirë. Si mendoni, cila është ajo?
- 2 Analizoni vargjet: *Këndo derisa të pëlçasësh/si kripa në flakë.*
- 3 Gjeni fjalën që përdoret më shumë në këtë poezi. Si mendoni, përse poeti e përsërit kaq shpesh këtë fjalë?

Interpretojmë tekstin

- 4 Në poezi përmendet një ritual pagan. Identifikoni vargun ku gjendet dhe shpjegoni simbolikën e tij.
- 5 Zbërtheni simbolikën e disa prej fjalëve kyçe të poezisë:
 - Bari _____
 - Fëmija _____
 - Kosat e egra _____
 - Zjarri _____
 - Qielli _____
 - Bregu _____
 - Zogu _____
- 6 Bota e poetit nuk është statike, por në një lëvizje të vazhdueshme. Strofa e parë nis me barin (në tokë) dhe përfundon me yjet (në qiell). Identifikoni dhe shpjegoni lëvizjen në strofat e tjera të poezisë.
- 7 Gjeni sa herë është përdorur në poezi fjala "breg"? Interpretoni shpeshtësinë e përdorimit të kësaj fjale.

Gjuha e poezisë

- 8 Gjeni dy krahasime në këtë poezi dhe shpjegoni domethënien e tyre.
- 9 Shpjegoni çfarë kërkon të thotë poeti me reticencën në fund të *vargjeve*:
kosave të egra s'do të mundesh t'u ikësh kurrë
kur çmenden kohërat në furtun'.
- 10 Gjeni figurat tingëllore në vargjet e kësaj poezie.

Reflektojmë rreth poezisë

- 11 Shpesh thuhet: "Heshtja është flori". Si mendoni, a është kjo gjithmonë e vërtetë? Kur nuk duhet të zgjedhim të heshtim?

Detyrë

- Realizoni një ese me temë: "Kush zgjedh të heshtë, zgjedh të mbetet pa emër".

Sharlota

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani në vargje "Sharlota". Kjo vepër rrëfen jetën e artistes Sharlotë Salomon, e lindur në prag të Luftës së Dytë Botërore, në Berlin, në një familje hebraike.

Kjo vepër rrëfen se si nëpërmjet procesit artistik krijues, individ mund të gjejë vetveten, me pasion, delikatesë dhe vëzhgim të imtësishëm të dhimbjeve të brendshme. Sharlota, në vetminë e saj, e gjen shpëtimin në përjetimin e kujtimeve të jetës së saj të shkuar, në krijimin e një sërë veprash autobiografike (imazhe figurative, fjalë dhe referenca muzikore), të cilat rrëfejnë gjithë historinë e jetës së saj. Nëpërmjet sintetizimit të ndjesive të saj të brendshme në art, ajo shpreh vullnetin për të mbijetuar. Arti e shpëton nga vetmia dhe i jep forcë për të vazhduar përpara.

Fjalor

La Belle Aurore – këtu: hoteli, bujtina ku qëndron heroina e veprës.

Leben? oder Theater? – gjerm.: "Jetë? apo Teatër?"



David Foenkinos

David Foenkinos është një nga shkrimtarët bashkëkohorë më të njohur në Francë. Ai është autor i dhjetëra romaneve, të përkthyer në tridhjetë gjuhë të botës, mes tyre edhe në shqip. Me romanin "Delikatesa", ai u bë një nga autorët më të shitur në Francë. Në vitin 2014, me veprën "Sharlota", Foenkinosi korri shumë sukses me lexuesit dhe me kritikën, duke fituar dy çmime letrare të rëndësishme.

Kur kthehet në "La Belle Aurore", gjithçka ndryshon.

Më shumë se kurrë, Sharlota ndien një ngut të madh.

I duhet të veprojë pa humbur kohë.

Vijat e vizatimeve të saj gjallërohen.

Faqe të shumta kanë vetëm tekst.

I duhet të tregojë historinë e familjes së saj.

Para se të jetë tepër vonë.

Disa vizatime përmbajnë më shumë skica.

Ajo nuk pikturon, por vrapon.

Kjo furi në pjesën e dytë të veprës është tronditëse.

Një krijim në buzë të humnerës.

E ngujuar, e dobësuar, e frikësuar, Sharlota harrohet dhe humb.

Deri në fund.

Në një letër, ajo do të shkruajë këto fjalë si përfundim:

Isha secili nga personazhet e veprës sime.

Mësova t'i shkelja të gjitha shtigjet.

Dhe kështu u bëra vetvetja.

Piktura e fundit të mbërthen me forcën e saj.

Ajo vizaton veten përballë detit.

Me kurriz nga shikuesi.

Mbi trup ajo shkruan: *Leben? oder Theater?*

Me atë mbyllet vepra që ka për subjekt jetën e saj.

Kjo pamje ngjan çuditërisht me një fotografi të Sharlotës.

Aty e sheh duke pikturuar diku në një kodër.

Që ngrihet mbi detin Mesdhe.

Ajo e shikon pa interes objektivin.

A thua se fotografi po vjedh një çast nga soditja e saj.

Nga jeta që bën në harmoni të plotë me natyrën.

Sharlota duket sikur është fije bari mes të tjerave.

E mrekulluar nga ngjyra e qiellit.

Përballë atij ndriçimi, mendja të shkon te fjalët e fundit të Gëtes.

Para se të jepte shpirt, ai nisi të thërriste: – Më shumë dritë!

Për të vdekur nevojitet një dritë verbuese.

Për orë të tëra, ajo rendit gjithë vizatimet.
Lypset të vërë rregull në historinë e jetës së vet.
T'u vërë nga një numër pikturave më të vona.
Ajo shton disa udhëzime muzikore të fundit.
E tërë vepra përmbledhet në tri pako.

Nëse ajo vetë do të marrë arratinë, nëse ajo vetë do të vdesë.
Tani për tani, duhet me çdo kusht që puna e saj të ruhet.
Të vihet në një vend të sigurt.
Sharlota i fut pakot në një valixhe të madhe.
I hedh një sy dhomës për herë të fundit.

Nën tryshninë e një emocioni të veçantë.
Një përzierje gëzimi dhe melankolie.
Kryerja e këtij misioni e shkëputi përkohësisht nga mendimet
e ngulmëta.
Pas kësaj, bota e jashtme shfaqet përsëri.
Ajo është verbuese, pas aq muajsh vetëvëzhgimi.
Papritmas heq dorë nga diçka që i është bërë shprehi.
Nga të këqyrurit e botës së brendshme.
Sharlota përqafohet gjatë me Martën.
E falënderon me gjithë zemër.
Ka ardhur koha të ndahen.
Atëherë ajo nis për në Vilëfranshë-syr-Mer.
Në këmbë, me valixhen e vet.
Kush vallë ta ketë takuar Sharlotën atë ditë?
Duke ecur me veprën e jetës së saj?
Thuajse dy vjet pas konsultës mjekësore, ajo kthehet te
Moridisi.
Këtu, ky është i vetmi njeri tek i cili ka besim.
...
Sharlota i beson, pra, veprën e vet Moridisit.

Romani në vargje

Romani në vargje është një formë e ndërmjetme mes poezisë dhe prozës. Ka shumë diskutime në lidhje me klasifikimin e formës së tij, pasi nuk është një poemë e gjatë e formës së "Iliadës", "Odisesë" etj., dhe as një përmbledhje poemash, por nuk është as një roman i formës së zakonshme.

Romani në vargje është një lloj romani i gjatë, në të cilin rrëfëhet përmes formës së poezisë shumë më tepër sesa po të përdorej proza. Mund të përdoren forma të thjeshta ose të ndërlukuara të vargjeve, por zakonisht ka një plan të gjerë të rrëfimit, zëra të shumtë, dialog, rrëfim, përshkrim, portretizim dhe veprim tipik si në një roman.

Karakteristikat kryesore të romanit në vargje janë: prania e skenave intensive emocionale (përqendrimi në luhatjet emocionale të personazheve), përdorimi i formave poetike (vargje të lira, hapësira boshe, thurje të pazakonta të vargjeve), ndërtimi i veçantë i subjektit.

Disa romane në vargje kanë subjekt të qartë, ku marrëdhëniet janë të shpjeguara si shkak-pasojë, por shumë prej tyre u mungon ai. Përqendrimi në anën emocionale i bën lexuesit të kuptojnë subjektin nga grimca ngjarjesh dhe historish, të cilat i mbledh si në një kolazh. Kjo bën që lexuesi të jetë ndërveprues dhe shumë i përfshirë gjatë leximit të tyre. Rrëfimtari i ofron atij shumë momente të shkëputura, të cilat mund t'i bashkojë.



Dhe ia dedikon gjithashtu.
 Ja tek gjendet para apartamentit të Moridisit.
 I bie ziles.
 Derën ia hap vetë doktori.
 Ah... Sharlota, – thotë ai.
 Ajo nuk përgjigjet.
 E vështron atë.
 Dhe i zgjat valixhen.
 Duke thënë “Kjo është gjithë jeta ime”.
 Në saje të Moridisit, ne e dimë që kështu foli ajo.
KJO ËSHTË GJITHË JETA IME.
 Ç'donte të thoshte ajo saktësisht me këtë frazë?
 Po ju jap një vepër që rrëfen krejt jetën time.
 Apo: Po ju jap një vepër po aq të rëndësishme sa jeta ime?
 Apo edhe: Kjo është tërë jeta ime, sepse jeta ime ka marrë fund.
 Mos vallë kjo do të thotë se ajo do të vdesë së shpejti?
 Kjo është **GJITHË** jeta ime.
 Kjo frazë nuk të shqitet nga mendja.
 Të gjitha mënyrat e interpretimit të saj duken bindëse.
 Moridisi nuk e hap valixhen.
 Ai e vendos diku si diçka të çmuar.
 Madje mund të thuhet: Ai e fsheh atë.
 E bija më tregoi vendin ku vepra është ruajtur.
 Qëndrova pa lëvizur përballë kësaj të kaluarë aq të prekshme.
 Një mallëngjim jashtëzakonisht tronditës.
 Kjo është gjithë jeta ime.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1** Lexoni fragmentin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Çfarë paraqet piktura e fundit e realizuar nga Sharlota? Cilat janë fjalët e fundit që ajo shkruan mbi të?
 - b) Fjalët e cilit shkrimtar i kujtohen rrëfimitarit, teksa e imagjinon Sharlotën, duke punuar mbi veprën e saj të fundit?
 - c) Kush është në qendër të subjektit të veprës së Sharlotës?
 - ç) Në sa pako përmbledhet vepra e saj krijuese?
 - d) Pas sa kohësh u kthye Sharlota te Moridisi? Çfarë profesioni ka ai?
 - dh) Kush ia tregon vendin ku ishin mbajtur dorëshkrimet e Sharlotës rrëfimitarit?

Analizojmë tekstin

- 2** Në këtë pjesë, rrëfimi realizohet:

<input type="checkbox"/> në vetën e parë;	<input type="checkbox"/> nga veta e tretë në vetën e parë;
<input type="checkbox"/> nga veta e parë në vetën e tretë;	<input type="checkbox"/> në vetën e tretë.
<input checked="" type="radio"/> Shpjegoni efektin që krijon kjo mënyrë të rrëfyeri.	

Studim teksti

- 3 Gjeni në tekst ato vargje që tregojnë:
- ▣ gjendjen e tensionuar që po kalon Sharlota;
 - ▣ nxitimin e saj;
 - ▣ shkëputjen nga realiteti përreth;
 - ▣ frikën se mund të mos ketë kohë të kryejë misionin;
 - ▣ pasigurinë për atë që e pret.

Interpretojmë tekstin

- 4 Interpretoni shprehjen: *Kryerja e këtij misioni e shkëputi përkohësisht nga mendimet e ngulmëta*. Cili është ky mision dhe në çfarë mënyre e shpëton Sharlotën ai?
- 5 Rrëfimtari jep disa interpretime të frazës: *Kjo është jeta ime*. Gjejini ato dhe shpjegoni pse janë dhënë në formë pyetjesh.
- 6 Shpesh përdoret fraza: *Jeta është një teatër i madh*. Duke u nisur nga kjo thënie, si e interpretoni titullin që u vendos dorëshkrimeve të saj Sharlota: *Leben? oder Theater? (Jetë? apo Teatër?)*
- 7 Duke u nisur nga vargu i parafundit: *Një mallëngjim jashtëzakonisht tronditës*, si mendoni se ka qenë fati i Sharlotës?

Gjuha e tekstit

- 8 Cilat janë epitetet që përdoren për të karakterizuar gjendjen shpirtërore të Sharlotës gjatë kohës që realizon veprën e saj?
- 9 Në tekst ka raste kur rrëfimtari krijon kontakt të drejtpërdrejtë me lexuesin. Gjejini ato dhe diskutoni mënyrën se si krijohet ky shkurtim distance mes rrëfimtarit dhe lexuesit.
- 10 Në pjesën më të madhe të rasteve, rrëfimi kryhet në kohën e tashme. Çfarë efekti krijon një zgjedhje e tillë?
- 11 Çfarë e karakterizon dialogun mes Sharlotës dhe Moridisit? Çfarë tregon ai për gjendjen shpirtërore të Sharlotës?
- 12 "Sharlota" është roman në vargje. Çfarë elementesh tipike për poezinë dhe çfarë elementesh tipike për prozën, shfaq pjesa e mësipërme?

Elemente të poezisë	
Elemente të prozës	

Reflektojmë rreth tekstit

- 13 Diskutoni rreth gjendjes emocionale të Sharlotës, duke u nisur nga fjalët që ajo shqipton: *Vetëvëzhgimi, të këqyrurit e botës së brendshme*.
- 14 Duke u nisur nga zgjedhja e Sharlotës për të treguar historinë e saj dhe të familjes së saj, misteret, dhimbjet, vuajtjet, gëzimet dëshirat, diskutoni në klasë në lidhje me atë që ju bëni në jetën tuaj. Ju pëlqen të tregoheni të mbyllur apo t'i ndani përvojat tuaja me ndonjë mik?

Detyrë

- ▣ Gjeni dhe sillni/tregoni në klasë libra të tjerë, të cilët rrëfejnë historinë e jetës së njerëzve realë.

Trashëgimia

Para leximit

Drama "Kandili argjandit" e kthen lexuesin në Shqipërinë e viteve '50, në një familje që po kalon një moment të vështirë. Kryetari i familjes, Shtjefni, sapo ka vdekur dhe kjo ngjarje ka shkaktuar një reagim shumë të fortë të pjesëtarëve të familjes. Të gjithë duan të dinë se ku është fshehur ari dhe a do të marrë secili prej tyre pjesën që i takon. Të gjithë drejtojnë sytë nga Leka, djali i vetëm që, me sa duket, s'di asgjë. Ngjarjet zhvillohen në vitet e para të regjimit komunist, në kohën kur pasuria jo për pak familje shqiptare u bë ogur i zi. Grabitja e paligjshme dhe e dhunshme prej pushtetit komunist e pasurisë së vënë ndër breza nga familje të pasura, u bë diçka e ligjshme. Camaj, me një objektivitet të dallueshëm, bën një analizë të hollë të natyrës njerëzore, në një moment specifik, atëherë kur të gjithë tregojnë fytyrën e tyre të vërtetë. Ari është i fshehur para syve të të tjerëve, aty ku nuk i shkon në mend askujt. Vendi ku është fshehur, habit shumë lexuesin dhe ul dramatizmin, duke krijuar entuziazëm.

Fjalor

çakla – rrecka, çikërrima.

turr – vrull.

shtetizue – shtetëzuar: shndërrimi në pronë shtetërore i pronës private.

grishë – ftoj; thërres, e josh.

i bie përfill – këtu: e qëmton, e

hulumton me kujdes, një për një.

bie në qull – humbet në atë që po bën, tregohet i ngathët.

nemë – nëm, mallkoj.

ledhet – baltë; ledhishte.

parzëm – pjesa e gjoksit, ku janë vendosur mushkëritë dhe zemra; kafazi i kraharorit.

nuk më ban as të nxehtë, as të ftohtë

– (shprehje frazeologjike) nuk më bën përshtypje, nuk ndikon tek unë.

i lë hijen – (shprehje frazeologjike)

largohet, papritur, fshehtas e shpejt prej dikujt.

pa i hyrë ferrë në këmbë – pa u dëmtuar aspak, pa kokëçarje.

pajë – plaçkat dhe pasuria që merrte me vete nusja e i çonte në shtëpinë e dhëndrit kur martohej.

dhelapën e lindun – (shprehje frazeologjike) shumë i zgjuar e dinak nga natyra.

i lëshuem zemre – (shprehje frazeologjike) i pikëlluar, i dorëzuar.

hap kuvend – hap bisedë.

shi – mu, pikërisht.

fill e për pe – krejtësisht, tërësisht, me çdo detaj.

shej kohe – shenjë kohe, këtu: çast.

ta lamë – këtu: ta zëmë.

Duka I

Skena e përparshme. Disa mobilje janë të mbulueme me pëlhurë si me i përgatitë të largohen andej.

LEKA: Tue hy i thotë Dorës që vjen nga dera tjetër përballë. Dikush kërkon diçka në dhomën time e kudo ku janë çaklat vetjake të mia. Tmerr! Njeriu e ndien veten të kontrolluëm edhe në shtëpi të vet.

PRENDI: Hyn tue shty karrocën me turr. Dikush ka ndalë dhandrrin tonë te dera, njerëz të Sigurimit. E kanë mbajtë një orë të ndrymë. E kanë pyetë çfarë lyp ai në shtëpinë tonë, si mos me qenë kjo shtëpia jonë, po e atyne: a keni ç'ndëgjoni!

DORA: Kush na siguron se nuk e kanë shtetizue shtëpinë me gjithë rrethinë?

LEKA: Tmerr! Tmerr! Tmerr! Të gjithë flasim vetëm për punët tona të mbrendshme pa sjellë kryet se shka po ndodh përjashta!

SHKRIMTARI: Mend e kemi atje ku e kemi, s'ke shka ban! Nuk ashtë e vërtetë se më kanë arrestue e mbajtë për një orë.

PRENDI: Të kanë marrë nën vrejttje, njisoj ashtë.

SHKRIMTARI: Të kuptohemi! Thashë se Njeriu i Huej më ka grishë në kafe prej të cilit mora vesh se auktoritetet më paskan mue në sy e se unë qenkam i zoti i shtëpisë, jo Leka! Ty, Lekë, të mbajnë tepër të ligshhtë për një përgjegjësi të tillë. Të gjithë shikojnë të shtangun. Natyrisht, nuk i kundërshtova: le të mos u bien punëve tona për fill! Besës E di se bie në qull unë ma parë se Leka, por atë nuk duhet ta gjejë asgjë e ligë: në tallje peshon sa ari!

DORA: Nuk po të kuptoj.

PRENDI: Si nuk kupton? Ky don me e mbrojtë Lekën, i përket familjes, si dreqin s'e kupton (më shtitë në mëkat me nemë!).

SHKRIMTARI: Ky ashtë trashigimtari, Leka e ka në gjak zotësinë e drejtimit e të shpëtimit të familjes. Unë ketë e mbaj si kapidan të një anije tue u mbytë. Mendoj dhe për gruen e... fëmijën. Instinkti, përvoja e tij, ashtë ma e vlefshme se ari i fshehun dikund në gjijet e kësaj



Shënim

Fjala "duka" vjen nga folja "me u dukë" dhe do të thotë "pamje". Në këtë tekst dramatik ka kuptimin "skenë". Camaj i qëndron besnik traditës së shkrimit të dramës, sipas së cilës edhe Fishta i emërtonte skenat "duka".



Martin Camaj

Martin Camaj lindi më 21 korrik 1925 në Temal (Dukagjin) dhe u nda nga jeta në 12 mars 1992, në Gjermani. Ai është autor i përmbledhjeve me poezi: "Një fyell ndër male" (Prishtinë 1953), "Legjenda" (Romë 1964), "Lirika mes dy moteve" (Munih 1967), "Drandja" (Munih 1981), "Palimpsest" (Munih 1991), "Djella: tregim në prozë e në vjershë" (Romë 1958), romanin "Rrathë" (Munih 1978), romanin "Karpa" (Romë 1987), "Shkundullima: vëllim me proza", (Munih 1981), dramën "Loja mbasdrekës" (1981) dhe "Kandili argjandit" (1983) etj. Camaj ka qenë kryeredaktor i revistës "Shejzat" të Koliqit në Romë, atje ku mbrojti dhe doktoraturën. Gjatë jetës së tij, ai ushtroi profesionin e profesorit në universitetin e Munihut dhe dha një kontribut të çmueshëm në fushën e gjuhësisë.

shtëpie ose në rithinë ndoshta edhe në **ledhet** që rrethojnë kopshtin.

LEKA: E mora me mend se nuk rrin pa e hapë kuvendin për arin, mbas hamendjes jo para të gjithëve, po mbanesh vetëm me mue.

PRENDI: Kam mendue keq për ty! Po mirë që jam gabue.

SHKRIMTARI: Kjo **nuk më ban as të nxehtë, as të ftohtë** se ke mendue se sillem këndeje vetëm për zbulim të arit, të marr një pjesë të tij, **pajën** e sime shoqe që nuk ia keni dhanë deri më sot e mandej t'u lamë hijen pa na hy ferrë në kambë. Por Njeriu i Huej aq i pa krypë si e kam mendue, besa, nuk ishte: ai të çmon si ma të urtin në këtë shtëpi, **dhëlpën e lindun**, tha ai.

PRENDI: Edhe mue më dhimbet shtëpia ma tepër se tanë ari i botës! Këto vlera duhen çmue: merre me mend se shka kanë vujejte të parët për këto troje! Qaje Zot të keqen, qaje Zot të keqen! Kësaj here përpara se të filloni të grindeni, po largohem këndeje. Jam kaq i ligësht sa nuk jam ma i zoti ta shtyj vetë karrocën.

DORA: Si ndër shumë raste tjera, Prend kësaj here ma tepër se kurrë jeni të nevojshëm të rrini këtu e t'i ndëgjoni se ç'ka thonë këta dy trima.

PRENDI: *I lëshuem zemre* Kësaj here vetëm Perëndia mund të na ndalë të keqen, të gjithë jemi të pafuqishëm si këto kambët e mia! *I bie koka mbi parzëm.*

SHKRIMTARI: *Lekës* Gabimi im qëndron në pikën se, ndonëse e pashë se je i acaruem, e hapa se e **hapa kuvendin** në këtë drejtim. Shiko, na të dy **shi** në këtë çast duhet të jemi të hapët mes nesh për t'i përballue së bashku vështirësitë.

LEKA: Vështirësitë? Çfarë vështirësish ke ti? A po të rrëzohet ty shtëpia?

SHKRIMTARI: Kadalë, të fillojmë me arsyetue, si thotë latini. Në daç që ta dish fill e për pe kujdesin tim, po ta thom: unë këtu, në këtë **shej kohe**, mproj interesat e time shoqe, sat motër!

DORA: *Shkrimtarit* **Ta lamë** se fshehet një thesar i tillë në trojet e kësaj shtëpie, një pjesë e tij i përket familjes sime.

LEKA: Don me thanë ty pse tina qenke e vetmja trashëgimtare, po qe se familja ime apo im atë janë vjedhës të pasunisë të parëve tu?

DORA: Edhe po t'ishte kështu, unë s'due farë përfitimi ose pjesë në të; kjo pasuni të gjithë neve do të na prishte gjakun e zemrës në marrëdhënie tona e do të sillte vetëm rreziqe.

Fjalor

katua – ahur në katin përdhes,
ku mbahen kafshë dhe prodhime

bujqësore; bodrum; qilar.

mjagullojnë – mjaullinjë.

çart – përçaj, fut grindje.

hise – pjesë.

parrizi – parajsja.

për piri – për shtat.

hallate – vegla a mjete pune.

e tretëm – e hodhëm.

kapelli – pjesa e ngritur përpara, pjesa
ballore.

shtin dreqin në kungull – (shprehje
frazheologjike) është shumë dinak e
mendjehollë.

i lanun – mjeran, i varfër.

i pari lemë – i parëlindur.

Drama

Drama është një lloj i veçantë letrar që qëndron më afër me tragjedinë sesa me komedinë, por ajo nuk synon domosdo një stil të madhërisëm, as përfundim tragjik, domethënë vdekjen e heroit, si zgjidhje të vetme (siç ndodh në tragjedi). Dramat zhvillojnë tension dramatik pa synuar maksimumin e përshkallëzimit negativ, duke ruajtur gjithsesi seriozitetin e duhur. Heroi i dramës është një individ, i cili e ndjen thellësisht vuajtjen dhe lufton me gjithë shpirt për të zgjidhur problemet e mëdha të jetës. Në kohët e hershme, drama shkruhej në vargje, ndërsa në ditët e sotme, ajo shkruhet kryesisht në prozë.

Drama mund të dëgjohet dhe shikohet kur vihet në skenë, ose mund të lexohet si çdo vepër tjetër letrare.

SHKRIMTARI: Vetëm rreziqe, po kuj ia thue këtë?

DORA: Ty, për shembull.

SHKRIMTARI: Me këtë problem, të arit, po due me thanë, nuk jam ballafaque kurr, as teorikisht, po due me thanë, në letërsi. Po tue e ndjekë hollë hollë si përjetim konkret: në një anë familja ime në këto kushte, ari si mjet për të mbetë gjallë e në tjetrën arin tue të vezullue para sysh, ta thomi, në terrin e një **katoit**, bahesh me dalë mendësh. [...]

PRENDI: Andaj mbas çdo lufte ose kolere u lyp prej nesh ari, por jo kurrë në këtë mënyrë brutale si sot. Ata njerëzit e paemën që **mjagullojnë** si maca edhe natën mbi ledhe e mure, s'e kanë pikën e njerëzisë.

DORA: Si çakej, thuej, po mirë që ky metal s'kalbet se do t'i kishin ra shpejt në erë.

SHKRIMTARI: Populli i ka cilësue, populli në emën të cilit flitet: njerëz pa emën, gjysa mashkull e gjysa femën.

[...]

DORA: Mue më acaron grindja juej nësa Njeriu i Huej e kushdi sa e sa tjerë që nuk i shohim, njerëz pa emën ose me dy emna, ndoshta të dy të trilluem, sillen rreth tash për të na **çartë**. Arin lypin të gjithë për vete, dikush në emën të familjes, dikush të popullit. Ku ashtë deh, ky metal më thoni ku ashtë?

SHKRIMTARI: Mirë, po ju vij të dyve te rruga! Ta zamë se Leka vërtet nuk e di se ku ashtë fshehë ari. Por edhe sikur të përpiqeni tanë ditën ta m'a mbushni mendën se ai nuk e beson se ekziston, këtë nuk mundem me e kapërdi. Tash të pyes kështu drejtas, Lekë, e zbulove ti para se të rrexohet shtëpia, a kishe me ia dhanë sat motër **hisen**?

DORA: Unë e njoh ma mirë Lekën: kurrën e kurrës nuk ia ndal hisën së motrës.

Duka V

Në skenë vetëm Katundari, Prendi e Besa

PRENDI: *Përçqafohet me Katundarin* Po çka të pruni ty këtu, bre? Kam kujtue se më ke harrue fare ose të ka gjetë ndoj gjâ e ligë: lavdo Perëndisë! Që qenke gjallë e shëndosh e mirë!

KATUNDARI: *Besës* Erdha me ju vjedhë lulet e kopshtit.

PRENDI: Thuej, erdha me i shpëtue lulet e kopshtit! Nuk di me çka me të nderue or mik i dashtun! A e sheh shka na ka gjetë: as gur mbi gur nuk po mbet. Ndoshta vetëm ti e paske ditë se çfarë kohësh do të vishin: gjithçka po kthehet për së mbrapshti. Unë si njeri i Zotit, si ma kanë ngjitë, kam predikue tanë kohën se **parrizi** nuk ashtë i kësaj jete, erdhën do tjerë e thonë të kundërtën: qe, thonë ata, këtë çka po sheh ti rreth e rreth, ky ashtë parrizi.

KATUNDARI: Ruej gjuhë krye! Rri urtë e mos fol: shaji karrocës se të del ma mirë. Këtu mes nesh a mundemi me folë lirisht? A ashtë kjo nusja që don me i lanë Amanetin e Zotit?

PRENDI: Janë dy!

KATUNDARI: Shtatzanë? Me ty s'e qet kush, edhe **dreqin din me shtie në kungull** e nuk ashtë e para herë, në heshtje e lehtë e lehtë i rregullon punët ashtu si të shkon ty **për piri**. Moj nuse, eja këtu se due me të kallxue diçka që pritet me u ditë prej shumkuj, por jo prej meje njeri të panjoftun e **të lanun** si po më sheh.

PRENDI: Vërtet, prej teje, jo! Ky zotnia nuk ashtë katundar i saktë pse din me përkulë e përpunue çdo lloj metali, tue fillue prej hekurit deri tek argjandi. Ka jetue shumë vjet në Prizrend e atje e nxuni zanatin prej mjeshttrash të zêjes si askund.

KATUNDARI: Për mos me e çue gjatë: në një cak moshe ktheva në katundin tim buzë Lumit që s'po i japim emën, në pension, si i thonë një fjale. Për sy e faqe merrem me kopshtari. Me randësi ashtë të dish, moj nuse, se jam mik i familjes.

PRENDI: Që mos ta çojmë ma gjatë, si thotë ky miku ynë, ky ka ardhë këtu me të kallzue vetëm ty se ku ashtë fshehë ari.

BESA: Tim vëlla, Lekës, atij i përket me ditë se ku ashtë i fshehun... ari! Ai ashtë trashigimtari.

KATUNDARI: Simbas këshillit e si e ka vendosë Prendi, tash për tash ashtë mâ mirë ta dish ti, shi sepse bota kujton se vetëm Leka e ditka fshehësinë si **i pari lemë** që ashtë.

BESA: Atëherë më thoni se ku ashtë pse plasa me ditë.

KATUNDARI: *I avytet karrocës dhe e shkund tue e mbajtë Prendin që mos të rrexohet* Këtu mbrendë gjindet ari... Si? Nuk e ke ditë?

PRENDI: Tanë karroca ime ashtë ari të kulluem.

BESA: Po kjo ashtë karroca e gjyshit! Ku mundet me u fshehë ari në të.

PRENDI: Duket si karroca e gjyshit, e tim et që edhe ai viente prej kësaj sëmundje që kam. Vetëm forma e jashtme, vetëm forma duket ashtu.

KATUNDARI: Sa plasi lufta, erdha këtu me **hallatet** e mia dhe në katu poshtë farkova një karrocë tjetër, këtu ku rro Prendi tash.

PRENDI: Karrocën e vjetër e **tretëm** e mbajtëm këtë të renë, krejt ari pos gozhdave e disa pjesë...

KATUNDARI: ... se shka nuk ashtë ari, lenjau ta gjejnë trashigimtarët. Por po, gypat rreth **kaptellit** të karrocës janë tytë përmbrenda po jo të zbrazët: gypat janë të mbushur me monedha e florina të vjetër e të rinj, simbas kohës e pushtuesit që kaluen kënde.

PRENDI: ... për familje kur bie ngusht për bukë. Karrocën, trungun kryesuer, mos e prekni. U mbetet trashigim breznisë së re.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth brendisë së pjesës së dramës.
 - a) Renditni emrat e personazheve që përmenden në fragment dhe tregoni lidhjen mes tyre.
 - b) Cila është biseda që bëhet më shpesh në familje?
 - c) Kush e di ku fshihet thesari? Pse është në dijëni të këtij informacioni ai?

Analizojmë tekstin

- 2 Cilat janë karakteristikat e arit që përmendet në tekst, që e bëjnë atë të përjetshëm dhe të vështirë për t'u gjetur?

Studim teksti

- 3 Kujt tjetër i tregohet se ku është i fshehur ari? Analizoni arsyet që i tregohet këtij personazhi dhe jo një tjetri.
- 4 Analizoni çfarë efekti ka shkaktuar ekzistenca e arit në marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes, duke u nisur nga fjalët e Dorës: *Kjo pasuni të gjithë neve do të na prishte gjakun e zemrës në marrëdhanye tona e do të sillte vetëm rreziqe.*

Interpretojmë tekstin

- 5 Për Lekën, shtëpia e tyre, të cilën duan ta prishin, është më e rëndësishme se ari. Me ar mund të blihet gjithçka. Çfarë ka kjo shtëpi që nuk e blen dot me ar dhe që e bën kaq të rëndësishme?
- 6 Interpretoni fjalinë e mëposhtme, duke gjetur dhe informacione rreth situatës së krijuar në Shqipëri, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.
Arin lypin të gjithë për vete, dikush në emën të familjes, dikush të popullit.
- 7 Gjeni në tekst dhe interpretoni fjalët e Lekës për rolin e dyfishtë që luan ari në jetën e njerëzve.
- 8 Në vepër ndihet tension i fortë dramatik. Shënoni me ✓ arsyet që e shkaktojnë këtë tension, duke i shpjeguar.
 - Vdekja e Shtjefnit.
 - Përpjekja e shtetit për konfiskimin e pasurisë së një familjeje.
 - Mbikëqyrja që i bën shteti jetës së individëve.
 - Shembja e shtëpisë.
 - Fakti që askush nuk e di ku fshihet ari.
 - Fakti që mund të priset shtëpia dhe ta gjejnë arin njerëz të panjohur.
 - Gjendja e Prendit në karrocë.
 - Dashuria brenda familjes, e Dorës dhe Lekës.
 - Prishja e marrëdhënieve familjare.
 - Shtatzënia e Besës.

Gjuha e tekstit

- 9 Gjeni në tekst krahasimet që përdoren për njerëzit e Sigurimit që duan të rrëmbejnë pasurinë e familjes.
- 10 Gjeni në tekst disa shprehje dialektore dhe kthejini në gjuhën letrare. P.sh.: *aq i pa krypë si e kam mendue, besa, nuk ishte. - Ai nuk është aq i pamend sa e kisha menduar.*

Reflekojmë rreth tekstit

- 11 Në fund të fragmentit, thuhet: *U mbetet trashigim breznisë së re.* Mendoni se brezat kanë përgjegjësi për pasardhësit?
- 12 A mendoni se është aktuale tema që trajton drama? Pse?

Detyrë

- Ktheni pjesën e dytë të fragmentit në prozë, duke rrefyer në vetën e tretë.

Makbeth

Para leximit

Në rrugën e kthimit nga lufta si fitimtarë, Makbethi dhe Bankoja përshëndeten nga tri magjistrice. Ato i profetizojnë Makbethit se do të bëhej than i Kodrit dhe që të nesërmen mbret, ndërsa Bankos që do të bëhej atë mbretërisht. Magjistricat kanë në këtë tragjedi aftësi të mëdha profetike, ndonëse thuhet se nuk është e sigurt nëse profecitë e tyre janë me të vërtetë të paracaktuara për t'u realizuar apo thjesht me fjalët e tyre e nxitin Makbethin të ndërtojë në mënyrë aktive fatin e tij. Fjalët e magjstricave duket se gërvishtin në karakterin e Makbethit atë që deri më tani ai e ruan thellë brenda vetes: etjen e madhe për pushtet, të pashprehur ende në atë formë ekstreme që do të zgjedhë më pas për t'u bërë mbret. Këto ambicie të brendshme, të strukura diku thellë në kufijtë e ndërgjegjes së tij, duket sikur magjistricat i nxitin në formën e parashikimeve, gjë që nuk ndodh te Bankoja, pasi ky nuk i merr seriozisht fjalët e tyre.

Përkthyer nga Fan S. Noli

E TRETA MAGJISTRICË

Gjëmen daull' e një ushtari:
Na vjen Makbethi, kumandari.

TË TRIA

Dor' për dore ziruni,
rreth' e rrotull priruni,
Tok' e det', përpihuni,
Tri her' un' e ti tri herë,
tri mbi to, del nënt 'e prerë.
Dhe u lidh magjia sterrë.
(Hyjnë Makbethi e Bankoja.)

MAKBETHI

Ditë që zbardh e nxin si kjo, s'kam parë.

BANKOJA

Ç'janë këto të fishkura dhe rrobëçjerra,
Që nuk duken ndenjësë të dheut
Megjithëqë banojnë përmbi të?
Të gjalla a jeni vallë?
A rroni vallë? A mund t'ju pyes?
Më dukeni sikur më merrni vesh,
Se përmbi buzët zhubra tuaja
Po vini duart e krasitura.
Duhet të jeni gra, po mjekrat tuaja
Nuk më premëtojnë të besoj.

MAKBETH

Flisni, në mundni; ç'jeni vallë?

E PARA MAGJISTRICË

Gëzuarsh, o Makbeth, o than i Gramsit!



Uilliam Shekspir

Uilliam Shekspir (1564-1616) është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të të gjithë kohërave. Po ashtu edhe dramaturg, poet dhe aktor. Gjatë krijimtarisë së tij, Shekspiri shkroi 37 vepra, nga të cilat 13 tragjedi, 10 drama historike dhe 14 komedi. Pjesa tjetër e krijimtarisë përfshin 154 sonete, që konsiderohen si realizimi poetik më i çmueshëm i gjithë asaj periudhe, si dhe 2 poema të gjata. Ndër veprat e tij më të bukura veçojmë tragjeditë: "Makbeth", "Hamlet", "Otello"; komeditë: "Shumë zhurmë për asgjë", "Nata e dymbëdhjetë"; dramat historike: "Henri IV", "Riçardi II" etj. Shekspiri e ngriti artin dramatik në majat më të larta të letërsisë botërore. Veprat e tij mbeten një pasuri e pashtershme për të gjitha kohërat dhe të admirueshme për çdo brez lexuesish.



Fjalor

than – titull i vjetër skocez, që i përgjigjet titullit të baronit anglez.

E DYTA MAGJISTRICË

Gëzuarsh, o Makbeth, o than i Kodrit!

E TRETA MAGJISTRICË

Gëzuarsh, o Makbeth, që bëhesh nesër mbret!

BANKOJA

V'lla, pse u drodhe? Pse të trembin gjëra

Q'i tingëlljnë veshit aqë bukur?

Për Zotin, jeni vallë pamje fantazie

Apo me trup, siç dukeni të gjalla?

Tim shok bujar këtu e salutoni

Me hir të shpejtëm' e profeti të madhe,

Për zyrë më të lart' e shpresë fronti;

Sa u habit e fluturon prej gazit;

Po mua nuk më flisni. Posa mundki

Të shihni shkoqur farën e së pritmes

E të tregoni ç'mbin e ç'nuk mbin?

Më flisni pra dhe mua, që s'ju lyp,

Favor as druhem nga urrejtja juaj.

E PARA MAGJISTRICË

Gëzuarsh!

E DYTA MAGJISTRICË

Gëzuarsh!

E TRETA MAGJISTRICË

Gëzuarsh!

E PARA MAGJISTRICË

M'i vogël se Makbethi dhe m'i madh.

E DYTA MAGJISTRICË

Jo aq i lumtur, po dhe ca më i lumtur.

E TRETA MAGJISTRICË

Ke për të lindur mbretër, po mbret s'bëhesh.

Gëzuarshi të dy, Makbeth e Banko!

E PARA MAGJISTRICË

Gëzuarshi të dy, Banko dhe Makbeth!

MAKBETHI

Qëndroni, folëse gjysmake, thomëni!

E di, jam than i Gramsit, si të vdes' im atë:

Po qysh i Kodrit? Than' i Kodrit rron

E përparon; dhe, që të bëhem mbret,

S'ka as të ngjar' as e besoj më tepër

Se than i Kodrit. Thomëni, që nga





ma sillni këtë lajmë të çuditshëm?
Dhe pse na ndalët te ky yrt i shkretë,
Me të këtilla salutime profetike?
Ju përgjëroj për Zotin, flisni! (Magjistricat zhduken.)

BANKOJA

Ka fluska dheu, pikërisht si uja.
T'atilla janë. Ku u zhdukën vallë?

MAKBETHI

U shkrinë trupa si firo më n'erë.
Ah, sikur të qëndronin dhe ca pak këtu!

BANKOJA

Këtu, a qenë vall'ato që pamë?
Apo mos kemi ngrënë rrënjë helmi,
që na e turbulluan arësyt?

MAKBETHI

Ke për të lindur mbretër!

BANKOJA

Bëhesh mbret.

MAKBETHI

Dhe than i Kodrit. Apo s'than ashtu?

BANKOJA

Atë avaz e ato fjalë. – Kush po vjen? (Hyjnë Rosi dhe Angusi.)

ROSI

Makbeth, me gaz ka pritur mbreti ynë
Mandatën e sukseseve të tua;
Dhe kur mësoi me ç'trimëri i theve
Rebelët, admiroi e lëvdoi
Fatbardhësinë tënde dhe të tij,
Pa me çudi se ç'bëre në një ditë:
U sule kundër burrave norvegë
pa pasur frikë nga rrezik a vdekja

si breshër dendur, lajmëtarët erdhën
T'i thonë me lëvdat' e brohori
Si ia ke mbrojtur fronin mbretëror.

ANGUSI

Dhe na dërgoi të t'falënderojmë,
përpara tij të të përcjellim vetëm
e jo të të shpaguajmë.

ROSI

Dhe si kapar prej nderesh më të larta
Më porositi të të quaj Than të Kodrit;
Me këtë titull pra të përshëndosh,
I vyer tha! Se tani është' i yti.

BANKOJA

Si? A e thënkërka të vërtetën djalli?
[...]

MAKBETHI

(Me vete) Jam than i Gramsit e jam than i Kodrit:
M'e madhja vjen pastaj. (Rosit dhe Angusit.)

Ju falem nderit!

(Bankos) Ka shpresa pra, t'ju bëhen bijtë mbretër
Pas profetis' së magjesticave,
Se than i Kodrit, siç më than', u bëra.

BANKOJA

N'u thënj besim zotimeve të tyre,
Të kanë për të ndezur kurorën
Pas titullit të Kodrit. Po çudi:
Dhe shpesh, që të na kap' e të na prishë,
Na e thotë të vërtetën djall'i ferrit,
Me profka të pafajshme na fiton
Dhe na përmbys n'avushën më të thellë.



Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Të tria magjesticat e përshëndesin Makbethin, duke iu drejtuar secila me nga një titull të ndryshëm. Shkruani secilin prej tyre dhe shënoni cilin titull ka në të vërtetë Makbethi.

- 2 Çfarë parashikojnë magjesticat për Makbethin? Po për Bankon?

Studim teksti

- 3 Çfarë ka bërë Makbethi që meriton kaq shumë lëvdata nga mbreti?
- 4 Çfarë titulli i ka dhënë mbreti Makbethit?
- 5 Kundër kujt kanë luftuar Makbethi dhe Bankoja?

Analizojmë tekstin

- 6 Makbethi dhe Bankoja u takuan me magjstricat në një *ditë që zbardh e nxin*. Nisur nga këto fjalë, përshkruani paralelizmin mes motit dhe gjendjes së personazheve.
- 7 Përshkruani pamjen e magjstricave duke u nisur nga fjalët e Bankos dhe Makbethit. Çfarë e bën Bankon të dyshojë në përcaktimin e gjinisë së tyre?
- 8 Magjstricat i shprehin Makbethit një profeci për të ardhmen e tij të lavdishme, ndonëse ky nuk ua kërkon një gjë të tillë. Ndryshe nga ai, Bankoja u lutet t'ia thonë këtë gjë. Pse?
- 9 Makbethi përdor togfjalëshin “salutim i profetizuar” për fjalët që i thonë magjstricat. Analizoni mënyrën e veçantë të të shprehurit të magjstricave.

Interpretojmë tekstin

- 10 Interpretoni fjalët e Bankos: *Si? A e thënkërka të vërtetën djalli?* Në cilin moment ai shprehet kështu?
- 11 Interpretoni fjalët e Bankos në fund: *“Dhe shpesh, që të na kap’ e të na prishë, na e thotë të vërtetën djall’i ferrit!”*. Çfarë tregon kjo për këtë personazh?

Gjuha e tekstit

- 12 Gjeni në tekstin e mësipërm dy krahasime të shprehura nga Makbethi dhe Bankoja për të përshkruar largimin e magjstricave. Me çfarë elementesh janë ndërtuar këto krahasime?
- 13 Si e shpreh në mënyrë figurative Rosi, famën e madhe që është përhapur për trimërinë e Makbethit?

Reflektojmë rreth tekstit

- 14 Nëse magjstricat nuk do të kishin profetizuar ato që i thanë Makbethit, a mendoni se do të bëhej Than i Kodrit? Mos vallë ato shërbejnë thjesht si shtysë për kalimin në veprim të Makbethit për të realizuar ato që dëshironte në fshehtësi? Ku duket kjo?
- 15 Duke qenë se magjstricat parashikojnë një profeci që realizohet, mos vallë Shekspiri kërkon të na komunikojë një pyetje të lashtë: Fatet tona janë të paracaktuara, apo e kemi ne në dorë atë që ndodh në jetën tonë?

Detyrë

- Analizoni subjektin dhe personazhet e një tragjedie tjetër të Shekspirit, ku vritet një mbret.

Cili është ndryshimi midis tragjedisë dhe shfaqjes së saj në teatër?

Të flasësh për tragjedinë “Makbeth” dhe shfaqjen e saj në skenën e një teatri, janë dy gjëra të ndryshme, megjithëse ndodh që të përmenden edhe në vend të njëra-tjetrës, duke mos bërë asnjë dallim mes tyre. Sidoqoftë, disa dallime janë të dukshme. Kur flasim për tragjedinë e Shekspirit, i drejtohem teksti të shkruar nga shkrimtari i madh, pra teksti të shkruar në letër. Teksti i tragjedisë shekspiriane është vetëm një dhe i pandryshueshëm. Gjithsesi, shkrimtarët kur shkruajnë një tragjedi, dramë, komedi, vërtet në punën e tyre më të rëndësishme kanë fjalën, por ata mendojnë njëkohësisht edhe për shfaqjen, për atë që do të ndodhë në skenë, si do ta luajnë aktorët, a ka nevojë për muzikë, kostumografinë etj. Në këtë mënyrë, fjalët e shkrimtarit janë të vendosura në një kontekst më të gjerë.

Zakonisht, kur flasim për shfaqjen e “Makbethit”, nënkuptojmë vënien në skenë, në një sërë shfaqjesh, ku secila prej tyre mund të ketë tiparet e veta specifike. “Makbeth” është vënë në Teatrin *Globus*; në skenën e Teatrit të Nju-Jorkut; në Teatrin Kombëtar të Tiranës etj. Natyrisht, një shfaqje teatrale mund ta shohim si në një teatër të madh kombëtar, ashtu edhe në një skenë të improvizuar në mjedisin e një shkolle.



Në leximin e tragjedisë së Shekspirit ndihmon pak ose aspak cilësia e letrës apo kopertina, sepse ato që kanë rëndësi janë vetëm fjalët. Ndërsa në një shfaqje teatrale janë një sërë elementesh që luajnë rol thelbësor. Elemente të tilla janë fjalët që thonë aktorët, loja skenike, plastika, kostumografia, skenografia, ndriçimi i skenës, zëri etj.

Realizimi i shfaqjes

Punën kryesore për realizimin e një shfaqjeje e bën regjisori, para të cilit shtrohen disa detyra dhe pyetje që kërkojnë përgjigje:

1. **Skena:** Sa e madhe është hapësira ku do të luhet shfaqja?
2. **Aktorët:** Personat që do të vënë në skenë pjesën, janë aktorë profesionistë apo amatorë?
3. **Kostumet:** Çfarë veshjesh do të veshin personazhet? A janë të përshtatshme për periudhën historike së cilës i përket pjesa që do të luhet? A u përshtaten karaktereve të personazheve?
4. **Skenografia:** Ç'pamje do të ketë skena? A i krijon spektatorit ndjesinë e "realitetit" ku ndodh ngjarja? A e vendos shfaqjen në një periudhë të veçantë historike?
5. **Ndriçimi:** Në ç'kënd të skenës është e nevojshme errësira? Ku duhet të jetë qendra e vëmendjes, pra cila pjesë e skenës duhet të ketë ndriçimin maksimal? Nga duhet të vijë drita: nga lart, apo nga poshtë? Si ndikon projektimi i dritës gjatë momenteve më dramatike të shfaqjes?

Ashtu si në teatrin e Antikitetit, edhe në atë të periudhës mesjetare dhe më pas të Rilindjes, përdorej kuptimi apo nuanca e fjalës për të përcjellë te spektatori mjedisin dhe kohën e zhvillimit të ngjarjeve. Kjo, sepse gjatë këtyre periudhave, interpretuesit nuk kishin teknologji të përpunuar të efekteve speciale për të krijuar iluzione teatrore. Për shembull, shumica e ngjarjeve në tragjedinë "Makbeth" të Shekspirit ndodhin natën. Mirëpo, asokohe, kjo tragjedi u shfaq fillimisht në një teatër të hapur, në një pasdite të shndritshme, gjithë diell. Natyrshëm lind pyetja: Si e komunikoi Shekspiri faktin që ngjarjet zhvillohen gjatë natës?

Kryesisht duke krijuar skena që të krijojnë menjëherë ndjesinë se gjithçka ndodh natën, vonë.

BANKOJA: O bir, sa është ora vallë?





FLEANCI: Ka perënduar hëna; po s'dëgjova sahatin të trokasë.

BANKOJA: Po hëna perëndon në dymbëdhjetë.

FLEANCI: Pra, do të jetë doemos më vonë.

BANKOJA: Na, mbama shpatën. – Qielli bën kursimë:

E shoi kandilin.

(Hyn Makbethi dhe një shërbëtor me një pishtar)

BANKOJA: Nëm shpatën, bir. **Kush është atje?**

Kush është aty? Personazhet hyjnë me pishtar dhe kjo është njësoj si të thuash është natë. Gjatë shfaqjes, personazhet shpesh pyesin: *Kush është atje?* Në këtë mënyrë krijojmë lehtësisht iluzionin se personazhet nuk mund ta shohin njëri-tjetrin.

I gjithë veprimi në shfaqje zhvillohet përmes **dialogëve** dhe **monologëve**.

Dialogu është formë komunikimi, përmes së cilës personazhet shprehin qëndrimet e tyre. Dialogët janë të gjallë, të tendosur në mënyrë që qëndrimet e personazheve të përfundojnë në kundërthënie të forta.

Të folurit e shkurtër të dialoguesve, nga i cili është ndërtuar dialogu, quhet **replikë**.

Monologu nënkupton shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave të një personazhi duke kuvenduar me vetveten. Përmes monologëve dalin në pah rrëfime personale, meditime të brendshme, shkakut i një ngjarjeje e cila është zhvilluar, por nuk është treguar në dramë.

Në dramën antike, para fillimit të shfaqjes, korifeu, udhëheqësi i korit, u komunikonte shikuesve se ç'do të paraqitej në dramë dhe kohën e zhvillimit të ngjarjeve. Kjo pjesë e dramës është quajtur **prolog**. Fundi i veprës dramatike, ku janë dhënë shpjegime se ç'ka ndodhur në dramë, është quajtur **epilog**.

Lista teatrore ose **afishja** është pjesa ku shënohen emrat e aktorëve që interpretojnë personazhet e dramës, emri i regjisorit dhe i skenografit, kostumografët etj.

Të folurit skenik shoqërohet me **mimikën**, e cila është në harmoni me fjalët që thuhën. Ajo nënkupton çdo lëvizje të muskujve të fytyrës për të shprehur një mendim a ndjenjë, duke u kombinuar edhe me **gjestet** (lëvizjet e duarve, kokës etj.)

Vepra dramatike ndahet në disa pjesë, të cilat quhen **akte**. Përgjithësisht, dramat janë me një ose dy akte, por ka edhe nga ato me pesë a gjashtë akte. Akti është pjesë e një veprë dramatike ose e një shfaqjeje teatrale, që përbëhet nga disa skena dhe që përfshin një veprim të plotë.

Akti mund të ndahet në **skena** (*dukje* ose *pamje*). Nënndarja e një akti të një pjesë teatrale, gjatë së cilës luajnë të njëjtat personazhe, quhet **pamje** ose **skenë**.

Disa skena ose pamje mund të përbëjnë një episod më të madh brenda një akti; një episod i tillë quhet **tablo**.

Studim teksti

- 1 Çfarë kuptojmë kur themi *tragjedia e Shekspirit*?
- 2 Çfarë përfytyrojmë kur themi shfaqja "Makbeth" e Shekspirit?
- 3 Cilat janë elementet më të rëndësishme të një shfaqjeje?
- 4 Diskutoni në lidhje me shprehjen: *Teksti i tragjedisë së Shekspirit është vetëm një dhe i pandryshueshëm*.
- 5 Çfarë përmban afishja?
- 6 I gjithë veprimi në një tekst dramatik zhvillohet nëpërmjet dialogëve dhe monologëve. Po mimika, çfarë roli ka?
- 7 Çfarë mund të ndryshojë nga një shfaqje teatrale në një tjetër?
- 8 Shikoni pamjet e mëposhtme. Në të tria fotografitë paraqitet skena e shtrigave nga tragjedia "Makbeth", por në tri shfaqje të ndryshme. Analizoni ndryshimet në veshje, shprehi, ndriçim të skenës etj.



- 9 Duke u nisur nga pamjet që shihni, si mendoni, në cilën periudhë janë vendosur ngjarjet e tragjedisë "Makbeth".
- 10 Diskutoni në klasë çfarë sjell ndryshimi i kontekstit kohor nga mesjeta në bashkëkohësi i vënies në skenë të kësaj tragjedie.

Shekspiri në teatër dhe Shekspiri në film

Filmi, në mënyrën e organizimit të tij, përdor të gjitha artet e tjera, i bashkon ato në vetvete dhe njëkohësisht qëndron krahas tyre, si art më vete. Disa elemente të letërsisë, teatrit, arteve figurative e muzikës, bëhen pjesë përbërëse të filmit. Këta komponentë nuk janë të vendosur njëri pranë tjetrit, por shkrihen në një sintezë organike për krijimin e një kualiteti të ri artistik, siç është filmi. Kjo është arsyeja që filmin e quajnë një art sintetik. Për krijimin e një veprë kinematografike marrin pjesë shumë krijues, duke filluar nga regjisori, skenaristi, operatori, kompozitori, aktorët etj., për të mos harruar këtu edhe bashkëpunëtorët teknikë dhe ekonomikë. Filmi

Për kalimin nga teksti në film, skenaristit i duhet të përmbushë njërin prej këtyre synimeve kryesore:

- ▣ të ndjekë me përpikëri subjektin e librit, strukturën e tij;
- ▣ në disa raste i duhet të zgjedhë vetëm skenat kyçe;
- ▣ të ruajë të paprekur strukturën bazë të tekstit, subjektin, personazhet, duke shmangur ndërkaq “detajet e panevojshme”, të cilat mund t’i zëvendësojë me situata ose momente të frymëzuara nga libri.

pra, në ndryshim nga artet e tjera, është art kolektiv. Letërsia mund të ushqejë filmin në mënyrë të dyfishtë, nga njëra anë me përvojën e vet artistike, nga ana tjetër me bagazhin konkret të veprave letrare, që mund të shërbejnë si burim i drejtpërdrejtë për krijimin e veprave kinematografike. Për të përfituar nga ky “ushqim”, kineastët duhet të njohin thellësisht letërsinë dhe autorët e saj, stilin dhe individualitetin e tyre.

Teksti letrar në thelb të tij ka fjalën, e cila është mjet gjuhësor, ndërsa filmi përdor mjetet vizuale. Në tekstin letrar, gjithçka realizohet nëpërmjet fjalës, kurse në film, krahas saj janë të rëndësishme edhe shumë elemente të tjera, si: lëvizja, veprimet, gjestet, mimika.



Një ekranizim i mirë kërkon transmetimin e shpirtit të veprës letrare

Tragjedia “Makbeth” është një vepër, të cilën shumë prej nesh kanë pasur mundësi ta shohin jo vetëm si realizim skenik, por edhe kinematografik. Arti i Shekspirit është i jashtëzakonshëm në çdolloj këndvështrimi.

Suksesi shumë i madh i veprës dhe i vënies së saj në skenë, ka nxitur e frymëzuar mjaft regjisorë dhe skenaristë për ta sjellë atë në variantin kinematografik. Përshtatjet filmike të veprës “Makbeth” janë nga më të ndryshmet. Versioni më i fundit është ai i regjisorit Rupert Goold, në vitin 2010. Në këtë film interpretojnë Patrick Stewart (në rolin e Makbethit) dhe Kate Fleetwood (Lejdi Makbeth).



Natyrisht, mes veprës letrare dhe realizimit filmik vihen re lehtësisht një sërë dallimesh, disa prej të cilave përshkruhen më poshtë:

- 1. Koha kur zhvillohen ngjarjet:** Në veprën e Shekspirit, ngjarjet vendosen në fund të viteve 1400 dhe në fillim të 1500-ës, ndërsa në filmin e vitit 2010, gjithçka ndodh në fillim të shekullit XX, rreth viteve 1920. Ndryshimi në kohë sjell ndryshime në të gjitha elementet që përcaktohen nga ky faktor. Sidoqoftë, ky lloj ndryshimi shkakton habi te lexuesit dhe adhuruesit e Shekspirit.
- 2. Vendi ku zhvillohen ngjarjet:** Në veprën “Makbeth”, nisur edhe nga shumë elemente që dëshmojnë për frymën e periudhës mesjetare, ngjarjet ndodhin në Skoci, ndërsa në film (realizimi i vitit 2010), gjithçka ndodh në një vend krejtësisht tjetër, një mjedis relativisht modern, në Rusi. Në këtë mënyrë, ideja që kemi krijuar prej leximit të veprës “Makbeth”, bie ndesh me shumë prej skenave apo situatave të përshkruara në këtë film.
- 3. Vdekja e Makbethit:** Në filmin e vitit 2010, vdekja e Makbethit shfaqet në përmasa gati të minimizuara. Ai është ulur në tryezën e ngrënies, krejt i vetëm, kur Makdafi e sulmon. Një betejë që zhvillohet thajse fshehtëazi, ku nuk arrijmë të shohim me saktësi çfarë ndodh. Për më tepër, Makbethi lufton në një mënyrë krejt të pashpresë. Në fund, Malkolmi merr kokën e prerë.
- 4. Paraqitja e shtrigave (magjistricave):** Skena e shtrigave të “Makbethi” është një nga skenat më të njohura të kësaj tragjedie. Në vepër, ato takohen me Makbethin në pyll ose më saktë në një zonë të shkretë, pa njerëz rreth e qark. Ndërsa në film, shtrigat paraqiten në shtëpinë e Makbethit.

Në veprën e Shekspirit, shtrigat luajnë një rol të rëndësishëm në parashikimin e asaj që do të ndodhë më pas, ndërsa në film ato janë qenie inferiore që përgojnë në hije, me sy të zgurdulluar. Çuditërisht, këtu ato paraqiten me imazhin e infermiereve. Përgjithësisht, në letërsi apo në teatër, infermieret janë personazhe që kujdesen për të tjerët dhe simbolizojnë të mirën, ndërsa në këtë film ato janë nëna e së keqes.

- 5. Fantazmat:** Në tekstin e Shekspirit shfaqen disa fantazma, të cilat ndikojnë jashtëzakonisht në gjendjen e Makbethit. Në tekst shfaqet një fëmijë i përgjakur, një djalë i vogël me një kurorë në kokë. Ndërsa në film ka vetëm trupa të pajetë brenda çantave, të cilët flasin përmes shtrigave. Fantazma e vetme që shfaqet në film është Bankoja, për t’u pasuar nga linja e Mbretërve.
- 6.** Në tekst, kur vritet familja e Makdafi, Makbethi nuk është i pranishëm, ndërsa në film po. Për më tepër, në film, Rosi sheh që ata janë vrarë ndërsa ishin në lojë, kurse në vepër, ai thjesht dëgjon për këtë.



Pavarësisht ndjesive dhe mbresave të veçanta që fal realizimi kinematografik i “Makbethit”, shumë nga lexuesit e kësaj vepre, veçanërisht adhuruesit e Shekspirit, bien dakord për faktin se në film vihen re shumë ndryshime. Aty janë prerë disa pjesë dhe janë shtuar të tjera, çka bën që historia të humbasë deri në njëfarë mase thelbin e saj. Versioni filmik i Rupert Goold-it nuk i përmbahet komplotit kryesor dhe kornizës kohore. Dhe kjo duket qartë që është shmangur

në film. Po kështu, çmenduria dhe etja për pushtet mungojnë ose thjesht janë përvijuar me konture shumë të holla.

Në tërësi, personazhi i Makbethit është minimizuar. Makutërinë e tmerrshme për pushtet, vegimet deri te çmenduria në fund, që personifikojnë aq fuqishëm figurën e Makbethit, nuk i shohim apo ndiejmë në filmin e Rupert Goold-it.

Përherë është diskutuar gjatë lidhur me besnikërinë e një realizimi kinematografik ndaj veprës letrare ku ai mbështetet. Shumë këmbëngulin në bindjen se teksti letrar ka përparësi dhe vlera superiore krahasuar me versionin filmik. Kjo për faktin se në film mungon fryma shpirtërore e letërsisë, mungon gjuha figurative, mungojnë nëntekstet që bart teksti.

Studim teksti

- 1 Çfarë raporti ka filmi me artet e tjera? Po me letërsinë në veçanti?
- 2 Çfarë marrin regjisorët dhe skenaristët nga letërsia?
- 3 Cili është mjeti bazë që përdoret në letërsi, po në film?
- 4 Diskutoni në klasë rreth arsyeve të ekranizimit të teksteve letrare.
- 5 Cilat janë rrugët që zgjedhin profesionistët për të realizuar një film duke u mbështetur në një vepër letrare?
- 6 Po regjisorin Rupert Goold, çfarë mënyrash zgjodhi për realizimin e filmit “Makbeth” në vitin 2010?
- 7 Në ç’kohë dhe ç’vend i vendos ngjarjet Rupert Goold-i në filmin e tij?
- 8 Si mendoni, a janë përherë me vend ndryshimet që i bëhen subjektit apo personazheve të një vepre letrare gjatë realizimit të saj kinematografik? Argumentoni përgjigjen.
- 9 Cili i qëndron më shumë besnik letërsisë: filmi apo teatri? Përse?
- 10 Shikoni filmin dhe diskutoni rreth realizimit të tij. Si mendoni, a ka arritur filmi të ruajë shpirtin e veprës së Shekspirit?

TEKSTI JOLETRAR

Tekstet joletrare kanë përmbajtje reale, pra nuk janë të trilluara, ashtu siç ndodh në të shumtën e rasteve me tekstet letrare. Në to tregohen fakte dhe përshkruhen rrethana apo objekte për qëllime funksionale, që lidhen me fushën e dijes për të cilën bën fjalë teksti.

Këto lloj tekstesh kanë si qëllim:

- *të tregojnë* ngjarje reale që kanë në qendër njerëz realë (kronika, shënime udhëtimi, biografi, intervista, ditarë etj.);
- *të paraqesin* të dhëna dhe informacione (njoftime, zëra nga enciklopeditë, raporte, relacione, fjalorë etj.);
- *të udhëzojnë*, këshillojnë, urdhërojnë për të mbajtur qëndrime të caktuara (udhëzime, urdhra, receta, ligje, rregullore etj.);
- *të argumentojnë* duke mbështetur ose kundërshtuar ide, opinione, fakte (ese, artikuj, fjalime me karakter nga jeta sociale, ekonomike, politike etj.);
- *të përshkruajnë* njerëz, vende, kafshë, objekte (guida turistike, enciklopedi, tekste shkencore etj.).

Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë

Para leximit

Pjesa e mëposhtme është një tekst biografik përkujtimor, që i kushtohet poetes Yllka Domi, e cila në vitin e fundit të gjimnazit, u vra nga forcat e ushtrisë serbe.

Teksti përkujtimor është shkruar nga Blerim Valla, mësuesi i Yllka Domit, në 12-vjetorin e vdekjes së saj.

Asnjë mësimdhënës nuk e paramendon për të gjallë të tij, e as unë, se do ta përjetojë vdekjen e nxënësit apo nxënëses së vet. Aq më larg, se do të marrë pjesë në përcjelljen e fundit për në amshim të ndonjërit prej tyre.

Por ja që në jetë ndodh gjithçka.

Lajmin për vrasjen e ish-nxënëses Yllka Domi, vetëm 17-vjeçare, ma kishin kumtuar shoqet dhe shokët e saj, po ashtu ish-nxënës të mi, menjëherë pas ofensivës së madhe të forcave paramilitare dhe militare serbe në Kodrën e Çabratit, që zgjati prej datës 7 deri më 11 maj të vitit 1999.

Lajmin për këtë e kishte dhënë, menjëherë pas luftës, gazetari i njohur Chris Stephen në gazetën *The New York Times*, pasi kishte vizituar personalisht Gjakovën, menjëherë pas luftës. Stephen, fill pas kthimit në SHBA, në gazetën prestigjioze amerikane kishte botuar dhe poezinë e Yllkës me titull “Kënga e pranverës”. Dhe sot, kur po mbushen 12 vjet nga vrasja barbare e saj, kujtimet më kthejnë para shumë viteve, kur Yllka si nxënëse 10-12-vjeçare vinte me fletoren e saj përplot poezi dhe kërkonte mendimin tim për poezitë e saj, duke insistuar të merrte pjesë edhe në orët e shumta letrare që organizoja në atë kohë në shkollën “Mazllum Këpuska”.

Dhe Yllka, mbesa e shkrimtarit të njohur gjakovar Kasim Domi, poezinë e kishte si ajrin, si jetën, si ujin, si bukën dhe nuk ndalej së shkruari.

Talenti dhe puna e saj e vazhdueshme e kishin bërë atë një poeteshë të pranueshme në qarqet letrare të qytetit, duke u shpërblyer me disa çmime letrare nga klubi letrar “Gj. N. Kazazi”. Por, të gjitha krijimet letrare të Yllkës, bashkë me ditarin e saj, u dogjën bashkë me shtëpinë e saj nga serbët në pranverën e vitit 1999. Ata vranë një vajzë të mitur, por nuk mundën ta vrasin kurrë shpirtin dhe poezinë e saj për dashurinë, lirinë, rininë, atdheun, jetën, vdekjen... Po, edhe

Teksti rrëfyese

Teksti rrëfyese është një lloj shkrimi, në të cilin autori rrëfen duke u bazuar në një ndodhi të vërtetë.

Personazhet janë reale, ashtu sikurse vendet, koha dhe ngjarjet. Në këtë lloj shkrimi përfshihen: intervistat, autobiografitë, biografite, kujtimet, udhëpërshkrimet, mbresat, reportazhet, ditarët, kronikat etj.

Rrëfimi gërshetohet me përshkrimin e hollësishëm, shpjegimin dhe informimin nëpërmjet fakteve.

Fjalitë janë të thjeshta dhe të qarta, me përdorim të kursyer të figurave letrare.

për vdekjen, sepse disi ajo kishte parandjenjë fatin e saj, se do të vdesë, e kjo më së miri del në poezinë e saj të fundit, për së gjallë, “Ti fluturon me dallëndyshet”.

Dhe pas vdekjes, më 2001, ishte po ky emër “Ti fluturon me, dallëndyshet” në krye të përmbledhjes me poezi të Yllkës, botim i “Lidhjes së Gruas Shqiptare të Kosovës”. Amanetin e saj të fundit e kishte lënë mu në këtë libër.

Në vitin 2002, klubi letrar “Gj. N. Kazazi” botoi librin tjetër kushtuar Yllka Domit, me titull “Një yll i pashuar”, i cili përmban mbresa e kujtime nga miqtë dhe të njohurit e

saj, pastaj krijime kushtuar asaj, si dhe disa poezi të pabotuara deri atëherë të Yllkës, të gjitha këto të mbledhura nga shoqja e saj Zana Bakalli, botuar nga klubi letrar “Gj. N. Kazazi”.

Ajo kishte sens për poezi, për aktrim, për vallëzim, recitim, e mbi të gjitha ishte një princeshë e poezisë dhe e bukurisë.

Për nder të saj, grupi letrar në gjimnazin “Hajdar Dushi” të Gjakovës, ku Yllka, deri para vdekjes, vijonte mësimet në vitin e tretë, mban emrin e saj. Për Yllka Domin, si poete shumë e talentuar që premtonte shumë, pastaj si nxënëse dhe aktiviste e shumë fushave të artit dhe të kulturës, për virtytet dhe shëmbëlltyrën e saj, pastaj për familjen e poetes dhe martires Domi, e cila bashkë me prindërit e saj kishin dhënë ndihmesë të madhe për luftëtarët e lirisë në kodrën e Çabratit, në Gjakovë, mund të dëgjosh nga të gjitha anët e qytetit vetëm fjalët më të mira.

Ishte ideja e autorit të këtyre rreshtave, që në shenjë nderimi për këtë poeteshë të re shumë të talentuar, qyteti dhe bota letrare në Gjakovë të themelonin një çmim letrar me emrin e saj, çmim i cili do t’u jepej për çdo vit krijueseve të reja për krijimtarinë e tyre poetike. Kjo iniciativë u mirëprit dhe hasi në mirëkuptim të plotë nga qarqet letrare të Gjakovës, sidomos nga shkrimtari dhe përkthyesi Agim Byci.

Dhe në mitingjet e organizuara deri më tani pas luftës, sikurse është aktiviteti më i madh letrar në Kosovë, Mitingu i Poezisë, që mbahet çdo vit në Gjakovë, ky çmim, në bashkëpunim me klubin letrar “GJ. N. Kazazi” dhe shtëpinë botuese “Fan Noli” nga Gjakova, deri tani iu është ndarë tri poeteshave, Abetare Domit, Gentiana Muhaxherit dhe Xhevahire Izmakut.





Gjakovë, 1998-1999

Yllka iku, por na la vlerat e vërteta prej njeriu dhe prej poeteje. Tek eci majë Çabratit dhe tek shkruaj këtë përkujtim për ish-nxënësen time, më kujtohen vargjet e fundit të shkruara nga Yllka Domi: “Nuk dua përmendore”. Ti Yllka, me veprën tënde, e ngrite përmendoren e lirisë.

(Shkruar nga Blerim Valla, më 9 maj 2011;
marrë me shkurtime nga: www.arkivalajmeve.com)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Si cilësohet që në titull Yllka Domi?
 - b) Kush ia dha autorit lajmin për vrasjen e Yllkës?
 - c) Çfarë kishte botuar në lidhje me Yllkën gazetari Chris Stephen?
 - ç) Si e vlerëson autori krijimtarinë e poetes së re?
 - d) Çfarë ndodhi me krijimet dhe me ditarin e Yllkës?
 - dh) Si titullohen librat e botuar në vitet 2001 dhe 2002? Çfarë përmbajnë ata?
 - e) Cili është qëllimi i themelimit të çmimi letrar që mban emrin e Yllka Domit?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

2 Si e kuptoni fragmentin në vijim?

[...] kujtimet më kthejnë para shumë viteve, kur Yllka si nxënëse 10-12-vjeçare vinte me fletoren e saj përplot poezi dhe kërkonte mendimin tim për poezitë e saj, duke insistuar të merrte pjesë edhe në orët e shumta letrare që organizoja në atë kohë [...] Shënoni me ✓.

- Poetja e ndiqte rregullisht mësimin.
- Yllka kishte talent për të shkruar që në moshë të vogël.
- Ajo nuk kishte interes të dinte se çfarë mendonin të tjerët për poezitë e saj.
- Yllka kërkonte mendimin e mësuesit për poezitë që krijonte.
- Ajo ishte shumë e interesuar për veprimtaritë letrare.

3 Duke u nisur nga titulli i poezisë "Ti fluturon me dallëndyshet" dhe nga vargjet vijuese të shkëputura prej saj, shpjegoni pse autori i këtij teksti biografik përkujtimor shprehet se ajo e kishte parandier fatin e saj?

Do të kërkosh për veten shpëtim.
 E s'do të gjesh kund emrin tim.
 Jetonim ne të dy në gjethe të trëndafililit.
 Jetonim duke shijuar erën e tij,
 Jetonim bashkë me këngën e bilbilit,
 Por në fund na therën gjembat e tij.

4 Çfarë ka vlerësuar më shumë Yllka në jetën e saj? Shprehni këndvështrimin tuaj dhe argumentojeni atë.

Gjuha e tekstit

5 Nënvizoni dhe emërtoni shprehjet e figurshme në tekst.

6 Gjeni fjalë të tjera që janë sinonimike me fjalët e nënvizuara. Evidentoni fjalët e huaja dhe vëreni nëse fjala shqipe me të cilën do t'i zëvendësoni, ia ndryshon kuptimin shprehjes.

menjëherë pas ofensivës së madhe të forcave paramilitare _____
 ma kishin kumtuar shoqet dhe shokët e saj _____
 duke insistuar të merrte pjesë edhe në orët e shumta letrare _____
 Talenti dhe puna e saj e vazhdueshme _____

Reflektojmë rreth tekstit


7 Interpretoni mbylljen e tekstit biografik përkujtimor, duke iu referuar fragmentit:

[...] më kujtohen vargjet e fundit të shkruara nga Yllka Domi: "Nuk dua përmendore". Ti Yllka, me veprën tënde, e ngrite përmendoren e lirisë.

8 Çfarë ndieni për fatin e kësaj vajze dhe të moshatareve të saj që kanë pasur të njëjtin fat?

9 Jepni mesazhe kundër dhunës së luftës dhe pro paqes.

Detyrë

-  Kërkoni dhe lexoni në klasë mbresa dhe kujtime të njerëzve që e kanë njohur Yllka Domin. Identifikoni mesazhet që ata përcjellin dhe interpretoni rëndësinë e tyre.

Udhëtimi në Paris

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga libri autobiografik i Mishel Obamës "Becoming - Të bëhesh", botuar në vitin 2018, në gjuhën angleze dhe në vitin 2019, në gjuhën shqipe. Kjo vepër na shoqëron në një udhëtim nga kuzhinat modeste, te sallat e ballo, nëpër çaste dhimbjesh therëse dhe provash qëndrueshmërie këmbëngulëse. Duke rrëfyer me ndershmëri dhe kurajë, Mishel Obama na vë përpara një sfidë: Cilët jemi në të vërtetë dhe çfarë dëshirojmë të bëhemi?

Fragmenti i mëposhtëm sjell kujtimet nga jeta në fillim të shkollës së mesme dhe nga një udhëtim me klasën në Paris.



Michelle Obama

Michelle Robinson

Obama ka qenë Zonja e Parë e SHBA-së nga viti 2009 deri në vitin 2017. Pas diplomimit në universitetet Princeton dhe Harvard, filloi karrierën si avokate në Çikago, në studion *Sidley & Austin*, ku takoi edhe burrin e saj të ardhshëm, Barack Obama-n. Në vijim, gjithnjë në Çikago, punoi në zyrën e kryebashkiakut, në universitet dhe në spitalin e të njëjtit institucion. Ndërkaq themeloi seksionin lokal të *Public Allies*-it, një organizatë jofitimprurëse në ndihmë të formimit të të rinjve për karrierë në sektorin publik.

Dëftesa me notat e semestrit të parë të shkollës doli me rezultate shumë të mira, po kështu edhe ajo e semestrit të dytë. Përgjatë vitit të parë dhe të dytë të shkollës, nisa të fitoja vetëbesimin që kisha edhe në *Bryn Mawr*. Me çdo arritje të vogël dhe çdo dreqosje që arrija të shmangia, dyshimet m'u zhdukën dalëngadalë. Më pëlqenin thujtë të gjithë mësuesit. Nuk kisha frikë të ngrija dorën në klasë. Në *Whitney Young* nuk ishte e rrezikshme të ishe e zgjuar. Supozohej që të gjithë po studionin fort që të shkonin në kolegji, gjë që përkthehej se kurrë nuk duhej ta fshihje inteligjencën, nga frika se mos dikush të akuzonte se flisje si një gocë e bardhë.

Më pëlqente shumë çdo lëndë që kishte të bënte me të shkruarit dhe haja veten me dhëmbë në algjebër e trigonometri. Nuk isha e shkëlqyer në frëngjisht. Kisha shokë e shoqe klase që ishin gjithnjë një hap para meje, që i arrinin rezultatet pa ndonjë përpjekje të madhe në dukje, por mundohesha që ky fakt të mos më vinte përfund. Po filloja të kuptoja se, nëse studioja disa orë më shumë, shpesh dallimi mes nesh zhdukej. Nuk isha nxënëse me të gjitha dhjeta, por përpiquesha gjithnjë dhe në semestra të caktuar pothuaj dilja me të gjitha dhjeta. Ndërkohë Krejgu ishte regjistruar në Universitetin Princeton, duke lënë zbrazët dhomën e tij në *Euclid Avenue*, duke lënë në përditshmërinë tonë një boshllëk prej një metër e tetëdhjetë e nëntë centimetrash dhe nëntëdhjetë kilesh. Frigoriferi nuk ishte kurrësi më aq dëng me mish e qumësht dhe linja e telefonit nuk zihej më nga vargu i vajzave që prisnin radhën për të bërë muhabet me të. Disa universitete të mëdha ishin përpjekur t'i ofronin bursë studimi dhe gjithë popullaritetin e një ylli basketbolli, por me inkurajimin e prindërve të mi, ai zgjodhi Princetonin, që kushtonte më shumë, por që në këndvështrimin e tyre ishte dhe më premtues. Im atë nuk mbahej nga gëzimi kur Krejgu, në vitin e parë të universitetit, hyri si fillestar në skuadrën e basketbollit të Princetonit. Me këmbët që i dridheshin dhe ndihmën e dy patericave, e bënte shend e verë gjithë atë rrugë me makinë. Kur arrinte të merrte ndonjë ditë pushim nga puna në impiantin e filtrimit, udhëtonte dymbëdhjetë orë rresht



përmes shteteve të Indianas, Ohajos, Pensilvanisë dhe Nju-Xhersit për të parë një nga ndeshjet e Krejgut.

Për shkak të rrugës së gjatë deri në *Whitney Young*, i shihja më pak prindërit. Tani që e kthej kokën prapa, mendoj se duhet të ketë qenë periudhë vetmitare për ta, ose periudhë që kërkonte një lloj përshtatjeje. Isha më shumë e ikur sesa në shtëpi. E lodhur nga qëndrimi në këmbë gjatë gjithë rrugës nëntëdhjetëminutëshe në autobus, së bashku me Terri Xhonsonin zbuluam një marifet: praktikisht, duhej të dilnim nga shtëpia pesëmbëdhjetë minuta më herët në mëngjes dhe të kapnim autobusin me drejtim komplet të kundërt me shkollën. Zbrisnim disa stacione më tutje në një lagje jo aq të populluar, kapërcenim rrugën dhe hipnim në autobusin e linjës me drejtim nga veriu, i cili ishte goxha më i lirshëm sesa ai ku hipnim zakonisht. Të kënaqur nga dinakëria jonë, zinim një vend dhe llotisnim apo bënim detyra gjatë gjithë rrugës për në shkollë.

Mbrëmjeve kthehesha e dërrmuar në derën e shtëpisë rreth orës gjashtë apo shtatë, në kohë për një darkë të shpejtë dhe një mundësi për të shkëmbyer dy fjalë me prindërit, për çfarë kishte bërë vaki atë ditë. Por me të mbaruar larja e enëve, zhytesha në detyrat e shtëpisë, shpesh duke marrë librat te qoshja poshtë shkallëve ku gjendeshin enciklopeditë, përbri apartamentit të Robit dhe Territ, ku gjeja privatësi dhe qetësi.

Prindërit nuk folën kurrë as edhe një fjalë për stresin e pagesave të kolegjit, por unë e kuptoja se ishte i pranishëm. Kur mësuesja e frëngjishtes deklaroi se do të ishte udhëheqësja e një udhëtimi të mundshëm me klasën në Paris, gjatë pushimeve të vitit, për ata që

Autobiografia

Autobiografia është jetëshkrimi i një njeriu, i hartuar nga ai vetë. Ndodhitë personale rrëfohen në vetën e parë, sipas këndvështrimit personal. Autori gjithashtu bën vetëprezantimin e historisë së tij duke përzgjedhur detajet dhe faktet që do të paraqesë në të. Kjo do të thotë që autori ka një qëndrim të lirë, vetëgjykes dhe subjektiv ndaj ngjarjeve dhe njerëzve të përfshirë. Përdoret kryesisht koha e tashme, por edhe kohët e shkuara për të rëfyer ndodhi dhe kujtime të së shkuarës. Ndryshimi mes autobiografisë dhe biografisë është se te kjo e dyta, autori rrëfen për dikë tjetër.

mund ta përballonin financiarisht një të tillë, as e mora mundimin t'ua thosha atyre të shtëpisë.

Kisha një shtëpi të rregullt e plot dashuri, biletën e autobusit për t'i rënë mes përmes qytetit për të shkuar në shkollë, si dhe një pjatë të ngrohtë kur mbërrija në mbrëmje vonë. Përtej kësaj, nuk kisha ndër mend t'u kërkoja prindërve as gjënë më të vogël.

Megjithatë, një mbrëmje prindërit më ulën, me një shprehje habie në fytyrë. Ime më e kishte marrë vesh për udhëtimin e Francës nëpërmjet mamasë së Territ.

– Pse nuk na the? – më pyeti ajo.

– Sepse kushton shumë.

– Në fakt, nuk të takon ty ta vendosësh, Mishel, – më tha im atë butësisht, gati i fyer. – Dhe si paske arritur në këtë përfundim kur ne nuk dimë gjë prej gjëje?

I pashë të dy, pa ditur ç't'u përgjigjesha. Mamaja më hodhi një vështrim të butë. Im atë kishte ndërruar uniformën e punës dhe kishte veshur një këmishë të bardhë e të kollarisur. Ata sapo kishin kaluar të dyzetat asokohe, martuar prej gati njëzet vjetësh. Asnjëri prej tyre s'kishte shkuar ndonjëherë me pushime në Evropë. Nuk shkonin kurrë në plazh apo për ndonjë darkë jashtë. Nuk kishin blerë as shtëpi. Ne ishim investimi i tyre, unë dhe Krejgu. Çdo gjë shkonte për ne.

Disa muaj më vonë, fluturova në Paris me mësuesen dhe rreth një duzinë shokësh e shoqesh klase të *Whitney Young*-ut. Qëndruam në një hostel, bëmë turin e Luvrit dhe të kullës Eifel. Blinim *crepes au fromage* nëpër kioskat e rrugëve dhe ecnim përgjatë brigjeve të Sienës. Flisnim frëngjisht ashtu si mund të flasim një tufë gjimnazistësh nga Çikagoja, por ama të paktën flisnim frëngjisht. Ndërsa aeroplani largohej nga pista atë ditë, shihja jashtë dritares në drejtim të aeroportit, e bindur se ime më ishte aty, diku, pas xhamave të zinj, e veshur me pallton e dimrit duke më përshëndetur me dorë. Më kujtohet se si motorët morën vrull me zhurmë shokuese. Dhe pastaj se si, me rrapëllimë, nisëm të bënim përpara në pistë dhe avioni mori për lart, ndërsa shpejtësia më pushtoi kraharorin dhe më shtyu pas ndenjësës, përgjatë atij çasti të çuditshëm, të ndërmjetëm dhe gjysmak, që vjen përpara se të ndihesh krejtësisht i lartësuar.

(Marrë me shkurtime nga libri i Michelle Robinson Obama-s, “*Becoming – Të bëhesh*”, përkthyer nga Ledia Agolli, *Shtëpia Botuese Dudaj, Tiranë, 2019*)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe shënoni ✓ në kutizën përbri secilit pohim që lidhet me përmbajtjen e tij.
- Autorja përcakton me saktësi vendet ku zhvillohen ngjarjet.
 - Rrëfimi i autores përfshin fakte dhe ngjarje të vërteta nga jeta e saj.
 - Autorja rrëfen kujtimet nga fillimi i shkollës së mesme dhe nga një udhëtim në Paris.
 - Rrëfimi i autores përmban argumente.
 - Rrëfëhet në vetën e parë dhe autorja është pjesëmarrëse në ngjarje.
 - Autorja përshkruan lidhjen e fortë që ka pasur me familjen.
 - Autorja rrëfen në kohën e ardhme.

Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni dy karakteristika të tekstit rrëfyes që dalloni në këtë rrëfim.
- 3 Shpjegoni kuptimin e frazës së mëposhtme dhe realitetin që paraqet ajo.
- 4 Analizoni pjesën e mëposhtme. Çfarë kuptoni prej saj?

...nga frika se mos dikush të akuzonte se flisje si një gocë e bardhë.

Kisha një shtëpi të rregullt e plot dashuri, biletën e autobusit për t'i rënë mes përmes qytetit për të shkuar në shkollë, si dhe një pjatë të ngrohtë kur mbërrija në mbrëmje vonë. Përtej kësaj, nuk kisha ndër mend t'u kërkoja prindërve as gjënë më të vogël.

Gjuha e tekstit

- 5 Zbërtheni nëntekstin e titullit të librit prej të cilit është shkëputur fragmenti i mësipërm. Si është ndërtuar ai nga ana gjuhësore?
- 6 Në çfarë kohe janë përgjithësisht foljet e kësaj pjese? Pse ndodh kjo?
- 7 Nënvizoni pesë shprehje të figurshme në këtë fragment dhe shpjegoni qëllimin e përdorimit të tyre.

Reflektojmë rreth tekstit

- 8 Duke u nisur nga teksti që lexuat dhe nga citimi i mëposhtëm prej parathënies së librit, diskutoni si ndikojnë ngjarjet e së shkuarës në jetën tonë.

Por njoh mirë veten time. Im atë, Fraser-i, më pati mësuar të punoj fort, të qesh shpesh dhe ta mbaj fjalën. Ime ëmë, Marian-a, më pati mësuar si të mendoj me kokën time dhe si ta përdor zërin tim.


Detyrë

- Gjeni informacione rreth ish-Zonjës së Parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mishel Obama. Shkruani vetëm ato informacione që ju bëjnë përshtypje dhe shpjegoni përse.

Homeri i Shqipërisë

Para leximit

Ishte viti 1921, kur deputeti francez, Zhystin Godart, u nis për të zbuluar Shqipërinë. Baroni D'Esturnel dhe Konstan, fitues i Nobelit për Paqen, i kishte kërkuar që ta zëvendësonte në një mision në Shqipëri. Pas kësaj, Godarti e vizitoi Shqipërinë edhe në vitet 1922, 1923, 1937 dhe 1951. Gjatë udhëtimeve në viset shqiptare, ai mbajti shënime të shumta në ditarët vetjakë. Pjesët e mëposhtme janë shkëputur nga këta ditarë dhe rrëfejnë përshtypjet e tij gjatë dy takimeve me At Gjergj Fishtën; njërin në Shkodër, kur vizitoi për herë të parë Shqipërinë dhe tjetrin në Paris, kur Fishta ndodhej atje për një vizitë.



Justin Godart

Justin Godart (1871-1965) është cilësuar një nga figurat e veçanta të Republikës së Tretë në Francë, si mendimtar i lirë, laik dhe humanist. Avokat, doktor në Drejtësi, por edhe anëtar i Akademisë Kombëtare të Mjekësisë, Doktor Honoris Causa i Universitetit Columbia të Nju-Jorkut, deputet, senator i Rhône-Alpes (1927-1940) etj. Veprimtaria e tij, kryesisht ajo që lidhet me mbrojtjen e Shqipërisë, është bërë e njohur në viset shqiptare qysh në vitet '20 e më tej në artikuj dhe punime të tjera të botuara.

Udhëtimi i vitit 1921

31 mars, e enjte

Dje ishte ditë udhëtimi.

Lamë Tiranën në orën 9 dhe morëm rrugën për në Shkodër... Pas darke erdhën të më shohin eprori i françeskanëve dhe At Gjergj Fishta! "Homeri i Shqipërisë" është madhështor në forcë dhe në inteligjencë. Biseda u kthye shpejt te shqetësimi i përgjithshëm. Ky vend, ose do të bashkohet, ose do të përçahet nga dasitë fetare. Për At Fishtën, ndryshimi mes krahinave të ndryshme nuk u detyrohet besimeve fetare, por kulturës së ndryshme që u kanë dhënë atyre fetë... Por, sipas tij, kjo gjë do të zhduket brenda dy brezave...

Dhjetor 1921

At Fishta ndodhej në Paris në datat 20-23 dhjetor

Erdhi të më bëjë vizitë At Gjergj Fishta.

Unë e prita me gëzim françeskanin truplidhur, i cili prillin e shkuar, në qelën e kuvendit të tij në Shkodër, në Shqipëri, më kishte paraqitur një program të tërë për marrëdhëniet intelektuale që duhet të vendoseshin midis Francës dhe Atdheut të tij. At Gjergj Fishta është poet, por është edhe një burrë veprimi. Me poezitë e tij fisnike dhe të forta, të cilat shumë shpejt u bënë klasike, ai ka folur për mizoritë, vuajtjet dhe shpresat e Shqipërisë dhe ka ngritur lart shpirtin për pavarësi të bashkëkombësve të tij. Ai jep mësim, boton shkrime tepër të vlefshme mbi këngët popullore të Malësisë, është deputet në Parlament dhe tani është duke punuar që të ngrihet një shkollë e mesme franceze në Shkodër. Për këtë projekt të fundit, At Gjergj Fishta ka nevojë për ndihmë. Unë e kundërshtova duke i thënë: "Po si doni ju që të bëhet kjo me gjithë ato që ndodhin te ju. Ja, pra, shihni se çfarë shkruhet në këta artikuj që kam shkëputur nga të gjitha gazetat tona..."

"Rrena, rrena, – përsëriste At Gjergj Fishta i indinjuar dhe i fyer. – Gjithnjë, pra, do të shpifin për vendin tonë aq burrëror dhe aq fatkeq... Si t'ia bëjmë që pranojmë të na gjykojnë sipas fakteve të shpikura, vetëm me qëllim që të na dëmtojnë?"



Dhe kë, neve që duam paqen e që ëndërrojmë vetëm të merremi me punën tonë të organizimit të një shteti modern! Kur do të na trajtojnë me drejtësi?”

Fatmirësisht munda ta qetësoj At Gjergj Fishtën...

(Marrë me shkurtime nga libri i Justin Godart-it, “Ditarët shqiptarë: shënimet e udhëtimeve nga marsi 1921 deri në dhjetor 1951”, përkthyer nga Asti Papa, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë, 2008)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Pasi të lexoni pjesët e shkëputura nga ditari, përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Për çfarë takimi bën fjalë pjesa e parë e ditarit?
 - b) Si e cilëson deputeti francez At Gjergj Fishtën?
 - c) Cila është tema e bisedës së tyre? Çfarë mendon Fishta në lidhje me të?
 - ç) Për çfarë takimi bën fjalë pjesa e dytë e ditarit?
 - d) Cili është qëllimi i vizitës që Fishta i bën Godartit në Paris?
 - dh) Për çfarë debatojnë ata gjatë këtij takimi?
 - e) Cila është pyetja që ngre Fishta? Çfarë e shtyn atë të bëjë këtë pyetje?

Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni në pjesët e shkëputura nga ditari ato fjali ku:
 - ▣ jepen detaje udhëtimi;
 - ▣ përshkruhet Fishta dhe veprimtaria e tij;
 - ▣ jepet informacion për tematikën e poezive të tij;
 - ▣ parashikohet se ç’do të ndodhë pas dy brezash;
 - ▣ përshkruhet atdhetarizmi i Fishtës.

Gjuha e tekstit

- 3 Analizoni këto veçori gjuhësore të këtij teksti:
 - ▣ llojet e fjalive më të përdorura;
 - ▣ kohën më të përdorur të foljeve.

Reflektojmë rreth tekstit

- 4 Godarti e cilëson Fishtën “Homeri i Shqipërisë”. Sipas jush, pse?
- 5 Si e kuptoni fjalinë e mëposhtme? A lidhet ajo me realitetin e sotëm?
 - ▣ *Për At Fishtën, ndryshimi mes krahinave të ndryshme nuk u detyrohet besimeve fetare, por kulturës së ndryshme që u kanë dhënë atyre fetë...*
- 6 Shkruani tri ide, të cilat ju mbeten në mendje pas leximit të këtij ditarit. Diskutoni në grup rreth tyre dhe vlerësoni arsyetimet e njëri-tjetrit.

Detyrë

- ▣ Shkruani një fletë ditari rreth një takimi që mund të keni pasur me drejtorin e shkollës suaj ose me një përfaqësues të pushtetit vendor në lidhje me një çështje që ju shqetëson.

Tung, babë!

Para leximit

Ish-kapiteni i Romës, Françesko Toti, i dedikoi një letër prekëse babait të ndarë nga jeta prej infektimit me Covid-19. Ikona e futbollit italian shkruan se “10 ditët e fundit kanë qenë më të tmerrshmet e jetës së tij”. Në fund, ish-numri 10, legjendar i klubit verdhekuq, i uron “udhëtim të mbarë” babait Enco.

Enco Toti, i cili njihet me pseudonimin “Sherifi”, e mbështeti të birin gjatë gjithë jetës së tij duke e ndjekur në çdo takim.



Tung, babë!

Kam kaluar 10 ditët më të vështira të jetës sime, duke e ditur që ishe aty “i vetëm”, në luftë me të keqen, pa pasur mundësi të të shihja, të të flisja, të të përqafoja dhe të të shtrëngoja. Do të bëja gjithçka vetëm që të mundesha të qëndroja pranë teje. Tani jeta ime nuk do të jetë si më parë. U rrita me vlera të rëndësishme, për të cilat dua të të falënderoj, dua të të falënderoj për gjithçka që ke bërë për mua, që më bërë një burrë të fortë dhe guximtar. Do të të dua gjithnjë baba im! Sa do të doja të dëgjoja sërish zërin tënd, më ka marrë malli për shakatë tona, për buzëqeshjen tënde, për

sytë e tu, për qëndrimin tënd në divan duke parë televizor. Duhet të të them më fal dhe faleminderit... Më fal për çdo herë që nuk të kam kuptuar, për të gjitha herët që nuk të kam thënë se të dua shumë, më fal për përqaftimet e munguara, për fjalët e pathëna, për gabimet që kam bërë, por mbi të gjitha, faleminderit që ishe babai im dhe që nuk do të reshtësh kurrë së qeni. Pa ty, nuk do t’ia kisha dalë kurrë mbanë dhe, megjithëse nuk je më me ne, kujtimi dhe buzëqeshja jote nuk do të harrohen kurrë!

Kishe shumë miq që të donin, sepse ti kishe diçka ndryshe, ishe gjithnjë i pranishëm, gjithnjë i gjindshëm, ishe miku i të gjithëve, ishe dhe je krenaria ime (shpresoj të kem qenë edhe unë e jotja). Sot më shumë se kurrë kam kuptuar se sa i rëndësishëm ke qenë në jetën time, ndaj në vitet që do të vijnë, do t’i mbaj në zemër këto kujtime të vjera.

Tung, babë... ose më mirë... tung, sherif... rrugëtim të mbarë!

Françeskoja yt

(Marrë nga: <https://www.lastampa.it>; <https://sport.alpenews.al>)

Letra personale

Letra personale është një tekst shprehës, që i jep mundësi dërguesit të komunikojë me marrësin, i cili është dikush që e njeh mirë: një mik, një i afërm, një koleg etj. Kjo lloj letre zakonisht shkruhet për të dhënë lajme të reja, për të shprehur ndjenjat, për të falënderuar, për të kërkuar falje, për të kujtuar ngjarje etj., duke përdorur një gjuhë të thjeshtë, të drejtpërdrejtë dhe jozyrtare.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve në tabelën e mëposhtme.

Ç'lloj është letra e mësipërme?	Kush e ka shkruar letrën?	Kujt i drejtohet?	Me çfarë qëllimi është shkruar?

Analizojmë tekstin

- 2 Pse Toti shprehet se ka kaluar 10 ditët më të vështira të jetës së tij? Në ç'rrethana është ndodhur ai?
- 3 Përse shërben falja që Françesko Toti i kërkon babait? Çfarë kuptojmë prej saj?
- 4 Analizoni mesazhin që përcillet në vijim.

Sot më shumë se kurrë kam kuptuar se sa i rëndësishëm ke qenë në jetën time, ndaj në vitet që do të vijmë, do t'i mbaj në zemër këto kujtime të vyera.

Gjuha e tekstit

- 5 Gjeni në tekst fjalët e shprehjet që përcjellin ndjenjat e dashurisë dhe të mirënjohjes së Françesko Totit ndaj babait që nuk është më.
- 6 Gjeni në tekst fjalët dhe shprehjet që përcjellin vlerësimin e tij për të atin, duke e konsideruar si model në jetë.

Reflektojmë rreth tekstit

- 7 Kujtoni tiparet e letrës zyrtare. Krahasojini ato me tiparet e letrës personale.
- 8 Si e keni përjetuar situatën e krijuar prej pandemisë së shkaktuar nga infektimi me COVID-19? Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje gjatë kësaj kohe?

Detyrë

- Shkruani një letër personale për babanë tuaj.
- Shkruani një letër zyrtare për drejtorin e shkollës, në të cilën të shprehni një propozim konkret për lehtësimin e procesit mësimor gjatë kësaj periudhe.

Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar

Para leximit

Intervista e mëposhtme është realizuar me themeluesin e një rrjeti të suksesshëm të shkollave shqipe në Zvicër, Vaxhid Sejdiu, në kuadër të një cikli intervistash me mësues shqiptarë në diasporë, të cilët kanë dhënë një kontribut të veçantë në përhapjen dhe ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës shqiptare dhe forcimit të lidhjeve të komunitetit shqiptar në vendin ku ndodhen.



Vaxhid Sejdiu

Vaxhid Sejdiu lindi në vitin 1961, në Kumanovë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Studimet universitare i ndoqi në Fakultetin Filozofik (sot Fakulteti Filologjik) të Prishtinës – Dega e Letërsisë dhe e Gjuhës Shqipe, ku u diplomua shkëlqyeshëm në vitin 1985. Aty kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mori titullin “Doktor i Shkencave Filologjike”. Që nga themelimi i shoqatës “Motrat Qiriazit” (e cila më vonë u shkri në Lidhjen e Arsimitarëve Shqiptarë të Kantonit të St. Gallen-it), ai ka dhënë pa ndërprerje një kontribut të çmueshëm në organizimin e mësimit plotësues në gjuhën shqipe dhe në organizimin e aktiviteteve me bashkatdhetarë.

Cila është historia juaj, e largimit nga vendlindja, dhe si ndikoi te ju ky ndryshim?

Në fund të viteve ‘90, ish-Jugosllavia kishte filluar të rrënohej në të katër anët. Sa më shumë rritej rezistenca kombëtare shqiptare, aq më shumë tërbohej klasa politike jugosllave. Strukturat e shtetit projektonin dhe zbatonin në pikë të ditës ligje dhe veprime antishqiptare. Në një ambient të këtillë, çdo gjë shqiptare ishte halë në sy për sistemin jugosllav dhe, mbi të gjitha, shkolla, gjuha dhe kultura shqiptare. Arsimi shqip, edhe pse tepër i kufizuar, ishte vënë nën kontroll policor. I madh ishte numri i nxënësve dhe studentëve, duke filluar nga shkollat fillore dhe deri në universitet, që privoheshin nga e drejta e shkollimit në gjuhën amtare. Numri i klasave në gjuhën shqipe ishte i kufizuar dhe fëmijët shqiptarë ishin të detyruar të mësonin edhe në gjuhën sllavo-maqedonase në Shkup, Veles, Prilep, Krushevë, Manastir etj. Në shkollat e mesme, mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën sllavo-maqedonase. Ata që përfundonin shkollimin, në pamundësi për t’u punësuar në vendlindje, e shihnin rrugën e mërgimit si e vetmja zgjidhje. Një gjë të tillë e përjetova edhe unë. Familja ime, ashtu sikurse pjesa më e madhe e familjeve shqiptare, ishte “e dërrmuar” ekonomikisht, nuk qëndronte më në këmbë, dhe e vetmja zgjidhje ishte mërgimi, edhe pse ishte rruga më e padëshiruar.

A qe e lehtë përfshirja në komunitetin shqiptar atje?

Zvicra në fillim të viteve ‘90 ishte bërë destinacioni më i preferuar për shqiptarët që jetonin nën pushtimin jugosllav, të cilët të përballur me sistemin e egër politik, kërkonin njëfarë shpëtimi jashtë vendlindjes. Prandaj edhe përfshirja ime në komunitetin shqiptar në Zvicër ishte pjesë e aktivitetit, sepse kishte shumë nevojë dhe ekzistonte një numër i madh i shoqatave shqiptare.



Si ishin të organizuar atëherë shqiptarët dhe, a ka ndryshuar ky organizim sot?

Tani, dallimi mes atyre viteve të vrullshme në shërbim të lirisë dhe kohës së sotme është shumë i madh. Një pjesë e madhe e shoqatave nuk funksionojnë më. Por, edhe aktiviteti i mërgimtarëve në shërbim kombëtar nuk është më siç ishte dikur.

Si është lidhja juaj me gjuhën amtare dhe si ka ndryshuar kjo lidhje për shkak të emigrimit?

Asnjëherë nuk më ka vajtur mendja se unë do të largohem nga vendlindja dhe në anën tjetër tërë jetën do të punoj sikur në vendlindje, në profesionin tim shumë të dashur – mësues i gjuhës shqipe, në një ambient shkollor shumë të modernizuar siç është Zvicra dhe me një numër kaq të madh nxënësish. T'ju them të drejtën, më se dy dekada jetoj si në vendlindje, si në Kosovë, si në Shqipëri, mu në mes të Zvicrës. A ka kënaqësi më të madhe se çdo ditë të jesh i rrethuar me fëmijë shqiptarë, të cilët dëshirojnë ta mësojnë gjuhën amtare, edhe pse të lindur në vend të huaj?

Ju keni mbi 20 vjet angazhim në mësimdhënie në diasporë. Si ka qenë kjo përvojë e juaja? Si ka ndryshuar ndër vite interesi i emigrantëve shqiptarë atje për të mësuar shqip?

Po, e vërtetë, ka më se dy dekada që zhvilloj një punë aktive jo vetëm në procesin mësimor, por edhe në organizimin dhe riorganizimin e shkollave shqipe. Një angazhim plus ky, shumë i vështirë, sepse organizimi i shkollave të reja kërkon edhe kohën e vet. Lirisht mund të themi se për të hapur një pikë shkollore nevojiten 3-4 muaj aktivitet, ku përfshihen takimet me prindër, takime të veçanta, por edhe me grupe të caktuara, mbledhje prindërore e kështu me radhë. Por, në këtë rrugëtim jam tepër mirënjohës ndaj bashkëveprimtarëve: mësuesve dhe prindërve shqiptarë, të cilët më kanë mbështetur në këto nisma. Fakt është se prindërit, të cilët janë të interesuar që fëmijëve të tyre t'ua ruajnë gjuhën amtare, nuk mungojnë. Por çështja është se sa i madh është numri i atyre që regjistrohen. Natyrisht, ne synojmë që të përfshijmë sa më shumë nxënës, me qëllim që pastaj ndarjen në grupe ta kemi sa më të lehtë. Synojmë ndarjen e nxënësve së paku në 3 nivele apo 3 grupe, sepse kështu cilësia e

Intervista

Me **intervistë** kuptojmë komunikimin mes një njeriu që konsiderohet i rëndësishëm ose interesant dhe një gazetari që ka si qëllim të informojë publikun ose të reklamojë diçka tek ai.

Intervista synon të njohë mendimet, qëndrimet, perceptimet, përvojat dhe karakteristikat e të intervistuarit. Intervista mund të jetë:

e strukturuar, gjysmë e strukturuar, e lirë.

- a) INTERVISTA E STRUKTURUAR** përbëhet nga pyetje të parapërgatitura që vendosen sipas një rendi logjik. Ajo mund të ngjasojë me një pyetësor të cilit i përgjigjesh me zë, por gjatë kryerjes së saj, ndryshe nga pyetësi, bashkëbiseduesit ndodhen përballë njëri-tjetrit.
- b) INTERVISTA GJYSMË E STRUKTURUAR:** pyetjet e intervistuesit janë të hapura dhe qëllimi i tij është të hetojë sa më shumë që të jetë e mundur një ngjarje, një situatë, një fakt. Renditja e pyetjeve nuk është e ngurtë, si në rastin e intervistës së strukturuar, por ndjek rrjedhën e bisedës, duke iu përshtatur përgjigjeve. Kjo intervistë është më e lirshme dhe origjinale.
- c) INTERVISTA E LIRË:** intervistuesi nuk ka pyetje të parapërgatitura por vetëm një sërë temash, të cilat do të përqendrojnë intervistën.

mësimi është më e lartë. Brezi i parë i mërgimtarëve shqiptarë ka qenë shumë i interesuar që fëmijët e tyre të ndjekin mësimin në gjuhën amtare, ta ruajnë gjuhën amtare. Ndoshta ishte një periudhë ku përpjekjet për liri e mbanin më lart dëshirën për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Brezi i dytë më duket më i papërgatitur për këtë mision. Por, nëse edhe me brezin e dytë nuk punohet sa duhet dhe si duhet, jam i bindur se gjërat do të ndryshojnë për keq. Në kushtet që ne punojmë, nuk mjafton të jesh vetëm mësues, por duhet të jesh edhe veprimtar i shkollës shqipe, të kesh kontakte të vazhdueshme me prindërit, sepse brezat ndërrohen dhe numri i nxënësve mund të bjerë. Unë po ju them me përgjegjësi, aty ku është hapur një pikë shkollore dhe ka qëlluar një mësues i mirëpërgatitur për këtë lloj mësimi dhe është arritur të formohet një këshill prindëror i përgjegjshëm, mësimi në gjuhën shqipe nuk është ndalur asnjëherë. Janë me dhjetëra shembuj, si: shkollat shqipe në Flums, në Mels, në Buchs etj.

Si e keni ndërtuar marrëdhënien tuaj me nxënësit e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Zvicër?

Marrëdhënia ime me nxënësit e gjuhës dhe kulturës shqiptare është një marrëdhënie e veçantë, e një mësuesi që ka përkushtimin jo vetëm me pjesën mësimore, por edhe me edukimin kombëtar, sepse këta fëmijë lindin dhe rriten në vend të huaj. Pra, mësimi i gjuhës amtare i shoqëruar me rregullat, saktësinë, respektin dhe të gjitha format e mirësjelljes, janë njëra anë e medaljes, por unë gjatë këtyre viteve jam munduar që të nxit në shpirtin e tyre të njomë atdhedashurinë. Pra, nëpërmjet njësive mësimore jam munduar t'ua bëj më të qartë se kush janë ata dhe si duhet të integrohen në shoqërinë zvicerane, kurse nëpërmjet aktiviteteve të lira ua kam bërë më të qarta rregullat se si ruhet gjuha dhe kultura shqiptare. Një integrim i mirë pa dyshim është shumë i dobishëm, njohja e gjuhëve të huaja është vlerë shumë e lartë, por mbi të gjitha, pa njohjen e gjuhës amtare nuk mund të arsyetohet asnjë hap. Nëpërmjet njësive mësimore jam munduar t'i njoftoj nxënësit e mi me historinë e popullit shqiptar, gjeografinë shqiptare, përpjekjet e brezave në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës kombëtare, sepse gjuha dhe kultura shqiptare janë vlerë botërore. Jam munduar t'ua dëshmoj nëpërmjet fakteve se, pa marrë parasysh nga vijnë dhe çfarë pasaportash kanë, ata në rend të parë janë shqiptarë dhe atdheu i tyre është Shqipëria. Jam munduar nëpërmjet fakteve, që në të ardhmen e tyre gjatë shkollimit, temat e prezantimit në klasë, në shkollën zvicerane, të marrin edhe nga gjuha dhe kultura shqiptare, sepse shpalosim çka kemi. Ne nuk duhet të turpërohemi nga gjuha dhe kultura jonë, por duhet me bindje ta promovojmë atë.

Përse e këshilloni mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare për të rinjtë atje?

Përvoja më ka dhënë gjithmonë të drejtë, sepse ato këshilla që ua kam thënë nxënësve të mi para 20 e sa viteve, sot ua thonë edhe kolegët e mi zviceranë. Ata në mbledhjet prindërore vazhdimisht ua tërheqin vërejtjen prindërve shqiptarë që t'i dërgojnë fëmijët në shkollën shqipe dhe ta mësojnë gjuhën amtare. Edhe pedagogët zviceranë e përsëritin vazhdimisht qëndrimin e tyre që prindërit t'i orientojnë fëmijët në mësimin e gjuhës amtare. Pastaj, pa njohjen e gjuhës amtare, fëmijët në atdhe ndihen si të huaj, nuk mund të merren vesh as me anëtarët e familjes. Dhe një fakt i këtu është një plagë më shumë në jetën e mërgimtarit shqiptar. Të jesh shqiptar, por pa gjuhë amtare, është e rëndë dhe nuk përjetohet lehtë. Prandaj, në këtë drejtim duhet të gjithë të punojmë bashkërisht.

Diku, ju shpreheni se mësimdhënia është një det përvojash. Çfarë vlere ka marrë profesioni juaj në diasporë?

Tani, profesioni im është begatuar me një përvojë të jashtëzakonshme profesionale, i frymëzuar nga një sistem shkollor i avancuar, në të cilin përdoren metodat dhe mjetet e punës më moderne në arsim. Puna me grupe apo me nivele është përvojë më vete. Krahasimi mes orëve mësimore në gjuhën shqipe dhe orëve në shkollën e vendit duhet të ketë një drejtpeshim. Në klasat e mia kam prindër dhe nxënës nga të gjitha trojet shqiptare, që në familje flasin të folme të ndryshme, por që në klasë flasin rrjedhshëm gjuhën letrare shqipe. Kjo “Shqipëri etnike” më jep shpresë se gjuha dhe kultura shqiptare në diasporë do të ngrihet në nivelin e dëshiruar.

Një fjalë të fundit për bashkatdhetarët...

Një fjalë të fundit për mësuesit-kolegët...

“Shkolla Shqipe” është e të gjithëve, prandaj po e përsëris thirrjen që ua kam drejtuar të gjithë mësuesve, të cilët janë në Zvicër: Ejani, ta bëjmë shkollën shqipe temë të përditshme, sepse fëmijët shqiptarë ashtu siç kanë nevojë për bukën, ujin, mësimin në gjuhën gjermane, frënge apo italiane, kanë nevojë edhe për mësimin në gjuhën shqipe.

Një porosi për prindërit – bashkatdhetarët...

Prindërve apo bashkatdhetarëve të mi, me të cilët ndajmë “bukën e hidhur të kurbetit”, u drejtohem me fjalët e dijetarit shqiptar Sami Frashëri: “Shenja e kombit është gjuha, kur një komb e humb gjuhën, ai humb edhe veten”. Prandaj, orientoni fëmijët tuaj drejt gjuhës dhe shkollës shqipe, sepse emrat e tyre të bukur: Flamur, Shqiprinë, Durim, Qëndrim, Gëzim, Besë, Krenare, Vlorë, Berat, Shkodran, Milot, Sarandë, Krutan, Kosovare, Iliridë, Shqipe etj., nuk kanë kuptim pa njohjen e gjuhës shqipe.

(Marrë me shkurtime nga: <http://qbd.gov.al>)

Kuptojmë tekstin

- 1 Pasi të keni lexuar intervistën, përgjigjuni pyetjeve.
 - a) Çfarë e detyroi mësuesin shqiptar në diasporë të emigronte?
 - b) Si u përfshi mësuesi në komunitetin shqiptar në Zvicër?
 - c) Si e përshkruan mësuesi angazhimin në mësimdhënie dhe më tej, në themelimin e shkollave shqipe në diasporë?
 - ç) Mësuesi i ndan mërgimtarët shqiptarë në dy breza. Ky qëndron dallimi mes brezit të parë dhe të dytë të mërgimtarëve shqiptarë?
 - d) Çfarë synon mësuesi gjatë punës së tij me nxënësit e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Zvicër?
 - dh) Përse e këshillon ai mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare?
 - e) Cila është thirrja që ai u drejton mësuesve që jetojnë në Zvicër?
 - ë) Po porosia për prindërit bashkatdhetarë?

Analizojmë tekstin

- 2 Intervista e mësipërme është:
 - e strukturuar;
 - gjysmë e strukturuar;
 - me strukturë të lirë.
- 3 Çfarë përcjell mësuesi nëpërmjet pyetjes retorike vijuese?
 - A ka kënaqësi më të madhe se çdo ditë të jesh i rrethuar me fëmijë shqiptarë, të cilët dëshirojnë ta mësojnë gjuhën amtare, edhe pse të lindur në vend të huaj?
- 4 Mësuesi shprehet se gjuha dhe kultura shqiptare janë vlerë botërore. Si ua ka dëshmuar ai nxënësve këtë fakt?
- 5 Analizoni pjesën e mëposhtme të njërës prej përgjigjeve të mësuesit. Shpjegoni përdorimin e thonjzave.
 - Kjo "Shqipëri etnike" më jep shpresë se gjuha dhe kultura shqiptare në diasporë do të ngrihet në nivelin e dëshiruar.

Gjuha e tekstit

- 6 Shpjegoni me fjalë të tjera kuptimin e secilës prej shprehjeve të mëposhtme:
 - zbatonin në pikë të ditës ligje dhe veprime antishqiptare
 - çdo gjë shqiptare ishte halë në sy për sistemin jugosllav
 - të përballur me sistemin e egër politik
 - jam munduar që të nxit në shpirtin e tyre të njomë atdhedashurinë
 - është një plagë më shumë në jetën e mërgimtarit

Reflektojmë rreth tekstit

- 7 Diskutoni rreth realitetit që përshkruan pjesa e përgjigjes së mëposhtme të mësuesit.
 - Numri i klasave në gjuhën shqipe ishte i kufizuar dhe fëmijët shqiptarë ishin të detyruar të mësonin edhe në gjuhën sllavo-maqedonase në Shkup, Veles, Prilep, Krushevë, Manastir etj. Në shkollat e mesme, mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën sllavo-maqedonase. Ata që përfundonin shkollimin, në pamundësi për t'u punësuar në vendlindje, e shihnin rrugën e mërgimit si e vetmja zgjidhje.

Studim teksti

- 8 A keni dëgjuar nga të afërmit tuaj në diasporë rreth mësimit të gjuhës shqipe? Diskutoni rreth këtyre përvojave.
- 9 Çfarë e karakterizon mbylljen e kësaj interviste?
- ▣ Arrin në një konkluzion për problemet e gjuhës shqipe në diasporë.
 - ▣ E lë mendimin e mësuesit të nënkuptuar.
 - ▣ Bën një thirrje dhe jep një këshillë.
 - * Argumentoni zgjedhjen tuaj.

Detyrë

- ▣ Mendoni cilin personalitet do të dëshironit të intervistonit. Përgatitni pyetjet e intervistës për të dhe përpunoni ta kontaktoni për të marrë përgjigjet e tyre.

Shkruajmë

Si të bëjmë një intervistë?

- ✿ Përcaktoni temën e intervistës suaj. Në varësi të saj, ajo do të marrë formë. Nëse intervista juaj është personale (drejtuar miqve dhe të njohurve tuaj), ajo do të jetë joformale dhe e lirshme. Nëse ju bëni një intervistë pune, atëherë ajo do të jetë formale.
- ✿ Zgjidhni një personazh të përshtatshëm për temën tuaj.
- ✿ Hartoni pyetjet. Në mënyrë që të kryeni një intervistë të suksesshme, duhet të mblidhni informacione nga burime të ndryshme për personazhin dhe për temën e intervistës suaj.
- ✿ Organizoni intervistën. Lidhuni me të intervistuarin për të caktuar kohën dhe vendin ku do të kryhet intervista. Për të realizuar intervistën, zgjidhni një vend të qetë, të përshtatshëm dhe siguroni mjetet për ta regjistruar atë.
- ✿ Kur bëni pyetjet, tregoni durim dhe respekt ndërkohë që prisni përgjigje. Jepini kohë të intervistuarit për t'u menduar, kështu do të keni mundësi që të merrni përgjigjet më të arrira. Dëgjoni me shumë vëmendje atë që thotë i intervistuari, në mënyrë që t'i drejtoni edhe pyetje të paparashikuara, të cilat lindin nga situata. Nëse përgjigjet nuk janë të qarta, pyesni menjëherë për shpjegime apo qartësime. Gjithmonë në fund të intervistës, falënderoni personin.
- ✿ Shkruajeni intervistën duke paraqitur me përpikëri faktet, pyetjet dhe përgjigjet. Për ta bërë sa më tërheqëse intervistën, vendosni edhe fotografi, që mund t'i realizoni gjatë procesit. Mund të shkruani edhe një hyrje interesante me mendimet dhe përshtypjet tuaja më të spikatura rreth intervistës dhe të intervistuarit.
- ✿ Rishikoni shkrimin tuaj nga ana kuptimore, leksikore, gramatikore dhe drejtshkrimore.



Bibliotekat më të bukura në botë

Para leximit

Bibliotekat gjithnjë janë konsideruar si një vend strehimi, ku mund të gjesh vetveten gjatë leximit të rreshtave, por dhe ta rizbulosh atë në një sërë dimensionesh.

Kur gjendemi në kontakt me librin, na mjafton prania e tij, izolimi nga zhurma e jetës së vrullshme.

Bibliotekat e mëposhtme janë konsideruar ndër më të bukurat në botë. Provoni të imagjinoni se çfarë ndjesie do të përjetonit brenda mureve të këtyre bibliotekave, teksa do të mbanit në duar një libër të mirë.

Biblioteka dhe Muzeu “The Morgan”, Nju-Jork, SHBA

“The Morgan”, që gjendet në zemër të Nju-Jorkut, përfshin një bibliotekë, një muze, salla shfaqjesh dhe është njëkohësisht shtëpia e koleksionit privat të librave të financierit J.P. Morgan. Ajo është gjithashtu shtëpia e një koleksioni të madh shtypshkrimesh që datojnë para vitit 1500, me autorë artistë evropianë, si: Leonardo, Mikelanxhelo dhe Rembrandi. Në raftet e bronza të bibliotekës gjenden dorëshkrimet origjinale të Valter Skotit dhe Honore de Balzakut.



Teksti informues-paraqitës

Teksti informues-paraqitës është një tekst që paraqet informacione, data dhe lajme, duke i shpjeguar në mënyrë të qartë dhe korrekte. Çdo paragraf i tij përmban informacione të reja dhe shpesh shoqërohet me ilustrime grafike, si: fotografi, skica, harta, grafikë etj. Informacioni përcillet te lexuesi në forma të ndryshme komunikimi, si nëpërmjet mediave të shkruara dhe atyre televizive, enciklopedive, artikujve, gazetave etj. Tekste shpjeguese-informuese janë artikujt, njoftimet, broshurat, fletëpalosjet, vërtetimet, kërkesat, raportet vjetore, procesverbalet, letrat zyrtare, ftesat, shpalljet, telegramet, etiketat etj. Në këtë lloj teksti përdoret gjuha standarde, si dhe fjalë teknike, sipas fushës për të cilën bën fjalë teksti. Nuk përdoret gjuha figurative.

Biblioteka e Shtutgartit, Gjermani

Moderne, minimaliste dhe estetikisht e këndshme – këto janë vetëm disa fjalë për të përshkruar bibliotekën e qytetit të Shtutgartit. Biblioteka është hapur në vitin 2011 dhe i ngjan një piramide të përmbysur. Me hapësirën e hapur dhe shkallët që lidhin bibliotekën shumëkatëshe, ofron një vend unik për të lexuar.



Biblioteka e Manastirit Strahov, Pragë, Çeki

E ndërtuar në vitin 1679, Biblioteka e Manastirit Strahov luajti një rol të rëndësishëm në historinë çeke dhe është “shtëpia” e mijëra shtypshkrimeve të realizuara midis shekujve XVI dhe XVIII. Po ashtu, është e njohur për afresket biblike që “të lënë pa frymë”. Biblioteka ka dy salla: sallën teologjike dhe sallën filozofike, të cilat janë të gjitha të dekoruara me elemente të praruara.

Biblioteka e abacisë Admont, Austri

Biblioteka e abacisë Admont është një nga manastiret më të vjetra dhe më të mëdha në botë. Është shtëpia e 70 000 mijë vëllimeve. Ambientet e brendshme janë zbukuruar me afreske dhe skulptura nga dy artistë të mëdhenj të periudhës baroke, Bartolomeo Altomonte dhe Xhozef Stamel.





Biblioteka Tianjin Binhai, Kinë

E quajtur si “Syri” për shkak të sferës në mes të bibliotekës, si dhe pamjes së saj unike nga jashtë që i ngjan një syri gjigant, kjo bibliotekë me pesë nivele është projektuar nga arkitektë holandezë. Ajo është shtëpia e 200 000 mijë librave.

Biblioteka Publike e Stokholmit, Suedi

Projektuar nga arkitekti i njohur suedez, Gunar Asplund, dhe themeluar në vitin 1928, Biblioteka Publike e Stokholmit është ikona më e njohur e qytetit, për strukturën e saj cilindrike. Biblioteka publike është gjithashtu e para në Suedi me raftet e hapura, që u jep vizitorëve lirinë e qasjes pa ndihmën e stafit, një koncept ky i frymëzuar nga bibliotekat amerikane.





Biblioteka e Kolegjit *Trinity* Dublin, Irlandë

Me raftet e saj prej druri të errët dhe tavanin e lartë të harkuar, kjo bibliotekë mahnitëse është edhe më e madhja në Irlandë. Ajo është shtëpia e 200 000 mijë librave të vjetër, si dhe e objekteve historike e dorëshkrimeve, si Libri i Kellsit, një dorëshkrim i ilustruar bukur që përmban katër ungjijtë në latinisht, i cili besohet se është krijuar në vitin 800 pas Krishtit.

Biblioteka e Aleksandrisë, Egjipt

Biblioteka e Aleksandrisë dikur konsiderohej një nga bibliotekat më të mëdha dhe më domethënëse të botës antike. Ajo ka hapësirë për tetë milionë libra dhe përbëhet edhe nga një qendër konferencash, katër muze, katër galeri arti, 15 ekspozita të përhershme, një planetar dhe një laborator për restaurimin e dorëshkrimeve.



Biblioteka Vasconcelos, Meksikë

Njihet gjithashtu si një megabibliotekë. Ajo ka një dizajn unik me rafta të vendosura në mënyrë asimetrike dhe mure transparente. Të krijon idenë e një mjedisi me elemente fantastike, të cilat përforcohen nga instalacioni i Gabriel Orozco-s, që është skeleti i një balene që qëndron mbi sallën qendrore të bibliotekës. Biblioteka është projektuar nga arkitektët meksikanë Alberto Kalach dhe Juan Palomar.

Biblioteka e Universitetit të Artit Tama, Japoni

Kjo bibliotekë njihet si një arritje arkitekturore për konceptin e saj. Është ndërtuar në vitin 2007 dhe, që atëherë, dizajni i saj modern mbetet i përjetshëm, me harqe prej betoni, mure qelqi dhe mobilie minimaliste.



(Marrë me shkurtime nga: <https://www.kultplus.com>)


Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Për çfarë informon ky tekst?
 - b) Në cilën prej bibliotekave gjenden librat e koleksionit privat të një financieri?
 - c) Cila bibliotekë është hapur në vitin 2011?
 - ç) Cila nga bibliotekat konsiderohet një arritje arkitekturore?
 - d) Në cilën prej bibliotekave muret janë transparente?
 - dh) Cilat janë dy sallat e Bibliotekës së Manastirit Strahov?

Analizojmë tekstin

- 2 Teksti i mësipërm shoqërohet me fotografi. Për çfarë ju ndihmojnë ato?
- 3 Rendit disa nga format gjeometrike që janë përdorur në dizajnin e këtyre bibliotekave. Çfarë tregojnë ato për projektuesit e tyre?
- 4 Biblioteka e Aleksandrisë ka hapësirë për tetë milionë libra. Çfarë kuptoni nga kjo e dhënë statistikore?
- 5 Në sa kontinente gjenden bibliotekat e këtij teksti?

Gjuha e tekstit

- 6 Cilat janë cilësitë e gjuhës së këtyre teksteve? Shënoni me  alternativat e sakta.
 - E hollësishme.
 - E thjeshtë.
 - E figurshme.
 - Me shifra.
 - Objektive.
 - Subjektive.
 - E qartë.
 - E ndërlikuar.

Reflektojmë rreth tekstit

- 7 Cilën prej këtyre bibliotekave do të donit të vizitonit? Pse?
- 8 Si mendoni, përse janë quajtur "më të bukurat në botë", bibliotekat e këtij teksti?

Detyrë

-  Mblidhni informacione të tjera për bibliotekën që ju pëlqeu më shumë. Prezantojini ato në klasë.

Bëni një fletëpalosje për bibliotekën më të afërt me vendbanimin tuaj.

Fletëpalosja është një fletë e madhe e shtypur dhe e palosur, ku jepen njoftime të ndryshme, botohen materiale me figura a me fotografi për ngjarje të ndryshme. Ajo jep një informacion të përbledhur dhe të shoqëruar me imazhe për çështjen në fjalë. Fletëpalosja shpërndahet në mënyra të ndryshme përmes gazetave, me postë, dorazi etj.

Një fletëpalosje shkruhet për të bërë publicitet, për të reklamuar një produkt, për të tërhequr vëmendje për një informacion të rëndësishëm apo për një ngjarje që do të organizohet së shpejti.

Brenda një fletëpalosjeje gjejmë titullin, nëntitujt, sloganin, qëllimin, ilustrimet e fotografitë, si dhe informacion për kontaktet e organizatorëve. Vendet ku ndodhen këto elemente përcaktojnë strukturën e fletëpalosjes.

Hapat për shkrimin e një fletëpalosjeje

- ❑ **Mendoni.** Duhet ta keni të qartë strategjinë, qëllimet dhe objektivat në lidhje me atë që doni të arrini. Për këtë duhet të mendoni, të mblidhni dhe të kërkonti ide edhe nga të tjerët.
- ❑ **Bëni një plan.** Plani jua lehtëson shkrimin e fletëpalosjes. Në këtë plan, duhet të shkruani se çfarë përmbajtjeje do të ketë fletëpalosja para se të filloni ta shkruani atë. Gjatë bërjes së këtij plani, duhet të përcaktoni çështjet ose idetë që do të shpalosni në fletëpalosje. Shprehini sa më thjeshtë idetë tuaja.
- ❑ **Shkruani.** Kur të jeni gati për ta hedhur në letër planin, përqendrohuni dhe shkruani në një skedë pikat e planit tuaj që lidhen me strategjinë, qëllimet, objektivat.
- ❑ Mos mendoni se varianti i parë i kësaj fletëpalosjeje do të jetë i përsosur. Mos u shqetësoni, ai do të rishikohet disa herë. Shkruajeni variantin e parë sipas strukturës që keni krijuar. Bëhuni kritik i vetes, kërkonti dhe konsultohuni me miq e kolegë. Shkruani variantin final pas konsultimeve.
- ❑ **Kontrolloni** faktet që keni paraqitur, fjalët kyçe që keni përdorur, qartësinë dhe saktësinë e tyre. Konsultohuni me një profesionist të fushës për të cilën po përgatitni fletëpalosjen.
- ❑ **Ideoni paraqitjen grafike.** Përdorni imazhe, skica, fotografi etj., për ta bërë më të lexueshme dhe më tërheqëse.



Veshjet popullore

Para leximit

Veshjet popullore janë pasuri e rëndësishme e popullit dhe e kulturës sonë tradicionale. Ato janë pjesë e identitetit kombëtar, të përcjella ndër breza, prej ilirëve deri në ditët tona. Veshjet popullore shqiptare janë të larmishme dhe ndryshojnë nga njëra krahinë në tjetrën. Sipas studiuesve, kjo larmishmëri ekziston falë fantazisë dhe talentit të artizanëve në shekuj. Teksti i mëposhtëm na njeh me disa veçori të kësaj trashëgimie materiale prej paraardhësve tanë.

Veshjet popullore janë pa dyshim një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës tradicionale. Ato përcjellin shumë elemente, që vijnë nga lashtësia dhe nga koha e mesme, por janë njëkohësisht edhe shprehje e marrëdhënieve kulturore me popuj të tjerë në rrjedhën e shekujve. Kostumografia apo veshja e një populli është gjithmonë trajtuar si elementi kryesor i kulturës shpirtërore e asaj materiale të një përkatësie etnike. Po ashtu, veshja e një populli është edhe rezultat i një procesi të zhvillimit, transformimit, evoluimit dhe përsosjes gjatë shekujve. Veshjet popullore, tipet e variantet apo pjesët e tyre punohen me dorë e me kreativitet. Gjatë punimit të tyre shprehet ndjenja për të bukurën. Motivet zgjidhen dhe krijohen duke u bazuar, krahas nivelit të zhvillimit ekonomik, edhe në zhvillimin shoqëror. Ndër motivet e veshjeve shqiptare, më së shumti ka dominuar dielli në trajtë spiraleje, pastaj shqiponja dykrenore, gjarpri si mbrojtës i shtëpisë, kuçedra si armike, dragoi, kurrizi i peshkut etj., kurse te pjesët e veshjes që punoheshin në vegjë kryesisht kanë dominuar



Veshje tradicionale të Rugovës



Veshje tradicionale të Hasit të Thatë

motive floreale e motive me figura gjeometrike. Sa u përket ngjyrave të përdorura, vërehet se ka pasur ndryshime në rrjedhën e viteve. Kjo shihet sidomos në periudha të ndryshme historike, kur kanë dominuar ngjyrat e forta, të cilat herë-herë janë zëvendësuar me ngjyra më të lehta. Në fakt, sa më thellë të futemi në lashtësi, ngjyrat na dalin më të uniformuara, sidomos kur janë përdorur ngjyrat natyrore të lëndës së parë.

Mozaiku i veshjeve popullore shqiptare përbëhet nga qindra e mijëra pjesë e eksponate elementesh, sipas destinacionit: për femra apo meshkuj; sipas kohëve: stinëve e punëve; sipas gjendjes emocionale të familjes: dasma, vdekje, martesë, fejesë, festa fetare e kombëtare, dalje në pazar; sipas zonave etnografike: krahinave e rajoneve; kurse sipas besimeve duhet të konstatojmë se dallimet fetare pothuajse nuk ekzistojnë, përkatësisht nuk reflektohen në veshje, sidomos në ato të meshkujve.

Veshjet karakterizojnë edhe krahina të caktuara. Kosova ka një pasuri të veshjeve që janë karakteristike për secilin rajon të saj.

Veshjet më autoktone, përkatësisht më të vjetra që janë ruajtur në Kosovë, me siguri që janë ato të meshkujve të rajonit të Rugovës, të cilat dallojnë nga çdo rajon tjetër, si dhe veshjet e femrave të Hasit të Thatë, të cilat jo vetëm që janë plot kolorit e shprehje artistike, por edhe nuk përsëriten në asnjë rajon etnografik në Kosovë e viset e tjera etnike shqiptare.

Në ditët e sotme, veshjet popullore përdoren më së shumti në ditë festash kombëtare, në veprimtari të ndryshme kulturore, në festivale brenda e jashtë kufijve, por edhe në gëzime familjare.

(Marrë me shkurtime nga: <https://veshjettradicionale.weebly.com>)

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Çfarë janë veshjet popullore? Çfarë përcjellin dhe çfarë shprehin ato?
 - b) Si punohen veshjet popullore? Cilat janë motivet që kanë mbizotëruar në veshjet shqiptare?
 - c) Cilat janë veshjet më autoktone në Kosovë? Çfarë i karakterizon ato?
 - ç) Në ç'raste përdoren kryesisht në ditët e sotme veshjet popullore?

Analizojmë tekstin

- 2 Si e kuptoni frazën e mëposhtme të shkëputur nga teksti?
 - ▣ [...] veshja e një populli është edhe rezultat i një procesi të zhvillimit, transformimit, evoluimit dhe përsosjes gjatë shekujve.
- 3 Plotësoni. Sipas këtij teksti, veshjet popullore krijoheshin:
 - ▣ sipas destinacionit – _____;
 - ▣ sipas kohëve – _____;
 - ▣ sipas gjendjes emocionale të familjes – _____;
 - ▣ sipas zonave etnografike – _____.
 Pasi të plotësoni vendet bosh, interpretoni informacionin e marrë.
- 4 Analizoni frazën e mëposhtme.
 - ▣ [...] sipas besimeve, duhet të konstatojmë se dallimet fetare pothuajse nuk ekzistojnë, përkatësisht nuk reflektohen në veshje, sidomos në ato të meshkujve.

Gjuha e tekstit

- 5 Cili mendoni se është kuptimi i fjalës me shkronja të zeza në frazën e mëposhtme?
 - ▣ *Mozaiku i veshjeve popullore shqiptare përbëhet nga qindra e mijëra pjesë e eksponate elementesh sipas destinacionit [...]*
- 6 Plotësoni pohimet e dhëna për tiparet gjuhësore të këtij teksti.
 - ▣ Fjalitë e këtij teksti janë _____
 - ▣ Foljet janë përdorur kryesisht në kohën _____
 - ▣ Gjuha figurative _____

Reflektojmë rreth tekstit

- 7 Si mendoni, pse veshja e një populli është trajtuar gjithmonë si elementi kryesor i kulturës shpirtërore e asaj materiale të një përkatësie etnike?
- 8 Reflektoni rreth informacionit që përcjell fjalja e mëposhtme.
 - ▣ Ndër motivet e veshjeve shqiptare, më së shumti ka dominuar dielli në trajtë spiraleje, pastaj shqiponja dykrenore, gjarpri si mbrojtës i shtëpisë, kuçedra si armike, dragoi, kurrizi i peshkut etj., kurse te pjesët e veshjes që punoheshin në vegjë kryesisht kanë dominuar motive floreale e motive me figura gjeometrike.
- 9 Veshjet popullore të cilës krahinë do të dëshiroje të vishje? Me ç'rast?

Detyrë

- ▣ Kërkoni në revista, enciklopedi ose në internet, informacione rreth veshjeve popullore të krahinës suaj. Diskutoni në klasë rreth tyre.

Këshilla për të shmangur shqetësimin e panevojshëm gjatë pasigurisë globale

Para leximit

Bota jonë ndryshoi me shpejtësi dhe u bë e pasigurt. Duke pasur parasysh disa nga zhvillimet që ndodhën dhe po ndodhin, është e vështirë të mos shqetësohemi për veten dhe për njerëzit që na rrethojnë. Këshillat e mëposhtme synojnë t'ju ndihmojnë për të menaxhuar shqetësimin e panevojshëm në këto kohë të pasigurta.

Është e natyrshme që të shqetësoheni në kohën që po jetojmë, por nëse mendoni se shqetësoheni tepër dhe se shqetësimi zë një vend të mirë në jetën tuaj, atëherë është e rëndësishme të përpiqeni të gjeni mënyra për ta kufizuar kohën që kaloni duke u shqetësuar. Në vijim janë përfshirë një sërë këshillash, të cilat mund t'ju ndihmojnë për menaxhimin e shqetësimit.

- ❑ Përpiquni të krijoni një rutinë. Nëse jeni duke kaluar më shumë kohë në shtëpi, është e rëndësishme të zbatoni me përpikëri oraret për t'u zgjuar, për të shkuar në shtrat, për t'u ushqyer, si dhe për t'u veshur me rrobat që do të mbani gjatë ditës. Fillimisht mund të hartoni një orar për të strukturuar ditën tuaj, derisa ai t'ju bëhet rutinë.
- ❑ Qëndroni aktiv mendërisht dhe fizikisht. Kur të hartoni orarin ditor, përfshini veprimtari që mbajnë në aktivitet mendjen dhe trupin. Për shembull, mund të përpiqeni të mësoni diçka të re nëpërmjet një kursi *online*, ose të sfidoni veten për të mësuar një gjuhë të huaj të re. Edhe aktiviteti fizik është i rëndësishëm. Për shembull, mund të kryeni punët përreth shtëpisë me vrull për 30 minuta, apo të ushtroheni sipas videove *online* me ushtrime fizike.
- ❑ Praktikoni mirënjohjen. Në kohë pasigurie, zhvillimi i praktikës së mirënjohjes mund t'ju ndihmojë që të kaloni momente gëzimi, gjallërie dhe kënaqësie. Në fund të çdo dite, reflektoni rreth asaj që ju bëri të ndiheshit mirënjohës. Përpiquni të vini re gjërat e reja të çdo dite. Për shembull: “Jam mirënjohës që kishte diell në kohën e drekës, sepse munda të qëndroja në kopsht”. Inkurajoni edhe familjarët e tjerë që të përfshihen në këtë aktivitet.

Teksti udhëzues

Teksti udhëzues ka si qëllim të udhëzojë lexuesin hap pas hapi në lidhje me një veprimtari të caktuar. Në funksion të qartësisë së shpjegimit, ato shoqërohen me ilustrime ndihmëse. Në këto lloj tekstesh përfshihen: nenet e ligjeve, manualet mësimore, recetat e gatimit, rregulloret e ndryshme etj. Gjuha e përdorur në to është formale, me fjalë dhe terma teknikë. Për të dhënë udhëzimet dhe shpjegimet rreth tyre, përdoren fraza të tilla, si: *së pari, pastaj, ndërkohë, derisa, si rezultat, për rrjedhojë, nga ana tjetër, duke e krahasuar me etj.*

- ❑ Vëreni dhe kufizoni nxitësit e shqetësimit. Ngaqë raportohen vazhdimisht lajme lidhur me situatën shëndetësore, mund të ndihemi sikur kemi nevojë në mënyrë konstante që t'i ndjekim edicionet informative apo që të kontrollojmë përditësimet në mediat sociale. Por mund të vëreni edhe se kjo nevojë për t'u përditësuar me informacion, nxit shqetësimin tuaj. Në këtë rast, përpiquini të identifikoni sa më shumë hollësi. Për shembull, a shqetësoheni më shumë kur ndiqni lajmet për më se 30 minuta? A ju shkaktohet e njëjta ndjesi shqetësimi nga kontrollimi i mediave sociale çdo orë?



Mundohuni të kufizoni kohën që ju ekspozon ndaj nxitësve të shqetësimit. Mund të zgjidhni të dëgjoni lajmet në një kohë të përcaktuar çdo ditë, apo mund të kufizoni kohën që shpenzoni në media sociale për të kontrolluar lajmet.

- ❑ Mbështetuni në burime të respektueshme të lajmeve. Kjo mund t'ju ndihmojë edhe në të ardhmen që të jeni të vëmendshëm për burimin prej të cilit merrni lajmet dhe informacionet. Bëni kujdes në zgjedhjen e burimeve të respektuara. Për shembull, në këtë situatë, Organizata Botërore e Shëndetësisë mundëson informacione të çmuara këtu: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/advice-for-public>


(Marrë me shkurtime nga: <https://www.psychologytools.com>)

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe shënoni me ✓ ose me ✗ pohimet e mëposhtme.

Teksti i mësipërm i udhëzon lexuesit që të ndjekin një udhërrëfyes.
 Teksti i mësipërm i këshillon lexuesit që të shmangin shqetësimin e panevojshëm përgjatë pasigurisë globale.
 Pyetjet që autori ngre në tekst, presin përgjigjet e lexuesve.
 Teksti i udhëzon lexuesit se si t'u përgjigjen këtyre pyetjeve.
 Teksti u sugjeron lexuesve disa përgjigje të mundshme.



- 2 Cili është qëllimi i hartuesve të këtyre këshillave?

Studim teksti

Analizojmë tekstin

- 3 Në tabelën e mëposhtme, shkruani me nga një fjali përmbledhëse (e cila duhet të përmbajë idenë kyçe) secilën nga këshillat që gjenden në këtë tekst.

Si ta shmangim shqetësimin e panevojshëm përgjatë pasigurisë globale	
Këshilla 1	
Këshilla 2	
Këshilla 3	
Këshilla 4	
Këshilla 5	

- 4 Si është i organizuar ky tekst? Shënoni me ✓.
- Ndërtohet në paragrafë të veçantë, që paraqesin hapa të ndryshëm të një dukurie.
 - Udhëzon hap pas hapi lexuesin rreth montimit të një pajisjeje.
 - Jep këshilla për të shmangur një gjendje të padëshiruar shpirtërore.
 - Në të tregohet se si dhe pse ndodh një dukuri.

Gjuha e tekstit

- 5 Kthejuni tekstit dhe identifikoni tiparet gjuhësore të mëposhtme.
- Koha e foljes që përdoret më shpesh: _____
 - Veta e rrëfimit: _____
 - Llojet e fjalive: _____

Reflektojmë rreth tekstit

- 6 Interpretoni rolin e paragrafit hyrës të këtij teksti.
- 7 Si mendoni, a janë të vlefshme për këdo këshillat e këtij teksti? Argumentoni mendimin tuaj.
- 8 Shtoni dy këshilla që i përshtaten problematikës së trajtuar në tekst.

Projekt

Zhvilloni një projekt me temë "Teknologjia ndihmon komunitetin". Ndahuni në grupe dhe realizoni:

- Grupi I – paraqitjen e programeve kompjuterike që lehtësojnë komunikimin në komunitet.
- Grupi II – udhëzues për përdorimin e një prej programeve të tilla kompjuterike.
- Grupi III – këshilla për të menaxhuar kohën gjatë përdorimit të njërit prej këtyre programeve kompjuterike.

Dieta e jetëgjatësisë

Para leximit

Kur është fjala për shëndetin dhe në veçanti për ushqyerjen, shpesh ndeshemi me moda kalimtare dhe teori të ngritura në rërë, që shpejt kapërcehen apo zëvendësohen nga zbulime të reja dhe moda e teori të reja. Kurse "Dieta e jetëgjatësisë", e shkëputur nga libri me të njëjtin titull, të autorit Valter Longo, mbështetet në ato që ai i ka quajtur "5 Kolonat e Jetëgjatësisë", të cilat përkohën me 5 disiplina që shërbejnë si një bazë e shëndoshë shkencore për programin e tij, të përbërë nga ushqyerja dhe ushtrimi fizik, për të përmbushur pikësynimin për një jetë të gjatë dhe të shëndetshme.



Valter Longo

Valter Longo, biokimist, ka lindur në Gjenovë, më 1967, dhe njihet në nivel ndërkombëtar si një nga liderët në fushën e studimeve rreth plakjes dhe sëmundjeve që lidhen me të, me botime në revistat më në zë shkencore. Këto përfshijnë zbulimin e disa prej gjeneve kryesore përgjegjëse rreth zgjatjes së jetës dhe identifikimin e një tjetërsimi gjenetik që i mbron njerëzit nga sëmundjet më të përhapura. Është profesor titullar i Gerontologjisë dhe Shkencave Biologjike, dhe drejtor i Institutit të Jetëgjatësisë në School of Gerontology në University of Southern California të Los Anxhelesit, një ndër qendrat kushtuar kryekëput mësimdhënies dhe kërkimeve rreth plakjes.

Të gjithë e njohim shprehjen "Jemi çka hamë", por për shumicën, kjo do të thotë që thjesht s'duhet të hamë ushqime të dëmshme. Edhe pse është e rëndësishme të ruajmë një mënyrë ushqyerjeje që na sjell kënaqësi, është gjithaq vendimtare të eliminojmë apo të pakësojmë në minimum lëndët ushqyese që na e bëjnë jetën më të shkurtër, me sëmundje dhe vuajtje, duke shtuar marrjen e lëndëve ushqyese dhe ndjekjen e një stili jete që do të na e zgjatë jetën. Më poshtë janë përmbledhur këshillat për të arritur këtë qëllim.

- 1) Ndiqni një dietë vegane duke shtuar peshkun; por kujdes nga peshku me përmbajtje të lartë mercuri. Kufizojeni peshkun në 2-3 vakte në javë.
- 2) Pakësoni në maksimum yndyrat e ngopura shtazore dhe sheqernat.
- 3) Konsumoni fasule, qiqra, bizele dhe bishtajore të tjera si burim kryesor energjie.
- 4) Konsumoni sasi të mëdha karbohidratesh komplekse (domate, brokoli, karota, bishtajore etj.).
- 5) Konsumoni sasi relativisht të lartë vaj ulliri (50-100 ml në ditë) dhe një grusht arra, bajame apo lajthi.



- 6) Hani peshk, krustace dhe molusqe me përmbajtje të lartë omega-3 dhe/ose vitaminë B12 (salmon, açuge, sardele, merluc, kocë, troftë, midhje vongole, karkaleca deti) të paktën dy herë në javë.
- 7) Ndiqni një dietë të pasur me vitamina dhe minerale, por integrojeni 2-3 herë në javë me një multivitaminik ose multimineral të cilësisë së lartë.
- 8) Hani në harkun e 12 orëve në ditë (filloni pas orës 8 dhe mbaroni para orës 20, ose pas orës 9 dhe para orës 21).
- 9) Mos hani të paktën 3-4 orë para se të bini në shtrat.
- 10) Për personat që janë mbipeshë apo që priren të vënë peshë, është e këshillueshme të hanë tri vakte në ditë: mëngjes, drekë ose darkë dhe dy zemra prej 100 kalorish, me përmbajtje të ulët sheqernash (më pak se 3-5 gramë), njëra prej të cilave të zëvendësojë një vakt. Këshillohuni me një nutricionist për të parandaluar kequshqyerjen.
- 11) Për personat me peshë normale dhe/ose që priren të humbasin peshë, është e këshillueshme të konsumojnë tri vakte normale, si dhe një zemër prej 100 kalorish, me përmbajtje të ulët sheqernash (më pak se 3-5 gramë).
- 12) Hani duke përzgjedhur përbërësit e duhur mes atyre që hanin paraardhësit tanë.

Dimë që faktori tejet vendimtar për jetëgjatësinë e një individi është trashëgimia e tij gjenetike, por meqenëse s'mund të ndikojmë mbi gjenet tona, përveç ndryshimit të ushqyerjes, mund të orvatemi të arrijmë një jetëgjatësi të shëndetshme edhe falë veprimtarisë fizike. Më poshtë janë përmbledhur këshillat për të arritur këtë qëllim.

- 1) Ecni me hap të shpejtë 1 orë në ditë.
- 2) Shmangni shkallët lëvizëse dhe ashensorët edhe kur keni shumë shkallë për të ngjitur.
- 3) Në fundjavë përpiquni të ecni më gjatë, duke shkuar në vende të largëta (shmangni zonat e ndotura).
- 4) Bëni ushtrime me intensitet mesatar 150-300 minuta në javë, me një kulm ushtrimesh intensive.
- 5) Bëni ushtrime, me ose pa pesha, për të forcuar muskujt (duke i kombinuar me vakte që përmbajnë 30 gramë proteina pas ushtrimeve me pesha).

(Marrë me shkurtime nga libri i Valter Longo-s, "Dieta e jetëgjatësisë", përkthyer nga Agim Doksani, Shtëpia Botuese Dudaj, Tiranë 2018)

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
- Sa udhëzime përmban ky tekst? Si janë të grupuara ato?
 - Për çfarë shërbejnë?
 - Cilat ushqime duhen konsumuar si burim kryesor energjie?
 - Në harkun e sa orëve duhen konsumuar vaktet?
 - Cili është regjimi ushqimor që rekomandohet për personat që janë mbipeshë?
 - Po për personat me peshë normale?
 - Sa dhe si këshillohet të ecim në një ditë të zakonshme? Po gjatë fundjavës?
 - Cili është lloji i ushtrimeve që këshillohen?

Analizojmë tekstin

- 2 Për çfarë na këshillon ky tekst? Shënoni me ✓.
- Për të arritur peshën ideale.
 - Për të ndjekur një program ushtrimesh fizike në palestër.
 - Për të jetuar sa më gjatë duke ndjekur një dietë ushqimore dhe mënyrë jetese të shëndetshme.
 - Për të shkruar këshilla për mbajtjen e një diete.
- 3 Nënvizoni në tekst fjalitë, në të cilat autori:
- shpjegon;
 - këshillon;
 - sugjeron.
- 4 Çfarë nënkupton autori me këshillën vijuese?
- Hani duke përzgjedhur përbërësit e duhur mes atyre që hanin paraardhësit tanë.

Gjuha e tekstit

- 5 Gjeni në tekst folje të mënyrës urdhërore. Përse përdoren ato?
- 6 Në tekst përdoren edhe folje në mënyrën dëftore, koha e tashme, veta e parë, numri shumë, të tilla si: *njohim, ruajmë, eliminojmë, pakësojmë, ndikojmë* etj. Si mendoni, çfarë funksioni kanë këto folje? Shënoni me ✓.
- Duket sikur autori i tekstit na shoqëron në përzgjedhjen e regjimit të duhur për trupin tonë.
 - Këto folje përdoren, sepse veprimet do t'i kryejmë ne, lexuesit.
 - Autori krijon efektin e bashkëpunimit me lexuesin e këshillave.

Reflektojmë rreth tekstit

- 7 Cili grup këshillash ju pëlqeu më shumë? Cilën këshillë do të veçonit nga ky grup? Pse?
- 8 Keni lexuar ndonjë dietë tjetër? Ku ngjason dhe ku ndryshon ajo me këtë dietë?

Detyrë

- Mendoni se është e rëndësishme mënyra e gatimit të ushqimeve? Jepni opinionin tuaj dhe më pas formuloni një recetë të shëndetshme për një nga vaktet e të ngrënit.
- Mendoni për ushtrimet fizike që kryeni zakonisht. Përzgjidhni njërin prej tyre dhe shkruani pesë udhëzime për realizimin e tij.

Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut

Skënderbeu, pasi priti përgëzimet e zakonta, u mbajti **këtë fjalë krerëve** dhe popullit të mbledhur, sipas Barletit:

“Kapedanë dhe ushtarë trima: Nuk është as e re, as e panjohur pamja që kam sot përpara syve. Ashtu si ju kujtonja, ju gjeta, stërnipër të thjeshtë të një race të vjetër dhe bujare, trima dhe besnikë të patronditur të atdheut tuaj. Edhe jam i lumtur tani që mund t’jua hap zemrën. Ju them pa mburrje që sa kam rrojtur, kam patur gjithnjë këtë mall për atdhenë dhe këtë dashuri për lirinë. Kur më ftuat për këtë vepër nga shërbimi i Sulltanit, kisha në zemër atë dëshirë që kishit edhe ju. Ndofta, ju shkoi në mendje që e kisha harruar edhe atdhenë, edhe nderin, edhe lirinë, kur ju kthenja prapë të helmuar pa ju dhënë asnjë shpresë dhe pa ju treguar asnjë ndjenjë fisnike dhe shpirtmadhe. Po unë sillesha me atë mënyrë, se ashtu e deshte shpëtimi juaj edhe imi, se puna ishte e atillë që duhej bërë dhe jo thënë, se shikonja që kishit më tepër nevojë për **fre** se sa për shtyrje. Jua fsheha planet e mia dhe nuk jua çfaqa dëshirën që jua dinja shpirtin, posa ju ishit të parët që e hodhët zjarrin edhe e nisët këtë valle, po se puna duhej mejtuar thellë, se duheshin gjetur mjetet, se duhej zgjedhur mirë koha. Ndryshe, do të derdhej gjak më kot, edhe përfundimi do të ishte një robëri më e keqe se e para; edhe atëherë çdo shpresë për të nesërmen do fluturonte; se një punë si kjo nisët një herë e mirë dhe në mos vaftë mbarë, rasti dhe mjetet për ta nisur përsëri ikin dhe nuk kthehen prapë. Prandaj nuk ia tregoja planin tim as vetes sime dhe ruhesha mos më shkiste gjuha dhe mos më dëgjonin muret. Kam për dëshmues Hamzanë, tim nip, që e kam patur përkrahës, këshilltar dhe shok armësh me disa të tjerë të paktë, me besnikërinë e të cilëve e vumë këtë plan në veprim. Tani, ndonëse rronim edhe hanim tok, edhe kishim një zemër edhe një shpirt, me gjithë këtë asnjë nga këta nuk më kishte dëgjuar ndonjëherë të zë në gojë atdhenë, lirinë dhe krishterimin gjersa erdhi rasti në betejën e Nishit.

Lirinë mund ta kishit fituar me trimërinë tuaj edhe me një tjetër çlirimtar, se Shqipërisë nuk i mungojnë burrat, po ju pëlqeu ta prisni nga dora ime, ndonëse vonë, se kështu ndoshta deshi vetë i madhi Zot. Se është me të vërtetë çudi që trima kryelartë si ju, të rritur në liri, duruat kaq kohë robërinë e barbarëve, duke

Fjalor

fjalë – këtu: fjalim.
krerë – komandantë, prijës.
fre – pengesë, frenim.
ushtë – heshtë.
gardian – ushtar.
principatë – shtet i vogël në mesjetë, që sundohej nga një princ.

Teksti argumentues

Teksti argumentues ka si qëllim të bindë lexuesin për një çështje të caktuar nëpërmjet argumenteve apo arsytimeve, të cilat janë fakte, shembuj, prova apo gjykime praktike të autorit. Autori i një teksti argumentues formulon një çështje, e cila shfaqet e gatshme për lexuesin ose është e nënkuptuar. Çështja është një pohim, një ide kyçe, mbi të cilën ndërtohet i gjithë teksti. Tekstet argumentuese më të përdorshme janë: fjalime, letra të hapura, artikuj gazete, ese argumentuese etj.



pritur të më shikoni një ditë në kryen tuaj. Po vallë a e meritoj këtë titull të bukur të çlironjësit që kini mirësinë të më jepni? Lirinë nuk jua solla unë, po e gjeta këtu në mes tuaj. Posa shkela këmbën këtu, posa ma dëgjuat emrin, rendët të gjithë, më dolët përpara, kush e kush më shpejt, sikur të ishin ngritur nga varret etërit, vëllezërit dhe bijtë tuaj, sikur të kishte zbritur nga qielli vetë Perëndia. Më prittë me aqë dashuri dhe gëzim, më sualltë shërbime aq të çmuara dhe të panumërta, sa më bëtë më tepër ju robin tuaj, se sa unë të lirë ju. Këtë fortesë dhe këtë qytet nuk jua dhashë unë, po ma dhuruat ju; armët nuk jua ngjeshja unë, po ju gjeta të armatosur; lirinë e kishit kudo, në kraharor, në ballë, në shpatë dhe në ushtat; si gardianë besnikë, të emëruar prej tim eti, ju ma vutë mi krye këtë kurorë, ju ma dhatë në dorë këtë shpatë, ju më bëtë zot të kësaj principate, të cilën më kini ruajtur me aqë besë, me aqë kujdes dhe me aqë mundime. Shpjermëni tani, me ndihmën e Perëndisë, që ta çlirojmë tërë Shqipërinë.”

Studim teksti

Fjalimi është një ligjëratë që mbahet në një mbledhje të gjerë. Fjalimi mund të ketë tematika të ndryshme dhe mund të jetë i organizuar në formë të gjatë apo të shkurtër.

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
 - a) Cili është qëllimi i mbajtjes së këtij fjalimi?
 - b) Cilat kanë qenë arsyet e pritjes së Skënderbeut?
 - c) Si i përshkruan ai shqiptarët në fjalimin e tij?
 - ç) Cila është thirrja që prijësi i bën popullit të vet?

Analizojmë tekstin

- 2 Në fjalën e tij, Skënderbeu përdor disa emërtime për shqiptarët. Shkruajini ato dhe tregoni efektin që krijon kjo zgjedhje leksikore.
- 3 Nënvizoni fjalitë në të cilat merrni informacion historik.
- 4 Shkruani argumentet e përdorura nga Skënderbeu në fjalimin e tij:
 - 📌 për të arsyetuar shkaqet e pritjes së tij;
 - 📌 për të bindur dhe motivuar shqiptarët për luftë.

Gjuha e tekstit

- 5 Shkruani tri veçori gjuhësore të këtij fjalimi.
 1. _____
 2. _____
 3. _____
- 6 Nënvizoni fjalët e përdorura në dialekt. Shkruani përbri formën e tyre sipas normës letrare.

Reflektojmë rreth tekstit

- 7 Si i kuptoni fjalët e Skënderbeut: *“Lirinë nuk jua solla unë, po e gjeta këtu në mes tuaj.”*
- 8 Jepni vlerësimin tuaj për strategjinë e Skënderbeut, e cila shfaqet në fjalën e tij.

Detyrë

- 📌 Kërkoni informacion në internet apo në libra historikë rreth figurës së heroit madhështor, Skënderbeut. Diskutoni në grup rreth vlerave të tij kombëtare.

Zbulimi i Hektorit

Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga vepra "Ftesë në studio" e shkrimtarit Ismail Kadare, e botuar për herë të parë në vitet '90. Në këtë shkrim eseistik, autori përqendrohet te dy figura të njohura të letërsisë antike greke: Akili dhe Hektori. I pari është i njohur nga lexuesit për trimërinë, guximin, zotësinë luftarake, ndërsa i dyti për virtytet dhe respektin që gëzon falë tyre. Kadare zbulon një përmasë krejt të panjohur të figurës së tyre. Përshtypjet e përhapura rreth Akil hyjnorit shfaqen nën një dritë re, krejt të ndryshme, e cila argumentohet natyrshëm dhe pasuron dijen letrare. A mbetet portreti i heronjve të antikitetit i pandryshuar në të gjitha kohërat?

Sa për zbulimin që bën Hektori, kur për herë të parë ia sheh nga afër fytyrën Akilit, ai është me interes të veçantë.

Së pari, Hektori është ende gjallë, kur Akili i shpon tejsat e këmbëve. Hektori e ka parë disa herë Akilin në fushë të luftës, pra, jo fort larg, dhe ndonëse ka dyshuar ("ka pasur një bindje") se fytyra e tij nuk është e bukur, siç thonë, ai nuk e ka bërë asnjëherë gjer tani këtë pohim. Është hera e parë që Hektori e sheh fare pranë fytyrën e tjetrit dhe kjo, me sa duket, ndodh kur Akili përkulet për t'i shpuar tejsat. Është çasti kur Hektori zbulon ashtu siç dyshonte ("bindja s'më ka mashtruar") se fytyra e tjetrit, ashtu si shpirti i tij, është mizore, pra e pahijshme. Këtu epiteti s'ka të bëjë me egërsinë, ashpërsinë etj., sepse Akili i tillë ka qenë përherë për trojanët. Këtu është fjala pikërisht për një zbulim, për një gjë që Hektori ka dyshuar, ndoshta ka polemizuar edhe me të tjerët, dhe që ka të bëjë me legjendën për pamjen e hijshme të Akilit.

Për herë të parë dhe të fundit, Homeri hedh një dyshim. Por dyshimi, ndonëse i dalë nga rivali i Akilit, ngjit. Na kujtohet vetmimi i Akilit, fyerja e shpejtë, nervozizmi, sidomos mënjanimi i tij. S'ka qenë asnjëherë aq i hijshëm sa ç'e bënë? Apo ka qenë i tillë, por një shkak

Fjalor

tejsat — dell a damar i hollë.

ekzemë — sëmundje kronike e lëkurës që shfaqet me skuajen e saj dhe me fluska a puçrra.



i papritur, puçrra, ekzemë, paralizë e pjeshme e ka shëmtuar, dhe tani, ashtu si aktorët që nuk duan më t'i zhgënjejnë adhurimtarët, edhe ai i mënjanohet publikut, kërkon shkaqe për t'u mbyllur në çadër, për të ikur fare nga fushata?

Armiqësia e tij me Hektorin s'është vetëm ajo e dy kundërshtarëve, por edhe e dy rivalëve në pamje. Hektori është pa dyshim shumë i pashëm (Homeri nuk harron kurrë ta theksojë këtë), ndaj qyshse rrëzohet, sidomos kur ia sheh nga afër fytyrën kundërshtarit, e ndien se ç'e pret. Por ashtu si Hektori sheh nga afër puçrrat ose ekzemën në fytyrën e Akilit, ashtu edhe ky sheh më pranë se kurrë hijeshinë e tjetrit. Dhe vendos ta shëmtojë atë bukuri të urryer, ta fëlliqë nëpër baltë duke e zvarritur me kokën poshtë. Hektori, që ka parandier këtë, përfiton nga grima e fundit e jetës që i mbetet për ta sfiduar edhe ai rivalin e tij. Nuk ka më kohë për shfryrje ose mallkime, në vend të tyre ai zgjedh një frazë të thjeshtë, por të hidhur helm: "Ti qenke ashtu siç dyshoja, i shëmtuar!" E gjithë kjo përsiatje mund të quhet disi e stërholluar po të mos njohësh epikën e mëvonshme ballkanase. Me qindra janë këngët e baladave ku këndohen hijeshia e personazheve, dhunimet, masakrimet, lutjet për të mos u shëmtuar fytyrat, sytë etj. Që nga Homeri e këtej ky motiv s'ka reshtur kurrë në popujt e gadishullit, gjersa, shqiptarët, në kodin e tyre të lashtë zakonor, ishin të parët që e ndaluan rreptësisht, jo vetëm dhunimin, por edhe preken e trupit të viktimës.

Ismail Kadare

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Vendosni shenjen ✓ për pohimet të cilat përputhen me përmbajtjen e pjesës.
- Hektori sheh për herë të parë Akilin.
 - Hektori gjithnjë e ka ditur se Akili është i shëmtuar.
 - Akili mendon se fytyra e Hektorit është ashtu si shpirti i tij, e pahijshme.
 - Legjenda rrëfen se Akili ka pamje të hijshme.
 - Hektori rendit shkaqet e shëmtisë së Akilit.
 - Homerit e thekson që Hektori është shumë i pashëm.
 - Hektori vërteton dyshimet e tij për pamjen e Akilit në momentet e fundit të jetës.
 - Dhunimi dhe preka e trupit të viktimës ndalohet në kodin zakonor të popujve të Ballkanit.

Analizojmë tekstin

- 2 Në ç'formë i ndërton autori dyshimet rreth pamjes së Akilit?
- Nëpërmjet pyetjeve.
 - Nëpërmjet argumenteve të bazuara në fakte.
 - Nëpërmjet fjalive pohuese.
 - Nëpërmjet rrëfimeve të legjendave.

Studim teksti

3 Plotësoni.

Teza e këtij teksti është: _____

Argumenti 1: _____

Argumenti 2: _____

Gjuha e tekstit

4 Cili mendoni se është sinonimi i fjalës “përsiatje” në fjalinë e përdorur në tekst? Zëvendësoni në tekst togfjalëshin “përsiatje e stërholluar” me sinonimin e tij.

5 Renditni 5 fraza gjuhësore, të cilat e bëjnë tekstin të ketë stil formal.

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

Reflektojmë rreth tekstit

6 Pas leximit të tekstit të mësipërm, po ju a mendoni se Akili ishte mizor dhe i pahijshëm? Ku bazoheni për këtë?

7 A mendoni se pamja e jashtme është pasqyrë e karakterit të një personi? Sillni shembuj nga letërsia dhe jeta për të konkretizuar mendimet tuaja.

8 Çfarë e karakterizon mbylljen e kësaj pjese?

- Përgjithëson dukurinë e trajtuar në pjesë.
 - Arrin në një konkluzion.
 - Rimerr tezën e dhënë në hyrje të pjesës.
 - E lë mendimin e autorit të nënkuptuar.
- Argumentoni mendimin tuaj, duke iu referuar tekstit.

Detyrë

- Lexoni vargjet e mëposhtme, të shkëputura nga “Iliada” e Homerit, kushtuar paraqitjes së Akilit dhe Hektorit. Shkruani një tekst të shkurtër në të cilin të krahasoni përshtypjet që ju lënë Hektori dhe Akili në të dyja tekstet (teksti i Kadaresë dhe teksti i Homerit).

Kënga XXII (Fragment)

Si foli ashtu, pallën si arëza e nxori,
që e madhe e e rëndë në rrip të mezit varej.
Kular kukzuar iu vërvit Akilit,
posi shqiponja që prej t'ëprash maja
zbret në lëndinë thikë përmes resh të zeza,
për të rrëmbyer ndonjë lepur t'frikshëm
a qengj të njomë. Ashtu u turr Hektori,
duke lëkundur t'mprehtën pallë si arëza.
Po atij rrëmbyeshëm iu vërvit dhe Akili,
që zemra i digjej nga tërbim i egër.
Gjoksin përpara ia mbulonte shqyti

mjeshtërisht punuar, dhe valë-valë i dukej
kaska vetuese katër rrathësh tunxhi
me katër kreshta ari vezulluese,
që në majë pranë e pranë vendosi Efesti.
Si ylli i mbrëmjes që shkëlqen më i bukuri
në mes të natës ndër yjet e qiellit,
ashtu vetonte maja e heshtës tunxhi,
që dora e fortë e Akilit vringëllonte,
Duke shartuar zi për Hektor divin,
dhe hulumtonte trupin e tij t'hijshëm
ku mund t'ia hapte pagën vdekjeprurëse.

Shkruajmë ese argumentuese

Një nga llojet e shkrimit joletrar është eseja argumentuese. Në këtë lloj eseje mbajmë qëndrim për një çështje të cilën e mbështetim me argumente. Ky qëndrim shprehet nëpërmjet tezës, e cila nga ana gjuhësore shprehet me një fjali dëftore. Nga pikëpamja logjike, ndaj këtij qëndrimi, ka pikëpamje të ndryshme, që edhe mund të jenë në kundërshtim me të. Një mënyrë e mirë për të shndërruar idetë në tezë, është t'u përgjigjeni pyetjeve rreth çështjes. Për shembull:

Pyetje: A luan rol të rëndësishëm shkencën në historinë e njerëzimit?

Përgjigje (Tezë): Merita e shkencës në historinë e njerëzimit është absolute dhe mbresëlënëse.

Struktura e esesë argumentuese mund të jetë: hyrja, teza, argumente për tezën, kundërteza dhe mbyllja.

Mjeshtëria argumentuese përdoret për të formuluar argumente sa më të forta. Detyra juaj është që të bindni audiencën, e cila mund të jetë e përfunduar ose të mos ndajë të njëjtin opinion me ju.

- ✿ **Lexoni shkrimin e mëposhtëm dhe vëzhgoni me kujdes mënyrën se si janë ndërtuar hallkat e çdo elementi të strukturës.**

Ashtu si dashuria, libri nuk vdes kurrë

Ditë më parë, duke kaluar hutueshëm nga njëri kanal i televizorit në tjetrin, ndesha në një kanal ku po transmetohej njëfarë spoti i gjatë, apo lajmërimi për një program të ri. (Nuk e mbaj mend se cili televizion ishte saktësisht, dhe kjo pohon se sa i pambrojtur ideologjikisht është telespektatori krahasuar me lexuesin e gazetave, i cili e di me saktësi se kush po i flet.) Po u bënin reklamë mrekullive të CD-ROM-ve, disqeve që mund të na ofrojnë të njëjlershmen e një enciklopedie të tërë, me ngjyra, tinguj dhe mundësiht me lidhje të menjëhershme nga argumenti në argument. Meqenëse po krijoj njëfarë përvoje në këtë fushë, e pra e njoh argumentin, nuk po i kushtoja vëmendje të madhe. Derisa, në njëfarë pike, dëgjova emrin tim: po thuhej se unë paskësja pohuar që këto disqe do të zëvendësojnë përfundimisht librat.

Askush, veç në qoftë paranojak, s'mund të mëtojë që të tjerët të lexojnë gjithçka që ai shkruan, por të paktën mund të shpresojë që mos t'i vënë në gojë pikërisht të kundërtën, sidomos nëse po e përdorin, në mënyrë të paligjshme, për t'i bërë reklamë diçkaje. Në të vërtetë, po e përsëris fort e më fort se CD-ROM-i nuk mund ta zëvendësojë kurrë librin.

Ka dy lloje librash, ata për t'u konsultuar dhe ata për t'u lexuar.

Të parët (prototip është lista telefonike, por mund të shkohet deri te fjalorët dhe enciklopeditë) zënë shumë vend në shtëpi, janë të vështirë për t'u manovruar dhe janë të kushtueshëm. Këta mund të zëvendësohen nga disqet multimediale, kështu lirohet hapësirë në shtëpi dhe në biblioteka publike.

Ndërsa librat për t'u lexuar (që shkojnë nga "Komedia Hyjnore" te romani i verdhë më i vonë) nuk mund të zëvendësohen nga asnjë gjësend elektronik. Janë bërë për t'u mbajtur në dorë, edhe në shtrat, edhe në barkë, edhe atje ku nuk ka spina elektrike, edhe atje ku e kur çfarëdolloj baterie shkarkohet, mund të nënvizohen,

Hyrja:

Autori tërheq interesin e lexuesit duke paraqitur situatën.

Teza:

CD-ROM-et nuk mund të zëvendësojnë librin.

Argumente

të përballojnë librashënues, mund të bien në tokë, apo të lëshohen ashtu të hapur mbi gjoks apo gjunjë kur na merr gjumi, rrinë në xhep, rrëgjohen, marrin një trajtë vetanake sipas intensitetit dhe rregullsisë së leximeve tona, na kujtojnë (nëse na shfaqen shumë të freskët dhe të paprekur) se ende nuk i kemi lexuar, lexohen duke mbajtur kokën si të duam ne, pa na detyruar të rrimë e të lexojmë të çimentuar në ekranin e kompjuterit, miqësor në gjithçka përveçse me cervikalen. Pa përpikuni të lexoni "Komedinë Hyjnore", goftë edhe vetëm një orë në ditë, në ekranin e një kompjuteri e pastaj ejani më thoni.

Libri për t'u lexuar u përket atyre mrekullive të teknologjisë së përjetshme, ku bëjnë pjesë rrota, thika, luga, çekiçi, tigani, biçikleta. Thika u shpik shumë shpejt, biçikleta shumë më vonë. Por sado të mundohen dizenjatorët, duke modifikuar ndonjë pjesë, thelbi i thikës mbetet gjithnjë i njëjtë. Ka makina që e zëvendësojnë çekiçin, por për disa gjëra do të lypet ngaherë nevoja e diçkaje që ngjason me çekiçin e parë të shfaqur ndonjëherë në sipërfaqen e tokës. Mund të shpikni një sistem kambioje shumë të sofistikuar, por biçikleta mbetet ajo që është, dy rrota, një shalë dhe pedalet. Përndryshe quhet motor dhe është tjetër gjë.

Njerëzimi ka përparuar nëpër shekuj, duke lexuar dhe duke shkruar fillimisht në gurë, pastaj në rrasa, pastaj në rrotulla, por ishte një mund i madh. Kur zbuloi se fletët mund të lidheshin mes tyre, edhe pse ende dorëshkrime, lëshoi një ofshamë lehtësimi. Dhe kurrë nuk mund të heqë më dorë nga ky mjet i mrekullueshëm.

Është e vërtetë që teknologjia na premtton makina, me të cilat mund të eksplorojmë nëpërmjet kompjuterit bibliotekat e gjithë botës, të përzgjedhim tekstet që na interesojnë, t'i shtypim në shtëpi në pak sekonda, me gerrat që dëshirojmë – ashtu siç na e lyp miopia, apo siç na e ka ënda nga ana estetike – teksa e njëjta fotokopje na i lidh fletët, në atë mënyrë që secili prej nesh të jetë në gjendje të krijojë vepra personale. Po pastaj?

Do të zhduken tipografitë, libërlidhjet tradicionale, por do të kemi ndër duar, ende dhe ngaherë, një libër.

Umberto Eco

Argumente:

Librat nuk mund të zëvendësohen nga asnjë send elektronik, sepse janë rezistentë dhe praktikë.

Rrëzohen me shembuj argumentet që kundërshtojnë tezën:

Çfarëdo që të bëjë teknologjia, libri mbetet libër.

Mbyllja

STRUKTURA E ESESË ARGUMENTUESE

Paragrafi i parë

Shpjegon shkurtimisht temën, rëndësinë e saj dhe në të zakonisht gjendet teza e esesë.

Paragrafët e zhvillimit

Autori zhvillon argumentet e tij dhe i mbështet ato me dëshmi të vlefshme dhe të besueshme. Argumentet mund të jenë logjike, statistikore ose faktike, varësisht nga tema e esesë.

Kundërteza





Jepen pikëpamjet e kundërshtarëve, që rrëzohen nëpërmjet argumentit më të fortë të dhënë nga autori.

Mbyllja

Zakonisht në të bëhet përmbledhja e argumenteve të dhëna gjatë zhvillimit. Asnjë informacion i ri nuk duhet të jepet në fund.

1

Shkruani një ese argumentuese për njërën prej temave të mëposhtme.

-  Kur lexoj një libër, mbyll një portë dhe ngre një perandori.
-  Libri prej letre është i lehtë, por forca e tij është aq e jashtëzakonshme, sa e ngre njeriun në majat e universit.
-  Libri apo filmi?
-  Ndikimi i videojërave tek adoleshentët.

Parku i Gërmisë

Në pjesën verilindore, qyteti i Prishtinës kufizohet me Parkun e Gërmisë, i cili ka një sipërfaqe prej 62 km². Që nga viti 1987, ai është një zonë e mbrojtur e natyrës dhe njihet edhe si zonë rekreacionale.

Zona për rekreacion dhe pushim fillon prej pishinës e vijon më tutje, në brendi të Gërmisë, duke përfshirë livadhet, ish-pushimoren e fëmijëve, terrenet sportive etj. Kjo zonë është e rrethuar me pyje të dushkut e të ahut dhe ofron një pamje tërheqëse e çlodhëse.

Kufiri perëndimor i Gërmisë kalon nga “Kodra e Vreshtave” dhe vazhdon në “Kodrën e Mirditës”, deri në Hajvali dhe lumin e Graçanicës.

Kufiri jugor kalon në lumin e Graçanicës, deri në vendin ku bashkohet me lumin Busia, vazhdon në fshatin Mramor dhe Butovc, deri te Lumi i Prishtinës që përfaqëson kufirin verior të kësaj zone malore. Pjesa më e lartë e Gërmisë është “Maja e Butovcit”, me lartësi mbidetare prej 1050 metrash.

Teksti përshkrues

Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë, duke informuar dhe duke treguar si është ndërtuar një objekt, cilat janë tiparet e një personi, të një kafshe, të një mjedisi, apo të një dukurie.

Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë duke paraqitur me detaje tiparet e një objekti, të një personi, të një kafshe, të një mjedisi apo të një dukurie. Përshkrimi mund të jetë objektiv (në enciklopedi, në tekste shkencore, dokumente zyrtare etj.) ose subjektiv (në ditarët, në letrat personale dhe në tekstet letrare). Përshkrimi mbështetet në perceptimin shqisor: të shikuarit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit. Në të jepen detaje dhe informacione të hollësishme të objekteve që përshkruhen.

Në tekstin përshkrues mbizotëron përdorimi i mbiemrave dhe fjalëve përshkruese.

Në funksion të përshkrimit përdoren edhe ndajfolje, parafjalë, fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet. Foljet e përdorura janë në kohën e tashme dhe të pakryer.





Parku i Gërmisë përbëhet nga kodra me lartësi të ndryshme, që ndahen në lugina e lumenj. Në këtë zonë dallohet lugina e Lumit Vellusha, burimi i të cilit ndodhet në pjesën perëndimore të Butovcit dhe përfaqëson pjesën më karakteristike me lartësi mbidetare më shumë se 1000 metra dhe gjatësi të luginës prej 8 kilometrash.

Parku i Gërmisë dallohet për resurse të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitet të pasur. Duke u bazuar në pozitën gjeografike, karakteristikat gjeologjike dhe kushtet klimatike, malet masive të Gërmisë janë të pasura me florë, vegjetacion dhe faunë. Sipas kërkimeve të bëra deri tani, janë identifikuar 610 specie të florës. Këto specie grupohen në 83 familje, 83 specie kërpudhore, 5 specie specifike për këtë zonë dhe 12 bimë mjekësore. Vegjetacioni pyjor i Gërmisë konsiston në 4 lloje pyjesh: dushku hungarez dhe turk (prej 600-700 m), lisi dhe shkoza (800 m), lisi (820-870 m) dhe ahë (1000 m). Vegjetacioni i larmishëm i Gërmisë siguron kushte të mira për një numër të madh specimesh. Për faunën e Gërmisë, bilanci i kërkimeve të deritanishme rezulton me: 5 specie amfibe, 7 specie zvarranike, 19 specie gjitarësh dhe 30 specie të zogjve, si dhe një numër i madh insektesh.

(Përshtatur nga “Plani zhvillimor urban i Prishtinës 2012-2022” dhe nga: <https://sq.wikipedia.org/>)

Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni kërkesave të mëposhtme.
- a) Plotësoni fjalitë:
 Në pjesën verilindore, qyteti i Prishtinës kufizohet me _____
 Kufiri perëndimor i Gërmisë kalon _____
 Kufiri jugor kalon _____
 _____ përfaqëson kufirin verior.
- b) Sa është sipërfaqja e Parkut të Gërmisë? Po maja më e lartë e tij?
- c) Përkruani vegjetacionin e Parkut të Gërmisë.
- ç) Si ndikon ai te fauna e parkut?
- d) Përkruani zonën për rekreacion dhe pushim të Parkut të Gërmisë.

Analizojmë tekstin

- 2 Shënoni me përgjigjet e sakta. Në përshkrimin e mësipërm, autori ka si qëllim:
- të përshkruajë duke informuar publikun;
 - të përshkruajë për t'i dhënë lexuesit kënaqësi estetike;
 - të përshkruajë për të bindur lexuesin rreth çështjes kyçe;
 - të përshkruajë në mënyrë subjektive objektin.
- 3 Shënoni me përgjigjet e sakta. Në përshkrimin e mësipërm, autori përshkruan:
- duke u përqendruar në ndryshimet e parkut në kohë;
 - duke përzgjedhur disa elemente të parkut si më të rëndësishmet e domethënëset;
 - duke e krahasuar atë me një park tjetër;
 - duke u përqendruar në vendndodhjen gjeografike të parkut.

Gjuha e tekstit

- 4 Cila nga kohët e foljes përdoret më shpesh në këtë përshkrim?
- 5 Zëvendësoni togfjalëshat me shkronja të theksuara me sinonimet e tyre:
- Parku i Gërmisë **dallohet për resurse** të trashëgimisë natyrore [...]
 - [...] janë **identifikuar** 610 specie të florës [...]
 - Vegjetacioni i larmishëm** i Gërmisë [...]
 - [...] **bilanci i kërkimeve të deritanishme** rezulton [...]

Reflektojmë rreth tekstit

- 6 Cili mendoni se është lexuesi i synuar i këtij teksti. Pse?
- 7 Raportet më të fundit nga Gërmia janë shqetësuese, pasi një sërë specimesh janë zhdukur. Përkruani me rreth dhjetë fjali pasojat negative të këtij fenomeni.

Detyrë

- Përkruani në mënyrë subjektive Parkun e Gërmisë ose një park tjetër që ju ka lënë mbresa. Bazohuni në perceptimin shqisor për të realizuar një përshkrim të arrirë. Vendosini shkrimin një titull dhe zgjidhni fotografi për ta shoqëruar atë.

Banesa tiranase

Banesa e familjes së njohur Shijaku, e ndodhur në rrugën “Virdar Luarasi”, Nr. 16, është shembull tipik i banesës tiranase. E ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XIX, ajo paraqet fazën më të zhvilluar të kësaj banese. Ajo ka planimetri katërkëndëshe të rregullt me dy kate. Në fazën e parë ka qenë me **çardak** e **hajat** në ballin kryesor. **Dhoma e zjarrit** është bërthama e mjediseve përçark saj. Në katin e parë janë ambientet ndihmëse ndërsa në katin e dytë, ambientet e ndenjjes dhe anekset e shërbimit. Shkallët që ndërlidhin katet janë prej druri. Në fazën e dytë, në fillim të shekullit XX, është bërë një rikonstruksion i mjediseve si dhe mbyllja e çardakut. Këto lloj banesash janë nga llojet më të lashta dhe, nga mënyra e ndërtimit dhe funksionimit, nuk hasen në qytete të tjera të Shqipërisë. Banesa rrethohet me mure qerpiçi dhe hyrja bëhet nëpërmjet portave të mëdha dykanatëshe që janë pothuaj gjithmonë të mbuluara me çati të thjeshtë. Banesa e Shijakasve është shpallur monument kulture i kategorisë së parë në vitin 1973, kurse dhoma kryesore e saj është shndërruar në një galeri arti, ku janë ekspozuar veprat e piktorit Sali Shijaku.




Fjalor

çardak — pjesë e hapur, e rrethuar zakonisht me parrmakë, në katin e dytë të shtëpive të vjetra, që shërbente për të pritur miq ose për të ndenjur në verë.
hajat — shesh përpara derës së një ndërtese, i mbuluar me çati të vendosur mbi shtylla.
dhoma e zjarrit — dhomë me oxhak a me sobë ku zakonisht rrinë anëtarët e familjes në dimër.

Studim teksti

Kuptojmë tekstin

- 1 Vendosni shenjen ✓ për informacionet e vërteta dhe ✗ në rastin e kundërt. Kujdesuni të nënvizoni informacionet që nuk janë dhënë në tekst.

Banesa e Shijakasve daton në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Planimetria e saj është katërkëndëshe e rregullt me dy kate.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Bërthama e mjediseve përçark saj është dhoma e zjarrit.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Banesat me vatër zjarri kryesisht gjenden në zonën e Tiranës dhe në fshatrat përreth saj.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Në katin e parë janë ambientet e ndenjjes dhe anekset e shërbimit.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Në fillim të shekullit të njëzetë është bërë një rikonstruksion i mjediseve, si dhe mbyllja e çardakut.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Këto lloj banesash hasen edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Banesa e Shijakasve është shpallur monument kulture i kategorisë së parë në vitin 1973.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>
Banesat shqiptare dallohen për tipologjitë e tyre të larmishme e të pasura.	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>

Analizojmë tekstin

3 Plotësoni tabelën e mëposhtme. Si realizohet përshkrimi në këtë tekst?

Objekti i përshkruar	Detajet	Shqisat në të cilat mbështetet	Mënyra e organizmit të ideve
_____	_____	_____	Psh.: përshkrim në rend kronologjik
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

Gjuha e tekstit

4 Plotësoni grupet e fjalëve të shkëputura nga teksti, me mbiemrat përkatës. Analizojini ata morfologjikisht.

P.sh.: shembull tipik	fazën _____	planimetri _____	ambientet _____	llojet _____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

5 Në tekstin e mësipërm, krahas mbiemrave përdoren edhe tregues hapësinorë e kohorë, që japin në mënyrë të detajuar vendndodhjen e objekteve të përshkuara. Nënvizojini ata dhe analizojini nga pikëpamja gjuhësore.

6 Shndërrojini fragmentin e mësipërm në një tekst përshkruar subjektiv. Lexoni modelin referues, vijoni edhe me pjesën tjetër, duke u kujdesur që të përdorni sa më shumë shprehje të figurshme.

- ▣ Ajo ka planimetri katërkëndëshe të rregullt me dy kate.
- ▣ Ajo ka një planimetri në formë katërkëndore dhe përsosmërisht simetrike, si dhe dy kate të lartuara nga themelet.

Reflektojmë rreth tekstit

7 A mendoni se këndvështrimi i autorit është i paanshëm? Ku e mbështesni arsyetimin tuaj?

8 Zhvilloni një diskutim me temë: "Arti dhe arkitektura janë pasqyrë e kulturës së një populli". Kujdesuni që secili të sjellë mendimin e vet dhe që informacionet e sjella të jenë të larmishme, brenda kornizës së temës.

Detyrë

- ▣ Mblidhni informacion rreth arkitekturës së qytetit tuaj të pëlqyer dhe shfrytëzoni atë për të krijuar një tekst përshkruar objektiv. Kujdesuni që të organizoni qartë mendimet tuaja.

Shkruajmë ese përshkruese

Eseja përshkruese është një nga llojet e shkrimit joletrar. Qëllimi i saj është të përshkruajë një person, kafshë, vend, ndjesi, objekt etj.

Ajo mund të jetë subjektive ose objektive. Në rastin e parë, autori përshkruan sipas këndvështrimit të tij, ndërsa në të dytin ai përshkruan duke qëndruar besnik i fakteve dhe i paanshëm.

Kur shkruani një ese përshkruese:

- ☉ Sigurohuni që e keni të qartë se çfarë do të përshkruani dhe kush do ta lexojë atë.
- ☉ Një organizues grafik do t'ju ndihmonte në renditjen e fakteve, karakteristikave dhe veçorive që do të përfshini gjatë organizimit të esesë suaj.
- ☉ Përcaktoni idetë kryesore për secilin prej paragrafëve të esesë.
- ☉ Ndërtoni paragrafët, duke filluar secilin prej tyre me nga një fjali-temë dhe më pas thellohuni në detaje teksa zhvilloni mendimet tuaja.
- ☉ Shkruani një mbyllje gjithëpërfshirëse, që paraqet idetë kryesore në lidhje me përshkrimin tuaj.
- ☉ Lexoni me kujdes shkrimin tuaj dhe korrigjoni gabimet e mundshme gramatikore.

1 Lexoni përshkrimin e mëposhtëm. Nënvizoni mbiemrat.

Buzë liqenit të Janinës

Pashai doli në breg të liqenit, ku e priste një barkë. Gjashtë remtarë, të nxirë nga dielli, me llërët përveshur, me kokat të rruara, e pritën me lopatat pezull. Ai u shtrua në sixhade, zbërtheu gjoksin, kërkoi çibukun dhe bëri shenjë të niseshin. Remtarët u dhanë lopatave njëherësh. Ajri ishte i freskët mbi liqen dhe pashai ndihej i gëzuar. Më tepër se gëzimi, ndiente një prehje e qetësi. Shikoi shpatullat e rremtarëve, lëvizjet e përpikta. Kur kthenin kokat, përpiqeshin t'i hidhnin një vështrim me bishtin e syve. Dukej sikur shpejtonin ta nxirnin barkën në bregun tjetër. Pashai mendoi se duhej t'i zëvendësonte me shqiptarë, por nuk iu kujtua asnjë ushtar që të merrte erë nga zanati. Para barkës lundronte një tufë me rosa, e hapur në vijë luftimi. Rrathët që përhapnin në ujë shkonin gjer në buzë të liqenit. Kur largësia ndërmjet tyre dhe barkës po pakësohej, u ngritën fluturim. Në çast u mbush qielli me rosa, pata e shpendë të të gjitha llojeve. Tufa pëllumbash fluturonin akoma më lart me krahët si pare argjendi. Një pjesë e asaj mizërie shpendësh, u kthyen në të majtë dhe u ulën pranë barishteve të blerta, të kuqe e të verdha, që hapeshin rreth bregut si kurorë. Të tjerat fluturuan matanë ishullit dhe u zhdukën rrëzë maleve. Tek-tuk shikoje ende ndonjë zog që nuk vendoste të ndiqte turmën. Gjahu në liqen ishte i madh.



Myftari do të binte aty si dhelpra në pula. Pashai u vu të shihte sipërfaqen e ujit e të gjente me mend se ku do të kërcente prapë peshku tulianos, që rritet gjer në shtatë okë dhe paguhej shtrenjtë në pazar. Aty poshtë ndoshta vërtiteshin ngjalat si litarë të trashë. Tani kurrizi i tyre duhej të kishte marrë një ngjyrë si në të blertë. Peshonin tri okë copa. Po asgjë nuk shihej, sado t'i lodhje sytë. Ujë të trazohej nga rrahja e rremave. Barka po i binte ishullit rrotull. Pashai donte të hidhej njëherë gjer te liqeni i poshtëm e të shihte kanalet e nëndheshme, që lidhnin të dy liqenet, por dielli kishte kaluar kupën e qiellit dhe e la për herë tjetër. Nga ai krahu, ishulli ishte i veshur me shkëmbinj. Aty-këtu bënte hije ndonjë lis i veçuar. Krahu tjetër e mbulonte bari i njomë dhe lulet. I gjithë ishulli i ngjante një mali të vogël të rënë në anë të liqenit. Ai shëtiti nën lisat dhe selvitë. Më poshtë shelgjet lëshonin degët në ujë. Gjatë bregut jugor ishin renditur kasollet e peshkatarëve, si me themelet në liqen, nja pesëdhjetë banesa, në mes të rrjetave dhe drurëve. Më poshtë dukej një rrip ranishte, me dy shtëpi të bukura prej druri të rrethuara me gardhe, tarracat e mbjella me lule dhe rrugicat e shtruara me zhavorr. Ishin shtëpi verimi të pasanikëve të Janinës.

Sabri Godo

- 2 Dalloni fjalitë përshkruese që janë bazuar në perceptimin shqisor. Për çdo rast, përcaktoni shqisën që ka përdorur autori.
 - 3 Ku ndryshon përshkrimi i mësipërm nga ai i Liqenit të Shkodrës? Si arritët në këtë përfundim?
 - 4 Zgjidhni njëren prej temave të mëposhtme dhe shkruani një ese përshkruese.

<i>Nata e Vitit të Ri</i>	<i>Një udhëtim i mrekullueshëm</i>
<i>Personi që admiroj</i>	<i>Adoleshenca</i>
<i>Kostumet popullore shqiptare</i>	<i>Fototeka Marubi</i>
- Përdorni një organizues grafik për të realizuar një shkrim sa më të mirorganizuar. Një model i tij paraqitet më poshtë.

Paragrafi hyrës

Çfarë do të përshkruaj?	
Si do ta organizoj këtë ese? (<i>hapësira, koha dhe rendi i përshkrimit</i>)	

Paragrafi i parë i zhvillimit

Detaje shqisore	shembuj specifikë
Figura letrare	shembuj specifikë

Paragrafi i dytë i zhvillimit

Detaje shqisore	shembuj specifikë
Figura letrare	shembuj specifikë

Mbyllja

Pse ka rëndësi për ju objekti i përshkruar?	
Çfarë doni që të mendojnë lexuesit për këtë objekt?	

Histori gjuhe

HISTORI GJUHE

Studion zhvillimin historik të një gjuhe në mënyrë që të shpjegojë gjuhën që përdoret sot.

Gjuha e folur

Gjuha e shkruar

Format e para të shkrimit njerëzor

Dokumentet e para të shkrimit shqip

Formula e Pagëzimit
Fjalori i Arnold Fon Harfit
Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve

Gjuha si mjet komunikimi gojor dhe shkrimor

Gjuha është mjeti themelor i komunikimit për shoqëritë njerëzore. Ajo mund të përdoret në formën e saj të folur dhe të shkruar. Ky pohim nuk vlen për prerje të thella kronologjike, pasi, siç dihet, shoqëritë primitive njerëzore kanë pasur si mjet komunikimi vetëm gjuhën e folur, ndryshe nga shoqëritë e mëvonshme, të cilat, krahas komunikimit gojor, përdorën shenja të ndryshme komunikimi, derisa erdhën te shkrimi.

Forma shkrimore e gjuhëve u parapri nga vizatime që njeriu primitiv bënte në shpella dhe në gurë. Në këtë fazë nuk mund të flitet për shkrim të mirëfilltë, pasi shkrimi nënkupton një lidhje të caktuar mes fjalëve, shprehjeve të një gjuhe dhe simboleve që lidhen me to. Për një kohë relativisht të gjatë, shkrimit i paraprinë piktura të ndryshme në eshtra, guaska, pllaka argjile etj., si forma komunikimi që zëvendësonin atë gojor. Shkrimi piktografik dallon shumë nga përbërja tingullore e fjalës. Për shembull, për përdorimin e fjalës *pemë*, nga komunikimi primar, vetëm gojor, u kalua në shkrimin piktografik, pra, duke vizatuar formën e një peme, për të ardhur më vonë në përbërjen tingullore të fjalës, pavarësisht alfabetit në përdorim. Sot, përdorimin e piktogrameve e hasim dendur në sinjalistikën rrugore. Kështu, imazhi i një kafshe në shenjat rrugore, paralajmëron drejtuesit e mjeteve për mundësinë e pranisë së kafshëve në rrugë.



Shkrim i qytetërimit
sumer, 3 300 vjet pr.K.

Sado që kalimi nga përdorimi vetëm gojor i gjuhës, drejt komunikimit me shkrim ka luajtur një rol themelor në zhvillimin dhe modernizimin e shoqërisë njerëzore, gjuha e folur mbetet parësore kundrejt gjuhës së shkruar. Shkrimi varet nga gjuha e folur dhe jo anasjelltas. Gjuha e folur, ekzistenca e së cilës mund të kërkohet që në fillesat e shoqërisë njerëzore, është shumë më e hershme se forma shkrimore e saj.

Dokumentimi i shkrimit të gjuhës shqipe

Dokumentimi i shkrimit të gjuhës shqipe është relativisht i vonë, ndonëse shqipja është një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Deri më sot, mund të flasim për dëshmi shkrimore të shqipes, që datojnë jo më herët se shekulli XIV, ndonëse ka shumë gjasa që kjo gjuhë të jetë shkruar shumë kohë më parë.

Në të mirë të kësaj teze flet dëshmia e një kleriku frëng, Guljelmus Ade (Guillelmus Adae, i njohur ndryshe si Brokardus Monakus - Brocardus Monacus). Në veprën e tij të botuar në vitin 1332, ndër të tjera ai shkruan: “Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin, në përdorim dhe në tërë librat e tyre”. Nga kjo dëshmi del në pah fakti se jo vetëm që shqipja është shkruar para shekullit XIV, por madje ka pasur edhe libra në këtë gjuhë. Këta libra mund të kenë qenë anale apo kronika të ndryshme të kohës së shtetit të parë të Arbrit, të themeluar rreth shekullit XII.

Dokumentet e para të shkrimit shqip i përkasin thuajse tërësisht sferës fetare. Kjo mund të shpjegohet me rrethanat historike të shoqërisë shqiptare. Pushtimi osman, që krahas të tjerave u shoqërua edhe me islamizimin e popullsisë shqiptare, ishte një kërcënim serioz për të ardhmen e krishterimit, qoftë lindor, qoftë perëndimor, në këto troje. Përfaqësuesit vendas të kulturës së krishterë ishin në shërbim të mbrojtjes së traditës dhe të kulturës së tyre fetare. Për këtë arsye, për t'i ardhur në ndihmë popullsisë, u bënë përpjekje për të sjellë në gjuhën shqipe pjesë nga liturgjitë e ndryshme fetare, çka shërbente njëkohësisht edhe për ruajtjen dhe mbijetesën e gjuhës shqipe, e cila u vu përpara kërcënimit serioz të zhdukjes së plotë të saj.

Lexo më shumë në: https://www.gazetaexpress.com/arte/arti-i-fjales-dhe-gjeneza-e-shkrimit-158734/?archive=1?utm_source=referral&utm_medium=web&utm_campaign=copyright

USHTRIME

- 1 E vërtetë ✓ apo e gabuar ✗?

<input type="checkbox"/>	✓	✗
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
- 2 Në ç'periudhë datojnë dëshmitë e para shkrimore të gjuhës shqipe?
- 3 Cilës sferë i përkasin dokumentet e para të shkrimit shqip dhe pse?
- 4 Hartoni një tekst me temë: “Ndikimi i shkrimit në zhvillimin e shoqërisë njerëzore”.

Dokumentet e para të shkrimit shqip

Formula e Pagëzimit

Deri më sot, dokumenti i parë i shkrimit të gjuhës shqipe njihet e ashtuquajtura “Formula e Pagëzimit”, shkrimi i së cilës daton në vitin 1462. Autori i saj është Pal Engjëlli, i cili jetoi rreth viteve 1417-1470. Pal Engjëlli ishte prift katolik, Arqipeshkëv i Durrësit dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut. Siç u përmend më lart, në kohën kur ai jetoi dhe shërbeu si meshtar, kisha përballej me vështirësi të mëdha. Duke qenë Arqipeshkëv, një ndër shkallët më të larta të klerit katolik, ai përpiqet t’i vijë në ndihmë organizimit të kishës dhe besimtarëve të krishterë, për të mos e humbur besimin e tyre. Kështu, gjatë një vizite baritore në krahinën e Matit, duke vënë re vështirësinë e funksionimit të kishave dhe mungesën e priftërinjve, ai lëshon një qarkore dhe disa udhëzime, të cilat edhe u shkruan në latinisht, për t’i ardhur në ndihmë klerit katolik të asaj zone. Një ndër këto udhëzime kishte të bënte me rastet kur pagëzimi nuk mund të kryhej në kishë, ose kur nuk kishte prift. Për raste të tilla, Arqipeshkvi lejon që pagëzimin ta bëjnë vetë laikët, pra, prindërit mund t’i pagëzonin vetë fëmijët e tyre, duke e përdorur shqip formulën, të cilën e shkruan kështu:

“Vnte’ paghesont premenit Atit et Birit et Spertit Senit”

(Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjtë).

Ky dokument u shkrua në dialektin e veriut (gegërisht) dhe me alfabetin latin. Ekzistenca e shkrimit të “Formulës së Pagëzimit”, në shqip, u zbulua jo më parë se në vitin 1915. Ajo u gjet në Bibliotekën “Laurentiana”

ulgari Albanico. Vnte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit. Et q. si quis hoc modo baptizatus fuerit iterum non rebaptizetur sed sufficit unius orationis et qd. dmissum est verum si dubitaretur. An uerba ista prolata fuerint a

të Firences, nga historiani i njohur rumun Nikola Jorga (Nikolla Jorga) dhe është botuar prej tij në vitin 1915.


Fjalori i Arnold von Harfit (1497)

Arnold von Harfi (Arnold von Harff, 1417-1505) ishte një qytetar gjerman, i cili në vitin 1496, ndërmori një pelegrinazh nga Këlmi, qytet në veri të Gjermanisë, drejt tokës së shenjtë, në Palestinë, udhëtim që e kreu për tre vjet. Gjatë udhëtimit të tij, ai shfaqti interes jo vetëm për vendet e ndryshme që vizitonte, por edhe për gjuhën e tyre. Kështu, ai hartoi një fjalorth me fjalë dhe shprehje në gjuhët e këtyre vendeve, si: në kroatisht, shqip, greqisht, hebraisht, turqisht etj. Fjalori i tij përmban kryesisht fjalë rreth të ushqyerit,

65			
cianeren, licht in Albanen eyn lantschaft.			
Item van Dulcina zo Duratzo		lxix mijlie.	
voeren wir gar mit boesen wyndt. dit is eyn groyse verstoerde stat van deme Turcken, yetzoet vnderworfen den			
5 Venecianern. item dese stat licht in Albanien dae sij ouch eyn eygen sprache hayt, der man nyet wael geschriuen en kan, as sij goyn eygen litter in deme lande en hauen.			
item van deser albanyscher sprachen haya ich etzliche woert behalden, as mit namen sij hie vnden geschreuen			
10 staynt nae vnzx littenen zo schriuen.			
Item albanische sprache.			
Item boicke broyt	fijet	slaffen	
vene	wijn	mirestrasse	guden morgen
oie	wasser	myrprama	guden nacht
15 mische	fleysch	meretzewen	guden daich
jat	kese	ake ja kasse zet ve	wat haista
foelje	eyer	dat mir beult	
oitter	essich	kess felgen gyo kaffs	wat gylt dat
poyle	eyn henne	do daple	ich wyl it geiden
20 pyske	vyssche	laff ne kammijss	wessche mir
krup	sals	mijn hempt	
myr	goyt	ne kaffs,	wie heyscht dat
kyeke	baesse	Tzellen.	
megarune	essen	nea	eyn
25 pijn	drincken	dea	tzwey
tauerne	eyn wirthuys	trij	drif
geneyre	eyn man	quater	vier
growa	eyn frauwe	pessa	vunff
denarye	wijsgelt	jast	sees
30 sto	ja	statte	seuen
jae	seyn	tette	acht
crise	got	nante	nyune
dreck	der dunel	dieta	tzien
kijrij	eyn kertz	nijtgint	hundert
35 kale	eyn pert	nemijgo	duesent
elbe	haue		
Item van Duratzo zo Saseno		lxix mijlie	
voeren wir in vunff vren. dit is gar cyne gude portz des			
mers. item dyt Saseno is gar eyn kleyn insel des Tur-			
40 cken. item hie off lijgen gar kleyne tzwee capellen,			
5			

boicke	bukë
vene	verë
oie	ujë
mische	mish
jat	djathë
foeije	vezë
krup	kripë
myr	mirë
kyckge	keq
megarune	me
groëa	ngrënë
jae	grua
kale	jo
nea	kalë
dua	një
trij	dy
quater	tri
pessa	katër
jast	pesë
statte	gjastë
tette	shtet
nante	tetë
dieta	nëntë
nijtgint	dhjetë
nemijgo	njëqind
	një mijë

përshëndetjeve të ndryshme, numrave, nevojave të udhëtimit etj. Në shkrimet e tij, Arnold von Harfi përdor alfabetin latin. Gjatë vitit 1497, ai kalon në bregdetin shqiptar, konkretisht në Ulqin, Durrës dhe Sazan. Kur tregon për udhëtimin e tij nga Ulqini në Durrës, e përshkruan Ulqinin si një qytet të bukur, nën juridiksionin e Venedikut, por tashmë të shkatërruar nga turqit.



Krahas përshkrimit të vendeve në trojet shqiptare, ai shënoi edhe disa fjalë të gjuhës shqipe, gjithsej 26, tetë shprehje, numrat nga një deri në dhjetë, numrat 100, 1000, të cilët i shoqëroi me përkthimin në gjermanisht. Fjalët dhe shprehjet i përkasin përdorimit të përditshëm. Më poshtë po sjellim disa prej tyre (djathtas – lista e sjellë nga Arnold von Harfi, majtas – rishkrimi i fjalëve sipas normës së sotme letrare).

Përshtypjet e udhëtimit të tij trevjeçar, Arnold von Harfi i hodhi në një dorëshkrim në gjuhën gjermane. Ky dorëshkrim u botua vetëm në vitin 1860, thuajse tre shekuj e gjysmë më vonë nga koha kur u hartua. Brenda këtij dorëshkrimi gjendet edhe ky fjalorth i vogël i gjuhës shqipe, i cili fiton një vlerë të veçantë, si dëshmi e shkrimit të gjuhës shqipe.



Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve

Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve është teksti i parë shqip i shkruar me shkronjat e gjuhës greke. Ky tekst i shkruar në një fletë, ndodhej brenda një kodiku greqisht, i cili i përket shekullit XIV. Ky kodik u gjend në Bibliotekën Ambroziane të Milanos. Në njërën anë të fletës është shkruar një pjesë nga Ungjilli i Mateut (XXVII, 62-66), ndërsa në anën tjetër të saj, gjendet një këngë pashkësh, e shkruar me alfabetin grek dhe në dialektin e Jugut.

Sipas studiuesit Xhevat Lloshi, teksti i fletës është hartuar për t'u përdorur në shërbesë ditën e Pashkëve, madje i kënduar, prandaj shoqërohet me nota muzikore. Pjesa nga ungjilli i Mateut është e përkthyer në shqip, për të shërbyer si parapërgatitje për këndimin e vargjeve.

Nisur nga analiza gjuhësore e tekstit në fjalë, studiuesi Lloshi gjykon se ky shkrim nuk mund të datojë para shekullit XVI. Lidhur me rrugëtimin e tij, mendohet se kodiku i shkruar në greqisht, brenda të cilit ndodhej kjo fletë, mund të ketë përfunduar në Itali, i shpënë atje nga shqiptarë, të cilët u shpërngulën nga vendi pas vdekjes së Skënderbeut.

Shkrime dhe libra të mëvonshëm në gjuhën shqipe, nga shekulli XVI e tutje, vijnë nga autorë të vjetër, si: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Lekë Matrënga etj.



USHTRIME

- 1 E vërtetë ✓ apo e gabuar ✗?

<input type="checkbox"/> Gjuhë të ndryshme mund të shkruhen me të njëjtin alfabet.	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/> E njëjta gjuhë mund të shkruhet me alfabetë të ndryshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/> Gjuha shqipe është shkruar me alfabetë të ndryshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
- 2 Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

<input type="checkbox"/> Cili është dokumenti i parë i shkrimit shqip? Çfarë shkruhet në të dhe kush është autori i tij?		
<input type="checkbox"/> Për ç'qëllim e shkroi Arnold fon Harfi fjalorthin e tij? A përkon viti i botimit me vitin e hartimit të tij?		
<input type="checkbox"/> Në ç'dialekt të shqipes u shkrua Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve? A njihet autori i saj?		
<input type="checkbox"/> Cili prej dokumenteve të para të shkrimit shqip u shkrua me alfabet latin dhe cili me alfabet grek?		
- 3 Shkruani një tekst të shkurtër me temë: "Rëndësia e dokumentimit me shkrim të një gjuhe".

Njohuri për gjuhën



1 Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit

Mbani mend ▶

Shenjat e pikësimit mund t'i ndajmë në shenja pikësimi që përdoren brenda fjalisë dhe në shenja pikësimi që përdoren në fund të saj.

Shenjat e pikësimit që përdoren brenda fjalisë

/	<p>Presja është një shenjë që përdoret në gjuhën e shkruar për të ndarë a veçuar fjalë a grupe fjalësh të një fjalie:</p> <p><i>Kënga e saj, sado që u interpretua bukur, nuk më la mbresa.</i></p> <p>Në gjuhën e folur, ajo i përgjigjet një pushimi të shkurtër.</p>
;	<p>Pikëpresja ndan më prerë se presja pjesë të ndryshme të pavarura të një fjalie të përbërë:</p> <p><i>Ky me katër veta u vendos kundrejt kryeportës së kështjellës; të tjerët kundrejt livadhishtave nga ana e Tiranës.</i></p> <p>Në gjuhën e folur, ajo shënon një pushim më të gjatë se presja.</p>
- " "	<p>Vizat dhe thonjëzat kryesisht shërbejnë për të dalluar fjalët e një ose më shumë bashkëbiseduesve në një ligjëratë të drejtë. Për shembull:</p> <p><i>– la dhe lajmin Benit?</i></p> <p><i>– Po. Unë i thashë: "Kemi lajme të reja."</i></p> <p><i>Nga dy vizat e përdorura në këtë dialog, kuptojmë që bëhet fjalë për dy folës të ndryshëm. Pjesa e futur mes thonjzave sjell një riprodhim të saktë të fjalëve të përdorura nga folësi në një situatë tjetër komunikimi.</i></p>
:	<p>Dy pikat lajmërojnë një shpjegim, një varg shembujsh etj.:</p> <p><i>Ata që morën pjesë në shfaqjen e shkollës ishin: nxënësit, familjarët, mësuesit, drejtuesit e shkollës etj.</i></p> <p>Në gjuhën e folur, dy pikat shënojnë një pushim që zgjat thuajse sa pikëpresja.</p>
()	<p>Kllapat shërbejnë për të dalluar, shquar dhe veçuar një grup fjalësh që shprehin një sqarim ose një mendim të ndërkallur:</p> <p><i>Më është dashur të dal hapur (mirë apo keq nuk e di) si një luftëtar i lirisë.</i></p> <p>Në gjuhën e folur, ato shënojnë një pushim të shkurtër, si presja.</p>

Shenjat e pikësimit që përdoren në fund të fjalisë

.	<p>Pika shënon intonacionin zbritës që shoqëron zakonisht fundin e fjalisë dëftore:</p> <p><i>Nuk e përfytyronte dot ndryshe Erlisin, veçse të qeshur e hokatar.</i></p>
?	<p>Pikëpyetja shënon përfundimin e një fjalie që shqiptohet me intonacion ngjites:</p> <p><i>Kur do ta pranosh se kjo është e vërteta?</i></p>
!	<p>Pikëçuditja shënon përfundimin e një fjalie që shqiptohet me intonacion të veçantë për të shprehur një emocion (gëzim, hidhërim, kundërshti, zemërim):</p> <p><i>Sa ma bëtë qejfin që erdhët!</i></p>
...	<p>Trepikëshi shënon lënien jashtë tekstit të një pjese të tij për arsye të ndryshme:</p> <p><i>Atëherë nesër në mesditë...</i></p> <p>Në gjuhën e folur, trepikëshi shënon ndërprerjen e ligjëritimit.</p>

USHTRIME

1 Vendosni thonjëzat në fjalitë e mëposhtme.

Agimi tha: Kjo ngjarje nuk do të përsëritet më në të ardhmen.
 Ndeshja më interesante e këtij sezoni do të zhvillohet në stadiumin Qemal Stafa.
 Gazeta Ekonomia nuk është për publikun e gjerë, por për një publik të specializuar.
 Ne jemi nxënës të klasës së nëntë në shkollën Fan Noli.

2 Vendosni dy pikat atje ku duhen.

Skënderbeu u përgjigj "Lëreni të shkojë...!"
 Unë vazhdoj t'i qëndroj mendimit për të pasur një vijueshmëri të suksesshme
 ne duhet të kemi edhe një ofertë ekonomike intriguese.
 Ai tha "Ky libër më pëlqen shumë."
 Kjo substancë gjendet në shumë produkte ushqimore, si qumësht, mish, misër, arra etj.
 Fshatari pyeti "Kur niset treni?"

3 Vendosni shenjat e pikësimit në dialogun e mëposhtëm.

- Ç'duan që vijnë në dasmat tona pyeti njëri nga djemtë e rinj
 Shët, se është turp
 Çfarë turpi pyeti një tjetër. Guxojnë edhe të ngrihen në valle
 Nuk mund t'i dëbonim. Kështu është zakoni i të parëve
 Ç'zakon Po për Nicën e shkretëtë, ç'thotë zakoni i të parëve
 Shët, se mos dëgjojnë
 Mos ki frikë u hodh një tjetër edhe sikur të dinin shqip, nuk do të kuptonin asgjë nga brenga e saj

4 Vendosni në tabelën e mëposhtme shenjat e pikësimit që përdorët në ushtrimin 2.

Shenja pikësimit që përdoren brenda fjalisë	Shenja pikësimit që përdoren në fund të fjalisë

5 Vendosni shenjat e pikësimit në tekstin e mëposhtëm.

Njerëzit që dilnin nga shfaqja kaluan nga trotuari duke kënduar me zë të ulët ose sa u hante fyti
 O engjëll i bukur, Luçia ime
 Atëherë Leoni, për t'u treguar si njohës arti, zuri të fliste për muzikën
 Ai kishte parë Tamburinin Rubinin Persianin Grisin pra në krahësim me ta Lagardi, me gjithë zërin buçitës që kishte s'ishte gjë fare
 Sidoqoftë ia preu fjalën Sharli, që e kafshonte çikë e nga një çikë akulloren e tij thonë që në aktin e fundit është me të vërtetë i mahnitshëm

6 Gjeni ku janë përdorur gabim shenjat e pikësimit. Shkruajini si duhet ato.

"Harabeli" nuk është shpend migrues.
 Studentët kanë një skuadër me emrin e vet "Studenti".
 "Skënderbeu" tha: Mos i besoni armikut, besoni vetëm te shpata dhe mendja juaj.
 "Gazeta" Flamuri i Arbrit është botuar nga De Rada.

7 Shkruani një tekst të shkurtër, në të cilin të përdorni shenjat e pikësimit që përdoren brenda fjalisë, si dhe shenjat e pikësimit që përdoren në fund të saj.

Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë

- ✿ Lexoni tekstin. Si është i ndërtuar ai? Nënvizoni fjalitë që thonë personazhet. Çfarë fjalish përdoren, të thjeshta apo të përbëra? Qarkoni shenjat e pikësimit.

Megjithatë, s'isha i kënaqur. Nxora një ofshamë dhe po vrisja mendjen.

– Ç'ke?! – më pyeti Ylli. La hapur librin "Zemra" të De Amiçit dhe m'u afrua.

E vështroi vizatimin tim për një kohë të gjatë me sy të picërruar dhe tha:

– Mirë e ke bërë. Gjithçka që të shikon syri këtu në plazh, ti e ke hedhur bukur në letër. Vetëm njerëz nuk paske fare te vizatimi yt! Pa njerëzit, deti dhe rëra duken të shkretë. Hë, keq e kam?! Ç'thua?

– Për këtë po vrisja mendjen e s'po e gjeja dot!

(*"Udhëve të fëmijërisë", Ramadan Pasmaçiu*)



Vini re:

Në **ligjëratën e drejtë**, fjalët e një folësi ose tonat shkruhen në formë të pandryshuar. Fjalët ritregohen ose riprodhohen siç janë thënë në fillim, pa asnjë ndryshim.

Ligjërata e drejtë përbëhet nga dy pjesë: **pjesa lajmuese** (fjalët e autorit) dhe **pjesa përmendëse** (fjalët e riprodhuara).

Në të shkruar, ligjërata e drejtë dallohet nga shenjat e pikësimit.

Nëse pjesa lajmuese ndodhet para pjesës përmendëse, pas saj vihen dy pikat, ndërsa pjesa përmendëse (fjalët e riprodhuara) mbyllet në thonjëza. Para thonjzave mbyllëse vihet pikë, pikëpyetje, pikëçuditje, tri pika.

Mësuesi u tha: *"Lexoni me kujdes pyetjet për provimin e gjuhës."*

Nëse pjesa lajmuese ndodhet pas pjesës përmendëse, përpara saj vihet vizë. Kur brenda thonjzave që mbyllin pjesën përmendëse (fjalët e riprodhuara) është përdorur pikëpyetja, pikëçuditja ose tri pikat, pas thonjzës vihet vetëm vizë. Kur brenda thonjzave ndodhet një fjali dëftore, pas thonjzës vihet presje dhe vizë.

*"Djalë, kjo këshillë vlen më shumë se gjithçka që do të të thosha", – tha mësuesi.
"T'i ketë ndodhur diçka e të mos na ketë thënë?" – pyeste veten ajo.*

Kur pjesa lajmuese ndodhet në mes të pjesës përmendëse, thonjzat hapen në fillim dhe mbyllen në fund të ligjëratës së drejtë, kurse para dhe pas pjesës lajmuese vihet presje dhe vizë.

"Si të gjithë, – i tha mësuesi, – dhe ti si shokët, por Borën mos e lër pa shkollë."

USHTRIME

- 1 Nënvizoni shenjat e pikësimit, duke shpjeguar përdorimin e tyre. Në secilën ligjëratë të drejtë, dalloni pjesën lajmuese. Shpjegoni përdorimin e shenjave të pikësimit.
 - ▣ *Kur ishin duke u shpërndarë, xha Trifoni tha: "Ne babagyshërve na është bërë zakon, para se të flemë, t'u tregojmë nipërve ndonjë përrallë."*
 - ▣ *"Skënderbeu ka goditur dhe ka shkatërruar karvanët e venedikasve, që po na sillnin furnizimet", – tha kryeveqilharxhi.*
 - ▣ *"Populli shqiptar, – deklaroi Ismail Qemali, – na zgjodhi dhe na dërgoi ne në këtë mbledhje, që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut."*
 - ▣ *"Miq të e mi, – u përgjigj Isa Boletini, edhe ai më këmbë e me burrnin, – unë nuk ndahem nga populli."*
 - ▣ *"Ishim të rrethuar, – tha ai. – Na duhej të çanim pa bërë zhurmë."*
 - ▣ *"Bredhi i bardhë nuk rritet në pyllin tonë, – tha përgjegjësi, – rritet në vendet e larta malore."*
- 2 Secilën ligjëratë të drejtë të ushtrimit të 1, rishkruajeni duke ndryshuar vendin e pjesës lajmuese. Kujdes përdorimin e shenjave të pikësimit.
- 3 Krijoni dhe shkruani tri ligjërata të drejta. Përdorni shenjat e pikësimit që duhen.
- 4 Në pjesën me titull "Ciklopi", shkëputni një dialog me 3-4 replika. Secilën nga replikat shkruajeni si ligjëratë të drejtë. Argumentoni vendosjen e shenjave të pikësimit në ligjëratat e drejta.

Përdorimi i drejtë i ligjëratës së zhdrejtë

Ç'ndryshime bëni në fjalitë e mëposhtme. Diskutoni rreth tyre.

"Kadareja është shkrimtari im i preferuar", – tha ajo.

Ajo tha se Kadareja ishte shkrimtari i saj i preferuar.

"Drini s'do të na lërë në baltë", – i tha me vendosmëri Anisa.

Anisa i tha me vendosmëri se Drini s'do t'i linte në baltë.

Vini re:

Në **ligjëratën e zhdrejtë**, fjalët e një tjetri a të vetë folësit shkruhen në formë të ndryshuar, por duke e ruajtur të paprekur kuptimin e tyre.

Gjatë kalimit nga ligjërata e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë, ndodhin ndryshimet e mëposhtme në formë.

Nuk përdoren dypikëshi dhe thonjëzat, por shtohen lidhëzat:

Ligjëratë e drejtë

"Në ç'shkollë je?" – e pyeti shkrimtari vajzën.

Ligjëratë e zhdrejtë

Shkrimtari e pyeti vajzën **se** në ç'shkollë ishte.

Pyetja, e shprehur me anë të ligjëratës së zhdrejtë, quhet pyetje e zhdrejtë. Në fund të pyetjes së zhdrejtë nuk vihet pikëpyetje.

Foljet dhe përemrat vetorë e pronorë të vetës së parë apo të dytë kthehen në vetën e tretë:

Ligjëratë e drejtë

Vjollca tha: "Motra **ime** është studente."

Ligjëratë e zhdrejtë

Vjollca tha se motra **e saj** ishte studente.

Ndryshon koha e foljeve:

Ligjëratë e drejtë

Erti i tha shokut të tij: "Nuk **humbe** kohë, por fole menjëherë me të".

Ligjëratë e zhdrejtë

Erti i tha shokut të tij se nuk **kishte humbur** kohë, por **kishte folur** menjëherë me të.

Fjalët *ky, kjo, këtu, kënde, kështu*, në ligjëratën e zhdrejtë zëvendësohen përkatësisht nga fjalët: *ai, ajo, aty, andej, ashtu*:

Ligjëratë e drejtë

Ajo tha: "**Ky** libër më pëlqen shumë."
"Ka ndonjë hotel **këtu** pranë? – pyeti pas pak.

Ligjëratë e zhdrejtë

Ajo tha se **ai** libër i pëlqente shumë.
Pas pak pyeti nëse kishte ndonjë hotel **aty** pranë.

Kur ligjëratë e drejtë është fjali pyetëse, nxitëse apo dëshirore, në ligjëratën e zhdrejtë zakonisht përdoren folje, si: *pyes, urdhëroj, uroj* etj.

Ligjëratë e drejtë

"Ke ndonjë ide tjetër?" – i **tha** dikush muratorit.
"Nga të kaloj?" – **tha** Albana.


Ligjëratë e zhdrejtë

Dikush e **pyeti** muratorin nëse kishte ndonjë ide tjetër.
Albana **pyeti** nga të kalonte.

USHTRIME

- Secilën ligjëratë të drejtë kthejeni në ligjëratë të zhdrejtë. Shpjegoni ndryshimet në formë për secilin rast.
 - Abdyl Frashëri ka thënë: "Të bashkohemi në një besë të gjithë shqiptarët."
 - Skënderbeu tha: "Lajmëroni fitoren dhe ndizni zjarret që t'i bëhet dritë popullit."
 - Populli thotë: "Më mirë një vezë sot se një pulë mot."
 - "Ku do të shkojmë?" – pyeti Edlira.
- Ligjëratat e zhdrejta kthejini në ligjëratat të drejta. Përdorni shenjat e pikësimit që duhen.
 - Më në fund, Artani më premtoi se do të më gjente dhe mua një libër si të tijn.
 - Vajza iu afrua një kalimtarit të rastit dhe e pyeti se nga duhet të kalonte për të mbërritur te stacioni i autobusëve.
 - I thashë se doja t'i njihja nxënësit, punët e tyre.
 - Ejona tha se ai libër i pëlqente shumë.
 - Besmira na tha se edhe një mijë pengesa sikur t'i dilnin përpara, ajo do t'i kapërcente me guxim.
 - Mësuesi u kërkoi nxënësve të nxjerrin përqindjen e normës së interesit, bazuar në të dhënat e ushtrimit.
 - Përfaqësuesi i agjencisë së udhëtimit u tha të mos lëviznin nga vendi, derisa të mbërrinin ekskursionistët e tjerë.
 - Babai i rikujtoi djalin se, që kur ishte kthyer nga emigracioni, kishte ndryshuar shumë.
- Përkruani një situatë të jetës së përditshme duke përdorur ligjëratat të drejta, ligjëratat të zhdrejta dhe një dialog me 4-5 replika.

Drejtshkrimi i fjalëve ku takohen dy zanore

 Qarkoni fjalët e shkruara saktë.

diell, e djel, ndiej, nxierr, alkohol, pavijon, ndiva, përkthyer, kaisi, aksion, milion, portier, trajner, medalie, parandjenja, e ndieshme, edukues, i vazhdueshëm, arsyje, ngjyjej

Shkruhen me ie:

Emrat te të cilët grupi i zanoreve **ie** ndiqet nga një prej bashkëtingëlloreve **l, ll, r** dhe të gjitha fjalët e formuara prej tyre:

miell, qiell, diell, diellor etj.

Foljet te të cilat ky grup i zanoreve ndiqet nga mbaresa **j**:

përziej, përzierë, ziej, ziente, ndiej, (kam) ndier.

Shkruhen me je dhe jo me ie:

Të gjitha fjalët e formuara nga folja "ndiej":

i ndjeshëm, ndjesi, ndjenjë, parandjenjë.

Shkruhen me oo:

Fjalët e huaja me **-oo-** shkruhen me **-oo-** edhe në gjuhën shqipe:

alkool, kooperativë, koordinatë, zoolog etj.

Zanoret e njëjta

Në disa fjalë të gjuhës shqipe shpesh hasen njëra pas tjetrës dy zanore të njëjta. Në këto raste ato shkruhen që të dyja:

i paaftë, i paafrueshëm, i paanshëm, paanësi etj.

USHTRIME

1 Në vend të pikave, vini shkronjën e duhur dhe nënvizoni grupin e zanoreve.

eksper...encë

jo...bjektiv

var...ant

kalc...um

eku...valent

z...oteknik

arter...e

port...er

ambi...nt

jo...rganik

përz...er

k..alic...on

ek...ilibër

aks...omë

i p...armatosur

akuar...um

2 Shkruani fjalët nga të cilat janë formuar fjalët e prejardhura të mëposhtme.

i arsyeshëm, i pathyeshëm, i përmuajshëm, huazim, pyetje, qiellor, diellor, mësues, i paharrueshëm, shkruese, vetëmohuese, arsyetim

3 Formoni mbiemrat nga foljet dhe krijoni fjali me ta.

shkruaj _____

pëlqej _____

përpunoj _____

dëgjoj _____

bluaj _____

ndiej _____

Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupet ye, ua, ue

Grupi i zanoreve ye:

Shkruhet i plotë te fjalët:

arsye, i arsyeshëm, dyer, fyell, lyej, pyes, pyetje, thyej, thyesë.

Grupi i zanoreve ua:

Shkruhet i plotë në trup të **emrave** dhe **mbiemrave**:

ftua, grua, muaj, përrua, i huaj, i përmuajshëm.

Shkruhet i plotë te foljet me temë më **-ua**:

shkruaj, shkruajmë, shkruani, bluaj, bluajmë, bluani.

Shkruhet i plotë në numrin shumës të kohës së kryer të thjeshtë, te habitorja dhe te pjesoret e foljeve me temë më **-o**:

mësuam, punuat, lexuan; mësuakam, punuake; mësuar, punuar, lexuar.

Grupi i zanoreve ue:

Shkruhet i plotë tek emrat dhe mbiemrat foljorë, të formuar me prapashtesat: **-s, -shëm**:

edukoj – edukues; gatuj – gatues; mësoj – mësues; ndërtoj – ndërtues; shkruaj – shkrues; afroj – i afrueshëm; gëzoj – gëzueshëm; vazhdoj – vazhdueshëm; shoqëroj – shoqërueshëm.

USHTRIME

1 Vendosni në tabelë fjalë që të kenë grupin zanor përkatës.

<i>grupi ye</i>	<i>grupi ua</i>	<i>grupi ue</i>

2 Në vend të pikave, vini shkronjën e duhur dhe nënvizoni grupin e zanoreve.

th...erja

gërr...erja

mës...es

lak...es

ft...a

përr...a

drag...a

gr...a

lang...a

ndërr...es

kërk...es

pastr...es

dysh...es

f...erja

f...ell

ars...e

3 Përshkruani peizazhin e fotografisë, duke përdorur sa më shumë fjalë në të cilat takohen dy zanore.



Drejtshkrimi i fjalëve të huazuara nga gjuhët e huaja

Fjalët me prejardhje të huaj që kryesisht i takojnë terminologjisë tekniko-shkencore, shkruhen sipas rregullave të mëposhtme të gjuhës shqipe.

Fjalët me burim nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja

Shkruhen me **d, t** dhe jo me **dh, th** fjalët ndërkombëtare me burim nga greqishtja e vjetër:

dekagram, dekametër, demokraci, diplomë, hidrogjen, ortopedi, pedagog; antipati, antologji, aritmetikë, etnografi, liturgji, maratonë, telepati, terapi, termik etj.

Shkruhen me **d, t** edhe emrat e përveçëm grekë e romakë, si:

Adanis, Afërdita, Alkibiadi, Dedali, Delfi, Demokriti, Demosteni, Driadat, Fedra, Iliada, Pelidi, Pindari, Leonida; Etiopia, Itaka, Maratona, Metodi, Prometeu, Skitia, Tesalia, Tezeu, Trakia, Zakinti etj.

Bëjnë përjashtim nga ky rregull fjalët dhe emrat e përveçëm të përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me **th, dh** dhe jo me **t, d**, si: *dhaskal, dhespot, dhisk (tabaka), dhjak, idhull, themel, Dhimitër, Dhimosten, Athina, Kleanth, Thanas, Themistokli, Theodor etj.*

Shkruhen me **l** dhe jo me **ll** fjalët e huaja me burim nga greqishtja e vjetër ose latinishtja:

alfa, algoritëm, ambulancë, analogji, antologji, atlas, balonë, balsam, bilanc, biolog, bulon, dialog, diplomaci, filologji, ideologji, kolos, lustër, tablo, spekuloj, zoologji etj.

Shkruhen me **l** edhe emrat e përveçëm grekë e romakë, si:

Apoloni, Atlantida, Atlantik, Babilonia, Lukiani, Pelagonia, Peloponezi, Penelopa, Platoni, Salusti, Shila etj.

Përjashtim nga ky rregull, janë fjalët dhe emrat e përveçëm të përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me **ll**, si: *apostull, ballkanik, ballkon, bllok, busull, çokollatë, dishepull, idhull, gorillë, galloshe, kablo, kapitull, konsull, orakull, llogari, protokoll, sallë, vullkan etj.*

Fjalët me burim nga latinishtja dhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një **c** të ndjekur nga zanorja **e** ose **i** shkruhen me **c**:

acetik, acetilen, celebrim, celulë, centimetër, central, cerebral, certifikatë, kancelar, koncert, koncesion, proces, agjenci, agjitacion, ciklamin, cinik, citat, deficit, konciz, recension etj.

Po ashtu, edhe emrat e përveçëm të kësaj kategorie shkruhen me **c**:

Barcelonë, Centauri, Cezari, Cincinati, Horaci, Lukreci, Marciali, Mecena, Sicilia etj.

Përrjashtim nga ky rregull, janë fjalët e përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me **ç**, si: *biçikleta, çiklist, çiklizëm, çimento, motoçikletë* etj.

Fjalët me burim nga anglishtja

Shkruhen me **I** disa fjalë me burim nga anglishtja, si:

gol, golf, kloun, klub etj.

Shkruhen me **//** disa fjalë me burim nga anglishtja, si:

basketboll, futboll, hendboll, penalti, volejball etj.

Fjalët me burim nga gjuhët sllave

Shkruhen me **I** disa fjalë me burim nga gjuhët sllave, si:

bolshevik, kolkosz, polak, polka etj.

Shkruhen me **//** disa fjalë me burim nga gjuhët sllave, si:

bjellorus, sllav, slllovak, slloven, Bjellorusi etj.

USHTRIME

- 1 Lexoni me kujdes grupet e fjalëve me burim nga latinishtja dhe greqishtja e vjetër. Mbylleni librin dhe shkruani në fletore dhjetë prej tyre. Kontrolloni punën e njëri-tjetrit.
- 2 Lexoni me kujdes grupet e fjalëve me burim nga anglishtja dhe nga gjuhët sllave. Shkruani saktë në fletore ato fjalë që deri tani i keni shkruar apo i keni shqiptuar gabim.
- 3 Gjeni cilat nga fjalët e mëposhtme janë shkruar gabim. Nënvizojini dhe shkruajini saktë në fletore.
dialog, diplomë, diplomaci, olimpiadë, pedagogji, antologji, arithmetikë, pathollog, patos, Herodoti, Thesalia, Maratona, Hietra, Iliada, dhjak, idhull, dhespot, Theodhor, Kleanth, ballonë, diallojoj, llotari, lluks, tabllo, sandalle, Apollonia.
- 4 Shkruani nga pesë fjalë me burim nga latinishtja dhe greqishtja, të cilat në shqip shkruhen me **c** dhe me **ç**. Zgjidhni pesë prej tyre dhe formoni fjali.

Drejtshkrimi i nyjës së përparme të emrave (i, e, të, së)

- Emrat në rasën gjinore shkruhen me nyjë të përparme (i, e, të, së):

dyqani i luleve; ndërmarrja e ndërtimit; rrethit të Tiranës etj.

- Kur një emër i rasës gjinore vjen pas një emri tjetër në rasën gjinore a dhanore, numri njëjës, trajta e pashquar, shkruhet me nyjën e përparme **të**, pavarësisht nga gjinia që ka emri para tij:

dëftesa e një nxënësi të Akademisë së Futbollit; dëftesa e një nxënëseje të shkollës 9-vjeçare; një atleti të skuadrës kombëtare etj.

- Kur një emër i rasës gjinore, pavarësisht nga gjinia që ka, vjen pas një emri të gjinisë mashkullore në rasën gjinore a dhanore, trajta e shquar, numri njëjës, shkruhet me nyjën e përparme **të**:

zyra e kryetarit të Forumit Rinor; fuqia e krahut të punëtorëve etj.

- Kur një emër i rasës gjinore, pavarësisht nga gjinia që ka, vjen pas një emri të gjinisë femërore në rasën gjinore a dhanore, trajta e shquar, numri njëjës, shkruhet me nyjën e përparme **së**:

historia e luftës së popullit shqiptar; përvjetori i shpalljes së pavarësisë etj.

- Kur një emër i gjinisë femërore, në rasën gjinore, dhanore a rrjedhore, numri njëjës, përcaktohet nga dy ose disa mbiemra të nyjshëm dhe nga një ose disa emra në rasën gjinore, fjala përcaktuese e dytë dhe të tjerat pas saj marrin nyjën **të** dhe jo **së**:

(i, e, të, së) fabrikës së re të këpucëve; (i, e, të, së) rrjedhjes së poshtme të Vjosës dhe të Semanit; (i, e, të, së) klimës së butë e të qëndrueshme të Vlorës, të Himarës, të Sarandës etj.

- Kur pas një emri të gjinisë femërore, trajta e shquar, rasa gjinore, dhanore a rrjedhore, numri njëjës, vijjnë dy a më shumë emra të gjinisë femërore në rasën gjinore, numri njëjës, nga këta të fundit i dyti dhe të tjerët pas tij marrin nyjën e përparme **së** dhe jo **të** në rastet kur përcaktojnë emrin në gjinore që ndodhet menjëherë përpara tyre; por në rastet kur këta përcaktojnë jo emrin në gjinore që ndodhet menjëherë përpara tyre, por atë që ndodhet para atij, shkruhen me nyjën **të** dhe jo **së**:

përmirësimi i cilësisë së racës së lopës së Shkodrës; zhvillimi i industrisë së naftës të Shqipërisë (është fjala për industrinë [e naftës] të Shqipërisë) etj.

- Kur një emër i gjinisë femërore, rasa gjinore, numri njëjës, përcaktohet nga dy ose më shumë emra të bashkërenditur, që janë po në rasën gjinore, emri i dytë përcaktues e të tjerët pas tij marrin nyjën e përparme **të** dhe jo **së**:

prodhimet e fushës së Korçës, të Myzeqesë, të Thumanës e të Zadrimës; punimet e stinës së pranverës, të verës, të vjeshtës, të dimrit etj.

- Kur një emër përcaktohet nga dy a më shumë emra të bashkërenditur të rasës gjinore, të gjithë këta përdoren zakonisht me nyjë të përparme:

stacioni i taksive dhe i autobusëve; (i, e, të, së) stacionit të taksive dhe të autobusëve; Ministria e Arsimit dhe e Sportit etj.

- ✿ Kur pas një emri të gjinisë femërore ndeshen dy nyja të përparme të rasës gjinore të gjinisë femërore (**së së**), e para nga këto shkruhet **të**:

frytet e fitores të së resë dhe të shembjes të së vjetrës; ditëlindja e vajzës të së motrës; dita e dasmës të së mbesës etj.

- ✿ Midis emrave të gjinisë mashkullore që lakohen si emrat e gjinisë femërore (bacë, dajë, gegë, hoxhë, toskë; Bato, Gjokë, Kolë etj.) dhe emrave ose mbiemrave që i përcaktojnë ata, pas rasës emërore të të përcaktuarve shkruhet nyja **i**, ndërsa në gjinore, dhanore e rrjedhore shkruhet nyja **së**:

daja i Zanës, (i, e) dajës së Zanës; Leka i Madh, (i, e) Lekës së Madh; Kola i Gjokës, (i, e) Kolës së Gjokës etj.

USHTRIME

- 1 Për secilin nga grupet e fjalëve të mëposhtme, gjeni rregullën drejtshkrimore që i referohet.

libri i një nxënësi të klasës
dhurata e vajzës të së motrës
nxitimi i klasës së Anilës së motrës së Edlirës
shtëpia e mësuesit të matematikës
përparimi i teknologjisë së ushqimit të Ballkanit
një sportisti të skuadrës lokale
historia e luftës së popullit shqiptar
...i rrjedhjes së poshtme të Vjosës dhe të Semanit
fletorja e një nxënëseje të klasës
...e vajzës së re të komshiut
e drejta e votës, e fjalës, e mbledhjes dhe e shtypit
Sula i Agronit

- 2 Shkruani grupet e fjalëve duke vendosur nyjën e përparme që duhet në vendet bosh:

recitimi i nxënëses ____ talentuar
sipas një fjale ____ urtë ____ popullit tonë
ushtrimet e lëndës ____ matematikës, ____ fizikës, ____ kimisë, ____ informatikës
punimet e një nxënëseje ____ talentuar
vlerësimi i këngës ____ bukur ____ fëmijëve

- 3 Për secilin nga rastet e ushtrimit 2, shënoni rregullën drejtshkrimore në të cilën u mbështetet për të vendosur nyjën e përparme të duhur.

- 4 Gjeni gabimet në përdorimin e nyjës së përparme në grupet e mëposhtme. Shkruajini saktë ato dhe argumentoni ndryshimet që do të bëni.

gomat e makinës së re
...i fjalës të rëndë nga ajo e ngrohtë
ardhja e ditëlindjes së të birit
dritaret e një shtëpie së vogël
përpara forcës së të ardhmes
fletorja e një nxënëseje së klasës

Drejtshkrimi i nyjës së përparme të mbiemrave dhe të përëmrave pronorë

Rastet e mbiemrave

Mbiemrat e nyjshëm të shkallës pohore, kur vijnë pas një emri të gjinisë femërore në rasën gjinore a dhanore, në trajtën e pashquar, numri njëjës, shkruhen me nyjën **të**, ndërsa kur vijnë pas një emri në trajtën e shquar, shkruhen me nyjën **së**:

oborri i një shkolle të madhe; fitoret e një skuadre të re; oborri i shtëpisë së madhe; fitoret e brigadës së re etj.

Në shkallën krahasore dhe në shkallën sipërore të formuar me pjesëzën **më**, mbiemrat e nyjshëm që përcaktojnë një emër të gjinisë femërore, në të gjitha rastet e zhdrejta të numrit njëjës shkruhen me nyjën e përparme **të**, ndërsa, kur ndodhen para emrit, shkruhen me nyjën **së**:

hartimi i një rregulloreje të re e më të plotë; çmimi iu dha shkollës më të dalluar të rrethit; prodhimi i më së mirës verë të vendit; zbriti prej më së lartës majë të Shqipërisë etj.

Kur mbiemrat e nyjshëm (ose numërorët rreshtorë) ndodhen përpara emrit në gjininë femërore, përdoret nyja **së** dhe jo **të**:

lotët e së shkretës e të së pangushëlluarës nënë; t'i caktohen faqet së parës, së dytës dhe së tretës kategori të zërave të Enciklopedisë etj.

Kur një emër i gjinisë femërore, në rasën gjinore, dhanore a rrjedhore, numri njëjës, përcaktohet nga dy ose më shumë mbiemra të nyjshëm (ose numërorë rreshtorë), mbiemri i dytë e të tjerët pas tij marrin nyjën **të** dhe jo **së**:

(i, e, të, së) vajzës së urtë, të zellshme dhe të shkathët; (i, e, të, së) fushës pjellore dhe të gjerë etj.

Po kështu veprohet edhe kur mbiemri i parë është i panyjshëm ose kur emri i gjinisë femërore përcaktohet njëkohësisht nga një përëmër pronor dhe nga një a më shumë mbiemra të nyjshëm:

(i, e, të, së) vajzës së tij të dashur; (i, e, të, së) vajzës së tij të mirë e të sjellshme etj.

Mbiemri i nyjshëm që ndjek një kundrinor të drejtë të shprehur me një emër në rasën kallëzore të shquar, merr nyjën **e** kur është përcaktor i emrit dhe merr nyjën **të** kur është përcaktor kallëzuesor:

ndaji mollët e mëdha nga të voglat (përcaktor i emrit). i dua mollët të ëmbla (përcaktor kallëzuesor).

Rastet e përemrave pronorë

Përemrat pronorë: **im, ime, yt, jote, ynë, jonë, juaj**, shkruhen pa nyje të përparme:

libri im, ky është libri im; fustani yt, ky fustan është yti; fletorja jote, kjo fletore është jotja.

Përemrat pronorë: **e mi, e mia, e tu, e tua, i tij, i saj, i tyre**, shkruhen me nyje të përparme në të gjitha trajtat dhe përdorimet:

librat e mi, fletoret e mia; shkolla e tij, shkolla e saj; qyteti i tyre, fëmijët e tyre.

USHTRIME

- 1** Për secilin nga grupet e fjalëve të mëposhtme, gjeni rregullën drejtshkrimore që i referohet.

*shkallët e një ndërtese të vogël
ekspozita e një piktoreje të talentuar
ekspozita e piktores së talentuar
ndërtimi i një fabrike më të madhe se e para
prodhimi i verës më të mirë të vendit
prodhimi i më së mirës verë të vendit
zbriti prej më së lartës majë të Shqipërisë
e cilësisë së parë, të dytë e të tretë*

- 2** Shkruaj grupet e fjalëve duke vendosur nyjën e përparme që duhet në vendet bosh:

*Ndërtimi i një shkolle më _____ bukur se e para.
Çmimi i parë iu dha nxënësës më _____ dalluar të shkollës.
Ndërtimi i më _____ bukurës shkollë.
Çmimi i parë iu dha më _____ dalluarës nxënëse të shkollës.
Kujtimi i motrës _____ saj _____ dashur e _____ paharruar.
Ndihmesa e një nxënëseje _____ dalluar
Vlerësimi i më _____ bukurës këngë.*

- 3** Për secilin nga rastet e ushtrimit 2, shënoni rregullën drejtshkrimore në të cilën u mbështetet për të vendosur nyjën e duhur.

- 4** Gjeni gabimet në përdorimin e nyjës së përparme në grupet e mëposhtme. Shkruajini saktë ato dhe argumentoni ndryshimet që do të bëni.

*dalloj fjalët të rënda nga të ngruhtat
ardhja e më të mirës ditë për ne
shikimi i më të riut film së kinemasë
ky stilolaps është imi
shtëpia ime është afër, kurse e juaja është shumë larg
dritaret e një shtëpie së vogël
përpara forcës së të ardhmes*

Drejtshkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura

Pjesëzat apo parafjalët që përdoren para trajtave foljore, para emrave a përemrave shkruhen zakonisht të plota.

Trajtat foljore që formohen me pjesëzat **do të**:

do të mësoj, do të mësoja, do të kem mësuar, do të kem mësuar etj.

Djali *do të shkruante* e *do të përsëriste* të gjitha rregullat drejtshkrimore.

Pjesëza **të** që vihet përpara mënyrës lidhore ose pjesoreve të foljeve shkruhet rregullisht në të gjitha rastet e përsëritjes së trajtave foljore përkatëse, bashkë me parafjalët që mund të ketë përpara (**për** ose **me**):

të jetojmë, të punojmë, të mendojmë, të ndërtojmë, për të folur, për të shkruar, me të ardhur, me të parë etj.

Mësuesi udhëzonte nxënësit *për të studiuar, për të kuptuar* dhe *për të zbatuar* të rejat e shkencës.

Ai mori masa urgjente *me të arritur* e *me të parë* gjendjen e spitaleve.

Pjesëza **duke** e përcjellores shkruhet në të gjitha rastet e përsëritjes së kësaj trajte foljore. Në raste mohimi, bashkë me të përsëritet edhe pjesëza **mos**:

Nxënësit argëtoheshin *duke kërcyer, duke kënduar, duke brohoritur* e *duke duartrokitur*.

Mund të gjykosh gabim *duke mos parë, duke mos kontrolluar* e *duke mos njohur* gjendjen.

Pjesëza **pa** përpara pjesores shkruhet rregullisht në të gjitha rastet e përsëritjes së kësaj trajte foljore:

Pa e parë e *pa e takuar* nuk e besoj.

Pa lexuar e *pa shkruar* nuk mësohet asgjë.

Parafjalët **në, te (tek), me, nga, prej** përsëriten para gjymtyrëve homogjene sa herë bashkërenditen dy a më shumë emra a përemra me të cilët ato lidhen.

në vjeshtë, në verë, në dimër, në pranverë; te popujt, te fiset, te pellazgët, te shqiptarët; me mish, me shpirt, me dashuri, me zjarr; nga Elbasani, nga Dibra, nga Kukësi, nga Saranda; prej merakut, prej dhimbjeve, prej të ftohtit; as në sjellje, as në fytyrë, as në trup, as në duar.





I pëlqen vendi i tij *në pranverë, në verë, në vjeshtë* dhe *në dimër*, pra në të katra stinët e vitit.

Shkoi *te Sara, te Beni, te Jona*, që të pyeste për mësimet e nesërme.

Andi i kishte të rrallë shokët *nga rregullsia, nga mençuria* dhe *nga serioziteti* në punë.

Përpiquej *me mish e me shpirt* për të arritur atë që donte.

Këto parafjalë mund të mos përsëriten për arsye të caktuara kuptimore a stilistike:

-  U nisën të gjithë nxënësit nga Vlora, Durrësi, Lushnja, Fieri.
-  Mësimdhënia kërkon nga mësuesit e pedagogët, përkushtim, seriozitet e profesionalizëm.
-  Nga vajzat e djemtë u thanë shumë fjalë të bukura.
-  Me libra e fletore në duar ata përshëndesnin që larg.

USHTRIME

- 1** Lexoni tekstin dhe gjeni raste të përdorimit të parafjalëve dhe pjesëzave. Shpjegoni përdorimin e tyre sipas rregullave të mësipërme.

Edhe këtu një pritje e paparashikuar. Vetë koordinatoresha e aktivitetit dhe disa familje amerikane, që do të bëheshin mikpritësit e fëmijëve tanë në ditët e qëndrimit tonë atje, kishin dalë për të na uruar mirëseardhjen. Shpejt e shpejt, në stilin krejt origjinal e praktik amerikan, ata i ndanë dhe i morën nëpër makinat e tyre fëmijët, duke na uruar në të njëjtën kohë natën e mirë mua dhe dy trajnerëve. Një ditë më parë skuadrat pjesëmarrëse në turne i kishin zhvilluar ndeshjet e radhës dhe prisnin ndeshjet e ditës së dytë. Vonesa jonë e kushtëzuar nga aeroporti i Ljubljanes do të na "ndëshkonte", pasi do të zhvillonim dy ndeshje brenda ditës, madje brenda 4 orëve.

- 2** Në tekstin e mëposhtëm plotësoni parafjalët dhe pjesëzat që mungojnë.

Këto fjalë qenë të papritura. Ne e dinim dashurinë e vogëlushes ____ lulet. Ballkoni ynë që kthyer ____ një lulishte: tulipanë, karafila, lulekine, bar italian, begonja, luleshpate, fikuse, zymbyla etj. Unë isha ____ rregulluar edhe një dërrasë si raft, ku mami ____ bashku me Inxhin ____ renditnin një sërë tjetër ____ saksi. Vogëlushja u gëzohej luleve. Rrinte ____ orë të tëra aty ____ ballkon. I njomte çdo mëngjes, u gërmonte dheun saksive, hiqte gjethet e thata, lidhte lehtë e ____ kujdes pas hekurave ndonjë kërcell të lëvarur. Dhe lulet rriteshin të shëndetshme, gjelbëronin e lulëzonin ____ lloj-lloj ngjyrash të ndezura. Inxhi ndiqte çdo ditë ____ kureshtje lulëzimin e tyre. Dhe, herë pas here, kumtonte duke i ndritur sytë: "Mami, luleshqiponja ka lëshuar një gjethë të re!", "gonxhja e karafilit të kuq ka hapur!"; "Nënëgjyshe, fikusi është ____ çelur një lule të vockël, të bardhë! Sa e bukur që është! Eja ta shohësh!"; Dhe ne nxitonim ta shikonim. Më tepër se lulja, na gëzonte fytyra e vogëlushes, që vetëtimte ____ lumturia.

- 3** Formoni pesë fjali duke përdorur parafjalët dhe pjesëzat e dhëna në mënyrë të përsëritur.

Duke mos (marrë) _____
 Do të (luaj) _____
 Pa _____
 Me _____
 Nga _____
 Prej _____
 Te _____

Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras

Shkrimi i fjalëve njësh

Shkruhen njësh të gjitha ato njësi që nga pikëpamja leksikore përbëjnë një njësi të vetme.

Fjalët me parashtesa:

mospërfillje, kundërvënie, nëndrejtor, parafytyrim, parashkollor, sipërmarrje, riatdhesim etj.

Fjalët e përbëra, gjymtyrët e të cilave kanë lidhje përcaktore ndërmjet tyre:

bashkatdhetar, bashkëjetesë, besëlidhje, bojëbizele, botëkuptim, datëlindje, dëmshpërblim, dobipurës, dritëshkurtër, duarkryq, dyvjeçar, elektromagnetik, faqebardhë, fjalëformim, fjalëkryq, flokëgështenjë, flokëpakrehur, fotoekspozitë, fuqiplotë, frymëmarrje, kokëfortë, krahëhapur, kryemjek, kryeqytet, kundërpërgjigje, letërnjoftim, liridashës, luledele, marrëveshje, ndihmësmjek, orëndreqës, paqedashës, paraardhës, parathënie, pikëmbështetje, pikënisje, pjesëmarrës, i porsaardhur, procesverbal, projektbuxhet, qymyrguri, syshqiponjë, ultratingull, vendburim, vendkalim, zëvendësministër etj.

Fjalët e përbëra, gjymtyrët e të cilave kanë lidhje këpujore ndërmjet tyre:

dritëhije, hekurbeton, juglindje, këmbadoras, marrëdhënie, pulagjel, shitblerje, shurdhmemec, veriperëndim, veshmbathje etj.

Emrat e përngjitur:

farefis, fëshfëshe, gjëegjzë, qoftëlargu, raketake, shtojzovalle, taketuke, thashetheme etj.

Numërorët e përngjitur:

njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, (i, e) njëmbëdhjetë, (i, e) njëzetënjë, (i, e) njëqindedytë etj.

Përemrat e pacaktuar të përngjitur:

asgjë, asnjeri, cilido, çdonjëri, çfarëdo, diçka, dikush, disa, gjëkafshë, gjësendi, gjithçka, gjithkush, gjithsecili, kurrfarë, kurgjë, kushdo, ndokush, ndonjë, secili, secilido, sekush, sikush, tjetërkush etj.

Ndajfoljet e parafjalët e përngjitura:

anembanë, askund, askurrë, asnjëherë, asodore, aspak, atëbotë, atëherë, brendapërbrenda, buzagaz, duarplot, gjithandej, gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithmonë, menjëherë, pardje, pareshtur, përpara, përpjetë, përqark, përreth, përsëri, prapëseprapë, rrallëherë, sakaq, sakaqherë, sidokudo, tekdo, vetvetiu etj.

Lidhëzat e përngjitura:

derisa, domethënë, gjersa, kurse, megjithatë, megjithëse, meqenëse, meqë, mirëpo, ndërsa, ndonëse, ngaqë, qëkurse, sesa, siç, sikur, veçse etj.

Pjesëzat e përngjitura:

kushedi, pikësëpari, pothuaj, pothuajse, seç, thuajse etj.

Pasthirrmat e përngjitura:

obobo, ububu, faleminderit, lamtumirë, mirëdita, mirupafshim, tungjatjeta etj.

Shkrimi i fjalëve ndaras

Shkruhen ndaras ato njësi që janë pjesë e një grupi emëror, e një shprehjeje ose e një emërtimi të përbërë.

Grupet emërore të tipit emër në rasën emërore + emër në rasën rrjedhore:

bar blete, bar miu, lule blete, lule dhensh, lule gjaku, lule sahati, vaj peshku etj.

Grupet emërore me kuptim mbiemëror, të përbërë nga emrat *bojë* ose *ngjyrë* dhe një emër në rasën rrjedhore:

bojë (ngjyrë) argjendi, bojë (ngjyrë) ari, bojë dheu, bojë ulliri, bojë uthulle, bojë vaji etj.

Ndajfoljet dhe shprehjet ndajfoljore:

së afërmi, së bashku, së fundi, së jashtmi, së larti, së paku, së pari, së toku, më së miri, për së afërmi, për së gjalli, më dysh, më tresh, për dy, për tre etj.

Shprehjet ndajfoljore të formuara nga dy fjalë të njëjta ose të ndryshme, të lidhura në mes tyre me një parafjalë ose me lidhëzën e:

këmbë mbi këmbë, ditë me ditë, buzë më buzë, gojë më gojë, ca nga ca, rrugë pa rrugë, brez pas brezi, herë pas here, aty për aty, ballë për ballë, ditë për ditë, mes për mes, mot për mot, pikë për pikë, vit për vit, fund e krye, fund e majë, kokë e këmbë, lesh e li, qesh e ngjesh, shkel e shko, rreth e (për)qark, rreth e rrotull, veç e veç etj.

Numërorët themelorë të formuar me pjesëmarrjen e fjalëve *mijë, milion, miliard* etj., si dhe pjesët përbërëse të një numërori themelor, të lidhura me lidhëzën e:

një mijë, pesëmbëdhjetë mijë, një milion, një miliard, njëzet e një, dyzet e katër, shtatëdhjetë e tre, njëqind e një, një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre, një milion e pesëqind mijë e dyqind e dymbëdhjetë etj.

Shprehjet parafjalore ose lidhëzore:

aq sa, ashtu si, deri ku, deri te, duke qenë se, edhe pse, edhe sikur, gjer kur, gjer në, gjer te, kaq sa, kështu që, kurdo që, mjaft që, në qoftë se, në mënyrë që, në rast se, ngado që, po qe se, po të jetë se, që te, qysh se, sado që, sapo që, si edhe, sido që, tekdo që, vetëm se etj.

Shprehjet pasthirmore që shprehin përshëndetje, urime, falënderime, ngushëllime etj.:

Mirë ardhshi!, Mirë ju gjetshim!, Mirë se erdhe!, Mirë se ju gjeta!, Për shumë vjet gëzuar!, Qofshi shëndoshë!, Me shëndet!, Shëndet paç!, Ju falemi nderit! Të falem nderit! Të rrosh vetë!, Si urdhëron! etj.

USHTRIME

1 Formoni fjalë të përbëra me lidhje përcaktore, ku njëra prej gjymtyrëve të jetë: besë, bojë, duar, ballë, bashkë, krye, ndihmës, para, pikë, udhë, gjysmë, vend.

2 Qarkoni variantin e shkruar saktë në shembujt e mëposhtëm.

Mirë se vjen!	Mirësevjen!
i para kohshëm	i parakohshëm
bojë bizele	bojëbizele
jug lindje	juglindje
letër njoftim	letërnjoftim
bashkatdhetar	bashkëatdhetar
vend qëndrim	vendqëndrim
bashkë jetesë	bashkëjetesë
rrugë dalje	rrugëdalje
jo kalimtare	jokalimtare
kryeredaktor	krye redaktor
katërmijë	katër mijë

3 Shkruani fjalët e përngjitura ose shprehjet e formuara nga bashkimi i fjalëve.

sado + që, gjer + sa, me + gjithë + që, i pa + marrë + vesh, për + se, tak + e + tuke, tej + për + tej, në + qoftë + se, kurdo + që, sado + që, duke + qenë + se, ashtu + edhe, deri + kur, sido + që, po + qe + se, me + qenë + se, në + se, veç + se, së afërmi, një + qind, në + mënyrë + që

Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes

Disa fjalë të përbëra dhe një numër formimesh të tjera shkruhen me vizë lidhëse në mes. Zakonisht, gjymtyrët e këtyre fjalëve janë të barasvlershme nga pikëpamja kuptimore, duke plotësuar njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë.

Shkruhen me vizë lidhëse në mes:

Formimet e përfutuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme:

copë-copë, duar-duar, fije-fije, fletë-fletë, grupe-grupe, herë-herë, kokrra-kokrra, kuti-kuti, lara-lara, lloj-lloj, ngjyra-ngjyra, palë-palë, petë-petë, pika-pika etj.

Formimet e përfutuara nga bashkimi i dy antonimeve:

aty-këtu, hyrje-dalje, pritje-përcjellje, vajtje-ardhje etj.

Formimet e përfutuara nga bashkimi i dy numërorëve themelorë, për të treguar një sasi të përafërt:

dy-tri (orë), dhjetë-pesëmbëdhjetë (vjet), katër-pesë (veta), pesë-gjashtë (ditë) etj.

Formimet onomatopeike të përfutuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajtë të ndryshuar:

bam-bam, ciu-ciu, ham-ham, hum-hum, kuak-kuak, llap-llap, bam-bum, fap-fup, gau-giu, paf-puf, tik-tak, gëk-mëk etj.

Emërtimet e përbëra të njësive të matjes:

ditë-punë, kuaj-fuqi, kilovat-orë, orë-makinë, orë-normë, ton-kilometër, vit-dritë etj.

Emërtimet e tipit:

bar-bufe, hotel-restorant, kafe-restorant, dhomë-muze, shtëpi-muze, dyqan-shtëpi, hotel-pension etj.

Formimet kryesisht mbiemërore që shprehin marrëdhënie plotësuese ose të ndërsjella:

historiko-gjeografik, politiko-kulturor, analitiko-sintetik, afro-aziatik, anglo-amerikan, austro-hungarez, shqiptaro-grek, trako-ilir etj.

Formimet që përmbajnë pjesëzën ish- përpara emërtimeve të ndryshme:

ish-drejtor, ish-ministër, ish-komandant etj.

Emërtimet e përbëra të pikave të horizontit, të formuara prej një fjale të thjeshtë dhe prej një fjale të përbërë:

jug-juglindje, jug-jugperëndim, lindje-verilindje, perëndim-jugperëndim, veri-verilindje etj.

Emrat e përbërë të krahinave e të fshatrave:

Pezë-Helmës, Mborje-Drenovë, Fier-Shegan, Fushë-Krujë, Zall-Dajt etj.

Emrat e përbërë gjeografikë të huaj:

Buenos-Ajres, Hong-Kong, Kosta-Rika, Nju-Delhi, Nju-Jork, Port-Artur, San-Francisko, San-Howe, San-Huan, San-Marino, Sierra-Leone, Sierra-Morena, Tel-Aviv, Tian-Shan, Ulan-Bator etj.



Kujdes

Tek emërtimet gjeografike, që si pjesë të parë kanë një nyjë të përparme në gjuhët përkatëse, ndërmjet saj dhe pjesës tjetër nuk vihet vizë lidhëse: *La Paz, La Plata, La Valeta, Los Anxhelos etj.*



Kujdes

Kur midis emrit dhe mbiemrit të një personi të huaj ndodhet një nyjë ose një pjesëz, këto zakonisht shkruhen veç: *Dora d'Istria, Gi de Mopasan, Leonardo da Vinçi, Lope de Vega.*

Emrat ose mbiemrat e huaj të personave, të përbërë prej dy a më shumë pjesësh:

Abu-Ali, Mak-Donald, Mari-Luizë, Sen-Simon etj.

Numërorët rreshtorë kur vetë numri ose një pjesë e tij shkruhet me shifra arabe:

klasa e 2-të, kreu i 4-t, e 9-ta A, Kongresi i 6-të, shekulli i 20-të, i 50-mijëti, 400-shi, 500-shi, 300 000-shi ose 300-mijëshi etj.

Emërtimet e përvjetorëve dhe formimet e ngjashme me to, kur numërori shënohet me shifër:

100-vjetori i Pavarësisë; shkolla 9-vjeçare; 15-ditëshi i parë i shtatorit; 30-vjetëshi i parë i shekullit XIX etj.

Mbaresat tek emërtimet e shkurtuara të institucioneve, të zyrave, të organizatave etj.:

korrespondentët e ATSH-së (Agjencisë Telegrafike Shqiptare), punonjësja e MAS-it (Ministrisë së Arsimit dhe Sportit) etj.

Gjymtyrët e para të dy a më shumë fjalëve të përbëra, të renditura njëra pas tjetrës, që përcaktohen nga një gjymtyrë e përbashkët, e cila shënohet vetëm një herë për arsye shkurtimi: *(lejë) dy-a treditëshe, (botime) dy-e shumëvëllimëshe, (paketë) katër-a pesëkilogramëshe, (ndërtesa) një-a shumëkatëshe, (moshat) tridhjetë-, dyzet-dhe pesëdhjetëvjeçare.*

USHTRIME

- 1 Rishkruani shembujt e mëposhtëm, duke i kthyer në numra numërorët e shënuar me fjalë.**
njëqindtredhjetëvjetori i Mësonjëtores; pesëdhjetëvjetori i lindjes së xhaxhait; shkolla nëntëvjeçare; ngjarjet e njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatës; shekulli i njëzet e një; gjashtëmbëdhjeta është katër herë më e madhe se katra.
- 2 Gjeni gabimet drejtshkrimore dhe rishkruajeni tekstin e mëposhtëm, duke i korrigjuar ato.**
Para dy vjetësh mora pjesë në një konferencë rinore në Lisbonë. Ishte konferenca 12 ndërkombëtare. Udhëtimi me avion Tiranë Lisbonë ishte mjaft i këndshëm, pasi qëndruam mbi 5-së orë në Vjenë të Austrisë. Nga aeroporti në Vjenë shkua me tren ekspres. Në një konferencë u njoha me disa anglo-saksonë dhe frankogjermanë. Erdhën përfaqësues nga O.K.B. dhe ekspertë të Unicef-t. Ditën 2 të konferencës, unë kisha ditë-lindjen. Ishte hera e parë që unë do ta festoja larg familjes e fare fisit tim. Kur ora po i afrohej 12, unë numëroja tik takun e saj. Sa po akrepat mbuluan njëri tjetrin, i pari më telefoniu babi. Edhe gjyshen tetëdhjetë e pesë vjeçare nuk e kishte zënë gjumi. U emocionova shumë dhe nuk e përmbajta dot veten. Hera herës u përlova. Më uruan dhe shumë bashkëmoshatarë. Dy prej tyre ishin nga La-Valetta, ndërsa dy të tjerë nga San Salvadori. Mos më pyesni sa vjeç isha. Ju jeni një grupmoshë me mua. Ne atë herë ishim nxënës në klasën e 9.

Tingujt dhe ndryshimet fonetike të tingujve në shqip: shtesat e tingujve

Fjala *fonemë* vjen nga greqishtja e vjetër: *phone-tingull, zë*. Ndryshimi i tingujve vjen si pasojë e ndikimit të tyre të njëri-tjetri. Nëse folësi do ta shqiptonte të veçuar një fonemë, për shembull: *-n, -a* etj., do t'i kushtonte vëmendje artikulimit të këtij tingulli, domethënë, mënyrës se si e përdor aparatit e të folurit (gjuhën, buzët, qiellzën, dhëmbët etj.) për prodhimin e një tingulli të caktuar. Në rrjedhën e të folurit, gjatë komunikimit, kuptohet që folësi nuk i kushton ndonjë rëndësi të veçantë mënyrës se si i nyjton tingujt, pasi e përqendron vëmendjen e tij te përmbajtja e thënies dhe fjalët i shqipton si një njësi e vetme, e gatshme, dhe jo si një tërësi tingujsh. Pikërisht gjatë fazës nyjetimore ndodh që tingujt ndikojnë te njëri-tjetri për arsye nga më të ndryshmet. Për shembull, fonema *-s*, te fjala *asgjë*, shqiptohet *-z (azgjë)*, për shkak se fonema *-gj* ndikon mbi fonemën *-s*, duke e bërë sa më të ngjashme me veten. Ndryshime të tilla si ky në fjalë, quhen **ndryshime fonemore**. Koha dhe shkaqet e ndryshimit të fonemave janë të ndryshme.

Disa ndryshime shpjegohen me rregulla fonetike që veprojnë aktualisht në gjuhë, çka na ndihmon të shohim konkretisht ndikimin e tingujve mbi njëri-tjetrin, si pasojë e pozicionit apo e kombinimit të tyre. Për këtë arsye janë quajtur ndryshime **pozicionale** dhe **kombinatorë**.

Nga ana tjetër, ka disa ndryshime fonemore, të cilat mund të shpjegohen vetëm me anë të rregullave fonetike që kanë vepruar kohë më parë në gjuhë, por që në ditët e sotme nuk veprojnë më si dikur. Këto ndryshime fonemore quhen **ndryshime historike**. Pra, i përkasin historisë së gjuhës.

Vitin e shkuar kemi trajtuar disa raste ndryshimesh kombinatorë dhe pozicionale, si: akomodimi, asimilimi, disimilimi, reduktimi i zanoreve etj. Kujtojmë se me ndryshime kombinatorë kuptojmë ndryshimin fonemor që vjen si rezultat i ndikimit të një tingulli mbi një tjetër, si rezultat i kombinimit, fqinjësisë mes tyre. Në kuadër të këtyre ndryshimeve është folur edhe për dukurinë e shtimit apo rënies së tingujve, proces për të cilin do të flasim më gjerësisht në këtë njësi mësimore.

Me **shtesë tingujsh** kuptojmë një ndryshim kombinator, si rrjedhim i të cilit shtohen tinguj në fillim, në mes apo në fund të fjalës. Një dukuri e tillë haset kryesisht në të folme të veçanta dialektore a nëndialektore dhe shpeshherë diktohet nga nevoja që ndjen folësi për të lidhur artikulimin e disa tingujve të veçantë, si për shembull: *harritëm* në vend të *arritëm*; *zembër* në vend të *zemër* etj.

Nisur nga pozicioni në të cilin shtohet tingulli brenda një fjale (në krye, në mes apo në fund), dallohen tri dukuri të ndryshme për shtesat e tingujve. Këto dukuri përshkruhen në tabelën e mëposhtme.

Ndryshime kombinatorë - Shtesat e tingujve			
	Përkufizimi	Tingulli i shtuar	Shembuj
Dukuria e protezës	Protezë quhet dukuria sipas së cilës, tingulli shtohet në krye të fjalës.	Tingulli i shtuar quhet <i>epentik</i> .	<i>heci (eci) ndrejt (drejt)</i>
Dukuria e epentezës	Epentezë quhet dukuria sipas së cilës, tingulli shtohet në mes të fjalës	Tingulli i shtuar quhet <i>epentik</i> .	<i>mbrekulli (mrekulli), zembra (zemra)</i>
Dukuria e epitezës	Epitezë quhet dukuria sipas së cilës, tingulli shtohet në fund të fjalës.	Tingulli i shtuar quhet <i>epitetik</i> .	<i>shkumbë (shkumë), sapund (sapun)</i>

Hiatusi

Rastet e mësipërme, ndonëse përdoren rëndom në të folmen e përditshme të folësve të shqipes, do të përbënin shkelje të rregullave drejtshkrimore në një kontekst të foluri apo shkrimi ku kërkohet respektimi i këtyre rregullave. Ndërkohë, duhet pasur parasysh se në disa raste, dukuria e shtesës së tingujve ka lindur si nevojë e shmangies së dy tingujve të njëjtë apo të ngjashëm dhe, si rrjedhojë, është ngritur në normë. Në gjuhën shqipe, kjo dukuri vihet re aty ku lind nevoja për shmangien e takimit të dy zanoreve, si në rastin e trajtave të fjalëve: kala-kalaja; këndo-këndova; nxito-nxithem. Siç vihet re, kur fjala ndryshon trajtë, si për shembull emri 'kala' nga trajtë e pashquar shkon në të shquarën, do të kishim takimin e dy zanoreve të njëjta: kala-a, çka në shqiptim do të krijonte efektin e hiatusit. Për të shmangur këtë, ndodh dukuria e kundërhiatusit, pra shtimi i një tingulli në mes të këtyre zanoreve. Ndërkohë, duhet të theksojmë se në pjesën dërrmuese të rasteve, kjo dukuri është e panevojshme, siç e dëshmon një gamë e gjerë shembujsh, p.sh.: flutur-flutura; shteg-shtegu; kap-kapa; ik-ika etj.

**USHTRIME**

- 1 Në të folmen e gjyshërve, prindërve, miqve dhe tuajën, përpikuni të dalloni nëse ka raste shembujsh të shtesave të tingujve. Paraqitini ato sipas modelit të tabelës së mëposhtme.

Ndryshime kombinatorë - Shtesat e tingujve			
	Përkufizimi	Tingulli i shtuar	Shembuj
Dukuria e protezës			
Dukuria e epentezës			
Dukuria e epitezës			
Dukuria e kundërhiatusit			

- 2 Përcaktoni nëse ka apo jo ndryshime fonemore të fjalët në vijim dhe përcaktoni llojin e tyre. Mbletë, mbrëmje, pambarimisht, hopingë, hecim, thembra, zembra, mbrekulli, krimb, shkumbë, shkumbës, sapund, përfundoj.
- 3 A ndikojnë tingujt mbi njëri-tjetrin si pasojë e pozicionit të tyre në fjalë? Nëse po, sillni dy shembuj që dëshmojnë këtë dukuri.
- 4 Çfarë kuptoni me dukurinë e shtesës së tingujve në fjalë? A mund të shtohen ata në çdo pozicion të fjalës? Nëse po, sillni nga një shembull për secilin rast..

Leksikologji

Leksikologjia

Studion tërësinë e fjalëve (leksikun) që ka një gjuhë, një dialekt ose një e folme.

Kuptimi i fjalës

- ▶ Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës
- ▶ Kuptimi i figurshëm i fjalës
- ▶ Fjalët me shumë kuptime

Dialektet e shqipes

- ▶ Gegërishte
- ▶ Toskërishte

Gjuha standarde

Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij

Me leksik kuptojmë tërësinë e fjalëve dhe të shprehjeve të një gjuhe. Kështu, mund të flasim për leksik të gjuhës shqipe, italiane, greke etj., që përgjithësisht e gjejmë të pasqyruar në fjalorë. Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 përmban rreth 48 000 fjalë. Lista e fjalëve dhe e shprehjeve të një gjuhe është gjithnjë e hapur, sepse ekziston gjithnjë mundësia që, për nevoja të komunikimit, të shtohen fjalë të reja.

Duhet bërë dallimi mes leksikut të një gjuhe dhe leksikut të një folësi, pasi ky i fundit nuk e përdor të gjithë leksikun e gjuhës së vet. Në përgjithësi, njeriut mund t'i shërbejë një sferë e vogël e leksikut (jo më shumë se 400-800 fjalë) për komunikimin e përditshëm. Në rastet e dhënies dhe të marrjes së mesazheve më të ndërlikuara, si për shembull, leximi i teksteve të ndryshme, nevojitet një bagazh leksikor prej 4000-5000 fjalësh. Për shkrimtarët apo studiuesit e ndryshëm, ky numër është më i lartë.

Për qëllime studimore, leksiku i një gjuhe mund të ndahet sipas burimit nga vijnë fjalët. Sipas kësaj ndarjeje, dallohet shtresa vetjake dhe shtresa e huazuar e fjalëve.

Shtresa vetjake e leksikut të shqipes

Fjalët e një gjuhe mund t'i përkasin fondit autokton, pra i kanë rrënjët thellë në origjinën e gjuhës amtare. Ky fond fjalësh përbën shtresën vetjake të leksikut të një gjuhe. Gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane dhe një pjesë e leksikut të saj i përket fondit të lashtë indoevropian.

Fjalë të fondit të lashtë indoevropian:

atë, bir, motër, dorë, emër, natë, gjarpër, punë, veri, zog, mal, mjegull, qaj etj.

Shtresa e lashtë indoevropiane përbën bërthamën e leksikut të shqipes. Fjalët që i përkasin këtij fondi janë më të qëndrueshme. Kjo do të thotë se ato nuk zëvendësohen lehtësisht me fjalë të reja. Po ashtu, kanë aftësi të mëdha fjalëformuese, pra me to mund të formohen fjalë të reja, si ato të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

dorë	dorëzoj – dorëzim – dorëzohem – i dorëzuar – dorëzanë – dorëcung – dorëdhënë – dorëheqje – dorëtharë etj.
punë	punoj – punim – përpunim – punësoj – i punësuar – i papunë – punëdashës – punëmirë – punëdore – punëdhënës – punëshumë – punësi – papunësi – punësim – punishte – punues – përpunues – nëpunës etj.

Shtresa e huazuar e leksikut të shqipes

Me proces të huazimit leksikor, kuptojmë marrjen e fjalëve apo të shprehjeve të një gjuhe të huaj, për t'i përdorur në gjuhën amtare. Për shembull, fjalët: *celular, televizor, lavatriçe, lavaman* etj., janë fjalë të huazuara që tashmë bëjnë pjesë në leksikun e shqipes. Rugët dhe arsyet e huazimit të fjalëve të huaja janë nga më të ndryshmet. Gjatë historisë së njerëzimit, popujt kanë qenë në kontakt me njëri-tjetrin, qoftë për shkak të afërsisë gjeografike, qoftë për shkak të marrëdhënieve kulturore, politike, ekonomike etj.

Një fjalë e re, e huazuar për të shënuar një nocion të caktuar (konkret ose abstrakt), mund të hyjë në përdorim së bashku me nocionin që shënon dhe

mund të dalë prej përdorimit kur nocioni që shënon, largohet prej jetës së përditshme.

Kështu, fjalë të tilla si: **shef kuadri, brigadier, kooperativiste** etj., nuk zënë më vend në të folurit e përditshëm të shqiptarëve.

Leksiku i një gjuhe është në zhvillim të pandërprerë, gjë që do të thotë se mundësia e hyrjes së fjalëve të reja është gjithnjë e hapur. Dy rrugët kryesore të përfutimit të fjalëve të reja paraqiten më poshtë.

Rrugët e përfutimit të fjalëve të reja

- ✿ Së pari, **fjalëformimi**: duke qenë se shqipja është një gjuhë me sistem morfologjik të pasur, është gjithnjë i mundur formimi i fjalëve të reja, sipas rregullave të fjalëformimit të shqipes: *dimër – dimëroj; verë – veroj; flokë – floktore* etj.
- ✿ Së dyti, **huazimi**: domethënë, futja e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe. Në disa raste, huazimet janë thujse të pashmangshme, por shpeshherë janë të panevojshme, madje të dëmshme, sepse cenojnë seriozisht pastërtinë e gjuhës dhe aftësinë riprodhuese të saj.

Një burim jo të vogël të leksikut të një gjuhe, e përbëjnë edhe dialektet dhe të folmet e saj. Një popull duhet t'i kushtojë gjithnjë vëmendje pasurisë së shumanshme të dialekteve dhe të traditës popullore, duke e parë atë jo vetëm si një mënyrë pasurimi të shëndetshme për gjuhën, por edhe si përçuese të urtisë dhe historisë së vet.

Leksiku i një gjuhe mund të shqyrtohet edhe sipas mënyrës së përdorimit, e cila mund të studiohet sipas:

- 🎯 **masës së përdorimit;**
- 🎯 **marrëdhënieve të leksikut me normën letrare.**

✿ Sipas masës së përdorimit, leksiku klasifikohet në: **leksik aktiv** dhe **leksik pasiv**. Çdo folës njih dhe zotëron një fond të caktuar fjalësh dhe shprehjesh, por ai mund të përdorë vazhdimisht vetëm një pjesë të këtij fondi, çka përbën leksikun aktiv të tij. Një pjesë tjetër e fjalëve dhe shprehjeve, ndonëse njihen prej folësit, përdoren shumë rrallë ose nuk përdoren fare prej tij. Kjo pjesë përbën leksikun pasiv të folësit.

✿ Sipas marrëdhënieve me normën letrare, folësi mund ta respektojë ose jo këtë të fundit.

Konteksti në të cilin përdoret gjuha, luan rol vendimtar në përzgjedhjen e variantit gjuhësor me të cilin komunikojmë. Në shkollë, në institucione shtetërore, në komunikimin publik me shkrim dhe me gojë etj., përdorim gjuhën standarde. Në jetën tonë private, në familje, me shoqërinë etj., mund të përdorim trajta dialektore apo atë të folme që kemi nxënë, së pari, nga prindërit tanë. Shpeshherë, shkrimtarët zgjedhin të shkruajnë në një variant që e konsiderojnë më shprehës dhe më afër lexuesit dhe shpirtit të tyre krijues. Në pjesën e sjellë në vijim mund të shikoni se me sa mjeshtëri dhe art poetik e realizon Camaj këtë.

Shqyrtimi i leksikut sipas mënyrës së përdorimit

Ata që presin barin me drapinj dhe kosa të shkurtra, posare për livadhe me gur në bjeshkën e Cukalit, janë njerëz të heshtun dhe vetëm në dukje të qetë: dhimba u bren kocat natën e i kap si pika në mëngjes në muskuj e gjymtyrë kur sjellin së pari rreptas hekurin në bar. Në parzmin e leshtë u fshehet frika e gjarpnit që pret tue njëhë në ritëm afrimin e krismës së drapnit në tërfojë. Mbledhësit e barit flejnë në vapën e ditës mbështetë për trungun e ahut nën hije e shohin andrra syçelë. Ma i riu i zgjoi njëherë e u tregoi atë që kishte gjetë, diçka të gdhendun, gungë e madhe ngjyrë ashti, rrashtë e breshkës e mbi atë gjarpnin dredha-dredha, gjithçka të bamun gurë! Mirë - thanë ata - na e dimë qëmoti se nëma e Orëve ndërron në shkamb çdo gja, edhe bariun me tufë përpara, po puna ashtë: si erdhi breshka deri këtu, kaq nalt?

(Martin Camaj, "Dranja")

- 🌱 Përpiquni ta rishkruani pjesën e mësipërme në shqipen standarde dhe diskutoni rreth dy varianteve.

USHTRIME

- 1 Ndërtoni familjet e fjalëve të mëposhtme.

emër	
çel	
shteg	

- 2 Duke ndjekur modelin e shpjegimit të fjalëve në fjalor, përpiquni të ndërtoni përkufizimet për fjalët e mëposhtme.

- *nën/ë,-a*:
 1. gruaja kundrejt fëmijëve të vet: *nënë e dashur*
 2. femra e një kafshe që ka pjellë: *nëna e koteleve*
 3. fig. burimi a shkaku i diçkaje: *nëna e të gjitha të mirave/të këqijave*
- *internet*: _____
- *celular*: _____
- *tastierë*: _____
- *dekoder*: _____
- *korrupsion*: _____
- *integrim*: _____

- 3 Për sendet e ndryshme që përdorni çdo ditë në shtëpi, shkollë dhe jashtë saj, hartoni një listë fjalësh që mendoni se janë të huazuara.

- 4 Klasifikoni fjalët e mëposhtme sipas tabelës së dhënë:

anellë, i famshëm, kullos, falëmeshëndet, interpelancë, çitjane, interes, tepsi, modë, kuvendoj, pazar, ranishte, seriozisht, lak.

Leksik aktiv	Leksik pasiv

- 5 Shkruani një tekst të shkurtër me temë: "Si t'i shpjegoj fjalët që nuk emërtojnë frymorë apo sende".

Dialektet e gjuhës shqipe

Në krahina, në fshatra apo në qytete të caktuara përdoren variante të gjuhës shqipe, që janë të kuptueshme kryesisht prej folësve të atij vendi. Kjo gjuhë nuk dallohet për respektim të standardit si në të folur, ashtu dhe në të shkruar.

Mbani mend

Dialekti është variant i gjuhës së një populli që përdoret nga një pjesë e popullsisë, por që kuptohet edhe nga folësit e tjerë të kësaj gjuhe.

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: **gegërishten** dhe **toskërishten**.

Edhe brendapërbrenda një dialekti ka dallime gjuhësore sipas krahinave të ndryshme. Këto dallime përbëjnë **krahinorizmat** ose të folmet krahinore.

Dialekti gegë përdoret në të djathtë të rrjedhës së lumit Shkumbin. Pra, deri në Vermosh brenda kufijve të Shqipërisë, në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore dhe në pjesën jugperëndimore të Malit të Zi.

Dialekti toskë përdoret në të majtë të lumit Shkumbin. Pra, deri në Konispol brenda kufijve të Shqipërisë, dhe në të folmet çame në Greqi deri në gjirin e Prevezës.

🌸 **Lexoni tekstet e mëposhtme dhe përcaktoni se cili prej tyre i përket dialektit të Veriut dhe cili dialektit të Jugut. Gjeni ndryshimet ndërmjet tyre.**

Shtegu që çon te kroni asht shetija e katundarvet. Buzë mbramje me buljere në krah, dalin gra e vajza për me mbushun uj në krue. Ndeshen udhës shoqe me shoqe e shëndrrojnë dy fjalë. Dita asht e mundshme ndër katunde e ato biseda mbramjeje disi janë një pushim e një argtim. E ndërsa dielli prendon e hana del, kroni i mbushë buljerat një nga një tue kendue. Secilës vajzë e secilës grue i kendon nga një kange, përse kroni te tana i njef. Vajzat i njef të vogla e i pau dalkadalë tue u rritë; gratë i njef nuse e i pau dalkadalë tue u plakë. Pasqyra e qetë e ujit mban kujtimin e të gjitha fytirave...

Ernest Koliqi

Emri i katundit është Bubutimë, si pas zurmës që bën deti. Paralajmërojmë lëçitësit të mos e kërkojnë këtë katunt të lashtë në vëndin ku pat qënë klhisur sepse e kanë shembur tërmetet e luftrat dhe vëndin e mbulon sot një pyll i dendur.

Të fundit njerës që dinin të na tregojnë gjyrmat: Tat Tanushi, Imzot Nikanori, një bari edhe njëmbëdhjetë priftërinj të asaj krahine, flenë sot gjumin e tokës dhe ne s'kemi fuqinë t'i sjellëm prapë në jetë që t'i pyesëm. Një gjë që dihet mirë është se Bubutima ka qënë një katunt i math, jo shumë lark nga deti që i thonë Adriatik. Vëndi është i bukur sepse toka bleron...

Mitrush Kuteli

Dialektet e shqipes, përveç të përbashkëtave të shumta, kanë edhe dallime. Disa prej tyre janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Karakteristika	Gegërishte	Toskërishte
Kanë togun	ue: <i>mue, punue, grue</i> etj.	ua: <i>mua, punuar, grua</i> etj.
Kanë zanoren	a hundore: <i>kambë, nanë, hana</i> etj.	ë: <i>këmbë, nënë, hëna</i> etj.
Kanë -n- ose -r- ndërzanore.	Ruan -n- në ndërzanore hundore: <i>zani, bana</i> etj.	-N- në ndërzanore të gegërishtes e kthen në -r-: <i>zëri, bëra</i> etj.


Dialektet janë pasuri leksikore e gjuhës. Gjuha standarde pasurohet duke marrë vazhdimisht fjalë prej tyre, me të cilat zëvendëson fjalët e huaja ose sjell nuanca e ngjyrimë emocionuese a larmi të shprehjes. Tabela e mëposhtme paraqet disa fjalë të tilla, bashkë me shpjegimet përkatëse.

<i>dhishta</i>	<i>vend dhish</i>	<i>emnaku</i>	<i>adashi</i>
<i>fushëgropë</i>	<i>fushë në mes malesh</i>	<i>fyshtë</i>	<i>zbrazëti, boshllëk</i>
<i>hatroj</i>	<i>mbaj me hatër</i>	<i>lylë</i>	<i>fluskë</i>
<i>ndërmjetëza</i>	<i>muri ndarës</i>	<i>i proshkët</i>	<i>i freskët, taze</i>
<i>pleqësore</i>	<i>pleqsh</i>	<i>i prajtë</i>	<i>i heshtur</i>

Edhe në fushën e fjalëformimit, gjuha standarde mbështetet shumë në modele dialektore. Për shembull, për formimin e disa emrave, si: *lexues, mësues, ndërtues, hekurpunues, i lejueshëm* etj., ka shërbyer si temë prodhuese pjesorja e dialektit të Veriut që mbaron me togun *-ue* (*lexue, ndërtue, punue, lejuë*). Nga ana tjetër, forma e pjesores në *-ua* e dialektit toskë ka shërbyer si temë fjalëformuese për mbiemrat e nyjshëm: *i lexuar, i mësuar, i ndërtuar, i punuar, i lejuar* etj.

USHTRIME

- Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes të folmeve dialektore dhe dialektit.



- Plotësoni tabelën e mëposhtme, në mënyrë që të paraqitni disa nga dallimet mes gegërishtes dhe toskërishtes.

Karakteristika	Gegërishte	Toskërishte

- Mblidhni fjalë dialektore të zonës suaj (duke pyetur të afërmit dhe të moshuarit) dhe përbri secilës prej tyre shënoni shpjegimin në gjuhë standarde.

Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj

Gjuha standarde shqipe është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar. Ajo përfshin gjuhën që përdoret në shkollë, në dokumente zyrtare, në botime, si dhe në komunikimin zyrtar. Të gjitha mediat, në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni e kudo ku ka shqiptarë, përdorin gjuhën standarde shqipe.

Gjuha standarde shqipe dallohet për praninë e rregullave dhe normave, që duhen zbatuar. Këto rregulla dhe norma janë vendosur pas shqyrtimit të disa formave të mundshme. Kjo do të thotë se ndër disa fjalë dhe ndërtime me të njëjtin kuptim, është zgjedhur njëra formë si **përfaqësuese** më e pëlqyeshme dhe janë përcaktuar edhe rregullat për çdo rast.

Realizimi i njësimin të gjuhës standarde u arrit nga Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i cili zhvilloi punimet nga data 20 nëntor deri në 25 nëntor të vitit 1972, në Tiranë. Në Kongres u përfaqësuan gjerësisht forcat e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare. Aty ishin të pranishëm 87 delegatë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, si dhe arbëreshë nga Italia.

Rasti	Forma të mundshme	Forma përfaqësuese
e pakryera e foljes	shkonja, shkojsha, shkoja	shkoja
e ardhmja e foljes	do shkoj, do të shkoj, kam me shkue, kam të shkoj	do të shkoj

Mbani mend

Pra, me **normë** duhet të kuptojmë jo vetëm format e fjalëve, ndërtimet fjalëformuese dhe sintaksore më të përhapura, por edhe tërësinë e rregullave të vendosura për përdorimin e tyre në standardin gjuhësor.

Kështu, norma apo standardi i një gjuhe përfaqëson kodin e përdorimit të saj. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* është dokumenti kryesor që përbën kodin e gjuhës shqipe. Në të pasqyrohen të gjitha normat fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore për të shkruar dhe për të folur gjuhën standarde.

Megjithëse gjuha standarde dhe dialektet ndryshojnë ndërmjet tyre, ato nuk janë të izoluar. Pra, japin e marrin mes tyre. Gjuha standarde thith nga dialektet vlerat e tyre më të mira.

USHTRIME

- 1 Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes gjuhës standarde dhe dialekteve.

gjuha standarde dialektet



- 2 Në tekstin me titull "I lumtur është njeriu që s'ka nakar", gjeni fjalët e gegërishtes. Përbri secilës fjalë shkruani formën që ka në gjuhën standarde.

- 3 Shkruani në gjuhën standarde fjalët e mëposhtme.

bani
syni
tash

me lexue
lark
ish

kam zgjidh
me shkue
foshnjisht

shqyptar
pa këndue
i math

- 4 Ndahuni në grupe dhe bëni një projekt me temë "Pasurimi dhe pastrimi i gjuhës standarde shqipe".

Huazimet. Shmangia e tyre

🌸 Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe dalloni ato fjalë që mendoni se janë të huaja.

Klikoni butonin "Office" dhe më pas vendoseni tek opsioni "Save as". Ju mund të fshini me "Backspace" ose "Delete". Komandat "Cut", "Copy" dhe "Paste" ekzekutohen në të njëjtën mënyrë si në "Word".

Në fillim është koncesioni i pullave fiskale, pastaj markimi i karburanteve. Kërkohet informacion i detajuar për koncesionin e skanimit në dogana.

Këto janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësisë prindërore. Përveç padisë posedimore, paditësi mund të ushtrojë edhe padinë e rivendikimit.

Ndryshimet e karakteristikave konstruktive të mjeteve në qarkullim dhe azhurnimi i lejes së qarkullimit. Mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre duhet të mbahen gjatë qarkullimit në efektivitet të lartë.

Dukuria e huazimit leksikor

▶ Dukuria e huazimit leksikor nënkupton marrjen e fjalëve apo shprehjeve të një gjuhe të huaj, për t'i përdorur ato në gjuhën amtare, duke i përshtatur sipas modelit të saj fonetik e morfologjik. Për shembull, fjala *xhinse* (jeans) është huazuar nga gjuha angleze, por shkruhet sipas modelit fonetik të shqipes. Po ashtu, kjo fjalë, e sjellë në gjuhën shqipe, i nënshtrohet sistemit morfologjik të saj, domethënë ndryshon sipas kategorive gramatikore të gjinisë, numrit, rasës etj.

Dukuria e huazimit të fjalëve nga një gjuhë në gjuhën tjetër është e lashtë, sa ç'janë të lashta marrëdhëniet mes popujve të ndryshëm dhe, shpeshherë, shërben për pasurimin e këtyre gjuhëve. Fjalët shpesh merren nga gjuhët e tjera për të plotësuar zbrazëtinë leksikore, për të emërtuar sende, koncepte a dukuri të ndryshme. Kështu shqipja e ka huazuar fjalën "penxhere" nga turqishtja, derisa krijoi fjalën e vet, dritare (domethënë, nga hyn drita).

Procesi i huazimit është i hershëm dhe në gjuhën shqipe mund të vërehen shtresëzime huazimesh, sipas periudhave të ndryshme historike, por edhe sipas gjuhëve nga kanë hyrë ato. Huazimet prekin fusha të ndryshme të gjuhës, si fonetikë, morfologji, sintaksë, por leksiku mbetet pjesa më e ndjeshme e saj, pasi dukuria e huazimit të fjalëve është më e përhapur, për vetë natyrën komunikuese të gjuhës.

Huazimet nga gjuhë të ndryshme

▶ Më poshtë, po sjellim një pasqyrë përmbledhëse të fjalëve të huazuara në kohë dhe gjuhë të ndryshme.

Huazime nga:

- 🇧🇪 *greqishtja e vjetër*: shpellë, drapër, pjepër;
- 🇮🇹 *latinishtja*: fëmijë, mbret, mik, fytyrë, kokë, shëndet, qen, furkë, ulli, gusht, e shtunë, i shkretë, gjykoj, qortoj, pagëztoj, kishë;
- 🇷🇸 *gjuhët sllave*: zakon, grazhd, kovë, bujar, prag, mace, dobi, avit, godit, prashit, vikas, padit;
- 🇹🇷 *turqishtja*: daulle, bej, xhami, çiflig, çorap, hambar, kazan, kurban, kasap, amanet;
- 🇦🇱 *greqishtja*: fonetikë, gjeografi, sintaksë, morfologji, demokraci, dialog, monolog, gjeometri;
- 🇮🇹 *italishtja*: kimi, muzikë, soprano, bas, barkë, shirok, timon, bankë, buletin, komunitet, koordinoj, pastiçeri;
- 🇫🇷 *frëngjishtja*: natyrë, marsh, bufe, garazh, triko, dantellë, atelie, bezhë, bluzë, pardesy;
- 🇬🇧 *anglishtja*: spiker, trajner, menaxher, stop, horror, suport, implementoj, trend, slogan, kompjuter, buxhet, draft, kolegji, menaxher, xhinse, printer, stres etj.

Huazime në fjalëformim

Përveç fjalëve a shprehjeve, gjuhët mund të huazojnë edhe mjete dhe mënyra fjalëformimi, si parashtesa, prapashtesa, përngjitje etj. Kështu, në gjuhën shqipe vërehet rëndom përdorimi i parashtesave të huaja, si: anti-, diz-, multi-, poli-, super- etj., dhe i prapashtesave me burim të huaj, si: -al, -ant, -acion, -llëk, -xhi, -çi, -izëm, -men etj.

Mënyra fjalëformimi	
<i>Parashtesim</i> Përdorimi i parashtesave: anti-, diz-, multi-, poli-, super- etj.	antikombëtar, dizinformoj, multifunksional, politeknik, superfuqi etj.
<i>Prapashtesim</i> Përdorimi i prapashtesave: -al, -ant, -acion, -llëk, -xhi, -çi, -izëm, -men.	kontinental, interesant, operacion, karshillëk, thashethemexhi, zanatçi, majtizëm, bllokmen etj.

Huazime në sintaksë

Në rrafshin sintaksor, huazimet ndikojnë drejtpërdrejt në strukturën e gjuhës, pra në mënyrën se si lidhen fjalët. Duhet thënë se huazime të tilla e dëmtojnë rëndë gjuhën, sepse ndërhyjnë në sistemin e saj. Kohët e fundit, në gjuhën shqipe vihet re një përdorim i shpeshtë i ndërtimeve të huaja, ndonëse është i panevojshëm.

	Ndikim i huaj	Ndërtim sipas normës shqipe
Fjali pyetëse	Kush djalë mungon?	Cili djalë mungon?
	Si njerëzit sillen sot?	Si sillen njerëzit sot?
Këmbimi vepror-pësor	Pronari në zotërim të objektit.	Pronari që zotëron mallin.
	U lind në Durrës.	Ka lindur në Durrës.
Gjinore në vend të kallëzores	Është e një rëndësie të veçantë.	Është me rëndësi.
Përdorimi i parafjalëve	Mendoj mbi këtë çështje.	Mendoj për/rreth këtë/kësaj çështje/çështjeje.
...		

Shmangia e huazimeve

Pra, megjithëse huazimi është një proces i vazhdueshëm në gjuhë, duhet mbajtur parasysh se përdorimi dhe zgjerimi i fondit vetjak të saj duhet të jetë kusht parësor për folësit e kësaj gjuhe. Profetori i shquar, Eqrem Çabej, shihte një lidhje të ngushtë mes pasurisë së gjuhës dhe nivelit kulturor të një kombi: *Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture.*

USHTRIME

1 Gjeni fjalët gjegjëse të shqipes për fjalët e mëposhtme.

fjalë e huaj	fjalë shqip
agresiv	
ingredient	
obligim	
dominoj	
performancë	
merkato	
kortezi	
illegal	
kreativ	

2 Klasifikoni fjalët e dhëna sipas tabelës së mëposhtme:

bashkekzistencë, low cost, dispozicion, jolegal, kundërofensivë, rikuperim, destabilitet, pakontestueshëm, facebook, play off, disavantazh.

Fjalë të ndërtuara me:	
parashtesë shqipe + fjalë të huaj	
parashtesë e huaj + fjalë e huaj	
fjalë shqipe + fjalë e huaj	
fjalë e huaj + fjalë e huaj	

3 Gjeni fjalët e huaja të përdorura në një faqe gazete dhe zëvendësojini ato me fjalët përkatëse të gjuhës shqipe.

4 Komentoni thënien e mëposhtme, në lidhje me termin "huazim".


Meqë asnjë gjuhë, kurrë nuk e ka marrë ndonjë fjalë nga ndonjë gjuhë tjetër me qëllim që një ditë t'ia kthejë, e meqë fjalët e tilla nuk janë kthyer ndonjëherë, atëherë, termi huazim është term i gabuar. (*David Crystal*)

5 Shkruani një koment të shkurtër rreth mesazhit që përcillet në poezinë e mëposhtme.



...Pra mallkue njai bir shqyptari
që kët gjuh të Perënis
trashëgim që na la i Pari,
trashëgim s'ia len ai fmis;
edhe atij iu thaftë; po goja,
që e përbuzë këtë gjuhë hyjnore;
që n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
flet e t'veten len mas dore...

(*Gjergj Fishta, "Gjuha shqype"*)

Regjistrat e gjuhës

 **Lexoni tekstet e mëposhtme. Në ç'rrethana komunikimi mendoni se mund të përdoren ato?**




-  *Stina e ftohtë e dimrit, përveç kushteve meteorologjike që e shoqërojnë, si ulja e temperaturave, lagështira etj., shoqërohet edhe me një sërë problemesh shëndetësore për të gjithë popullatën në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë për moshat pediatrike, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe të sëmurët kronikë. Këshilla që u japim të gjithë qytetarëve është të vishen mirë, të mbajnë ngrohtë dhe të ajrosin herë pas here banesën, të mos frekuentojnë mjedise të mbyllura dhe të mbipopulluara, si dhe të shmangin vizitat e panevojshme në qendrat spitalore.*
-  *Erdhi dimri? Mbërritën ngricat? Mbështillu e rri ngrohtë në mos daç të të mbërthejë gripi e rrufa. E mos e kalo pragun e shtëpisë se, kur të ngjitet, s'të shqitet kollaj.*

Çdo gjuhë e gjallë ka një bërthamë të qëndrueshme, e cila është në zhvillim të vazhdueshëm, për aq kohë sa është në përdorim nga folësit e saj. Pra, bërthama përbën bazën dhe strukturën e gjuhës nga ku lindin dhe zhvillohen variante të ndryshme.

Lindja e varianteve gjuhësore ka burime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendet ai historik, gjeografik, por edhe rrethanat e komunikimit mes folësve të një gjuhe luajnë rol të rëndësishëm. I njëjti folës, në varësi të vendit, tematikës, bashkëbiseduesit, kanalit të komunikimit etj., përzgjedh variantin dhe regjistrin gjuhësor përkatës.

Kështu, dallohen së pari dy variante të komunikimit: komunikimi i folur dhe komunikimi i shkruar.









Gjuhët, për vetë natyrën dhe funksionin që luajnë, shfaqen fillimisht në trajtën e folur dhe më pas në trajtën shkrimore. Edhe në përdorimin konkret të saj, vërejmë se folësi më parë mëson të flasë e më pas të shkruajë. Për më tepër, nëse të folurit, tek i vogli, zhvillohet si një proces i pavetëdijshëm, të shkruarit kërkon ndërgjegjësim dhe mësim. Të gjithë i kujtojmë përpjekjet tona të para për të mësuar shkrim e lexim, ndërkohë që e kemi thujse të pamundur të rindërtojmë në mendjen tonë se si kemi mësuar të flasim. Pas kësaj faze fillestare, folësit fitojnë aftësinë për të bërë dallimin mes situatave të ndryshme të komunikimit, ku në secilën prej tyre përdorin me vetëdije regjistra të ndryshëm gjuhësorë. Përgjithësisht, këta regjistra mund të klasifikohen në tri grupe kryesore: regjistër i zakonshëm, i thjeshtë dhe i ngritur.

Regjistri i thjeshtë (i shkujdesur)

Regjistri i thjeshtë (i shkujdesur) përdoret kryesisht në rrethana familjare dhe në shoqëri. Në këto situata, komunikimi karakterizohet nga lirshmëria dhe shkujdesja si në përzgjedhjen e temave ashtu dhe në realizimin konkret të tyre. Mbizotëron përdorimi i formave dialektore dhe nuk i kushtohet vëmendje zbatimit të normës letrare.







Disa tipare të regjistrit të thjeshtë janë:

-  Forma mbizotëruese është dialogu.
-  Fjalitë janë kryesisht të shkurtra dhe të paplota. Shpeshherë mund të mungojnë gjymtyrë të ndryshme, madje edhe kallëzuesi.
-  Përdoren dendur shprehje dhe togje të gatshme, tipike për atë të folur apo dialekt.
-  Përdorim të gjerë kanë edhe pasthirmat dhe fjalë të ndryshme parazite, si: *uau, bo-bo, që thua ti, po pra, ehu* etj.
-  Intonacioni dhe theksi i fjalisë, luajnë rol të rëndësishëm për shprehjen e habisë, çudisë, ironisë etj.
-  Gjestet dhe mimika që shoqërojnë komunikimin, fitojnë po ashtu vlerë të veçantë dhe nuk janë të papërfillshme për nuancat e këtij regjistri.

Regjistri i zakonshëm

Leksiku që përdoret në **regjistrin e zakonshëm**, ka të bëjë më shumë me fjalë të jetës së përditshme, por edhe të fushave të veçanta për shkak të tematikave që trajtohen. Nëpërmjet ligjëritimit të zakonshëm, folësit arrijnë ta përdorin një fjalë me shumë kuptime. Për shembull, fjala "grykë" në gjuhën shqipe del me shumë kuptime, si: pjesë e trupit të frymorëve, grykë shisheje, grykë mali etj.




Disa tipare të regjistrit të zakonshëm janë:

-  Nëpërmjet regjistrit të zakonshëm, shprehet në mënyrë të plotë funksioni komunikues i gjuhës.
-  Forma kryesore e realizimit të tij është dialogu.
-  Zakonisht, bashkëbiseduesit e ndërtojnë komunikimin mes tyre pa ndonjë përgatitje paraprake.
-  Bëhet kujdes të respektohen normat e gjuhës letrare.
-  Për nga përmbajtja, mbizotërojnë temat e jetës së përditshme.
-  Për nga forma, parapëlqehen trajtat e thjeshta, fjalitë e paplota, togjet e gatshme për komunikim, përdorimi i foljeve kundrejt emrave foljorë, mbizotërimi i formave veprare kundrejt atyre pësore etj.

Regjistri i ngritur

Regjistri i ngritur kërkon që mjetet e gjuhës të organizohen e të marrin trajtë të përcaktuar e të qëndrueshme. Komunikimi nëpërmjet regjistrit të ngritur, qoftë ky në formën e shkruar apo të folur, mund të kryhet në rrethanat e marrëdhënieve shoqërore formale, zyrtare, publike, institucionale etj.






Disa tipare të regjistrit të ngritur janë:

-  Për mënyrën se si prodhohet, në thelb kemi të bëjmë me monolog, por nuk përjashtohen edhe format e ndryshme të dialogut.
-  Për nga forma, i kushtohet vëmendje e veçantë përpunimit të saj. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit. Ndërtimet emërore janë më të shpeshta se ato foljore; ka përdorim të shpeshtë të togjeve librore dhe të trajtave pësore të foljeve; përdoren gjerësisht lokucionet lidhëzore etj.
-  Për nga përmbajtja, u kushtohet vëmendje përpunimit të mendimit dhe shtjellimit të tij. U kushtohet vëmendje rregullave të logjikës formale dhe përmbajtja ka shumë elemente abstrakte.

USHTRIME

1 Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.

Në regjistrin e zakonshëm dallojmë këto tipare:





-  Forma kryesore e realizimit të tij është dialogu.
-  Kërkon një përgatitje të gjatë paraprake.
-  Nuk respektohen medoemos normat e gjuhës letrare.
-  Për nga përmbajtja, mbizotërojnë tema nga shkencat ekzakte.
-  Fjalitë janë zakonisht të paplota.



<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2 Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.

Në regjistrin e thjeshtë dallojmë këto tipare:

-  U kushtohet vëmendje e veçantë formës dhe përmbajtjes së ligjëritimit.
-  Përdoret kryesisht në rrethana formale dhe mes të panjohurish.
-  Nuk këshillohet që gjatë të folurit të përdoren gjeste dhe mimikë, apo luhatje intonacioni në fjali.
-  Gjejnë përdorim të dendur format dialektore.



<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

3 Për temën "Ndiheh qytetar i botës", hartoni dy tekste ku njëri të ketë tiparet e regjistrit gjuhësor të thjeshtë, kurse tjetri të regjistrit të ngritur.

4 Shprehjet e mëposhtme, që përdoren gjatë komunikimit të folur, kthejini në formën që ato përdoren në komunikimin e shkruar.

<i>Komunikimi i folur</i>	<i>Komunikimi i shkruar</i>
shoferi i makinës	drejtuesi i automjetit
doktori i zemrës	
dhashë provim kiminë	
pije ilaçin	

Stilet e gjuhës

Për përcaktimin e stileve të gjuhës bazohemi sidomos te fusha në të cilën realizohet komunikimi dhe te funksionet mbizotëruese të tij. Ndër fushat në të cilat realizohet komunikimi, dallohen:

- ▣ fusha e veprimtarisë shkencore e teknike;
- ▣ fusha e veprimtarisë juridike e administrative;
- ▣ fusha e veprimtarisë politike e shoqërore;
- ▣ fusha e gjuhës dhe e krijimit artistik.

Për secilën nga këto fusha, ligjërimi strukturohet dhe përshtatet në varësi të nevojave që mbulon e gjithë veprimtaria në një fushë të caktuar dhe kështu krijohen stilet përkatëse për secilën fushë. Si të tillë mund të përmendim:

- ▣ stili shkencor-teknik;
- ▣ stili juridiko-administrativ;
- ▣ stili politiko-shoqëror;
- ▣ stili i letërsisë artistike.

Stili shkencor-teknik

Stili shkencor-teknik lidhet me transmetimin e njohjes dhe të dijes nga fusha të ndryshme, si ajo e shkencave shoqërore, shkencave natyrore, teknikës, teknologjisë etj. Këto dije përcillen nëpërmjet një niveli të lartë formal të gjuhës. Shembulli i sjellë më poshtë, është shprehje e përdorimit të gjuhës sipas këtij stili.

Neutroni është thërrmijë apo grimcë e atomit. Neutronet së bashku me protonet (grimcat e ngarkuara me energji pozitive) gjenden në bërthamën e atomit dhe numri i tyre është i barabartë me numrin e protoneve. Emrin "neutron" e ka marrë për shkak të neutralitetit mes protoneve të ngarkuara me energji pozitive dhe elektroneve të ngarkuara me energji negative.

Disa nga tiparet e gjuhës së stilit shkencor-teknik janë:

- 🎧 Gjuha e përdorur duhet të përmbushë funksionin informues të këtij ligjërimi.
- 🎧 Informacioni që përcillet është objektiv dhe i vërtetë dhe duhet të përcillet me vërtetësi.
- 🎧 Në thelb, komunikimi është një monolog me karakter përgjithësues dhe abstrakt.
- 🎧 Shmangët sa të jetë e mundur dykuptimësia dhe qëndrimet emocionale.
- 🎧 Krijimi me vetëdije i një varianti të posaçëm, i ndryshëm nga rrjedha e zakonshme e gjuhës së përditshme.
- 🎧 Teksti duhet të ketë organizim logjik, shtjellim pa kundërthënie dhe sistemim në tërësinë e vet.

Stili juridiko-administrativ

Stili juridiko-administrativ mbulon tri aspekte të mëdha të organizimit shtetëror të jetës së një vendi, që kanë të bëjnë me pushtetin ligjvënës, pushtetin ekzekutiv dhe atë gjyqësor. E thënë ndryshe, është ai stil gjuhe që përdoret për hartimin e ligjeve, hartimin e akteve dhe udhëzimeve për zbatimin e tyre dhe për kontrollin që ushtrohet mbi zbatimin ose jo të tyre. Shembulli i mëposhtëm, i cili është një nen i Kushtetutës së Shqipërisë, është shprehje e këtij stili.

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia

kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

(Kushtetuta e Shqipërisë, neni 3)

Disa nga tiparet e gjuhës së stilit juridiko-administrativ janë:

- 🇷🇺 Gjuha e përdorur duhet të përmbushë funksionin informues dhe parashkrues të këtij ligjërimi. Pra, nëpërmjet gjuhës jepen udhëzimet përkatëse për mënyrën dhe kohën e përmbushjes së asaj që është shprehur më parë.
- 🇷🇺 Gjithçka paraqitet në emër të ligjit dhe të shtetit, ndaj nuk mund të flitet për stil individual të hartuesit, por për ndjekjen e një modeli të mirëmenduar dhe të paracaktuar në formë dhe përmbajtje.
- 🇷🇺 Gjuha duhet të jetë e drejtpërdrejtë dhe të mos lërë rast për dykuptimësi apo për paqartësi.
- 🇷🇺 Shpesh, tekste të tilla nuk hartohen për t'u lexuar e shqiptuar, siç është rasti i teksteve në kartëmonedha, bileta etj.
- 🇷🇺 Mbetet kryesisht një stil tradicional që jo pa vështirësi ndjek rrjedhën e ndryshimeve në gjuhë.

Stili politiko-shoqëror

Veprimtaria politike e shoqërore është në zhvillim të pandërprerë dhe sot njih një përhapje si kurrë më parë, falë edhe sofistikimit të mjeteve të komunikimit. Tradita e gjatë e të shprehurit dhe të shkruarit për një publik të gjerë, ka çuar në formësimin e një stili të caktuar gjuhe, i cili zhvillohet në mënyrë të pandërprerë. Për këtë ndikojnë faktorë të ndryshëm, si ai historik, ekonomiko-shoqëror etj. Një shembull i realizimit të këtij stili jepet në pjesën e mëposhtme:

Qysh të mos ketë shqiptari të drejtë të shkruajë e të këndojë gjuhën e tij, kur gjithë kombet e kanë këtë të drejtë dhe njeri s'i ndalon? Pse shqiptarët të jenë të mërguar nga një e drejtë që e kanë gjithë kombet e dheut? Të mos mundin të shkruajnë e të mësojnë gjuhën e tyre, po të tjera kombe të huaja të vijnë e t'u hapin shkolla në gjuhërat e tyre e t'u kthejnë kombësinë e gjuhën e tyre? Janë kaq të dobët shqiptarët? Jo! Një mijë herë jo...!

(Sami Frashëri "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet")

Në këtë stil përfshihen botimet e organizatave shoqërore e politike (libra, broshura, pamflete etj.), veprimtaritë e tyre (mbledhje, tubime, seminare, mitingje etj.), mjetet e komunikimit masiv (shtypi, radioja, televizioni, dokumentaret etj.), propaganda dhe reklama.

Disa nga tiparet e gjuhës së stilit politiko-shoqëror janë:

- 🇷🇺 Gjuha e përdorur duhet të përmbushë funksionin informues dhe ndikues. Kjo do të thotë që jo vetëm paraqiten të dhëna, mendime e qëndrime për një çështje të caktuar, por njëkohësisht synohet të ndikohet mbi mendimet, qëndrimet dhe vlerësimet e lexuesve ose të dëgjuesve.
- 🇷🇺 Mesazhi që përcillet, synon informimin dhe, nëpërmjet tij, formimin e prirjeve, shijeve, bindjeve, botëkuptimit të të tretëve.
- 🇷🇺 Jo gjithnjë informacioni është objektiv dhe në përputhje me realitetin. Mjafton t'u hedhim një sy teksteve të reklamave.
- 🇷🇺 Shpeshherë, qëndrimi subjektiv dhe të shprehurit emocional janë pjesë e pandashme e këtij stili.

**Stili i letërsisë
artistike**

Në këtë stil përfshihen të gjitha krijimet artistike që realizohen nëpërmjet gjuhës së shkruar apo të folur. Dy janë degëzimet e mëdha të krijimtarisë artistike: nga njëra anë, krijimtaria gojore popullore dhe, nga ana tjetër, krijimtaria e shkrimtarëve, domethënë, letërsia e kultivuar.

Kush j-u fali aq dëshirim

Dh'aqe zjarr e aqe flakë,

Dhe'i gatoj me aq durim

Yjtë-e lum e varfanjakë?

(“Vallja e yjeve”, Lasgush Poradeci)

Disa ndër tiparet e gjuhës së letërsisë artistike janë:

- 🎨 Gjuha e përdorur ka funksion estetik. Nëpërmjet saj jo vetëm kumtohet diçka, por njëkohësisht synohet të kultivohet dhe të edukohet shija estetike.
- 🎨 Ligjërimi synon shcallën më të lartë të përpunimit artistik.
- 🎨 Në një tekst letrar mund të flasim për së paku dy rrafshë kuptimore, pra për mundësinë e interpretimit të shumëfishtë të një vepre letrare.
- 🎨 Ndryshe nga stilet e tjera, këtu fiton rol parësor ana krijuese e autorit, organizimi individual i tekstit.

USHTRIME**1 Lexoni pjesët e mëposhtme. Dalloni ç'kanë të përbashkët dhe ç'i dallon ato mes tyre.**

- 📌 Familja (lat. familia, nga famulus – rob shtëpie, shërbëtor) është njësi shoqërore më e vogël e përbërë nga dy ose më shumë persona, të cilët kanë midis tyre lidhje martesore, gjaku ose birësimi; që jetojnë në të njëjtin mjedis për një kohë relativisht të gjatë, kanë marrëdhënie kulturore dhe ekonomike të përbashkëta, si dhe përkujdesen për njëri-tjetrin.
- 📌 Unë jam dakord me idenë që ne nuk mund të ecim në rrugën postmoderne, duke mbivlerësuar dhe shenjtëruar pa sens mase familjen si strukturë, duke ekzagjeruar rolet sociale brenda saj, as duke e konsideruar qëndrueshmërinë e strukturës klasike të saj, përtej nevojave të zhvillimit dhe dinamikës së jetës postmoderne.
- 📌 Familja e vogëlushit të sëmurë kërkon ndihmë nga shteti, pasi e ka të pamundur të përballojë shpenzimet për kurimin e tij. I pyetur nga stafi i gazetës sonë, mjeku pohon se medikamentet për të luftuar një sëmundje të tillë nuk gjenden lehtësisht në qendrat tona spitalore.
- 📌 Pasi qëndroi një copë herë të gjatë, me shikimin ngulur përtej dritares, ai u kthye drejt nesh duke na thënë, po aq shtruar, se familja i kishte qëndruar gjatë gjithë kohës pranë. Se ishte fëmija i parë dhe, ndonëse kishte kaluar shumë kohë, mbante mend mjaft mirë vitet e para të fëmijërisë.

2 Në cilin stil gjuhësor është shkruar teksti i mëposhtëm? A mund të rishkruhet në një stil tjetër?

Atomi është i përbërë nga bërthama dhe elektronet me ngarkesë elektrike negative që rrotullohen rreth saj. Në brendësinë e bërthamës gjenden neutronet që janë thërrmija pa ngarkesë elektrike dhe protonet me ngarkesë elektrike pozitive. Për çdo atom në gjendje normale numri i protoneve është i barabartë me numrin e elektroneve. Kur numri protoneve është i barabartë me numrin e elektroneve, atëherë themi që atomi është neutral.

3 Me temën “Planeti ynë”, shkruani katër paragrafë të ndryshëm sipas katër stileve gjuhësore dhe nënvizoni mjetet gjuhësore tipike për secilin rast.

Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat dhe stilet e ndryshme në gjuhën shqipe

Pasi kemi parë dhe analizuar disa nga llojet e stileve dhe të regjistrave në gjuhën shqipe, le të shohim tani më konkretisht përdorimin e mjeteve gjuhësore për realizimin e tyre.

A. Tiparet dhe mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat e ndryshëm në gjuhën shqipe

Kujtojmë se në tërësinë e lëvrimit të gjuhës dallohen tre regjistra kryesorë gjuhësorë: regjistri i thjeshtë, i zakonshëm dhe i ngritur.

Tiparet gjuhësore të regjistrit të thjeshtë

- ✿ **Gjatë përdorimit të regjistrit të thjeshtë (të shkujdesur)** vihen re disa nga tiparet dhe mjetet gjuhësore të mëposhtme.
 - ▣ Intonacioni luan një rol të veçantë, duke qenë se kemi të bëjmë me gjuhë të folur.
 - ▣ Disa tinguj nuk shqiptohen qartë, si për shembull ë-ja e patheksuar apo disa grupe diftongjesh.
 - ▣ Gjatë bisedës, shkurtohen togje emërtuese, si dhe modifikohen mënyrat e të shprehurit. Kështu, mund të hasim në përdorim: “nuk e kam hapur matematikën”, për të thënë “nuk e kam mësuar lëndën e matematikës”.
 - ▣ Lidhjet e fjalëve realizohen me një sintaksë të thjeshtë, çka do të thotë se grupet e fjalëve përgjithësisht nuk dalin të zgjeruara.
 - ▣ Fjalitë thjeshtohen dhe në to mbizotërojnë lidhjet bashkërenditëse përkundrejt atyre nënrenditëse.
 - ▣ Ka një përdorim të shpeshtë të shprehjeve frazeologjike dhe ndërtimeve klishe të përdorimit të përditshëm.
 - ▣ Sinonimia dhe polisemia e fjalëve është po ashtu një tipar gjuhësor që haset shpesh gjatë regjistrit të thjeshtë.

Tiparet gjuhësore të regjistrit të zakonshëm

- ✿ **Gjatë përdorimit të regjistrit të zakonshëm** vihen re disa nga tiparet dhe mjetet gjuhësore të mëposhtme.
 - ▣ Fjalitë janë kryesisht të thjeshta dhe me rend të zakonshëm.
 - ▣ Bëhet kujdes për të shmangur fjalitë e paplota.
 - ▣ Bëhet përpjekje për të shmangur nga përdorimi forma dhe trajta të ndryshme dialektore.
 - ▣ Kufizohet përdorimi i pasthirmave dhe i fjalëve të ndryshme parazite, ashtu si edhe luhatjet e intonacionit të fjalisë.
 - ▣ Përzgjidhet fjalori, sipas situatës së komunikimit.
 - ▣ I kushtohet vëmendje zbatimit të normave letrare të gjuhës.

Tiparet gjuhësore të regjistrit të ngritur

- ✿ **Gjatë përdorimit të regjistrit të ngritur** vihen re disa nga tiparet dhe mjetet gjuhësore të mëposhtme.
 - ▣ Gjatë komunikimit me shkrim apo me gojë, i kushtohet vëmendje e veçantë zbatimit të normës letrare në formulimin e thënieve, në drejtshkrim, pikësim dhe shqiptim, por edhe në rastet e dialogimit.
 - ▣ Bëhet kujdes për shkrimin dhe shqiptimin e plotë të tingujve të patheksuar, të diftongjeve, të grupeve të bashkëtingëlloreve etj.

- ▣ Fjalitë lidhen në paragrafë dhe këta të fundit organizohen duke ruajtur lidhjen e brendshme të tekstit.
- ▣ Vihet re një përdorim më i shpeshtë i ndërtimeve emërore përkundrejt atyre foljore, si për shembull: *Rënia e shirave në mënyrë të vazhdueshme, u bë shkak për bllokimin e rrugëve*. Ndërtimi foljor mund të ishte: *Rrugët u bllokuan, sepse binte shi pa ndërprerë*.
- ▣ Ka një përdorim të shpeshtë të fjalive të përbëra, ndër të cilat mbizotërojnë ato me nënrenditje. Për pasojë, në vend të lidhëzave të thjeshta, ligjëruesi përzgjedh lokucione lidhëzore, si: *pavarësisht se, duke qenë se, në krahasim me, me kusht që* etj.
- ▣ Një vend të gjerë zë leksiku terminologjik. Në ligjërimin e shkruar gjejmë përdorime të tilla si: *medikamentet të merren nëpërmjet gojës, përkundrejt të pish ilaçet; stacioni hekurudhor përkundrejt stacioni i trenit; produkte qumështi përkundrejt bulmet* etj.

B. Tiparet dhe mjetet gjuhësore me të cilat shprehen stilet e ndryshme në gjuhën shqipe

Kujtojmë që për të përmbushur nevojat e komunikimit sipas fushave dhe funksioneve të ndryshme, folësit kalojnë nga njëri stil i gjuhës në tjetrin, duke u kushtuar vëmendje tipareve dhe mjeteve gjuhësore për secilin lloj.

Tiparet gjuhësore të stilit shkencor-teknik

- ✿ **Në stilin shkencor-teknik** synohet që informacioni të jepet i formuluar sa më saktë, të jetë i ngjeshur dhe pa shmangie kuptimore, gjë që bën të ketë shumë përkufizime, formulime apo formula për dukuri abstrakte.
- ▣ Fjalitë janë të zgjeruara me grupe fjalësh dhe pjesë fjalish që përgjithësisht janë në marrëdhënie nënrenditjeje mes tyre. Kjo bën që të vihen në përdorim mjete lidhëse më të ndërlikuara, si shprehjet lidhëzore apo fjalët lidhëse që nuk hasen rëndom në të folurit e përditshëm.
- ▣ Mbizotërojnë ndërtimet emërore përkundrejt atyre foljore.
- ▣ Përdoren shumë folje të mënyrës dëftore, në kohën e tashme dhe fjalë e shprehje, si: *mund, ndoshta, përgjithësisht* etj., për të shmangur pohimet absolute. Bërthamën e leksikut shkencor e përbëjnë termat.

Tiparet gjuhësore të stilit juridiko-administrativ

- ✿ **Me anë të stilit juridiko-administrativ** mbulohet veprimtaria me shkrim e me gojë në fushën ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore dhe gjithë puna administrative lidhur me to. Gjuha e përdorur synon standardizim sa më të lartë, ndaj këtu vihen re lehtë këto tipare dhe mjete gjuhësore:
- ▣ Mbizotërimi i stereotipave në të shkruar e në të shprehur, si për shembull: *sipas ligjeve në fuqi, marrja e masave administrative, hyrja në fuqi, shfuqizimi i ligjit* etj.
- ▣ Respektimi i modeleve të paracaktuara për hartimin e shkresave të ndryshme. Format standarde të shkrimit të datës, adresës, formulat e gatshme të hyrjes dhe të mbylljes së tekstit, nënshkrimi i tij etj. Për shembull: *Unë, i nënshkruari... në cilësinë e... deklaroj se...*
- ▣ Gjuha duhet të jetë e qartë dhe pa shmangie të mundshme kuptimore.

Thëniet ndërtohen të plota dhe ndjekin një vijimësi logjike të saktë.

- ▣ Mbizotërojnë ndërtimet klishe, çka bën që kjo mënyrë e përdorimit të gjuhës të jetë mjaft e ndryshme nga komunikimi i përditshëm. Krahasoni: *parashikohet ndalimi fizik i personit – të arrestojnë*.
- ▣ Është i zakonshëm përdorimi i shkurtesave si prirje për të lehtësuar tekstet, si: OSSHE, OKB, BE etj.

Tiparet gjuhësore të stilit politiko-shoqëror

🌸 **Në stilin politiko-shoqëror** përfshihen këto krijime: publicistika, të folurit në publik, reklama etj.

Mjetet gjuhësore të përdorura mund të grupohen në tri grupe: mjetet e zakonshme të gjuhës letrare, mjetet standarde dhe mjetet shprehëse.

- ▣ Me grupin e parë, pra me mjetet e zakonshme të gjuhës letrare kemi parasysh të gjithë gamën e mjeteve, përgjithësisht neutrale, asnjëse, që ofron gjuha për komunikim.
- ▣ Mjetet standarde të përdorura në stilin politiko-shoqëror, janë togje fjalësh apo mënyra shprehjeje të gatshme për t'u përdorur në një situatë të caktuar. Këto i gjejmë rëndom në shtypin e përditshëm, nga ku si shembuj mund të sjellim shprehje të tilla, si: *sipas njoftimeve të deritanishme...; autori u largua në drejtim të paditur...* etj.
- ▣ Mjetet shprehëse gjejnë po ashtu përdorim të gjerë në këtë stil, për t'i çelur rrugë qëndrimit dhe anës emocionale që nuk përjashtohet nga përkrahimi i veprimtarisë së kësaj fushe. Shtypi shfrytëzon mënyra nga më të ndryshmet, jo vetëm për ta përcjellë informacionin, por edhe për të ndikuar në ndjeshmërinë dhe gjykimin e marrësit të mesazhit, siç e dëshmojnë disa shembuj si këta: *policia e shtetit – blutë; gjelbërimi i qytetit – mushkëritë e qytetit; nafta – ari i zi* etj.

Tiparet gjuhësore të stilit të letërsisë artistike

🌸 **Stili i letërsisë artistike** është i hapur për të gjitha përdorimet e mundshme gjuhësore, kur kjo përzgjedhje ka, kryesisht, një synim të caktuar artistik letrar.

Ndarjet e mëdha të letërsisë janë: proza, poezia dhe drama.

- ▣ Proza është një lloj ligjërimi letrar që realizohet nga përpunimi artistik i rrëfimit të gjuhës së gjallë dhe i monologut. Aty ndërthuren të gjitha format e tjera të gjuhës së shkruar e të folur.
- ▣ Poezia është shfaqja më e epërme e përdorimit gjuhësor, e cila edhe në paraqitjen shkrimore dallon nga mënyrat e tjera të komunikimit. Në ligjërimin poetik, vëmë re një organizim të të gjitha niveleve të gjuhës, duke shfrytëzuar mjete të tilla, si: shkrimore, leksikore, semantike, sintaksore etj.
- ▣ Drama shfaqet në dy mënyra të dallueshme: tragjedi dhe komedi. Këtu mbizotëron mënyra skenike e të rrëfyerit, çka do të thotë që i gjithë ligjërimi është në gojën e personazheve, ndërkohë që mungojnë fjalët e autorit.

USHTRIME


1 Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.

- Tematika e një teksti përcakton llojin e shkrimit.
- Ligjërimi sipas regjistrit të ngritur është më i segmentuar se ai në regjistrin e thjeshtë.
- Ligjërimi sipas regjistrit të zakonshëm është gjithnjë në përputhje me normën letrare.
- Një tekst pa gabime drejtshkrimore, përmbush kërkesat për tekstin e shkruar në një regjistër të ngritur.
- Në çdo rast, folësi është i lirë të përzgjedhë regjistrin gjuhësor që parapëlqen.

2 Supozoni që kërkonti t'i jepet zgjidhje një problemi që ju shqetëson, si për shembull: "Rrezikshmëria e lartë e çiklistëve në rrugët e qytetit". Ndërtoni tri situata të ndryshme komunikimi sipas regjistrit: të thjeshtë, të zakonshëm dhe të ngritur.
3 Në cilin stil gjuhësor është shkruar teksti i mëposhtëm? A mund të rishkruhet në një stil tjetër?

Bakri (*lat. Cuprum*) është një element kimik, i cili në sistemin periodik gjendet me simbolin Cu dhe ka numrin rendor 29. Është një metal i periodës së 4-t në grupin e 11-të të sistemit periodik. Emri *kuprum* rrjedh prej fjalës *cyprium*, "mineral nga ishulli i Qipros". Bakri ka qenë metali i parë i përdorur nga njeriu për prodhimin e veglave të ndryshme, si dhe të armëve.

4 Përcaktoni në ç'stil gjuhësor është shkruar teksti i mëposhtëm dhe nënvizoni fjalët apo shprehjet që i vlerësoni si tipike për këtë stil.

Ndoshta është i pafat, sepse çdo fillimsezon i duhet të rindërtojë skuadrat e tij fituese dhe shumë shpesh ia del, por në këtë sezon janë dëmtimet e shpeshta të lojtarëve që po ia bëjnë jetën ferr, aq më shumë në përballjet e rëndësishme si ajo me Napolin, një javë më parë, apo akoma më shumë edhe në 90-minutëshin e shumëpritur nga të gjithë bardhezinjtë si ky i mbrëmjes së sotme kundër Interit.


5 Gjeni dhe lexoni disa ligje të kodit penal dhe civil. Nënvizoni mjetet gjuhësore që mendoni se i përkasin veçanërisht kësaj fushe.
6 Shprehjet e mëposhtme, që përdoren gjatë komunikimit të folur, kthejini në formën që ato përdoren në komunikimin e shkruar.

<i>Komunikimi i folur</i>	<i>Komunikimi i shkruar</i>
shoferi i makinës	drejtuesi i automjetit
doktori i zemrës	
dhashë provim kiminë	
pije hapen	

7 Pjesa e mëposhtme i përket komunikimit të shkruar. Kthejeni në formën e komunikimit të folur. Argumentoni ndryshimet e bëra.

Një aksident i rëndë ka ndodhur në orën 9.30, në kryqëzimin e quajtur "Shtegu i ngushtë", ku katër automjete janë përplasur mes tyre. Nga informacionet mësohet se njëri prej automjeteve është përmbysur, ndërsa si pasojë e aksidentit janë plagosur disa persona, të cilët janë dërguar në spital për ndihmë mjekësore. Mësohet se forcat e rendit kanë shkruar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Morfologji



Klasat e fjalëve

Sipas veçorive të përbashkëta leksiko-gramatikore, të gjitha fjalët grupohen në klasa fjalësh. Ato quhen pjesë të ligjëratës. Në gjuhën shqipe, dallohen këto pjesë ligjërate:

emra, mbiemra, përemra, folje, numërorë, ndajfolje, parafjalë, lidhëza, pjesëza, pasthirrma.

- I. Sipas veçorive të tyre morfologjike, fjalët grupohen në **fjalë të ndryshueshme** dhe në **fjalë të pandryshueshme**.

Ej, pikërisht ata janë dy shokët që shpëtuan aq trimërisht macen e braktisur në shtëpinë e rrënuar.



- ✿ Për secilën fjalë të fjalisë së mësipërme, përcaktojmë klasën e fjalëve ku bën pjesë:

ej - pasthirrmë

janë - folje

që - lidhëz

trimërisht - ndajfolje

në - parafjalë

pikërisht - pjesëz

dy - numëror

shpëtuan - folje

macen - emër

shtëpinë - emër

ata - përemër

shokët - emër

aq - ndajfolje

e braktisur - mbiemër

e rrënuar - mbiemër

- II. Sipas veçorive sintaksore, fjalët grupohen në **fjalë të mëvetësishme** dhe në **fjalë të pamëvetësishme**.
 - ▣ Janë emërtuar **fjalë të mëvetësishme**, sepse mund të qëndrojnë më vete kur përdoren në fjali. Në këtë grup, bëjnë pjesë: *emri, folja, mbiemri, numërori, përemri, ndajfolja* dhe *pasthirrma*.
 - ▣ Janë emërtuar **fjalë të pamëvetësishme**, sepse nuk kanë kuptim të pavarur dhe nuk mund të qëndrojnë më vete në fjali. Në këtë grup, bëjnë pjesë: *parafjala, lidhëza* dhe *pjesëza*.

- III. Mbështetur në kuptimin leksikor të fjalëve, ato i ndajmë në **fjalë kuptimplota**, në **fjalë jokuptimplota** dhe në **fjalë thirrmore**.
- ▣ Janë emërtuar **fjalë kuptimplota**, sepse kanë kuptim të plotë leksikor: *lule (emër); e bukur (mbiemër); çel (folje), herët (ndajfolje); kjo (përemër); dy (numëror)*.
 - ▣ Janë emërtuar **fjalë jokuptimplota**, sepse nuk kanë kuptim të pavarur: *me (parafjalë); dhe (lidhës); mos (pjesëz)*.
 - ▣ **Fjalët thirrmore** shprehin thirrje në formë ndjenjash dhe dëshirash: *oburra, hop, tungjatjeta etj.*

USHTRIME

1 Nënvizoni me një vijë fjalët e ndryshueshme dhe me dy vija fjalët e pandryshueshme.

Disa ditë më vonë, bashkë me dy shokë të tjerë, ai erdhi për të na kthyer vizitën. Përveç punës sime si mësues, më duhej të kryeja edhe shumë punë të tjera në ndihmë të njerëzve.

Ai i bluante të gjitha përbrenda dhe me ne, shokët e tij të ngushtë, nuk guxonte të hapej. Unë përfytyrova se si kishte ardhur ai, i huaji, pas gjurmëve të mia.

2 Lexoni me kujdes fragmentin, emërtoni fjalët dhe vendosini në tabelë.

Po afrohej mbrëmja. Dielli, si një disk i madh dhe i kuq, po prekte detin e kaltër. Faqja i shkëlqente prej dritës së tij. Befas u dëgjua troku i një kali. Një kalorës po rendte drejt grumbullit të luftëtarëve të Gjon Kastriotit. Vinte nga kalaja e Gurit të Bardhë. Të gjithë luftëtarët ia ngulën sytë kalorësit, i cili ndali vrapin sapo u afrua pranë tyre. Djersët i shkonin si rrëqe faqeve dhe kali shkumonte nga lodhja.

emër	mbiemër	folje	numëror	përemër	ndajfolje	lidhës	parafjalë	pjesëz	pasthirmë

3 Fjalët e mësipërme grupojini sipas ndarjes në tabelë.

Fjalë të mëvetësishme	Fjalë të pamëvetësishme

4 Grupojini në fjalë kuptimplota, në fjalë jokuptimplota dhe në fjalë thirrmore, fjalët e paragrafit të mëposhtëm.

- Ju po më trembni! - tha rrënja e trëndafililit. - Nuk i kisha menduar kurrë këto gjëra!

- Po, po merret vesh që ju nuk e lodhni shumë mendjen. Po, a e keni vlarë mendjen ndonjëherë të merni vesh përse ju lulëzoni dhe si ndodh kjo? Përse kështu dhe jo ndryshe?


Fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme

Kujtojmë

Fjalët që e ndryshojnë formën gjatë përdorimit të tyre në fjali, quhen fjalë të ndryshueshme (*emri, folja, mbiemri, përemri, numërori*).

Fjalët që nuk e ndryshojnë formën gjatë përdorimit në fjali, quhen fjalë të pandryshueshme (*ndajfolja, parafjala, pjesëza, lidhëza, pasthirrma*).

1. Fjalët e ndryshueshme



Kujdes

Nyja nuk përbën klasë më vete fjalësh. Ajo është pjesë e emrave, mbiemrave, përemrave, numërorëve.

Emri është fjalë e ndryshueshme, sepse e ndryshon formën e tij sipas *trajtës, lakimit, gjinisë, numrit, rasave*.

Klasa	Kategoritë leksiko-gramatikore të emrit				
	trajta	lakimi	gjinia	numri	rasat
Emri	e pashquar/e shquar	I – (mali) II – (ujku) III – (lulja) IV – (të folurit)	femërore mashkullore asnjanëse	njëjës shumës	emërore/gjinore/ dhanore/kallëzore/ rrjedhore
Shembuj	<i>mik/miku</i>	<i>muri/miku</i> <i>/lulja/të folurit</i>	<i>hëna/shiu/ të shkruarit</i>	<i>shoku/shokët</i>	<i>shiu/ i,e shiut/shiut/ shiun/prej shiut</i>

Mbiemri është fjalë e ndryshueshme, sepse e ndryshon formën e tij sipas *numrit, gjinisë, rasave, shkallëve*.

Klasa	Kategoritë leksiko-gramatikore të mbiemrit			
	numri	gjinia	rasat	shkallët
Mbiemri	njëjës shumës	mashkullore femërore	emërore/gjinore/ dhanore/kallëzore/ rrjedhore	pohore/krahasore /sipërore
Shembuj	<i>i bukur/të bukur</i>	<i>i bukur/e bukur</i>	<i>i bukur/i,e të bukurit/ të bukurit/ të bukurin/ prej të bukurit</i>	<i>i bukur/më i bukur/ shumë i bukur</i>

Folja është fjalë e ndryshueshme, sepse e ndryshon formën e saj sipas **vetës, numrit, kohës, mënyrës, zgjedhimit, formës**.

Klasa	Kategoritë leksiko-gramatikore të foljes					
	veta	numri	koha	Mënyra	zgjedhimi	forma
Folja	I II III	njëjës/ shumës	e tashme/e shkuar/e ardhme	dëftore/lidhore/ kushtore/habitore/ dëshirore/ urdhërore	I II III folje të parregullta	veprore/ joveprore
Shembuj	<i>ulem/ulesh /ulet</i>	<i>ulem/ulemi</i>	<i>ulem/ulesha/ do të ulem</i>	<i>ulem/të ulem/të ulesha/u ulka/u ulsh/ulu</i>	<i>laj/kap/ rri/them</i>	<i>shkruaj/ shkruhem</i>

Përemri është fjalë e ndryshueshme, sepse e ndryshon formën e tij sipas **vetës, numrit, rasës**.

Klasa	Kategoritë leksiko-gramatikore të përemrit		
	veta	numri	rasat
Përemri	I II III	njëjës/shumës	emërore/gjinore/ dhanore/kallëzore/ rrjedhore
Shembuj	<i>unë/ti/ai</i>	<i>unë/ne; ti/ju; ai/ata</i>	<i>ai/ i,e atij/atij/atë/prej atij</i>

Numërori është fjalë e ndryshueshme, sepse e ndryshon formën e tij sipas **rasës: i dyti/ i,e të dytit/ të dytit/ të dytin/ prej të dytit**.




Kujdes

Nga fjalët e ndryshueshme: folja zgjedhohet; emri, mbiemri, përemri, numërori lakohen.

2. Fjalët e pandryshueshme

Lidhëza, ndajfolja, parafjala, pjesëza dhe **pasthirrma** quhen fjalë të pandryshueshme, sepse nuk e ndryshojnë formën e tyre.



USHTRIME

- 1** Plotësoni vendet bosh me fjalë, pa prishur kuptimin. Emërtoni se çfarë pjese ligjërata janë ato.

Mbi ... me dëborë ... mjegull ... tufan. Po fluturojnë... i fitores. Enea shkon shkollë ... ditë. Mes gjen një grykë, mes majash një shteg. Dhe tufa e ndjek dhe i vjen ... me bindje.

- 2** Lidhni me shigjetë fjalët me klasën në të cilën bëjnë pjesë. Shtoni të tjera sipas llojit.

Emër	<i>i zgjuar, i mirë, pranveror</i>	
Mbiemër	<i>ne, ju, unë, ata</i>	
Përemër	<i>kuti, lojë, djalë, fletore</i>	
Numëror	<i>shpesh, këndshëm, pak, larg</i>	
Folje	<i>dhjetë, një, tre (tri)</i>	
Ndajfolje	<i>notoj, kërkoj, kam dalë, luaj</i>	
Parafjalë	<i>pikërisht, veç</i>	
Lidhës	<i>ah, obobo</i>	
Pjesëz	<i>me, në, nëpër</i>	
Pasthirmë	<i>e, edhe, se</i>	

- 3** Shkruajeni në numrin shumë tekstin e mëposhtëm dhe nënvizoni fjalët që ndryshojnë formë. Emërtojini ato.

Ishte një zë i dëgjuar. Para tij u shfaq një njeri me flokë të ndarë në mes. Flokët i kishte të lagur nga shiu që kishte rënë pak më parë. Ishte e ditur rruga nga ai që kishte ardhur deri këtu. Dukej i kënaqur me pamjen e tij. Por edhe i bindur për të folur si i barabartë me gjithë të tjerët.

- 4** Nënvizoni vetëm fjalët e pandryshueshme dhe emërtojini ato.

Ishte bërë i kuq dhe dukej i gëzuar. Në medalje dukej rripi i bardhë, i kuq e i verdhë. Nëna qante e qeshte, babai përdridhte mustaqen me dorën që i dridhej. Në kopsht dëgjohej lehtas një jehonë e ëmbël, që dukej sikur largohej ngadalë poshtë bregut.

- 5** Emërtoni fjalët dhe bëni një grafik me shtylla, që të tregojë shpeshtësinë e përdorimit të tyre në këtë tekst.

Kur del era, fshatarët shpërndahen me punë fushave të Zadrimës. Edhe fëmijët ndjekin nga pas qengjat që kullotin rrëzë kodrinave. Dhe mblidhen tek oborri i kishës së fshatit Troshan, ku ka vend për të luajtur të gjithë. Vetëm Zefi qëndron mënjanë. Është më i vogli dhe asnjë grup lojtarësh nuk i bën vend. Disa luajnë kaladibrance. Janë djemtë më të rritur. Hidhen fluturim mbi njëri-tjetrin. Fluturon edhe Zefi me mend mbi të gjithë, por fantazia e tij nuk e zbavit. Duhet edhe muskuj. E ai ende nuk i ka.


emra	mbiemra	folje	përemra	numërorë	ndajfolje	lidhëza	parafjalë	pjesëza	pasthirrma

Kujtojmë

- Format e ndryshme që merr emri gjatë përdorimit të tij në fjali, quhen rasa.
- Emri ka pesë rasa: emëroren, gjinoren, dhanoren, kallëzoren, rrjedhoren.
- Tërësia e ndryshimeve që pëson emri kur vendoset nëpër rasa, quhet lakim.

Emrat ndahen në katër lakime.

- Në lakimin e parë** bëjnë pjesë emrat e gjinisë mashkullore, që në emëroren e shquar njëjës marrin mbaresën **-i**: *mal-i, kal-i, djal-i, dyqan-i, spital-i* etj.
- Në lakimin e dytë** bëjnë pjesë emrat e gjinisë mashkullore, që në emëroren e shquar njëjës marrin mbaresën **-u**: *mik-u, fik-u, borzilok-u, finok-u* etj.
- Në lakimin e tretë** bëjnë pjesë emrat e gjinisë femërore, që në emëroren e shquar njëjës marrin mbaresën **-a/-ja**: *dera, vajza, lulja, lagjja* etj.
- Në lakimin e katërt** bëjnë pjesë emrat e gjinisë asnjënjësore, që në emëroren e shquar njëjës marrin mbaresën **-t/-it/të**: *të ftohtët, të ngrohtët, të folurit, të parit, të kuqtë, të zitë* etj.



Kujdes

Në disa raste, emrat e numrit shumës në rasën rrjedhore mbarojnë me **-sh**: *Dëgjoheshin lloj-lloj fjalësh (jo lloj-lloj fjalëve)*.
Por ka edhe raste kur mund të qëndrojnë të dyja variantet: **-sh/-ve**: *Ishte dërrmuar prej hallesh/halleve të shumta*.

Rasa	Pyetjet	Numri	I pashquar	I shquar
emërore	<i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i>	njëjës shumës	(një) libër (disa) libra	libri librat
gjinore	<i>I kujt? E kujt? Të kujt?</i>	njëjës shumës	i/e (një) libri i/e (disa) librave	i/e librit i/e librave
dhanore	<i>Kujt? Cilët? Cilës? Cilëve? Cilave?</i>	njëjës shumës	(një) libri (disa) librave	librit librave
kallëzore	<i>Kë? Cilin? Cilën? Cilët? Cilat?</i>	njëjës shumës	(një) libër (disa) libra	librin librat
rrjedhore	<i>Prej kujt? Prej cilit? Prej cilës? Prej cilëve? Prej cilave?</i>	njëjës shumës	prej (një) libri prej (disa) librash	prej librit prej librave

Lakimi i parë

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	muri	muret	(një) mur	(disa) mure
gjinore	i/e murit	i/e mureve	i/e (një) muri	i/e (disa) mureve
dhanore	murit	mureve	(një) muri	(disa) mureve
kallëzore	murin	muret	(një) mur	(disa) mure
rrjedhore	prej murit	prej mureve	prej (një) muri	prej (disa) mureve

Lakimi i dytë

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	breg <u>u</u>	brigjet	(një) breg	(disa) brigje
gjinore	i/e breg <u>ut</u>	i/e brigjeve	i/e (një) breg <u>u</u>	i/e (disa) brigjeve
dhanore	breg <u>ut</u>	brigjeve	(një) breg <u>u</u>	(disa) brigjeve
kallëzore	breg <u>un</u>	brigjet	(një) breg	(disa) brigje
rrjedhore	prej breg <u>ut</u>	prej brigjeve	prej (një) breg <u>u</u>	prej (disa) brigjeve

Lakimi i tretë

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	fjal <u>a</u>	fjalët	(një) fjalë	(disa) fjalë
gjinore	i/e fjalës	i/e fjalëve	i/e (një) fjalë	i/e (disa) fjalëve
dhanore	fjalës	fjalëve	(një) fjalë	(disa) fjalëve
kallëzore	fjalën	fjalët	(një) fjalë	(disa) fjalë
rrjedhore	prej fjalës	prej fjalëve	prej (një) fjalë	prej (disa) fjalëve

Lakimi i katërt

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	të folur <u>it</u>	të folurat	(një) të folur	(disa) të folura
gjinore	i/e të folur <u>it</u>	i/e të folurave	i/e (një) të folur <u>i</u>	i/e (disa) të folurave
dhanore	të folur <u>it</u>	të folurave	(një) të folur <u>i</u>	(disa) të folurave
kallëzore	të folur <u>in</u>	të folurat	(një) të folur	(disa) të folura
rrjedhore	prej të folur <u>it</u>	prej të folurave	prej (një) të folur <u>i</u>	prej (disa) të folurave

USHTRIME

1 Shkruani në formën e duhur emrat në kllapa dhe përcaktoni rasën e tyre.

Gjithë _____ (trup) më ishte mpirë dhe _____ (gishtërinj) nuk i ndieja. Kur _____ (dhëmb) e mi po kërcisnin nga të ftohtit, _____ (ujq) filluan të shqetësoheshin. Kryetari _____ (familje) së tyre, ai që ishte poshtë meje, u ngrit dhe iu afrua të tjerëve. Ujkonja filloi të shikojë rreth e rrotull. Duhet të ndienin ndonjë _____ (zhurmë) të largët! Mundet që _____ (udhëtar) të jenë diku pranë, mendova unë dhe _____ (shpresë) më ndriti sytë.

2 Nënvizoni emrat dhe përcaktoni rasën.

Shpesh lojërat edukojnë të fëmijët aftësi praktike, si: forcën, guximin, rezistencën ndaj kushteve të mjedisit, që do t'u duhen atyre kur të rriten. Për shembull, në Arabinë Saudite ka fëmijë që jetojnë në thellësi të shkretëtirave. Ata luajnë një lojë që quhet "kockat", e cila mpreh vështrimin e tyre.

USHTRIME

3 Lakoni sipas rasave emrat në tabelë.

Rasa	lapsi	ujku	gjuha	të ngrënit
emërore				
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

4 Plotësoni tabelat e lakimit të emrave.

Gjinia femërore

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	lulja			
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

Gjinia mashkullore

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	vëllai			
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

Gjinia mashkullore

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	shoku			
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

Gjinia asnjënjësore

Rasa	Trajta e shquar		Trajta e pashquar	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	të menduarit			
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

5 Shkruani një shkrim me titull “Në familje”, ku të përdoret emri “dashuri” në të gjitha rasat.

6 Në pjesën me titull “Komandanti i klasës”, gjeni emrat dhe përcaktoni lakimin, trajtën dhe rasën e tyre.

Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi

Shkruhen me dy trajta shumësi:

- a.** Emra me dy forma shumësi që përdoren me kuptime të ndryshme. P.sh.: *brinjë*: *brinjë-t* (brinjët e trupit), *brinja-t* (ato kodra, ato brinja); *grykë*: *grykë-t* (më dhembin grykët), *gryka-t* (grykat e maleve); *lëkurë*: *lëkurë-t* (tharja e lëkurëve), *lëkura-t* (lëkurat e pemëve); *pikë*: *pikë-t* (fitoi pesë pikë), *pika-t* (pikat e shiut) etj.
- b.** Emrat me formë të dytë të shumësit që mbaron me **-ra** për qëllime të caktuara shprehëse ose për ngjyrimë të veçanta kuptimore. P.sh.: *çudi-çuditë*, *çudira*; *kusi*, *kusitë*, *kusira*; *marrëzi*, *marrëzitë*, *marrëzira*, *shaka*, *shakatë*, *shakara*, *tepsi*, *tepsitë*, *tepsira*, *trimëri*, *trimëritë*, *trimëriria* *ide*, *idetë*, *idera*, *bela*, *belatë*, *belara*, *mrekulli*, *mrekullitë*, *mrekullira* etj.

Format normative të shumësit

Emri	Variantet e shumësit	Emri	Variantet e shumësit
<i>bakall</i>	<i>bakej, bakaj</i>	<i>gjysh</i>	<i>gjyshër, gjyshja</i>
<i>çakall</i>	<i>çakej, çakaj</i>	<i>kec</i>	<i>keca, kecër</i>
<i>dhaskal</i>	<i>dhaskenj, dhaskaj</i>	<i>nip</i>	<i>nipa, nipër</i>
<i>çam</i>	<i>çamë, çamër</i>	<i>prind</i>	<i>prindër, prindë</i>
<i>lab</i>	<i>lebër, labë</i>	<i>stof</i>	<i>stofra, stofa</i>
<i>byrek</i>	<i>byrekë, byreqe</i>	<i>buf</i>	<i>bufa, bufër</i>
<i>dyfek</i>	<i>dyfekë, dyfeqe</i>	<i>këlysh</i>	<i>këlyshë, këlyshër</i>
<i>hendek</i>	<i>hendeqe, hendekë</i>	<i>qen</i>	<i>qenër, qen</i>
<i>jastëk</i>	<i>jastëkë, jastëqe</i>	<i>ujk</i>	<i>ujq, ujqër</i>
<i>oxhak</i>	<i>oxhakë, oxhaqe</i>	<i>çudi</i>	<i>çudi, çudira</i>
<i>ulluk</i>	<i>ullukë, ulluqe</i>	<i>gosti</i>	<i>gosti, gostira</i>
<i>bli</i>	<i>blirët, blinj</i>	<i>rreth</i>	<i>rrathët, rrethet</i>
<i>flamur</i>	<i>flamurë, flamuj</i>	<i>vit</i>	<i>vitet, vjetët</i>

USHTRIME

1 Lexoni tekstin dhe nënvizoni emrat që kanë dy forma të shumësit.

A e keni pyetur veten ndonjëherë pse prodhohen kaq shumë makina çdo vit?

Disa arsye ndoshta janë: makinat na ndihmojnë që të lëvizim sa më shpejt; shumica i përdorin makinat për të kryer punë të ndryshme dhe disa të tjerë (këtu në Shqipëri) i përdorin për argëtim, edhe pse territoret që përshkohen nga to janë të vogla.

2 Në tekstin e mëposhtëm, vendosni fjalët e duhura në vendet bosh.

Lëku _____ e kafshëve të egra përdoren në industri. Copë _____ e tyre të thara staxhionohen dhe përpunohen në fabrika moderne. Të palosura dhe të vendosura si pe _____ byreku, ato transportohen nga një vend në tjetrin.

3 Në tekstin me titull "Çmimet", nënvizoni emrat dhe kthejini në numrin shumës. Gjeni emrat që kanë dy trajta shumësi.

Kujtojmë

Përemri vetor është fjalë e ndryshueshme që tregon veta të ndryshme: vetën e parë, vetën e dytë, vetën e tretë, në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Përemri vetor është fjalë e ndryshueshme që tregon në veta të ndryshme (vetën e parë, vetën e dytë, vetën e tretë, në numrin njëjës dhe në numrin shumës).

Numri njëjës	Numri shumës
Veta e parë – UNË – tregon atë që flet.	Veta e parë – NE – tregon një grup vetash ku bën pjesë edhe personi që flet.
Veta e dytë – TI – tregon atë me të cilin flasim.	Veta e dytë – JU – tregon bashkëbiseduesit.
Veta e tretë – AI/AJO – veta për të cilën flitet, por që nuk është e pranishme.	Veta e tretë – ATA/ATO tregon ata për të cilët bëhet fjalë, por që nuk janë të pranishëm.

Përemrat vetorë lakohen në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Përemrat e vetës së parë dhe të dytë, njëjës dhe shumës, nuk lakohen në rasën gjinore.

Lakimi i përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra

Njëjës					Shumës			
Veta I		Veta II	Veta III		Veta I	Veta II	Veta III	
Emërore	unë	ti	ai	ajo	ne	ju	ata	ato
Gjinore	-	-	i, e atij	i, e asaj	-	-	i, e atyre	i, e atyre
Dhanore	mua më	ty të	atij i	asaj i	neve na	juve ju	atyre u	atyre u
Kallëzore	mua më	ty të	atë e	atë e	ne na	ju ju	ata (ta) i	ato (to) i
Rrjedhore	prej meje	prej teje	prej (a)tij	prej (a)saj	prej nesh	prej jush	prej (a)tyre	prej (a)tyre

Mbani mend

Gjatë lakimit, përemrat vetorë në rasat dhanore dhe kallëzore dalin me dy forma (**trajtë e plotë** + **trajtë e shkurtrë**).

Trajtat e shkurtra qëndrojnë pranë foljes dhe zakonisht vendosen para saj:
E lajmëroi menjëherë shoqen (atë).

Ka raste kur trajtat e shkurtra i ngjiten foljes pas: *Lajmëroje menjëherë shoqen.*

Ka edhe raste kur trajtat e shkurtra futen në trup të foljes: Lajmërojeni menjëherë shoqen.

USHTRIME

1 Nënvizioni trajtat e plota dhe trajtat e shkurtra të përemrave vetorë.

<i>Edhe mua më gëzoi shpallja e pavarësisë së Kosovës.</i>	<i>(kë?)</i>
<i>Më trego edhe mua një përrallë.</i>	<i>(kujt?)</i>
<i>Ty të erdhën shokët për ditëlindje.</i>	<i>(kujt?)</i>
<i>Edhe ty të ftuan në ditëlindjen e Anës.</i>	<i>(kë?)</i>
<i>Atij i dhuruan disa disqe të reja.</i>	<i>(kujt?)</i>
<i>Atë e falënderuan për rezultatet e arritura në mësim.</i>	<i>(kë?)</i>
<i>Për rezultate të larta na falënderuan edhe ne.</i>	<i>(kë?)</i>
<i>Neve na bëri përshtypje sjellja e saj e pahijshme ndaj një të moshuari.</i>	<i>(kujt?)</i>
<i>Ju ju respektojnë të gjithë në shkollë.</i>	<i>(kë?)</i>
<i>Juve ju tregoi një përrallë gjyshi?</i>	<i>(kujt?)</i>

2 Nënvizioni përemrat vetorë (trajtat e plota dhe trajtat e shkurtra) në pjesën e mëposhtme. Përcaktoni vetën, numrin dhe rasën e tyre (për vetën e tretë edhe gjininë).

Po luftëtari nuk flet dot. Ai, që s'i ishin mvrejtur sytë kur i binin me shigjetat dhe gjylet si breshër mbi supe, qan si çilimi, bie më gjunjazi, i puth dorën princeshës së nderuar, po lotët e mbytin dhe s'thotë dot "unë jam!". Por nëna e mori vesh. E njohu nga syri, e njohu nga fytyra, e njohu nga sjellja. Pastaj e njohu më mirë ajo dhe Shqipëria, dhe bota nga ato që bëri. Ai qe i tërë dhe i gjallë, Gjergj Kastrioti, princi i Krujës, konti i Matit dhe Zoti i Dibrës, që u quajt Skënderbe prej Sulltanit, mbret i Shqipërisë dhe i Maqedonisë prej Papës.

Si mori bekimin e nënës dhe u bë dy herë më i fortë se më parë, rrëmbeu shpatën, e ngjeshi në brez dhe shkoi kaluar në fortesë.

Kruja që dukej e shkretuar, lëviz dhe ngjallet. Burra, gra, fëmijë janë mbledhur në shesh të qytetit. Flamuri i huaj u hoq dhe tani valon në erë flamuri i Shqipërisë. Për atë gëzohet populli, për atë tingëllojnë kabanat, për atë gjëmojnë topat. Ato që ngjanë nën atë flamur, nën atë kryeushtar, i shkruan historia me shkronja të arta, i buçasin malet, brigjet dhe gurët e Shqipërisë, i tregojnë përrallat dhe legjendat e pleqve dimrit rreth vatrës.

Fan Noli

3 Vendosni në rasën e duhur përemrat në kllapa.

(unë) nuk më erdhi mirë që nuk u takuam sot bashkë. Cilitdo prej (ju) mund t'i ndodhë një ngjarje e tillë. Unë duhet t'ia dhuroja librin (ajo), sepse kështu më dukej (unë)..... më mirë.

(Ne) nuk na lejohej të nxirrnim libra nga biblioteka. (Ne) kujdeseshim shumë për (ai) Në bibliotekë më merrnin çdo javë edhe (unë)..... .

4 Lakoni përemrat unë, ne, ti, ju.**5 Shkruani nga një fjali me çdo përemër të tabelës së mësipërme, në rasën dhanore e kallëzore.**

Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor



Emi donte t'i telefononte Elizës, por **ajo** nuk **iu** përgjigj.

Kujtojmë

Përemri është fjalë e ndryshueshme që tregon në përgjithësi frymorë, sende, sasi të pacaktuara. Përemrat përdoren shpesh në vend të emrave, me qëllim që ata të mos përsëriten dhe të mos e rëndojnë frazën apo fjalinë.

Kemi përemra: vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë, të pacaktuar.

Në rasat **kallëzore** e **dhanore**, përemrat vetorë **mua, ne, neve; juve, ju; atë, atij (asaj), ata (ato), atyre** kanë edhe trajtat e shkurtra përkatëse: **më, në, të, ju, e, i, u**.

Rasat						
emërore	unë	ti	ai/ajo	ne	ju	ata/ato
gjinore	-	-	i, e atij/i, e asaj	-	-	e atyre
dhanore	mua më	ty të	atij i/asaj i	neve na	juve ju	atyre u
kallëzore	mua më	ty të	atë e	ne na	ju ju	ata i
rrjedhore	meje	teje	atij	nesh	jush	atyre

Trajtat e shkurtra janë **të thjeshta** dhe **të bashkuara**.

Trajtat e shkurtra të bashkuara formohen nga përdorimi pranë njëra-tjetrës i një **trajte të shkurtër të rasës dhanore** dhe **i një trajte të shkurtër të rasës kallëzore në vetën e tretë**: më + e = ma.

Një trajtë e shkurtuar e rasës dhanore + një trajtë e shkurtuar e rasës kallëzore, veta e tretë = trajtë e shkurtuar e bashkuar

Formimi i trajtave të shkurtra dhe të bashkuara

Siç shihet nga tabela, në rasat dhanore e kallëzore përemrat vetorë kanë një trajtë të plotë dhe një trajtë të shkurtër.

Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrave vetorë

dhanore + kallëzore (veta III njëjës)	Shembuj	
<i>më</i> (mua) + <i>e</i> (atë) =	ma	<i>Ma</i> tregoi edhe mua librin e ri që kishte bërë.
<i>të</i> (ty) + <i>e</i> (atë) =	ta	<i>Ta</i> tregoi edhe ty librin e ri që kishte bërë.
<i>i</i> (atij, asaj) + <i>e</i> (atë) =	ia	<i>Ia</i> tregoi edhe atij librin e ri që kishte bërë.
<i>na</i> (neve) + <i>e</i> (atë) =	na e	<i>Na e</i> tregoi edhe neve librin e ri që kishte bërë.
<i>ju</i> (juve) + <i>e</i> (atë) =	jua	<i>Jua</i> tregoi edhe juve librin e ri që kishte bërë.
<i>u</i> (atyre) + <i>e</i> (atë) =	ua	<i>Ua</i> tregoi edhe atyre pikturën që kishte bërë.
dhanore + kallëzore (veta III shumës)	Shembuj	
<i>më</i> (mua) + <i>i</i> (ata, ato) =	m'i	<i>M'i</i> tregoi edhe mua librat e rinj që kishte bërë.
<i>të</i> (ty) + <i>i</i> (ata, ato) =	t'i	<i>T'i</i> tregoi edhe ty librat e rinj që kishte bërë.
<i>i</i> (atij, asaj) + <i>i</i> (ata, ato) =	ia	<i>Ia</i> tregoi edhe atij (asaj) librat e rinj.
<i>na</i> (neve) + <i>i</i> (ata, ato) =	na i	<i>Na i</i> tregoi edhe neve librat e rinj që kishte bërë.
<i>ju</i> (juve) + <i>i</i> (ata, ato) =	jua	<i>Jua</i> tregoi edhe juve librat e rinj që kishte bërë.
<i>u</i> (atyre) + <i>i</i> (ata, ato) =	ua	<i>Ua</i> tregoi edhe atyre librat e rinj që kishte bërë.

Trajtat e shkurtra të bashkuara **ma**, **ta** shkruhen pa apostrof, ndërsa trajtat **na e**, **na i** shkruhen ndaras.

USHTRIME

1 Në tekstin e mëposhtëm, vendosni në vendet bosh trajtat e shkurtra që mungojnë.

___ kishim rezervuar pushimet në internet gjashtë muaj më parë dhe nuk ___ kishim varë mendjen për asgjë. ___ kishim marrë qetë se çdo gjë ___ dukej në rregull. Kështu që nuk mund ___ imagjinoni befasinë tonë kur ___ u tha që ne nuk mund të fluturonim sepse djalit tonë ___ kishte skaduar pasaporta. ___ kujtua një shok dhe vrapuam tek ai me shpresën se do të ___ ndihmonte dhe do të ___ rregullonte punën e pasaportës.

2 Vendosni në vendet bosh përemrat dhe trajtat e shkurtra ose të bashkuara.

Unë besoj se ___ nuk ke ikur, sepse do të ___ kishe lajmëruar. ___ i duam prindërit tanë, prandaj dhe ___ respektojmë gjithmonë. ___ mori mendja që e keni takuar. ___ thirrën urgjent në shkollë. Për të festuar ditëlindjen e nënës sime ___ veshi një fustan që të gjithë ___ pëlqyen.

3 Plotësoni vendet bosh me përemra vetorë ose trajta të shkurtra dhe të bashkuara.

Unë e besoj ____, përse ___ nuk më beson ____. ___ duam prindërit tanë edhe ___ duan ____. Për të festuar ditëlindjen e nënës ___ organizuam një festë që do të jetë surprizë për ____. ___ janë duke dëgjuar me vëmendje këngën që ___ këndoi.

4 Shkruani sipas modelit, nënvizoni trajtën e shkurtër.

Më thuaj të vërtetën. Thua **ma** të vërtetën.

Nëse të pëlqen medaljoni im e merr me vete sot dhe ma kthe (___) pas një jave.

E bleve akulloren, më jep (___) edhe mua pak. Nëse do të nisesh shpejt i fol shoferit (___). Më ktheni (___) sa më parë te nëna ime. Ju thuaj (___)

atyre të mblidhen sa më parë. Çfarë ka ndodhur më thoni (___) të vërtetën.

5 Në pjesën me titull "Bojaxhiu finok", nënvizoni përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra dhe të bashkuara. Përcaktoni numrin, rasën dhe si janë formuar.

Përdorimi i apostrofit para trajtave të shkurtra

Apostrofi është një shenjë si presje, e cila vihet sipër rreshtit në vend të një zanoreje a të një rrokjeje që ka rënë dhe pas pjesëzës mohuese **s**.

Ndër të tjera, apostrofi përdoret në disa raste të shkrimit të trajtave të shkurtra dhe të bashkuara.

Shkruhen me apostrof trajtat e shkurtra:



më + i = m'i	<i>m'i dha; t'i dha; T'i shkruash shoqes. T'i zbatosh rregullat. Do t'i kërkoja. Do t'i flas. Me t'i thënë një fjalë... etj.</i>
më + u = m'u	<i>M'u tha e verteta... etj.</i>
më + ia = m'ia të + ia = t'ia	<i>Të m'ia thuash të gjitha. T'ia kërkosh librin... Të mos m'ia prishi qejfin... etj.</i>
të + iu = t'iu	<i>Për t'iu përgjigjur nënës... Me t'iu afruar shtëpisë... etj.</i>
të + ju = t'ju	<i>Dua t'ju ndihmoj. Do t'ju kisha marrë... Do t'ju lutesha... Me t'ju njoftuar... etj.</i>
të + jua = t'jua	<i>Dua t'jua them hapur. Do t'jua kisha thënë më parë. Do t'jua di për nder. Do t'jua lehtësojë shumë punën... etj.</i>
më + ua = m'ua	<i>Mos m'ua prishni festën... etj.</i>
të + u = t'u	<i>T'u themi të vërtetën. T'u japim një lajm të mirë.</i>

Trajtat e shkurtra të bashkuara **ma, ta** shkruhen pa apostrof: *ma dha fjalën; pa ma thënë; ta dha fjalën, ta kërkoi një nder etj.*

USHTRIME

1 Shkruani si duhet trajtën e shkurtër.

do ti kërkoja; do ti flas; për ti pasur si dëshmi; me ti thënë një fjalë, ngrihet në këmbë; do tu kërkosh falje; tu marrësh nga një dhuratë; do tu kisha lajmëruar; do tu përgjigjem menjëherë; t'jua them hapur; do t'jua kisha thënë më parë; do t'jua lehtësojë shumë punën; të mia thuash të gjitha fjalët; do tia tregoj.

2 Qarkoni trajtën e saktë të trajtave të shkurtra.

Disa ditë më vonë, bashkë me dy shokë të tjerë, ai erdhi për (ta/t'a) kthyer vizitën. Përveç punës sime si mësues, më duhej (ta/t'a) mbaja dhe rrisja edhe si nënë atë fëmijë. Ai (s'i/si) dëgjoi këshillat e mjekut e lutjet e prindërve, prandaj s'(ju/iu) kthye shëndeti.

3 Në tekstin me titull "Zodiaku", nënvizoni rastet e përdorimit të apostrofit në trajtat e shkurtra dhe tregoni rastin.

4 Shkruani një shkrim të shkurtër me temë "Fluturim në kozmos", ku të përdorni deri në katër raste të përdorimit të trajtave të shkurtra dhe të bashkuara në të cilat përdoret apostrofi.

✿ Nënvizoni foljet dhe thoni çfarë tregojnë.



Folja është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, që emërton një veprim ose gjendje të kryefjalës.

Kuptimi ► Folja tregon:

- ✿ **veprimin**, të cilin e kryen kryefjala e fjalisë:
kërcej, mbjell, shkruaj, eci, notoj, prek, hekuros.
- ✿ **gjendjen**, në të cilën ndodhet kryefjala e fjalisë:
mbetem, zemërohem, gëzohem, frikësohem, emocionohem.

Folja është gjymtyra kryesore dhe më e rëndësishmja e fjalisë.

Përshtatja ►
në numër
dhe në
vetë

Folja përshtatet me kryefjalën në numër dhe në vetë. Ajo merr forma të ndryshme sipas vetës, numrit, mënyrës, kohës.

Folja	Përshtatja
Shtegu të <u>shpinte</u> ...	në numrin njëjës, veta III
Ata i <u>hapën</u> vend...	në numrin shumës, veta e III
Kjo <u>ishte</u> parë...	në numrin njëjës, veta III
Vargmalet e Fatit nuk <u>kishin</u> ...	në numrin shumës, veta III
gjerësinë e së cilës s'ta <u>rrokte</u> dot syri.	në numrin njëjës, veta II

Përdorimi ►
i foljeve në
fjali

Foljet përdoren në fjali:

- ▣ me kuptim leksikor të plotë: Unë **mbolla** një pemë.
- ▣ si folje ndihmëse: Unë **jam** nisur që prej dy orësh.

Foljet kam dhe jam quhen folje ndihmëse, kur përdoren për të ndërtuar format e kohëve të përbëra të foljes.

Zgjedhimi i foljeve

📌 Nënvizioni foljet në vargjet e mëposhtme.

Dhe shpezët udhëtarë fluturuan.

Me shtërg e dallëndyshe e-gjithë-ç'qenë.

Veç harabeli vendit nuk po luan.

Ai nuk ia beson kujt folenë.

D. Agolli

🌸 Foljet e nënvizuara i vendosim në vetën e parë, numri njëjës, koha e tashme e mënyrës dëftore.

fluturuan - fluturoi

qenë - jam

luan - luaj

beson - besoj

Siç shihet, foljet nuk dalin vetëm në një formë. Ato e ndryshojnë formën sipas vetës, kohës e mënyrës.

🌸 Provojmë që dy nga foljet e nënvizuara t'i vendosim në vetën e dytë dhe të tretë, numri njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore.

veta e parë fluturoj, luaj

veta e dytë fluturon, luan

veta e tretë fluturon, luan

ky veprim quhet zgjedhim i foljes. Pra, me zgjedhim të foljes kuptojmë tërësinë e formave që merr folja sipas vetës, numrit, mënyrës e kohës.

Foljet grupohen në tri zgjedhime **sipas mbaresave që marrin**.

Klasifikimi i foljeve në zgjedhime

Zgjedhimi I ▶ Në zgjedhimin e parë përfshihen foljet që në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore marrin mbaresën -j: *luaj, lexoj, punoj, mësoj*.

Zgjedhimi II ▶ Në zgjedhimin e dytë përfshihen foljet që në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore dalin me temë me **bashkëtingëllore**: *mbjell, vjel, kap, flas, djeg*.

Zgjedhimi III ▶ Në zgjedhimin e tretë përfshihen foljet që në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore dalin me temë në **zanore**: *di, pi, ha, rri*.

Folje të parregullta janë foljet që gjatë zgjedhimit ndryshojnë rrënjën: *jam, qesh, qenë; kam, pata, pasur; bie, rash, rënë; shoh, pashë, parë; lë, lashë, lënë* etj.

Tabela e zgjedhimeve të foljes në kohën e tashme të mënyrës dëftore

	Veta	Zgjedhimi I	Zgjedhimi II	Zgjedhimi III
I	unë	laj	rrit	di
II	ti	lan	rrit	di
III	ai/ajo	lan	rrit	di
I	ne	lajmë	rritim	dimë
II	ju	lani	rritni	dini
III	ata/ato	lajnë	rritin	dinë

USHTRIME

1 Nënvizoni foljet.

Pak nga pak shqoi në errësirë një tufë rrezesh drite të dobëta e të kuqërremta. Atë e rrezatonte një libër i hapur, i cili qëndronte pezull mu në mes të sallës vezake. Libri rrinte pak pjerrtazi, kështu që ajo ia dallonte titullin. Ai ishte i lidhur me një kapak prej mëndafshi në ngjyrën e bakrit dhe, njëlloj si te gjerdani që Perandoresha-fëmijë e mbante të varur në qafë, edhe në atë libër dukeshin dy gjarpërinj që kafshonin bishtin e njëri-tjetrit dhe formonin një figurë.

2 Plotësoni tabelën me folje me kuptim të plotë leksikor dhe me folje ndihmëse.

Me kuptim të plotë leksikor	Si folje ndihmëse

3 Plotësoni fragmentin e mëposhtëm me foljet që mungojnë.

Mënyra se si nxënësit i _____ detyrat e tyre _____ në vite. Në vitin 1900, fëmijët _____ me shkumësa dhe pena. Sot fëmijët i _____ shumë kohë kompjuterit. Por ende në botë, mjeti parësor i të shkruarit _____ lapsi.

4 Lidhni me shigjetë grupet e dhëna të fjalëve, duke krijuar fjali. Nënvizoni foljet.

- | | |
|-------------------------------------|----------------------------------|
| ▣ Pse luajmë | me të cilët luan. |
| ▣ Sepse ato janë pjesë e jetës sonë | dhe e bëjnë atë më të këndshme. |
| ▣ Por ka edhe shumë e shumë | lidhen me idenë e "lojës". |
| ▣ Pa dyshim që | çdo lojë ka rregullat e veta. |
| ▣ Të cilat duhet t'i njohësh, | t'i zbatosh, gjatë gjithë lojës. |
| ▣ Të jesh pjesë e moshatarëve | lojëra të ndryshme? |
| ▣ Të gjitha këto | arsye të tjera. |

5 Në foljet e ushtrimit të mësipërm, dalloni mbaresën nga tema e foljes. Më pas përcaktoni numrin, vetën, kohën.

6 Shkruani foljen e duhur, duke përshtatur vetën dhe numrin me kryefjalën e fjalisë.

- Arbana i _____ një ninullë motrës së vogël.
- Përpara postës _____ shumë njerëz në radhë.
- Kushërinjtë e mi dje _____ një ekskursion mësimor.

7 Nënvizoni foljet dhe grupojini në një tabelë sipas zgjedhimeve që u përkasin.

Jeta është një mundësi, kape.

Jeta është bukuri, adhuroje.

Jeta është lumturi, shijoje.

Jeta është ëndërr, bëje realitet.

Jeta është sfidë, përballoje.

Jeta është detyrë, përmbushje.

Jeta është lojë, luaje.

Jeta është e çmuar, kujdesu për të.

Jeta është pasuri, vlerësoje.

Jeta është dashuri, jetoje.

Jeta është mister, zbuloje.

Jeta është premtim, mbaje.

Jeta është trishtim, kaloje.

Jeta është himn, këndoje.

Jeta është betejë, pranoje.

Jeta është aventurë, rrezikoje.

Jeta është jetë, mbroje.

Nënë Tereza


Mënyrat dhe kohët e foljes

Folja mund ta shprehë veprimin në mënyra të ndryshme. Mënyra të foljes quajmë format e ndryshme që merr folja për të shprehur një veprim të sigurt, të mundshëm, të dëshirueshëm ose të papritur.

Folja ka gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore.

Mënyrat	Kuptimi	Shembuj
Mënyra dëftore	Gjendja ose veprimi përmes foljes shprehet si i vërtetë.	Ai punonte natë e ditë.
Mënyra lidhore	Gjendja ose veprimi shprehet si i mundshëm.	Mund të thuash të vërtetën.
Mënyra kushtore	Gjendja ose veprimi paraqitet si i mundshëm, i vërtetë, nëse realizohet një kusht.	Nuk do të kthehesha prapa, po të dyshoja .
Mënyra dëshirore	Gjendja ose veprimi është i dëshirueshëm, në formë urimi, gëzimi a mallkimi.	Kalofshi edhe shumë vite të tjera bashkë!
Mënyra habitore	Gjendja ose veprimi shprehet si i vërtetë i shoqëruar me një ndjenjë habie.	Sa larg qenkan këto dyqane!
Mënyra urdhërore	Gjendja ose veprimi paraqitet në formën e një urdhri, lutjeje, dëshire a kërkesë.	Hidhu dhe priti ata topa!


Folja ka tri kohë: kohën e shkuar, kohën e tashme dhe kohën e ardhme. Ato tregojnë kohën kur ka ndodhur veprimi në lidhje me çastin e ligjërimit.





Kohët e foljes ▶ Veprimi që kryhet nga folja, ndodh:

- 🌸 në çastin kur ligjërojmë, **koha e tashme**:
*Me vendosmëri njeriu **kërkon** të drejtat e tij.*
- 🌸 para çastit kur ligjërojmë, **koha e shkuar**:
*Me vendosmëri njeriu **kërkoj** të drejtat e tij.*
- 🌸 pas çastit kur ligjërojmë, **koha e ardhme**:
*Me vendosmëri njeriu **do të kërkojë** të drejtat e tij.*

Koha e shkuar ka pesë nëndarje, sipas skemës së mëposhtme.



Koha e ardhme ka dy nëndarje: kohën e ardhme dhe kohën e ardhme të përparme



Format e pashtjelluara të foljes nuk zgjedhohen.

USHTRIME

1 Nënvizoni foljet dhe vendosini në të gjitha mënyrat, në tabelë.

– Nuk do të flasim për këtë gjë, Budard. Shpejt do të shohësh se do të shërohem; nuk ndodhi aspak për fajin tënd! Kur pushimet po mbaronin, ne të gjithë sikur po shkallonim... Askush nuk ka pse bëhet me faj. Fani gjendej në dhomën e vet dhe Budardi i qëndronte te koka. Një zjarr bubulak përskuqte tërë vatrën dhe përhapte një ngrohtësi për zili mes një zhairime të mbytur... Ishte e enjte. Karrocet e tregut zunë rrokullimën përgjatë rrugës. Në nëntor, nata nuk vonon të bjerë.

Mënyra dëftore	Mënyra lidhore	Mënyra kushtore	Mënyra dëshirore	Mënyra habitore	Mënyra urdhërore
flas	të flisja	do të kisha folur	folsha	folkam	fol

USHTRIME

2 Shkruani fjalinë e mëposhtme, duke e përdorur foljen në të gjitha mënyrat e saj.

Mënyra dëftore	<i>Borën e vlerësojnë si vajzë me zemër dhe mendje të hapur.</i>
Mënyra lidhore	
Mënyra kushtore	
Mënyra habitore	
Mënyra dëshirore	
Mënyra urdhërore	

3 Plotësoni vendet boshe me foljet që mungojnë dhe tregoni mënyrën e kohën e tyre.

Dihet, se sa më shumë fjalë _____, aq më mirë _____ si me shkrim, ashtu dhe me gojë. Nëse _____ një tregim për dikë që _____, nga mënyra se si _____ fjalët, _____ përfytyrime të ndryshme të lexuesi. Kështu, kur ju _____ “Djali u ul _____ në divan me kokën mes duarve” – lexuesi _____ një djalë, i cili _____ në divan i shqetësuar. Po nëse _____ “Djali _____ në divan me kokën mes duarve”, atëherë _____ një përfytyrim tjetër, më të ndryshëm nga i pari. Sa më shumë fjalë të zgjedhura _____, aq më bukur _____ gjithçka për një ngjarje a person të caktuar.
(Fjalë ndihmëse: përdor, shprehem, shkruaj, njoh, shkruaj, jap, shkruani, duke menduar, them, tregoj, mendon, ulet, u lëshua, krijon.)

4 Gjeni foljet dhe tregoni se në çfarë mënyre, kohe, vete dhe numri janë.

Vite të tëra, ajo rrugë nuk më shqitej nga mendja. Ishte rruga nga ku niste odiseja ime, një portë e hapur drejt një bote tjetër. Ajo rrugë të shpinte drejt asaj toke të premtuar, që unë do ta shihja një ditë, por që në fillim do ta pushtoja ca nga ca. E zbuloja vit pas viti, duke përkrahur gjithnjë një etapë të re, duke lënë pas çdo vit atë gur kilometrik ku uleshja në udhëtimin tim të gjatë.

Folja	Mënyra	Koha	Veta	Numri

5 Formoni fjali me foljet *lexoj, flas, zhvilloj, pres, laj, eci, hyj*, duke i përdorur në mënyra të ndryshme.

Forma veprore dhe forma joveprore e foljeve

Nënvizoni foljet e tekstit të mëposhtëm. Çfarë vini re?

Maçoku i zi madhosh po ngrohej për shtatë palë qejfe në diell, duke menduar sa mirë ndihej aty, me bark përpjetë nën ato rreze të vakëta, me të katra putrat e mbledhura dhe bishtin të shpalosur. Pikërisht atëherë kur ishte kthyer tërë përtaci për të ngrohur shpinën në diell, maçoku dëgjoi fishkëllimën e shkaktuar nga një objekt fluturues që u afrua me shpejtësi marramendëse.



L. Sepulveda

- ✿ Folja *dëgjoi* është në formën veprore, sepse tregon një veprim që e kryen kryefjala *maçoku* dhe bie mbi kundrinorin e drejtë *fishkëllimën*.
- ✿ Ndërsa foljet *ngrohej*, *ndihej*, *ishte kthyer*, *u afrua* janë në formën joveprore, sepse tregojnë veprime që kryehen prej dikujt tjetër dhe që i pësojnë kryefjalët ose që vetë kryefjalët veprojnë dhe pësojnë.

Format joveprore të foljeve ndërtohen:

- ▣ *me mbaresa* që janë të ndryshme nga ato të formës veprore: *dëgjohem*, *lahet*, *ftohej* etj.;
- ▣ me pjesëzën *u* në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore: *u ktheva*, *u lava* etj.;
- ▣ me ndihmën e foljes *jam* për të formuar kohë të përbëra: *jam drejtuar*, *jam këshilluar* etj.

USHTRIME

1 Nëvizoni foljet dhe përcaktoni formën e tyre.

Kangahu hapi flatrat dhe u ngrit në fluturim. Dallga e madhe e rrëmbëu të tërin në gjirin e saj. Kur doli sërish në sipërfaqe, drita e ditës ishte zhdukur. Pasi shkundi fort kokën, e kuptoi që mallkimi i detrave po i errësonte shikimin. Më kot krodhi disa herë kokën nën ujë, derisa ndonjë rreze e mekur drite mbërriti në bebëzat e syve të veshura nga nafta. Njolla veshtullore ia kishte ngjitur flatrat pas trupit, kështu që shkundi fort kthetrat me shpresën se do të largohej me shpejtësi nga qendra e dallgës së errët.

L. Sepulveda

2 Shndërroni në formën veprore fjalitë e mëposhtme. Çfarë vini re?

Çelësat e shkollës mbahen nga roja. _____
 Dreni u prit nga prindërit me mall. _____
 Idetë e tij ishin përkrahur nga shokët. _____
 Mësueses i ishin dhuruar lulet nga nxënësit e saj. _____
 Unë jam përkrahur shumë nga vëllai i madh. _____

3 Formoni 6 fjali me foljet *mbaj*, *dëgjoj*, *marr*, duke i përdorur në formën veprore dhe në formën joveprore.

Pjesorja dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes

I. Pjesorja

Pjesorja është ajo formë e pashtjelluar që ka tipare foljore dhe mbiemërore: *Flokët i mbante lëshuar dhe duart kryqëzuar.*

Pjesorja mund të kthehet në mbiemër me ndihmën e nyjës: *Flokët i mbante të lëshuar dhe duart të kryqëzuara.*

Pjesorja NUK i ka kategoritë gramatikore të foljes: kohë, vetë, numër, mënyrë etj., megjithatë ajo ndiqet nga rrethanorë dhe gjymtyrë të tjera, gjë që është karakteristike për format foljore: *Malet u gdhinë mbuluar me borë.*

Mbyllur në atë kafaz, **thurur** për të, zogu nuk zinte vend.

Edhe në ato raste kur pjesorja kthehet në mbiemër, vazhdon të ruajë kuptimin foljor të veprimit: **I mbyllur** në atë kafaz, **të thurur** për të, zogu nuk zinte vend.

II. Format e pashtjelluara, të ndërtuara mbi bazën e pjesores

Format e pashtjelluara

<i>pjesore</i>	<i>duke + pjesore</i>	<i>pa + pjesore</i>	<i>për të + pjesore</i>	<i>me të + pjesore</i>	<i>një të + pjesore</i>
ardhur	duke ardhur	pa ardhur	për të ardhur	me të ardhur	një të ardhur

Andi u largua nga bletët **duke vrapuar** me shpejtësinë e erës. Bletët i ishin vënë nga mbrapa **për ta arritur**, por ai ishte i vendosur që të vraponte **pa u ndalur**.



Funksionet e formave të pashtjelluara

Përcjellore	mënyror	kohor	shkaktor	kushtor	
	Ecte (si?) duke u mbajtur në bastun.	M'u kujtua (kur?) duke dalë nga porta se kisha lënë dritat ndezur.	Duke mos parë rrugëdalje, zogu u mblodh kruspull në kafaz (pse?).	Duke lexuar veprën, njih edhe shkrimtarin.	
Mohore	mënyror	kohor		kushtor	
	U larguan (si?) pa thënë një fjalë.	Dolën (kur?) pa mbaruar mbledhja.		Pa ngrënë hudhra, s'të vjen era.	
Paskajore	kryefjalor	kundrinor	përcaktor	qëllimor	mënyror
Për të + pjesore	I mbetjet vetëm (çfarë?) për të shtyrë edhe ato pak ditë.	A ke menduar (çfarë?) për t'ia filluar nga e para?	Kjo s'është fjalë (ç'fjalë?) për t'u thënë.	U shtri (përse?) për të fjetur.	Ishte bërë (si) për t'i qarë hallin.
me/një të + pjesore	kohor				
	Me të parë të emën, fëmija kërcu nga gëzimi (kur?). Një të trokitur dera, brofi në këmbë (kur?).				

USHTRIME

1 Dalloni pjesoret sipas skemës së dhënë.

- Karvanët ktheheshin ngarkuar plot e përplot.*
- Jam shumë i ngarkuar me punë.*
- Këpucët i kishte të lagura.*
- Mos rri lagur, se ftohesh.*
- Ishte njeri i mbyllur në vetvete.*

Pjesore	Mbiemër
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2 Rishkruani fjalitë, duke i kthyer pjesoret në mbiemra dhe anasjellas.

- Derën e gjeta të hapur.* _____
- Shtëpia ishte e larë dhe e pastruar.* _____
- Kjo poezi nuk është e përkthyer mirë.* _____

3 Dalloni format e pashtjelluara foljore dhe thoni llojin e tyre.

Kreshnikët e Jutbinës tuboheshin në bjeshkë të dielën, pa dalë dielli, për të kaluar së bashku disa orë nën hijen e pemëve, duke ngrënë e duke pirë e duke kujtuar bëmat e hershme.

- *Po ti, o Muj, a nuk ke për të rrëfyer ndonjë trimëri?*

- *Habitem me ju, o burra, se mbetet gjithë ditën e lume duke shitur trimëri...*

4 Formoni katër fjali me formën përcjellore të foljeve të dhëna.

- mendoj* _____
- ngre* _____
- afroj* _____

5 Rishkruani ato fjali në të cilat forma mohore e foljes mund të kthehet në formë foljore të shtjelluar.

P.sh.: Erdhi pa ftuar. Erdhi, ndonëse nuk ishte ftuar.

- Doli pa përcjellë.* _____
- Qëndronte pa folur.* _____
- Pa u munduar, nuk fitohet asgjë.* _____
- Duhej të mbërrinim pa rënë nata.* _____
- Fliste pa na vështruar në sy.* _____

6 Rishkruani fjalitë duke e kthyer formën **për të + pjesore** në formë foljore të shtjelluar.

- Njeriu bën gjithçka për të gjetur lumturinë.* _____
- Njeriu bën gjithçka që* _____
- Të notuarit ndihmon për të pasur një jetë më të shëndetshme.* _____
- Pat thënë se s'kishte për t'u kthyer më në atë vend.* _____
- Ankohej se kishte për të bërë shumë detyra.* _____

7 Në pjesën me titull "Mandolina e braktisur", nënvizoni pjesoren dhe format e pashtjelluara të foljeve. Emërtoni çdonjërin prej tyre.

Mami: Doni t'i provoni biskotat e mia?

Lola: Po mami, unë mund të ha gjithë ditën vetëm biskotat e tua.

Ervini: Po filloi të hajë biskota Lola, nuk do të ngelet asnjë për ne.



Kujtojmë

Kallëzuesi i thjeshtë shprehet me një folje, ose shprehje foljore, e cila tregon mënyrë, kohë, vetë.

Kallëzuesi i përbërë përbëhet nga dy pjesë, ku pjesa e parë është folje gjysmëndihmëse, që tregon një mënyrë veprimi, kurse pjesa e dytë është folje me kutim të plotë leksikor.

Lexoni fjalitë:

Shiu **filloi** menjëherë.

Ata **mund të vijnë** shumë shpejt.

Miq të tanë **duhet të ndihmohen**.

Në fjalinë e parë, folja **filloi** është përdorur me kuptim të plotë leksikor (pas saj nuk qëndron një folje tjetër). Ajo është folja-kallëzues e fjalisë, pra gjymtyrë kryesore e saj. Në fjalinë e dytë dhe të tretë, foljet **mund** dhe **duhet** janë pjesë e kallëzuesit të përbërë, por nuk luajnë rol kryesor nga ana e kuptimit leksikor. Veprimin e foljeve kryesore, **të vijnë** dhe **të ndihmohen**, ato vetëm e paraqesin si të mundshëm ose të detyrueshëm.

Këto quhen folje gjysmëndihmëse.

Foljet gjysmëndihmëse e zbehin kuptimin e tyre leksikor gjatë përdorimit si pjesë përbërëse e kallëzuesit. Folje gjysmëndihmëse mund të jetë folja **jam, mund, duhet, do, nis, filloj, vazhdoj**.

Folja
këpujore *jam*

Folja ndihmëse **jam** shërben për të vënë në lidhje pjesën emërore (emër, mbiemër, përemër) të kallëzuesit me kryefjalën, pra shërben si **këpujë**:
- Është shumë i ndjeshëm, - plotësoi infermierja. - Më vonë ai do të dalë një ditë, po së paku të jetë i shëndoshë.

Foljet që
ndihmojnë
në kryerjen e
veprimit

- ☐ **Mund** – e ndjekur nga një folje në lidhore. Në këtë përdorim, veprimi i foljes kryesore paraqitet si **i mundshëm**:
Kjo furrë mund të ushqejë tërë lagjen.
- ☐ **Duhet** – e ndjekur nga një pjesore ose folje në mënyrën lidhore. Në këtë rast veprimi i foljes kryesore paraqitet si i detyrueshëm.
Ne duhet të futemi sa më parë në Evropë.
- ☐ **Do** – e ndjekur nga një pjesore ose folje në mënyrën lidhore, veprimin e foljes themelore e paraqet si **të domosdoshëm**:
Do vajtur sa më parë tek ajo.

Struktura e
përdorimit
të foljeve si
gjysmëndihmëse

Folje **filloj, nis, zë, vazhdoj, mbaroj** tregojnë fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e veprimit.

- ✿ Për të shprehur **fillimin e veprimit**, përdoren foljet **filloj, nis, zë** + folje themelore **në lidhore**: *Filloi të lëvizte ngadalë.*
- ✿ Për të shprehur **vazhdimin e veprimit**, përdoren foljet **vazhdoj, vijoj** + folje në lidhore: *Gjyshja vazhdoi ta shihte të nipin me mall.*
- ✿ Për të shprehur **mbarimin e veprimit**, përdoret togfjalëshi i tipit **mbaroi së foluri** (emër prejfoljor asnjans). *Pushuan së kënduari natën vonë.*

USHTRIME

1 Në tekstin e mëposhtëm, dalloni foljet ndihmëse nga foljet gjysmëndihmëse.

Pylli vetëtin nga tisi i florinj të i rrezeve të diellit, që zënë e thyhen në shkëlqimin e gjetheve. Ketrat hidhen nga njëra degë te tjetra dhe mbajnë në duart e vockla boçe pishë të hapura. Aromat e luleve, të barit dhe të drurëve janë përzier së bashku dhe të krijojnë një ndjesi të çuditshme, si jashtëplanetare. Kjo gjendje të bën të ëndërrosh për gjëra të gëzuara.

Nga koha kur romakët mundën Teutën dhe zotëruan detin, shqiptarët u detyruan të mbështeteshin me shpatulla në male. Tani duhej luftuar për të tjera troje dhe me të tjera mjete.

2 Shkruani tri fjali në të cilat foljet *filloj, vazhdoj, mbaroj* t'i përdorni një herë si folje me kuptim të plotë leksikor, një herë si folje gjysmëndihmëse.3 Shkruani dy fjali në të cilat të përdorni foljen *jam* një herë si pjesë e kallëzuesit emëror dhe një herë me kuptim të plotë leksikor.

4 Shkruani pesë fjali në të cilat të përdorni foljet gjysmëndihmëse:

vazhdoj _____
mund _____
filloj _____
nis _____
do _____

5 Në tekstin me titull "Zbulimi i një të fshehte shekullore", nënvizoni foljet gjysmëndihmëse.

Sintaksë

FJALIA

- ▶ **Sintaksa** studion mënyrat si lidhen fjalët në grupe fjalësh, fjali dhe vetë fjalitë në mes tyre.

Gjymtyrët kryesore

kryefjala

- ▶ me emër
- ▶ me grup emëror
- ▶ me numëror
- ▶ me përemër

kallëzuesi

- ▶ emëror
- ▶ foljor
 - ▶ i thjeshtë
 - ▶ i përbërë

përcaktori

- ▶ me përshtatje
- ▶ me drejtim
- ▶ me bashkim
- ▶ me ndajshim

Gjymtyrët e dyta

kundrinori

- ▶ i drejtë
- ▶ i zhdrejtë
 - ▶ me parafjalë
 - ▶ pa parafjalë

rrethanori

- ▶ kohe
- ▶ vendi
- ▶ mënyre
- ▶ sasi
- ▶ shkaku
- ▶ qëllimi

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe nënvizoni kallëzuesit.


Pra, ka ardhur vërtet ora e provës. Sepse prova e vërtetë është çasti kur lëvozhga, domethënë ushtria dhe administrata jonë, do të tërhiqet nga ky vend. I ke parë arrat kur u thyen lëvozhgën? Atëherë duket se ç'ka brenda: kokrrën e shëndoshë apo të bërë pluhur nga krimbi. Kështu është edhe puna e një vendi të pushtuar pas mbarimit të pushtimit. Kur lëvozhga të thyhet, do të shohim ç'ka nën të.

Kujtojmë

Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë dhe bërthama organizuese e saj. Rreth tij bashkohen të gjitha grupet e fjalëve të një fjalie.

Me të dëgjuar zilen, doli me vrull nga dhoma e saj për të hapur derën.

Kallëzuesi ► Gjymtyra kryesore e kësaj fjalie është kallëzuesi **doli**. Rreth tij bashkohen të gjitha grupet e tjera të fjalisë:



Grupet *me të dëgjuar zilen*; *me vrull*; *nga dhoma e saj*; *për të hapur derën* kanë fjalë drejtuese kallëzuesin **doli**, prandaj varen vetëm prej tij. Këto grupe nuk hyjnë në lidhje varësie me njëra-tjetrën, prandaj mund ta ndryshojnë vendin e tyre në fjali:

- ▣ *Doli me vrull nga dhoma e saj për të hapur derën, me të dëgjuar zilen.*
- ▣ *Nga dhoma e saj doli me vrull për të hapur derën, me të dëgjuar zilen.*

Marrëdhëniet e kallëzuesit me grupet e fjalëve në fjali

Grupet e fjalëve lidhen rreth një kallëzuesi për të formuar fjali. Janë të rralla rastet kur kemi fjali pa kallëzues: *Natë dimri. Acar. Heshtje varri.*

Lloji i foljes me të cilën shprehet kallëzuesi, përcakton funksionin dhe vlerën e grupeve të tjera në fjali. Dallohen katër lloje të ndryshme foljesh.

Folje që kërkojnë kryefjalë dhe kundrinorë. ►

A. Folje që kërkojnë kryefjalë dhe kundrinorë.

- ▣ Në këtë grup bën pjesë ajo klasë foljesh që kërkon të plotësohet me një kryefjalë dhe një kundrinor: *Djali theu gotën.*

Folja **theu** shërben si kallëzues dhe shtron dy pyetje themelore për të formuar një fjali: *kush theu? (djali) çfarë theu? (gotën).*

- Edhe nëse kjo folje del si kallëzues i përbërë, nevoja për kryefjalë dhe kallëzues mbetet e njëjtë: *Djali mund të thyejë gotën.*
- Po ashtu, kryefjala dhe kundrinori mund të zgjerohen me fjalë të tjera dhe dy grupet mbeten të lidhura me kallëzuesin: *[Djali i vogël] theu [gotën e ujit].*
- Në këtë fjalë mund të shtohen fjalë dhe grupe të tjera me vlerën e rrethanorit, por nuk janë të domosdoshme për kallëzuesin: *(Përsëri) [djali] theu (pa dashje) [gotën].*

Fjalët **përsëri** dhe **pa dashje** shërbejnë si rrethanorë dhe mund të hiqen nga fjalia, sepse nuk janë të domosdoshëm për foljen kallëzues, pra nuk e prishin strukturën e fjalisë.

Folje që kërkojnë vetëm kryefjalë.

B. Folje që kërkojnë vetëm kryefjalë.

- Në këtë grup bën pjesë ajo klasë foljesh që kërkon vetëm kryefjalë dhe nuk pranon kundrinor: *Djali ecën *rrugën.*

Folja **eci** kërkon një kryefjalë (kush ecën? – djali), por nuk pranon kundrinor. Kësaj foljeje mund t'i shtohet një apo më shumë rrethanorë, por këta nuk janë të domosdoshëm: *Djali ecën rrugës vetëm. (ku? rrugës; si? vetëm)*

Folje që kërkojnë kryefjalë dhe kundrinorë të drejtë dhe të zhdrejtë.

C. Folje që kërkojnë kryefjalë dhe kundrinorë të drejtë dhe të zhdrejtë.

- Në këtë grup bën pjesë ajo klasë foljesh që kërkon të plotësohet me një kryefjalë, një kundrinor të drejtë dhe një kundrinor të zhdrejtë: *Ata nuk i kthyen përgjigje askujt.*

Me foljen **kthej**, mund të lidhen edhe rrethanorë të ndryshëm, por vetëm kryefjala dhe kundrinorët janë të domosdoshëm: *[Kësaj here], ata nuk i kthyen përgjigje askujt.*

Folje që nuk kërkojnë as kryefjalë dhe as kundrinorë.

D. Folje që nuk kërkojnë as kryefjalë dhe as kundrinorë.

- Në këtë grup bën pjesë ajo klasë foljesh që nuk merr as kryefjalë e as kundrinor. Këto janë folje pavetore, si: *vetëtin, bubullin, veson etj.: Po erret.*

Folja pavetore **erret** nuk merr as kryefjalë, as kundrinor, por mund të shoqërohet me rrethanorë të ndryshëm: *Tani erret më shpejt.*

USHTRIME

1 Nënvizoni kallëzuesit e fjalive të pjesës së mëposhtme.

Nuk di të them sa të gjata m'u dukën këto pesë ditë. Kur i kujtoj, më duket sikur kanë zgjatur me vjet. Më kujtohet kur rrija e mbaja vesh të gjithë tingujt që mund të dëgjoheshin në shtëpi dhe që m'i zinte veshi...

Pastaj gdhihej dita prapë, vinte dreka, mbrëmja, koha kur shokët e mi loznin dhe unë rrija dhe i shikoja nga dhoma ime.

USHTRIME

2 Ndërttoni fjali me foljet e mëposhtme. Rrethoni gjymtyrët e domosdoshme, nënvizoni ato që nuk janë të domosdoshme.

- gjej _____
- fle _____
- dërgoj _____
- pyes _____
- gjëmon _____
- di _____

3 Gjeni kallëzuesit dhe gruponi foljet sipas ndarjes në tabelën e mëposhtme.

Ne u ngritëm menjëherë, veshëm palltot tona, morëm valixhet dhe, pa nxjerrë fjalë prej goje, dolëm nga porta e madhe në rrugën e ftohtë. Diku larg gjëmonte. Nga të dyja anët e rrugës, njerëzit na shikonin me çudi. Ne e ndjenim veten mjaft të vetmuar dhe, me sa dukej, po fillonin prapë ditët moderne, sepse heshtja po vazhdonte.

Folje (kallëzues) që marrin (përveç rrethorëve):			
vetëm kryefjalë	kryefjalë dhe kundrinor	kryefjalë, kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë	as kryefjalë e as kundrinorë

4 Në fjalitë e mëposhtme, rrethoni grupet e domosdoshme për foljen (kallëzues) dhe nënvizoni ato që nuk janë të domosdoshme.

- Nesër do të shkoj në kinema me shokët e mi.
- Kush trokiti në derë?
- Autobusi ndaloi në të dalë të qytetit.
- Rritja e temperaturave ndikoi në përhapjen e zjarreve.
- Macja flinte e qetë mbi divan.

5 Dalloni grupet e fjalëve dhe rishkruani fjalinë duke u ndryshuar vend atyre në fjali.

Pa i hequr sytë nga dritarja, dëgjonte mendueshëm dhe i përhumbur zhurmat e para të mëngjesit.

6 Hartoni një tekst të shkurtër me temë të lirë. Dalloni kallëzuesit dhe klasifikojini sipas numrit të gjymtyrëve që kërkojnë.

Llojet e kallëzuesit: foljor dhe emëror

Kujtojmë

Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë që tregon një veprim apo një gjendje të kryefjalës. Kallëzuesi është emëror dhe foljor. Kallëzuesi foljor është i thjeshtë dhe i përbërë.

✿ Klasifikoni kallëzuesit sipas tabelës së mëposhtme.


Çfarë po bën? Kam për të bërë shumë punë, por nuk di ç'duhet të bëj më parë. Fola me Anën. Ishte duke bërë prova për koncertin e radhës. Ajo është shumë e talentuar, por është në merak për nesër. Sikur të bëja pak pushim tani? Si thua?

Kallëzues		
foljor		emëror
i thjeshtë	i përbërë	

Ndryshe nga disa fjalë të tjera, që e ndryshojnë rolin në fjali në varësi të fjalës drejtuese, **folja shërben gjithnjë si kallëzues**, pavarësisht fjalëve me të cilat lidhet.

Kallëzuesi shërben si qendër organizuese e fjalisë. Rreth tij bashkohen të gjitha gjymtyrët e tjera, pavarësisht pozicionit të tyre në fjali. Vëreni me kujdes lidhjet që vendosen mes gjymtyrëve të fjalisë së mëposhtme.

Qytetarët i drejtuan bashkisë një kërkesë me shkrim.



Folja, shpeshherë, mund të përdoret edhe në një trajtë të pashtjelluar. Në këtë rast, shërben si kallëzues kur i përgjigjet një kryefjalë. P.sh.: **Nuk nisemi pa ardhur ju.** Në raste të tjera, mund të shërbejë si rrethanor: **Rrinte pa folur.**

✿ Proveni të ndryshoni rendin e gjymtyrëve në këtë fjali, duke dhënë pesë variante të ndryshme. A ndikon rendi në funksionin e tyre sintaksor? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Kallëzuesi mund të jetë foljor dhe emëror. Kallëzuesi foljor mund të jetë i thjeshtë dhe i përbërë.



Kujdes

Jo çdo fjalë ka rend të lirë në fjali. Në fjalinë e mësipërme, emri "shkrim" nuk mund të ndahet nga parafjala "me".

Folja **jam** mund të shërbejë si kallëzues kur del me kuptimin e saj të plotë: Ku është ai?

Folja **jam** mund të shërbejë edhe si pjesë e kallëzuesit emëror. Në këtë rast, ajo quhet këpujë: Ora është e prishur.

Kallëzuesi foljor		Shembuj
i thjeshtë	Shprehet me forma foljore të ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> ☐ Kush po këndon? ☐ Sa bukur kënduakan! ☐ Kush ka për të kënduar tani? ☐ Na këndo një këngë! ☐ Kush është duke kënduar kështu? ☐ Sikur të këndoja më mirë. ☐ Pa kënduar ata, nuk largohem.
i përbërë	Formohet nga dy folje ku e para tregon mënyrën e veprimit dhe e dyta vetë veprimin.	<ul style="list-style-type: none"> ☐ Fillim veprimi: <i>Filloi të flasë.</i> ☐ Vazhdim veprimi: <i>Vazhdonte të fliste.</i> ☐ Mbarim veprimi: <i>Pushoi së foluri.</i>
	Formohet nga dy folje ku e para tregon mënyrën e kryerjes së veprimit dhe e dyta vetë veprimin.	<ul style="list-style-type: none"> ☐ Domosdoshmëri: <i>Duhet të flasim.</i> ☐ Mundësi: <i>Mund të flasim.</i>

Kallëzuesi emëror formohet nga këpuja "jam" + një mbiemër, emër, përemër, numëror, grup fjalësh etj.

- ☐ Nata **ishte e qetë.**
- ☐ Nata **ishte pus.**
- ☐ Nata **ishte pa hënë.**

USHTRIME

1 Dalloni kallëzuesit dhe nënvizoni fjalët që varen prej tij.

- ☐ *Ardhja e pranverës i gëzon të gjithë.*
- ☐ *Karakteret e forta nuk i përkul asgjë.*
- ☐ *Kush është duke folur në telefon?*
- ☐ *Ka për t'u kthyer prapë këtu.*

2 Ktheni kallëzuesit e mësipërm në kallëzues të përbërë dhe formoni fjali me ta.

3 Analizoni funksionet e formave foljore të pashtjelluara. Nënvizoni fjalët që lidhen me to.

- ☐ *S'ka për t'u nisur njeri, pa perënduar dielli.*
- ☐ *Shkova në bibliotekë për të marrë një libër.*
- ☐ *Një të rënë zilja, të gjithë vërshuan në oborr.*
- ☐ *Ecte duke fishkëllyer.*

4 Dalloni funksionet e foljes **jam**.

kallëzues këpujë

Kush është në shtëpi?

Unë nuk jam ti.

Duhet të jesh më i kuptueshëm.

Ç'është kjo?

Na ishte njëherë.

5 Gjeni kallëzuesit dhe gjymtyrët që varen prej tyre. Thoni llojin e kallëzuesit.

E kishte pritur me padurim pragun e Vitit të Ri për të bërë këtë telefonatë, pa e ditur se kjo do ta brengoste më shumë nga ç'ishte i brengosur deri më tash. Disa herë deshi të ngrihej e të ikte, as që i duhej ajo e folur. Zëri i nënës iu duk i huaj, i panatyrshëm. Deshi ta pyeste, por...

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje

Kujtojmë që një fjali është e thjeshtë kur ka vetëm një kallëzues dhe e përbërë kur ka dy a më shumë kallëzues.

Fjali e thjeshtë: *Ai ecte duke u lëkundur sa andej-këndej.*

Fjali e përbërë: *Ai ecte ngadalë dhe lëkundej sa andej-këndej.*

Në fjalinë e parë ka dy folje, një e shtjelluar **ecte** dhe një e pashtjelluar **duke u lëkundur**, por vetëm një kallëzues, prandaj fjalia është e thjeshtë. Në fjalinë e dytë, ka dy folje të shtjelluara **ecte** dhe **lëkundej**, të cilat shërbejnë si kallëzues më vete, ndaj fjalia është e përbërë.

Vini re:

Në fjali mund të ketë dy folje të shtjelluara, por nëse ato funksionojnë si kallëzues homogjenë, fjalia është e thjeshtë dhe jo e përbërë, si në shembullin: *Ai ecte dhe lëkundej njëkohësisht.* Në këtë fjali, kallëzuesit janë homogjenë (**ecte dhe lëkundej**), prandaj fjalia është e thjeshtë dhe jo e përbërë.

Fjalitë e përbëra grupohen në:

- a) fjali të përbëra me bashkërenditje;
- b) fjali të përbëra me nënrenditje.

Nga vetë termi **bashkërenditje**, të parat janë fjali të përbëra ku pjesët renditen bashkë duke ruajtur njëkohësisht edhe pavarësinë prej njëra-tjetrës, pra ato mund të qëndrojnë edhe si fjali më vete:

Dy fjali të thjeshta: *Unë jam në vit të parë.*

Vëllai im është maturant.

Një fjali e përbërë: *Unë jam në vit të parë, kurse vëllai im është maturant.*

Fjalitë e nënrenditura, ndryshe nga ato me bashkërenditje, varen prej njëra-tjetrës: *Kur unë isha në vit të parë, vëllai im ishte maturant.* Varësia mes pjesëve të fjalisë realizohet në mënyra të ndryshme, gjë që do ta shohim më hollësisht në mësimin vijues.

Llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje

Sipas marrëdhënieve që vendosen mes pjesëve të fjalisë, fjalitë e përbëra me bashkërenditje grupohen si më poshtë:

- a) fjali me pjesë të bashkërenditura me marrëdhënie këpujore;
- b) fjali me pjesë të bashkërenditura me marrëdhënie kundërshtore;
- c) fjali me pjesë të bashkërenditura me marrëdhënie veçuese;
- ç) fjali me pjesë të bashkërenditura me marrëdhënie përmbyllëse.

Fjali me pjesë bashkërenditëse:	Përshkrimi dhe tipare dalluese	Lidhëza dhe lokucione lidhëzore	Shembuj fjalish
shtuese	Kanë përdorim të gjerë dhe larmi shumë të madhe nga pikëpamja ndërtimore. Shpesh shprehin ngjyrimë numërimi a renditjeje dukurish a faktesh.	e, dhe, edhe, jo vetëm që... por edhe, le që... por as etj.	<i>Jo vetëm që binte shi i rrëmbyeshëm, por frynte dhe një erë e ftohtë.</i>

- D. Tani është thatësirë e madhe dhe ka mungesë uji, por në dimër lumenjtë rrezikojnë jo vetëm të dalin nga shtrati por edhe të përmbysin gjithçka rreth tyre.



Këtu kemi trajtuar vetëm pjesët e fjalive që bashkërenditen mes tyre, por shpesh fjalitë përbëhen prej pjesëve që hyjnë si në lidhje bashkërenditëse, ashtu dhe në marrëdhënie nënrenditëse mes tyre. Në temat vijuese do të analizojmë fjali ku gërshetohen të dyja lidhjet.

USHTRIME

1 Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra.

- | | e thjeshtë | e përbërë |
|---|--------------------------|--------------------------|
| <input type="checkbox"/> Për të pasur shëndet të mirë, duhet të ushqehesh mirë. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Ushqehu mirë dhe ke për të pasur shëndet të mirë. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Që të kesh shëndet të mirë, duhet të ushqehesh mirë. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Mund të ushqehesh mirë, por mund të mos gëzosh shëndet të plotë. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Për të pasur shëndet të plotë nuk mjafton vetëm të ushqyerit mirë. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

2 Lidhni fjalitë e mëposhtme me lidhëza bashkërenditëse dhe përcaktoni llojin e marrëdhënies që vendoset mes tyre.

- Shtëpia ishte e braktisur. Lulet në oborr ishin tharë.

- Bie shumë shi. Do të shkoj në kinema.

- Të dielën do të shkoj në stadium. Do ta shoh ndeshjen në shtëpi.

- Ishte mesi i gushtit. Në oborrin e shkollës dëgjohej vetëm kënga e gjinkallave.

3 Dalloni fjalitë me bashkërenditje dhe mjetet që lidhin pjesët mes tyre.

Fillimisht vrapova drejt saj dhe e ndihmova të ngrihej, por pastaj u ktheva për të parë ç'bënte Lila. Kishte zbritur nga trotuari dhe po shkonte te Melina duke kaluar rrugën, por pa ua vënë veshin kamionëve që kalonin njëri pas tjetrit. I shqova në sjellje, më tepër se në fytyrë, diçka që më turbulloi e që sot e kësaj dite e kam të vështirë ta përcaktoj, pasi, edhe pse shkonte përmes rrugës, e vogël e zezë, nervoze, edhe pse e bënte me vendosmërinë e saj të zakonshme, gjithsesi kishte ngecur si e ngrirë.

4 Ndërtoni skemën e fjalive të mëposhtme.

- Dikush trokiti në derë, por askush nuk u përgjigj.
- Frynte erë, binte shi, gjëmonte e vetonte, por në rrugë kishte ende shumë lëvizje.
- Këtë fundjavë do të shkoj me prindërit në mal, ose do të takohemi me shokët në det.

5 Ndërtoni katër fjali të përbëra bashkërenditëse, sipas modelit të skemave të dhëna në këtë mësim.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje

Kujtojmë që në fjalitë e përbëra me nënrenditje, pjesët e fjalive hyjnë në lidhje dhe marrëdhënie varësie mes tyre. Kjo do të thotë se, ashtu siç kemi parë te gjymtyrët e fjalisë, njëra pjesë drejton dhe tjetra varet prej saj: *Pashë se dikush doli.*

Kjo është një fjali e përbërë, sepse ka dy kallëzues **pashë** e **doli** dhe, për rrjedhojë, dy pjesë fjalish **pashë** dhe **se dikush doli**. Këto dy pjesë nuk kanë të njëjtën vlerë sintaksore në fjali, siç kemi parë te pjesët e fjalive bashkërenditëse, por njëra drejton dhe tjetra varet. Në rastin në fjalë, pjesa drejtuese është **pashë** dhe, me anë të saj, mund të drejtojmë pyetjen: ç'pashë? – se dikush doli.

Pjesa që i përgjigjet pyetjes, është pjesë e varur.

[Pashë]
(çfarë?) ↓
[se dikush doli]

Llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje

Kujtojmë se nisur nga marrëdhënia që vendoset mes pjesëve të fjalisë që varen prej njëra-tjetrës, fjalitë me nënrenditje grupohen në:

- fjali me pjesë të varur filluese;
- fjali me pjesë të varur rrethore;
- fjali me pjesë të varur përcaktore.

Tabela e tipareve dalluese të fjalive të përbëra me nënrenditje

Fjali me pjesë të varur	Lidhja mes pjesës kryesore dhe asaj të varur	Shembull	pjesë kryesore + pjesë e varur
filluese	Pjesa e varur është e domosdoshme dhe plotëson kallëzuesin e pjesës kryesore.	<i>Pashë se dikush doli. Thuhej se vuante nga një sëmundje e rrallë.</i>	Pashë + se dikush doli. Thuhej + se vuante nga një sëmundje e rrallë.
rrethore	Pjesa kryesore mund të qëndrojë edhe pa pjesën e varur.	<i>U kthjem kur u errësua. Dritarja u hap ngaqë frynte erë e fortë.</i>	U kthjem + kur u errësua. Dritarja u hap + ngaqë frynte erë e fortë.
përcaktore	Pjesa e varur përcaktore nuk lidhet me kallëzuesin e pjesës kryesore, por me një gjymtyrë emërore të saj.	<i>E pashë filmin që u shfaq në kinema.</i>	E pashë <i>filmin</i> + që u shfaq në kinema.

Disa skema fjalish të përbëra me pjesë të varur filluese

Pjesa drejtuese e fjalive filluese ka në përbërje të saj një folje, e cila kërkon të plotësohet nga pjesa e varur e kësaj fjalie. Për këtë arsye, rendi i pjesëve zakonisht është i tillë që pjesa e varur ndjek atë drejtuese, si në fjalinë e mëposhtme.


Nuk e dinim që ishte i huaj. (ç'nuk dinim? – që ishte i huaj)
[nuk e dinim] [që ishte i huaj]
↑ ↑
pj. drejtuese pj. e varur

Në disa raste, pjesa e varur mund t'i prijë asaj drejtuese:

Që ishte arkeolog, dihej. (ç'dihej? – që ishte arkeolog)
 [që ishte arkeolog] [dihej]
 ↑ ↑
 pj. e varur pj. drejtuese

Skema me anë të së cilës paraqitet lidhja mes pjesëve të fjalisë së përbërë me nënrenditje ffilluese, duhet të paraqesë lidhjen e varësisë që vendoset mes këtyre pjesëve, për këtë arsye, kutizat që përfaqësojnë pjesët e fjalisë vendosen në pozicion vertikal me njëra-tjetrën:


Disa skema fjalish të përbëra me pjesë të varur ffilluese



Kjo fjali mund të zgjerohet më tej duke shtuar një pjesë tjetër të varur ffilluese, e cila bashkërenditet me të parën, si në shembullin e mëposhtëm:

Nuk e dinim që ishte i huaj dhe që jetonte vetëm.

[nuk e dinim] → [(që ishte i huaj) dhe (që jetonte vetëm)]
 pj. drejtuese pj. e varur ffilluese + pj. e varur ffilluese




Shënim: Kllapat e rrumbullakëta përdoren për fjalitë që bashkërenditen mes tyre, ndërsa kllapat katrore për grupet e fjalive që vendosen në marrëdhënie dhe lidhje varësie mes tyre.

Ashtu si fjalitë e varura, edhe fjalitë drejtuese mund të dalin të bashkërenditura mes tyre, duke ruajtur të njëjtën marrëdhënie me pjesën e varur apo pjesët e varura:

Jo vetëm që nuk e dinim por as nuk na e merrte mendja që ishte i huaj.

[jo vetëm që (nuk e dinim) por as (nuk na e merrte mendja)] → [që ishte i huaj]
 pj. drejtuese + pjesë drejtuese pj. e varur



Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethanore

Kujtojmë se fjalitë e varura rrethanore tregojnë rrethanën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja e pjesës kryesore. Pra, nëpërmjet tyre shtohen të dhëna të tjera rreth përmbajtjes që jepet në pjesën kryesore, ndonëse ato jo gjithnjë janë të domosdoshme për plotësimin e kuptimit dhe të strukturës së saj, siç ndodh me fjalitë fthilluese.

▣ Në shembujt e mëposhtëm, vini re rolin e pjesës së varur **kur niset treni** në raport me pjesët kryesore përkatëse.

- A. Të gjithë e dinë kur niset treni.
- B. Të gjithë largohen kur niset treni.



Fjalitë e përbëra me pjesë të varur rrethanore

Fjalitë e mësipërme janë fjali të përbëra me nënrenditje. Pjesët e këtyre fjalive ruajnë të njëjtin rend: pjesë kryesore - pjesë e varur. Në përbërjen e tyre ndryshon vetëm folja, por kaq është e mjaftueshme për të ndryshuar jo vetëm kuptimin, por edhe llojin e fjalive të nënrenditura. Dimë që folja luan rol qendror në organizimin e fjalisë.

Në fjalinë A, pjesa e varur **kur niset treni** ka vlerën e një pjesë të varur fthilluese kundrinore, sepse folja e pjesës kryesore kërkon të plotësohet prej saj: ç'dinë?- (se) kur niset treni.

Këtu, lidhëza fthilluese mund të shtohet ose të hiqet prej fjalisë.

Në fjalinë B, si pjesë e varur shërben po ashtu pjesa **kur niset treni**, por marrëdhënia që vendos me pjesën kryesore, ndryshon. Këtu kemi të bëjmë me marrëdhënie rrethanore: kur largohen? - kur niset treni.

Folja e pjesës kryesore **largohen** ka natyrë të ndryshme prej foljes **di**, ndaj pjesa kryesore **të gjithë largohen** nuk mund të drejtojë një pjesë të varur fthilluese, por vetëm një pjesë të varur rrethanore, në rastin konkret, rrethanore kohore. Këtë e dëshmon edhe pamundësia e përdorimit të lidhëzave fthilluese *se/që* pranë ndërtimeve të tilla: **Të gjithë largohen se/që kur niset treni.*

Dy pjesët e kësaj fjalie të përbërë lidhen me lidhëzën e nënrenditur kohore **kur**

dhe nuk mund të pranohet shtimi i një lidhëze të nënrenditur filluese.

Nisur nga lloji i marrëdhënies rrethimore që vendosin me pjesën kryesore, pjesët e varura rrethimore mund të jenë:			
Fjali me pjesë të varur rrethimore	Përshkrimi dhe tipare dalluese	Mjete lidhëse	Shembull fjalie
kohore	Tregon kohën kur ndodh veprimi, ngjarja e shprehur nga kallëzuesi në pjesën kryesore.	kur, ndërsa, gjersa, pasi, para, para se, ndërkohë që etj.	<i>Kur mbërrita në stacion, treni ishte nisur.</i>
vendore	Tregon vendin ku ndodh veprimi, ngjarja e shprehur nga kallëzuesi në pjesën kryesore.	ku, kudo që, ngado që, te/tek, nga etj.	<i>Ngado që hidhje sytë, shihje vetëm gjelbërim.</i>
shkakore	Tregon arsyen, shkakun pse ndodh veprimi, ngjarja e shprehur nga kallëzuesi në pjesën kryesore.	se, sepse, ngaqë, duke qenë se, për shkak se, për arsye se etj.	<i>U rrëzova, sepse dysHEMEJA ishte e lagur.</i>
qëllimore	Tregon qëllimin përse ndodh veprimi, ngjarja e shprehur nga kallëzuesi në pjesën kryesore.	që, me qëllim që, në mënyrë që	<i>Fërkonte sytë që të shihje më mirë.</i>
mënyrore	Tregon mënyrën se si ndodh veprimi, ngjarja e shprehur nga kallëzuesi në pjesën kryesore.	si, siç, sikur, sikurse, ashtu, ashtu si etj.	<i>Bëj siç të thashë.</i>
krahasore	Veprimi apo gjendja për të cilën bëhet fjalë në fjalinë drejtuese ilustron me anë të një krahasimi në fjalinë e varur.	sa, aq sa, po aq sa, sa ç', nga ç', më sa etj.	<i>Shumë mallra kushtojnë më shumë nga ç'vlejnë.</i>
kushtore	Tregon kushtin nga i cili varet kryerja ose moskryerja e veprimit të shprehur në pjesën kryesore.	në, nëse, në qoftë se, po, po qe se, po të jetë se, me kusht që etj.	<i>Nëse nuk i plotësoni këto kushte, kërkesa juaj nuk do të merret parasysh.</i>
lejore	Veprimi apo gjendja që shprehet në pjesën e varur pritet të bëhet pengesë për atë të fjalisë drejtuese, por, në të vërtetë, veprimi kryhet.	ndonëse, sido që, sado që, edhe pse, kushdo etj.	<i>Ndonëse vendi kishte plot mundësi zhvillimi, njerëzit jetonin në skamje.</i>
rrjedhimore	Shprehet marrëdhënia mes faktit a ngjarjes së shprehur në fjalinë kryesore dhe përfundimit logjik të saj, të shprehur në fjalinë e varur.	ndaj, prandaj, për pasojë, për rrjedhojë, saqë, aq sa, kështu që etj.	<i>Erdhën pak veta, kështu që e shtymë për nesër.</i>

Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore



Kujtojmë që në fjalitë përcaktore, pjesa e nënrenditur hyn në lidhje me një gjymtyrë emërore të pjesës kryesore dhe tregon një tipar apo veçori të saj.

Vajza që doli, quhet Eva.

Kjo është një fjali e përbërë ku si fjali drejtuese shërben pjesa **Vajza quhet Eva**, ndërsa si pjesë e nënrenditur **që doli**. Kjo e fundit është futur në mes të fjalisë drejtuese. Ndryshe nga llojet e tjera të fjalive me nënrenditje, pjesa e nënrenditur përcaktore nuk hyn në lidhje me kallëzuesin e pjesës kryesore, por me një gjymtyrë emërore a përemërore të fjalisë së nënrenditur. Kështu, pjesa e nënrenditur e fjalisë së mësipërme, lidhet me gjymtyrën emërore **vajza** duke dhënë informacion shtesë rreth saj.

Si mjete lidhëse për këto fjali mund të shërbejnë përemrat lidhorë **që, i cili/e cila**, ku këta të fundit mund të shoqërohen ose jo me parafjalë:

▣ Ato mjete qarkullimi, **të cilave** nuk u është bërë kontrolli teknik, duhen bllokuar.

Përemri lidhor përshtatet në gjini dhe në numër me gjymtyrën që përcakton, por vendoset në atë rasë që e kërkon folja e pjesës së nënrenditur. Kështu, ndonëse gjymtyra e përcaktuar është në rasën emërore **ato mjete**, përemri lidhor del në rasën dhanore **të cilave**.

Përemri lidhor **i cili**, ndryshe nga përemri lidhor **që**, mund të shoqërohet me parafjalë:

▣ Më pëlqejnë njerëzit **me të cilët** shoqërohesh.

Si mjete lidhëse mund të shërbejnë edhe ndajfoljet lidhore: **ku, nga**.

▣ U rrethua i gjithë vendi **ku** ndodhi ngjarja.

Rimarrja e gjymtyrës emërore të një fjalie përcaktore mund të dalë edhe e tillë:

▣ Burri, kapela e të cilit ra në tokë, donte të largohej.

Pjesa e nënrenditur përcaktore ndjek gjithnjë gjymtyrën e pjesës kryesore me të cilën është e lidhur, ndaj pozicioni i kësaj pjese është në mes, ose pas pjesës drejtuese, por jo në krye të saj.

Llojet e fjalive përcaktore

Lidhja që vendoset mes pjesës së nënrenditur përcaktore dhe gjymtyrës emërore a përemërore që ajo përcakton, nuk është gjithnjë e njëjtë. Në disa raste, pjesa e nënrenditur përcaktore ka lidhje të ngushtë me këtë gjymtyrë dhe shërben për të sqaruar kuptimin e saj. Në këtë rast, kemi të bëjmë me fjali përcaktore kufizuese: *Fjala që thuhet me rrëmbim, nuk kthehet më mbrapsht.*

Në fjalinë e mësipërme dallojmë pjesën e nënrenditur përcaktore **që thuhet me rrëmbim**. Duke qenë se emri **fjalë** është një emër i përgjithshëm, kjo pjesë e nënrenditur përcaktore shërben për të kufizuar një lloj të caktuar fjale **atë që del me rrëmbim**, prandaj kjo pjesë luan rolin e fjalisë përcaktore kufizuese.

Në disa raste, gjymtyra emërore nuk e ka të nevojshme të ndiqet nga një fjali që përcakton kuptimin e saj, por mund të ndodhë që rreth kësaj gjymtyre të jepet një informacion shtesë, jo i domosdoshëm. Kjo pjesë fjalie quhet fjali **përcaktore shtuese**: *Lumi Vjosë, i cili është një ndër lumenjtë më të bukur të Ballkanit, duhet ruajtur i paprekur.*

Në këtë fjali, pjesa e nënrenditur përcaktore është shtuese, pasi jep një informacion shtesë dhe jo të domosdoshëm për kuptimin e gjymtyrës që përcakton **lumi Vjosë**. Pjesa e nënrenditur përcaktore shtuese, zakonisht, lidhet me pjesën kryesore me anë të përemrit lidhorë **i cili/e cila**, ndërsa ajo kufizuese me anë të përemrit lidhor **që**.


Disa modele fjalish për paraqitjen skematike të strukturës së fjalive të përbëra me nënrenditje përcaktore

Disa skema fjalish të përbëra me pjesë të varur përcaktore

Duke ndjekur modelin e sjellë në mësimet e mëparshme, po paraqesim me anë të skemave strukturën e fjalive përcaktore, duke i parë ato të gërshetuara edhe me lloje të tjera fjalish.


Nga vjen treni që ndaloj në stacion?

[nga vjen treni] → [që ndaloj në stacion]
pj. kryesore pj. e nënrenditur




A vjen nga Durrësi treni që ndaloj në stacionin që u hap së fundi?

[A vjen nga Durrësi treni] → [që ndaloj në stacionin] → [që u hap së fundi]
pj. kryesore pj. e nënrenditur pj. e nënrenditur



Skemë fjalie me pjesë të varur përcaktore

Hante gjithçka që ishte e shijshme dhe që tretej lehtë.
 [hante gjithçka] → [(që ishte e shijshme) dhe (që tretej lehtë)]
 pj. kryesore pj. e nënrenditur + pj. e nënrenditur



USHTRIME

1 Dalloni fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore dhe mjetet e tyre lidhëse.

Gjithë udhës nga ikte, dukeshin gjurmët e hënës së plagosur. Ja kjo ishte vërtet një ëndërr që ia vlente barra qiranë të merreshe me të. Ishte vërtet një ëndërr serioze, me të cilën kishe qejf të merreshe. Ebu Qerimi mendoi se, sidoqoftë, puna e interpretuesve, pavarësisht se ishte tepër e vështirë dhe delikate, ishte e këndshme, sidomos kur kishe të bëje me ëndrra të tilla. Atij vetë, megjithëse i lodhur, i lindi dëshira të interpretonte ëndrrën. Madje kjo gjë s'iu duk aspak e zorshme, pasi kuptohej që macja e zezë ishte një forcë armiqësore që vepronte kundër tyre. Një ëndërr e tillë i ka të gjitha shanset për t'u shpallur kryeëndërr, mendoi Ebu Qerimi.

2 Ndërtoni nga një fjali të përbërë përcaktore duke përdorur si mjete lidhëse:

që _____
 prej të cilës _____
 me të cilin _____
 ku _____
 e cila _____

3 Për secilën nga fjalitë e mësipërme, ndërtoni skemën përkatëse.

4 Në secilën nga fjalitë e mëposhtme, përcaktoni funksionin e fjalës që dhe llojin e fjalisë në të cilën përdoret.

- ▣ Më lëndoi kjo fjalë që the.
- ▣ Dihet që këtu ka shumë vështirësi.
- ▣ Nuk është dëgjuar më parë që një robot të marrë shtetësinë e një vendi.
- ▣ Duhet të punosh shumë që t'ia dalësh mbanë.
- ▣ Erdhën që të dy me vonesë.

5 Dalloni dhe analizoni fjalitë e përbëra si dhe mjetet e tyre lidhëse.

Që në orën dy të natës më zgjonte një mërmërimë e mbytur, si të dilte nga ropullitë e dheut. Ishin njerëzit që zinin radhë poshtë, në dyqanin e qumështit. Ata flisnin, diskutonin, grindeshin, sidomos kur mbërrinte shitësja e qumështit. Ky që çasti kulmor i grindjeve për të mos lejuar prishjen e radhës nga hileqarët. Këtyre u ishte treguar vendi sepse njerëzit shtrëngoheshin pas njëri-tjetrit, secili kishte të drejtë të merrte dy litra dhe, nëse arrinte t'i merrte, largohej i kënaqur për të ardhur të nesërmen.

6 Hartoni një tekst me temë të lirë dhe dalloni aty të gjitha fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore. Nënvizoni mjetet lidhëse.

Referenca

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, 1997.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, 1997.
- Bahri Beci, *Për një konceptim bashkëkohor të mësimit të gjuhës amtare në shkollë, Gjuha jonë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Chaney, T. Burk, *Teaching Oral Communication in grades K-8*, 1998.
- D. Foenkinos, *Sharlota, Pegi*, Tiranë 2017.
- Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, 1997.
- Ismail Kadare, *Ftesë në studio*, Tiranë 1990.
- IGJL, Tiranë 1993.
- J. K. Rowling, *Harry Potter dhe dhoma e të fshehtave*, Dituria, Tiranë 2012.
- Justin Godart, *Ditarët shqiptarë: shënimet e udhëtimeve nga marsi 1921 deri në dhjetor 1951*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2008.
- K. Grillo, *Fjalor edukimi*, Tiranë 2002.
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës e rishikuar, Prishtinë 2016.
- Kurrikula bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës, Prishtinë 2016.
- Kurrikula lëndore/programi mësimor për lëndën *Gjuhë shqipe 9*.
- Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë 2009.
- Mimoza Gjokutaj, Dr. Nj. Kazazi, *Prirja e sotme për mësimin e gjuhës shqipe*, Shkodër 2003.
- Mimoza Gjokutaj, N. Mërkuri, *Modele të suksesshme mësimdhënieje*, Tiranë 2008.
- Mimoza Gjokutaj, *Probleme të sotme të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë*, Tiranë 2001.
- M. Witcher, *Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit*, Pegi, Tiranë 2018.
- M. Camaj, *Vepra letrare 5*, Apolonia, 1996.
- Michelle Robinson Obama, *Becoming – Të bëhesh*, Shtëpia Botuese Dudaj, Tiranë 2019.
- N. Chomsky, *Aspects of the theory of Syntax*, MIT Press, Boston 1965.
- Palaj, B., Kurti, D., *Visaret e Kombit II*, Shtypshkronja Nikaj, Tiranë 1937.
- *Plani zhvillimor urban i Prishtinës 2012-2022*.
- Ragip Gjoshi, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Prizren 2017.
- Ragip Gjoshi, *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (aspekte historike dhe didaktike)*, Prishtinë 2016.
- Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, 2008.
- Standarde për tekstet shkollore, Prishtinë 2011.
- Shaban Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, 2017.
- Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007.
- W. Shekspir, *Makbethi*, shqipëroi F. Noli, Argeta - LMG, Tiranë 2001.
- Valter Longo, *Dieta e jetëgjatësisë*, Shtëpia Botuese Dudaj, Tiranë 2018.
- Xh. Lloshi: *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, 2001.
- Z. Rrahmani, *Njohuri nga teoria e letërsisë*, SHBLSH, 1996.
- Z. Rrahmani, *Njohuri nga teoria e letërsisë*, Tiranë 1996.

Burime nga interneti

- <https://www.dreamstime.com/>
- <https://www.lastampa.it>
- <https://sport.alpenews.al>
- <http://qbd.gov.al>
- <https://www.kultplus.com>
- <https://sq.wikipedia.org/>
- <https://veshjettradicionale.weebly.com>
- <https://www.arkivalajmeve.com>
- <https://www.psychologytools.com>

